



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS

DISERTACION

PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

QYTETI SOCIALIST NË SHQIPËRI **Kombinati i Tekstileve “Stalin”**

Kandidati:

MSc. Arch. Eled FAGU

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA

Prof. Ulisse TRAMONTI

Tiranë, 2021



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS**

Disertacion për fitimin e gradës shkencore “Doktor”

Paraqitur nga:
MSc. Eled FAGU

TEMA:

**QYTETI SOCIALIST NË SHQIPËRI
KOMBINATI I TEKSTILEVE STALIN**

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA
(Universiteti Politeknik i Tiranës)

Prof. Ulisse TRAMONTI
(Universita degli Studi di Firenze)

Mbrojtur në datën 21.12. 2021 para Jurisë të përbërë nga:

- | | |
|-----------------------------------------|-----------------------|
| 1. Prof. Dr. Andrea MALIQARI | Kryetar |
| 2. Prof. Dr. Armand VOKSHI | Anëtar/Oponent |
| 3. Prof. Dr. Akli FUNDO | Anëtar |
| 4. Prof. Dr. Pirro THOMO | Anëtar |
| 5. Prof. Asoc. Arta BASHA JAKUPI | Anëtar/Oponent |

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT

Përmbajtja e këtij punimi është krejtësisht autentike.

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të evidentuara nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam i vetëdijshëm se në rast të mospërputhjes, Senati i UPT-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktorate) në UPT “

Kandidati:

Eled FAGU

Datë: 21.12.2021

ABSTRAKT

Ky studim trajton zhvillimet në lidhje me arkitekturën dhe urbanistikën në Shqipëri, pas vendosjes së regjimit totalitar komunist, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Politikat ndërtimore të kësaj periudhe, ndër të tjera lidhen ngushtë me proceset e industrializimit dhe themelimit të qyteteve të reja për këto qëllime. Analiza bazohet kryesisht në studimin e transformimeve në qytetin e Tiranës, si kryeqendër e zhvillimeve politiko-kulturore në vend, me një fokus të veçantë në qytetin industrial të Kombinatit të Tekstileve, si rasti i parë i aplikimit ad-hok të ideologjisë komuniste në territorin shqiptar. Nën një atmosferë politike ekstremisht të radikalizuar, pasojë e historisë së afërt dhe të largët të popullit shqiptar, zhvillimet me arkitekturën nuk mund të shihen si të ndara, por thellësisht të influencuara prej filozofisë së përgjithshme e cila konsistoi në përmbysjen e klasave dhe shkëputjen nga e kaluara. Njëpërmyjet shembujve të reja të ndërtimit, regjimi përveç shfaqjes së dominancës mbi territor, kërkoi të implementonte një mënyrë të re jetese dhe një shoqëri të organizuar prej punës në industri. Por, teksa fillimet e këtij procesi u karakterizuan prej një optimizmi për ngritjen e një identiteti të ri kolektiv, i cili kryesisht u bazua mbi huazime ekonomike dhe kulturore prej vendeve më të zhvilluara të frontit lindor siç ishte ish-BS, zhvillimet e mëvonshme paraqesin një panoramë tejet të ndryshme. Shpejt objektivat modernizuese i lanë vendin një klime tensioni dhe terrori të cilat u pasqyruan edhe në zhvillimet arkitekturore të kësaj periudhe. Prestacionet e munguara u zëvendësuan prej një shfaqje propagandistike nacional-socialiste me tendencë të theksuara izolacioniste, sjellje kjo që dominoi skenën e përgjithshme kulturore duke siguruar vazhdimësinë e sistemit deri në vitet '90. Njëpërmyjet studimit krahasimor të arkitekturës dhe urbanistikës së periudhës së parë të regjimit që trajtohen në këtë tekst, shfaqen të qarta politikat dhe mjetet me të cilat vepruan sistemet totalitare në Shqipëri, duke nxjerrë në pah rëndësinë historike dhe dokumentuese të prodhimit ndërtimor të kësaj periudhe. Arkitektura në këtë rast, shfaqet si një libër i hapur ku brenda përmbajtjes materiale mund të lexohen e tregohen qartë objektivat dhe mesazhet politike që karakterizojnë zhvillimet në një periudhë historike të errët e të pazbuluar ende në ditët e sotme. Nga ana tjetër, qytetet e themeluara apo të zhvilluara gjatë periudhës së industrializimit socialist, me transformimet post-socialiste, kanë humbur rolin e tyre të dikurshëm, ndërkohë që vijojnë të egzistojnë si pjesë domethënëse e territorit të urbanizuar duke influencuar ndjeshëm në përcaktimin e cilësisë së jetës së banorëve të tyre. Disa prej tyre po përballen me zhvillimet e rritjes kaotike, teksa të tjerë po rrudhen dhe po zhduken gradualisht duke u bërë faktor degradimi mjedisor dhe social. Sot, teksa periudha e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut po shfaq rezultatet e saj, ndërsa Shqipëria dhe rajoni i Ballkanit Perëndimor ndjekin politikat integruese drejt BE, bëhet emergjent rikonceptimi dhe rikonfigurimi i kësaj trashëgimie të diskutueshme, përtej politikës së vjetër diferencuese dhe drejt rikrijimit të një identiteti të ri urban, i cili nuk mund të jetë shumë më i ndryshëm apo krejt i shkëputur nga ai i mëparshmi, por duke e rikonceptuar utopinë e dikurshme, në funksion të kuptimit dhe evidentimit të një të ardhmje distopike, më racionale dhe ekologjike.

Fjalë kyçe: qyteti socialist në Shqipëri, urbanizmi totalitar, realizmi socialist, komunitet mono-industrial, qyteti post-socialist në Shqipëri, integrimi europian.

ABSTRACT

This study deals with the architecture and urban planning developments in Albania, during the establishment of the totalitarian communist regime, right after the Second World War. The construction policies of this period, among others, are closely related to the processes of industrialization and the founding of new cities for such purposes. The analysis is mainly based on the study of transformations in the city of Tirana, as the main center of political and cultural developments in the country, with a special focus on the industrial city of the Textile Factory, as the first case of an ad-hoc application of communist ideology in the Albanian territory. Under an extremely radicalized political atmosphere, a consequence of the recent and distant history of the Albanian people, the developments in architecture can not be seen as separate, but deeply influenced by the general philosophy which consisted of the overthrow of the classes and the dissociation from the past. Through new examples of construction, the regime in addition to the emergence of dominance over the territory, sought to implement a new way of life and a society organized by work in industry. But, while the beginnings of this process were characterized by an optimism for the establishment of a new collective identity, which was mainly based on economic and cultural borrowings from the most developed countries of the eastern front such as the USSR, the later developments present a very different picture. The modernizing objectives soon gave way to a climate of tension and terror which were also reflected in the architectural implementations of this period. The poor performance was soon replaced by a national socialist propaganda show, with strong isolationist tendencies that dominated the overall cultural scene, ensuring the continuity of the system until the 1990s. Through comparative studies of architecture and urban planning of the first period of the regime which is addressed in this text, the policies and means with which the totalitarian systems operated in Albania are clearly shown, highlighting the documented historical importance of the built production of this period. Architecture, in this case, appears as an open book in which not only can we read the material content but it also clearly shows the objectives and political messages that characterize the developments of a dark era, still not fully discovered to this day. On the other hand, cities founded or developed during the period of socialist industrialization, with post-socialist transformations, have lost their former role, while continuing to exist as an important part of urbanized territory significantly influencing the definition of the quality of life of their inhabitants. Some of them are facing the developments of chaotic growth, while others are shrinking and gradually disappearing, thus becoming a factor of environmental and social degradation. Today, as the period of transition toward a market economy is showing its results, as Albania and the Western Balkans region pursue integration policies towards the EU, it becomes urgent to reconceptualize and reconfigure this controversial heritage, beyond the old differentiating politics towards integration of a new urban identity, which can not be much different nor completely detached from the previous one, but by recontextualizing the former utopia, it could be useful to better understand and highlight a dystopian, more rational and ecological future.

Keywords: socialist city in Albania, totalitarian urbanism, socialist realism, mono-industrial community, post-socialist city in Albania, European integration.

PËRMBAJTJA

<i>ABSTRAKT</i>	1
<i>1. HYRJE</i>	8
1.1. Qëllimi i temës	10
1.2. Pyetjet kërkimore	12
1.3. Përkufizime	13
1.4. Kufinj të dhe limitet	16
1.5. Metodatat e përdorura	19
<i>2. SFONDI HISTORIK I ARKITEKTURËS SHQIPTARE (1912 – 1944)</i>	23
2.1. Arkitektura tradicionale shqiptare	23
2.2. Arkitektura e qyteteve kryesore në fillim të shekullit XX'	26
2.3. Arkitektura gjatë periudhës së protektoratit italian	31
2.4. Arkitektura dhe urbanistika gjatë periudhës së pushtimit fashist	35
<i>3. QYTETI I RI SOCIALIST DHE APLIKIMI I TIJ NË SHQIPËRI</i>	42
3.1. Ngjashmëri dhe ndryshime midis qyteteve të reja socialiste dhe atyre kapitaliste.	43
3.2. Evolucioni i konceptit urban tek qytetet e reja socialiste.	46
3.3. Analiza teorike mbi modelin e qytetit socialist	53
3.4. Proçesi i industrializimit në ekonominë e planifikuar në Shqipëri.	55
3.5. Kultura urbane Sovietike dhe raportimi me kontekstin Shqiptar në fillim të viteve 50'	59
3.6. Planifikimi i qendrave të banimit - influenca në shoqëri dhe pejsazhin urban.	68
3.7. Industrializimi dhe shoqëria	75
3.8. Shtëpitë dhe Pallatet e Kulturës.	77
3.9. Njesite e Projektimit në Shqipëri e viteve 50-60'	86
<i>4. KOMBINATI I TEKSTILEVE NË TIRANË</i>	95
4.1. Pozicionimi dhe raporti me kontekstin.	96
4.2. Struktura Urbane	98
4.3. Manifestime të ideologjisë dhe propagandës nëpërmjet arkitekturës	103
4.4. Zona e banimit	109
4.5. Zona industriale	117
<i>5. SFIDAT DHE PROBLEMATIKAT KRYESORE TË ISH-QYTETEVE SOCIALISTE</i>	124
5.1. Ndërlkime në përcaktimin e qytetit socialist	125
5.2. Funkzioni dhe roli përfaqësues në arkitekturën e qytetit socialist	128
5.3. Sheshet e qytetit socialist	129
5.4. Fabrikat dhe impiantet industriale	131
5.5. Banesat dhe zonat e banimit.	133
<i>6. TRANSFORMIMET POST-SOCIALISTE TË QYTETEVE</i>	137
6.1. Fenomene tranzitore në arkitekturën post-socialiste	138
6.2. Inkongruenca ndërmjet transformimeve urbane dhe institucioneve vendimarrëse.	140
6.3. Problematikat e organizimit hapësinor dhe social në qytetin post-socialist.	142
6.3. Ruajtja historike dhe konfrontimi me të kaluarën	152
6.5. Integrimi European	158
<i>7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME</i>	166
<i>REFERENCES</i>	174

1. HYRJE

Studimet shkencore mbi arkitekturë dhe urbanistikën e periudhes së socializmit në Shqipëri mund të konsiderohen si një fushë e zhvilluar relativisht rishtazi krahasuar me vendet e tjera Europiane e në rajon. Procesi frenetik i urbanizimit që ka karakterizuar tre dekadat e fundit të ndërtimit në Shqipëri, ka evidentuar në mënyre kostante një qasje neglizhuese ndaj rëndësisë së hulumtimit dhe kërkimit shkencor mbi ambientin urban egzistues. Veçanërisht, periudha e socializmit, e cila risjell në vëmendje një të kaluar jo shumë të largët dhe të hidhur, për shkak të mpleksjes së prodhimit arkitekturor dhe urbanistik me ideologjinë totalitare, ka vështirësuar akoma më tepër procesin e studimit të kësaj fushe. Ndërkohë sot, pas shume vitesh tranzicion, ndodhemi përpara një fakti të dukshëm edhe në qytetet e tjera Europiane e jo vetëm, ku urbanizimi i gjërë i periudhës së socializmit ende përmbën një pjesë të rëndësishme të pëlhures urbane dhe shpesh, siç ndodh në rastin e Tiranës, qytetet janë rritur rreth nuklit urban të periudhës së socializmit duke ndezur automatikisht procesin e historifikimit. Ndërkohë që përfshirja e ideologjisë në arkitekturë shkakton një lloj kontroversialiteti i cili tenton të dyhzojë perceptimin, qytetet të çfarëdo tipi- lindja dhe zhvillimi i tyre, përbëjnë një lloj libri të hapur të momenteve epokale për shoqërinë të cilat ngurtësohen brenda materies inerte në një mënyrë të përpë realiste. Në këto kushte, njohja dhe analizimi i qyteteve socialiste me qellim përcaktimin e tipareve dhe raportin me politikën e kohës dhe kushtet e shoqërisë, përbën një nevojë të pashmangshme dhe emergjente për konsolidimin e mendimit profesional të fushës, duke e orjentuar atë drejt një statusi më objektiv dhe të bazuar mbi metoda shkencore.

Pikërisht për këtë rol kaq të vecantë që luajnë qytetet në jetën dhe identifikimin historik të shoqërisë, politika dhe udhëheqësit e saj në një mënyrë apo në një tjetër janë munduar të identifikohen me dhe të lenë gjurmë në ndërtimin e tyre. “Hedhja e themeleve të Shqipërisë së re” ishte një nga librat e Enver Hoxhës mbi historinë e krijimit dhe të zhvillimit të ardhshëm të Partisë Komuniste Shqiptare në vitet e udhëheqjes së tij, nga viti 1941 deri në vitin 1980. Ai e përdori fjalën “themelim” kur iu referua krijimit të Partisë, duke nënkuptuar nevojën që themelet e Partisë të ishin po aq të forta sa ato të një ndërtese që i kishte rezistuar kohërave. Themelet ishin një pjesë e rëndësishme e retorikës ideologjike komuniste në Shqipëri. Duke iu referuar traditave vendase dhe legjendave të vjetra që bënin thirrje për pastrim dhe sakrificë sublime, ato duhej të rrënjoseshin shumë thellë në tokë, njësoj si ndërtesa për të qenë e “pavdekshme” (Hoxha, 1984; 6), siç shkroi Hoxha në vitet e fundit të jetës së tij. Ai zakonisht e përshkruante Shqipërinë socialiste si një “kështjellë të pathyeshme të socializmit triumfues” dhe sipas tij, “nderi dhe lavdia e shqiptarëve do të rriten lart e më lart në të ardhmen, nga gjaku i 28.000¹ e bijve dhe bijave më të mirë të kësaj toke është derdhur në themelet e tyre, sepse ato janë vendosur, ngritur dhe çimentuar me djersë, me përpjekje dhe sakrifica të panumërta nga populli ynë dhe Partia jonë” (Hoxha, 1984; 6). Një varg krahasimesh populiste nëpërmjet termash që burojnë prej një leksiku të përdorur në fjalorin e ndërtimit. Pas një periudhe të gjatë pushtimesh e shkatërrimi, me vendosjen e regjimit popullor i gjithë territori i Shqipërisë u konceptua si vënd ndërtimi shpesh duke ju kundërvënë edhe natyres e ekosistemit siç ishte rasti i ndërtimeve të industrive të mëdha e qyteteve pranë tyre si ishte rasti i Kombinatit metalurgjik në Elbasan, industria për

¹ I referohet humbjeve njerëzore nga forcat partizane gjate L.L.B (shënim autori).

rrafinimin e naftes në Ballsh, etj. Sidoqoftë, në afro pesëdhjetë vjet të komunizmit, planet për ndërtimin dhe industrializimin e vendit kanë ndryshuar në vazhdimësi si përsa i përket destinacionit po ashtu edhe dezajnin ndërsa sakrificat, ashtu si në legjendat e vjetra shqiptare, kërkoheshin tani jo vetëm nga njerëzit që mbështetin komunizmin por kryesisht nga ata që e kundërshtonin atë. Ashtu siç shkruan M.Velo "arkitektura socialiste ishte çimentuar me gjakun e të burgosurve politikë" (Velo, 2013; 140). Ashtu siç ndodhi vite më parë në Bashkimin Sovietik gjatë fillimeve të regjimit stalinist dhe politikave "anti-kulak", edhe në Shqipërinë socialiste një pjesë e mire e ndërtimeve të asaj periudhe ngurosin brenda materies së tyre punën e detyruar të "armiqve të popullit" të cilët siç tregon historia e mëvonëshme ishin veç armiq të sistemit dhe kastës drejtuese.

Arkitektura socialiste në Shqipëri u bazua në të njëjtin kontekst ideologjik që frymëzoi edhe arkitekturën në vendet e tjera komuniste në botë, por zhvilloi edhe disa veçanti që tregojnë një kurs të vetin i cili do të eksplorohej më tutje në këtë tezë. Fokusi kryesor i këtij studimi është periudha 1948-1956 e cila korrespondon me venien dhe avancimin e raporteve strategjike me BS dhe vënien në zbatimin të ashtuquajturës arkitekturë të "stilit stalinist" në Shqipëri, duke ju referuar veprës më domethënëse që ishte Kombinati i Tekstileve Stalin në Tiranë. Kjo periudhë përkon edhe me instalimin e regjimit të planifikimit ekonomik të stilit Sovietik dhe vënien në zbatimin të Planit të Parë Pesëvjeçar duke u fokusuar kryesisht në aplikimet në fushën e ndërtimit. Duke qënë se qëllimi i planit të madh ishte industrializimi i vendit është e kuptueshme që investimet kryesore mbuluan sektorin ndërtimor industrial dhe qytetet e reja që lidheshin me këtë sektor zhvillimi.

Interesi kryesor kërkimor për këtë temë qëndron në zbardhjen dhe analizimin e disa faktorëve urban dhe arkitektonik të cilat hedhin dritë mbi aplikimin e stilit monumental të realizmit socialist në Shqipëri nëpërmjet rastit më të arritur që është ish-Kombinati i Tekstileve në Tiranë si dhe disa vepra të tjera domethënëse që do të shërbejnë si shëmbuj mbështetës. Gjithashtu me interes dhe e ndërlidhur shfaqet hulumtimi mbi influencën që pati urbanistika dhe arkitektura e realizmit socialist në ngritjen e shoqërisë së re socialiste si dhe në krijimin e përditshmerisë në kontekstet ku është aplikuar. I ashtuquajtur "stil i realizmit socialist" për atë që nënkupton ky term për kritikën perëndimore, nga pikepamja e përmbajtjes u refuzua edhe në Shqipëri pas vitit 1955 për të njëjtat shkaqe për të cilat u refuzua nga i gjithë fronti socialist pas vdekjes së Stalinit. Ndërkohë që emertimi vazhdon të egzistojë si i vetmi klasifikim artistik zyrtar i sistemit edhe pse nga përmbajtja u rikonceptua tërësisht. Njëjtë si me figurën e vetë ideatorit Stalin, e cila vazhdoi të njihet si modeli kryesor i liderit deri në ditët e fundit të regjimit komunist. Në Shqipëri pra ka egzistuar një lloj konservatorizmi sipërfaqësor i cili gjen fushën e aplikimit jo tek produkti në këtë rast artistik, por tek përmbajtja ideologjike dhe mesazhi politik i cili në vija të përgjithshme mbetet i pandryshuar përgjatë gjithë sistemit totalitar komunist. Kjo tezë tenton të shohë arkitekturën si një libër të hapur ku arkivohen ide, koncepte, ideologji të kohës kur janë ndërtuar, duke i paraqitur ato në një mënyrë të qartë e të dallueshme po aq edhe sa vetë fjala. Pra, studimi i arkitekturës si një metodë për të njohur historinë shoqërore e politike në një konteksti konkret e ngren disiplinën në një shkallë tjetër interesi e cila tejkalon perceptimin e saj vetëm shqisor. Për shembull për estetistin Boris Groys, arkitektura e realizmit socialist është njëkohësisht monotone dhe tërheqëse. "Vazhdimisht ofron të njëjtin imazh të përpjekjeve kolektive, të njëjtën ekstazë sociale, të njëjtin paradoks të brendshëm dhe të njëjtin dështim individual. Ky tension i brendshëm e manifeston vetveten në një ripërsëritje obsesive, dhe pikërisht

përmes këtyre përsëritjeve shquhet edhe nga vëzhguesi i jashtëm” (Dobrenko, Naiman, 2003; 117). Për Anatole Kopp “kolonadat ekstravagande të viteve 1935 - 1955 nuk përfaqësonin asgjë të re” (Kopp, 1987; 28). Ky është edhe këndvështrimi i shumë arkitektëve në Shqipëri të cilët kanë kritikuar ndërtimet e klasiqizmit socialist për eksces dekorativ dhe papërshtatshmëri kontekstuale. Për këtë, Ata që kanë punuar në atë periudhë, janë kritikuar si gjatë ashtu edhe pas rënies së regjimit socialist, edhe pse shpesh vetëm për arsye ideologjike. Groys më tej shkruan se “ndërtimet në epokën Staliniste kuptohen vetëm brenda kontekstit ideologjik të asaj kohe. Arkitektët e asaj periudhë ndërtonin gjithmonë të njëjtat ndërtesa – ndërtesa të ideologjisë Staliniste, në të cilat çdo gjë ose duhej të gjente vendin e vet ose përndryshe duhej shkatërruar – pavarësisht nga pozicioni gjeografik apo funksionaliteti i objektit” (E. A. Dobrenko, Eric Naiman, 2003; 117). Në Shqipëri, ndërtesa të ngjashme filluan të kritikohen vetëm pas 1966 pas prishjes së marrdhënieve me Bashkimin Sovjetik kur kritika zyrtare përfshi të gjitha ndërtesat me projekt me inspirim sovjetik, përfshi ato të periudhës hrushoviane, duke i konsideruar të gjitha si ‘shfaqje të huaj’.

Edhe pse kjo temë ka në fokus analizën e impaktit të arkitekturës së realizmit socialist në Shqipëri-quajtur ndryshe edhe arkitekturë Staliniste, është i pashmangshëm studimi gjithashtu i ideologjisë totalitariste që inspiroi këtë stil të vonuar, efekti i saj propagandistik mbi popullsinë e varfë të asaj kohe, gjithashtu raporti i projektuesit me politiken dhe përdorimi i ambientit urban si skenë e gjallë për propagandën shtetërore. Ashtu siç përshkruhet nga një autor postsocialist: “ideologjia dhe urbanistika kanë qenë ngushtësisht të lidhura edhe në qytetin apo fshatin më të vogël. Pejsazhi të cilin shohim sot është rezultat i ideologjive të së tashmes të mbivendosura në indin urban të së shkuarës, më tej modifikuar nga kulturat, ekonomia dhe shoqëria. Kjo tendencë shfaqet në çdo system, por bëhet jashtëzakonisht e dukshme në sistemet totalitare dhe regjimet jo-demokratike” (Czepczynski, 2008; 59). Këto çështje dhe të tjera që ndërlidhen me këto, përbëjnë një përcaktim relativisht të zbehtë të kufinjve të studimit i cili sot shfaqet tejet i domosdoshëm në kushtet e një heshtje të tejzgjatur mbi faktet dhe produktet e një prej periudhave më të errëta por edhe njëkohësisht me impaktin më të madh në territorin e ndërtuar.

1.1. Qëllimi i temës

Qëllimi kryesor i këtij studimi është zbardhjen dhe analizimin e disa faktorëve urban dhe arkitektonik të cilat hedhin drite mbi aplikimin e ideologjise komuniste nëpërmjet stilit zyrëtar të realizmit socialist në Shqipëri. Nëpërmjet analizimit të një prej shëmbujve më të arritur siç është ish-Kombinati i Tekstileve Stalin tentohet të ngrihet një metodë hulumtimi mbi tipologjinë e qytetit socialist duke i kushtuar një vëmendje të veçantë transformimeve post-socialiste apo të periudhës së tranzicionit me qëllim zhvillimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme me ambientin dhe shoqërinë. Siç kam shpjeguar më lart, kjo periudhë kohore korrespondon edhe me zbatimin e arkitekturës staliniste në Shqipëri e cila ka lënë edhe sot gjurmët e saj në pejsazhin urban dhe organizimin social të qyteteve të reja të themeluara. Përveç ish-Kombinatit të Tekstileve Stalin, në Shqipëri brënda periudhës studimore të kësaj teze 1948-1956, u krijuan edhe disa qytete të tjera si implementim i politikave të industrializimit. Këtu mund të përmendim Kuçovën - qytetin e naftës, i themeluar para lufte sipas një projekti Italo-Shqiptar; qyteti i përpunimit të naftës në Cerrik të Elbasanit; qyteti mineral i Memaliajt; qyteti i sheqerit dhe industrisë ushqimore në Maliq ndërtuar me projekt sovjetik, paralelisht me Kombinatin e Tekstileve. Kjo periudhë kohë korrespondon edhe me zbatimin e Planit të Parë Pesëvjeçar, i cili pati si qëllim

kryesor transformimin e Shqipërisë në një vend industrial me ndihmën financiare të Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit në veçanti. Çështjet lidhur me themelet e qyteteve industriale dhe transformimet e vazhdueshme do të paraqiten këtu duke iu referuar aspekteve të tyre urbane dhe arkitektonike duke përfshirë çështje të planifikimit hapësinor, urbanistikës dhe arkitekturës me fokus në përjetimin e hapësirës publike, gjuhës arkitektonike nëpërmjet së cilës kryhej propaganda zyrtare, dukë tentuar të ndiqet një këndvështrim i lidhur me shoqërinë dhe individin.

Në këtë studim i qëndrohet pikëpamjes se egziston një vazhdimësi historike e caktuar e cila bëri të mundur instalimin e sistemit totalitar komunist. Në këtë kuptim bëhet i nevojshëm një studim më i gjërë historik i cili përpiqet të hedhi dritë mbi konditat kontekstuale të krijuara në historinë e afërt. Një pjesë e këtij studimi është ndërtuar në konfrontimin e dialektikave midis ideologjive totalitare dhe stileve arkitektonike në periudhën e ndikimit të fashizmit italian (1914-1944) dhe periudhën e Paktit të Varshavës si dhe marrëdhëniet me sovjetikët (1949-1964). Kjo mënyrë përafrimi historike do të ndihmojë në nxjerrjen e disa “rregullave”, të cilat në aspektin ideologjik dhe përdorimit të arkitekturës për propagandë shtetërore, tregojnë më tepër për vazhdimësi sesa për revolucion dhe shpëtim. Ndërsa për sa i përket performancës arkitektonike-kulturore, bëhet fjalë për një rikthim drejt një lloj populizmi klasiçist i cili spostoi ekselencën vite mbrapa në kohë.

Më tepër se në të kaluarën, në mund të gjejmë në të ardhmen e këtyre qyteteve arsytet dhe qëllimet kryesore pse është e rëndësishme ti studjojmë ato. Pas rënies së sistemit socialist, transformimi i tyre manifeston transformime të mëdha për shkak të riorientimit të flukseve ekonomike. Disa prej tyre po ndeshin një rrije dhe zgjerim kaotik, ndërsa të tjerët po rrudhen ngadalë dhe rrezikojnë të zhduken duke lënë pas thjesht kujtimin e një revolucioni në tentativë. Duke ecur me vazhdimësi dhe ndërprerje, këto qytete kanë nevojë për një të ardhme të re që duhet të shkrijë të kaluarën e tyre në të tashmen, duke lënë prapa politikën e vjetër dhe t'i shohë ato si një resurs historik eksperimentimi për vetë karakteristikat e veçanta që përmbajnë ato brenda pejsazhit urban globalist. Gjithashtu vlen të theksohet se kjo është një periudhë pak e studjuar në Shqipëri. Siç shkruan arkitekti M.Velo “periudha nga 1945 -1990 është një periudhë jo shumë e studjuar në Shqipëri dhe kjo sepse është akoma shumë e afërt për në dhe janë evident interesat e projekteve të ndryshme që janë punuar në atë periudhë” (Velo, 2013; 128). Interesi i studimit të kësaj periudhe qëndron së pari sepse, ajo përfaqëson momentin e parë të shpresave të shoqërisë komuniste për të transformuar jetën e përditshme nëpërmjet industrializimit, në mënyrë të ngjashme me si ndodhi me vendet e tjera ish komuniste por jo vetëm. Së dyti, pavarësisht problematikave që do të cekën në vijim, qytetet që u krijuan gjatë kësaj periudhe i kanë mbijetuar ndryshimeve të regjimeve nga pikëpamja fizike duke treguar një shkallë përshtatshmërie edhe pse në një pjesë të tyre numri i banorëve është zvogëluar konsiderueshëm. Përveç arsyeve që lidhen me politikën ekonomike nacionale, është gjithashtu e vërtetë se disa nga rrënjët e problemeve të tyre sot mund të gjenden në arsytet ideologjike të themelimit të tyre.

Supozimi i parë i marksistëve ishte se ndryshimi i marrëdhënies me prodhimin në qytete do të ndryshonte gjithashtu mënyrën e jetës së qytetarëve, ndërjegjen dhe mentalitetin e tyre. Siç e përshkruan këtë Anatole Kopp “kjo jetë e re nënkuptonte shpëtim nga traditat e vjetra dhe ndarje e të jetuarit nga shërbimet; në mënyrë që të krijojë një mjedis fizik ku aktivitetet sociale dhe kolektive do të kenë përparësi ndaj individëve, duke i liruar gratë nga punët e shtëpisë, jo vetëm me fjalë, por me fakte”

(Kopp, 1987; 28). Ndërkohë që Aldo Rossi shkruan: “Në varësi të opinionit të njerëzve, arkitektura mund të jetë e dobishme ose e panevojshme, e bukur apo e shëmtuar, e gjerë ose e ngushtë, moderne ose arkaike. Qëllimi estetik dhe krijimi i ambientit rrethues më të mirë për jetën, janë dy karakteristikat e përhershme të arkitekturës” (Rossi, 1982; 21). Shumica e pikëpamjeve të shprehura në këtë tezë i përkasin thjesht mendimeve të profesionistëve, arkitektëve, studiuesve, të cilët përgjithësisht pajtohen se në termat arkitektonikë, arkitektura e periudhës së Stalinit nuk solli asgjë të re. Megjithatë kjo tezë mbështet edhe një mendim tjetër, se me themelimin e këtyre qyteteve u arrit progres, dhe jeta e përditshme e njerëzve u përmirësua e deri diku u modernizua, duke krijuar kushtet për ndezjen e memorjes urbane dhe duke lidhur kontekstin me shoqërinë, edhe pse shpesh në një mënyrë të urryer dhe makthsjellëse. Ëndrra qytetare e një shoqërie mirë funksionale dhe në të njëjtën kohë të një jete urbane të harmonizuar me ambientin, në fazën e parë të aplikimit të sistemit marksist penetronte mendjet dhe nxiste dëshirën e shumë njerëzve. Kjo qe një ëndërr që tërhoqi shumë mendimtarë dhe arkitektë avangard lindor e perëndimor siç ishte Ernst May, Bruno Taut, apo edhe personalitete të kapacitetit kulturor si Le Corbusier. Ata u ftuan të kontribuonin në planet e qyteteve të Bashkimit Sovjetik mes viteve 1920-1935. Pas vitit 1933, mendimi sovjetik ndërroi trajektore me vendosjen e regjimit Stalinist dhe stilit zyrtar të realizmit socialist i cili u ringrit mbi themele që kundërshtonin arritjet e dëriatëhershme të arkitekturës moderne, fakt që gjendet i pasqyruar edhe në Shqipëri. Zevi duke cituar shpjegon se mendimi sovjetik gjatë kësaj periudhë ishte se “indikacionet figurative nuk do të vendosen nga lart, por ato duhet të deduktohen nga ndjenjat e njerëzve. Nëse proletarët do të donin të jetonin si të pasur, me kolonada klasike dhe dekoracione baroku, në duhet t'i plotësojmë ato.” (Zevi, 2001; 152). Ndoshta kjo linjë mendimi mund të jetë e hasshme edhe në Shqipëri, por këtu mund të shtojmë edhe një faktor tjetër të rëndësishëm që mund të ketë ndikuar në përqafimin e arkitekturës së realizmit socialist. Në këtë rast ndjekja e modelit sovjetik dhe rekomandimeve të Stalinit, mund të kenë qënë një domosdoshmëri për liderin shqiptar Enver Hoxha, i etur për të fituar mbështetje politike dhe ekonomike. Kjo na ndihmon të kuptojmë kontekstin në të cilin u ndërtua asaj kohe i cili në vetvete na jep indikatorët për të kuptuar shkallën dhe statusin efektiv të trashëgimi kulturore që ato kanë fituar me kalimin e kohës. Rivlerësimi i trashëgimisë arkitekturore në qytetet industriale të krijuara gjatë regjimit totalitar komunist mund të shërbejë gjithashtu si një mjet efektiv për zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm në të ardhmen e tyre të afërt, duke shfrytëzuar më mire resursin real që këto konglomerate urbane mund të përmbajnë.

1.2. Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore thelbësore mbi të cilat ngrihet ky kërkim, janë si më poshtë:

- Cili ka qënë sfondi politik dhe shoqëror që ka ndikuar në formimin e qyteteve të reja socialiste?
- Cili ka qënë vizioni politik që ka udhehequr industrinë dhe metodën e urbanizimit në këtë periudhë?
- Në ç’masë këto struktura i korespondojnë ideologjisë totalitare në kontekstin lokal dhe atë global?
- Cilat janë ndryshimet që paraqet konteksti lokal dhe shkalla e integritit të elementit traditë?
- Cilat janë tiparet, karakteristikat sot që e bëjnë qytetin industrial konkurrues ndaj qytetit tradicional?

- Si u klasifikuan këto struktura nga shoqëria në histori dhe cili është status i tyre aktual?
- Cilat janë metodat për ripërdorimin dhe ripërtëritjen e trashëgimisë moderne dhe si mund të përshtaten ato në rastet konkrete?

Të gjitha këto pyetje kërkimore të ndara mund të rigrupohen, sipas gjetjeve kryesore të këtij studimi, në katër pyetje qendrore kryesore:

- Cilat ka qenë shkalla e zhvillimit me arkitekturën dhe urbanistikën dhe cili është raporti me zhvillimet e reja socialiste?
- Si u implementua arkitektura e realizmit socialist gjatë raporteve Shqipëri-BS dhe cilat ishin veçantitë lokale brenda linguazhit të përgjithshëm të stilit duke ju referuar veçanërisht arkitektures së Kombinatit të Tekstileve, por edhe pjesës tjetër të krimtarisë së kësaj periudhe?
- Si ka ndikuar tranzicioni drejt ekonomisë së tregut në formën urbane të qyteteve postsocialiste?
- A duhet dhe si mund të ruhet trashëgimia arkitektonike e qyteteve postsocialiste duke u bërë pjesë e zhvillimeve të qëndrueshme?

Pyetja e parë është e dyfishtë dhe përqendrohet në kontekstin historik të fenomenit në fjalë dhe krijon skenën për pjesën e mëvonshme empirike të hulumtimit në dy mënyra të rëndësishme: Së pari, ai lidh temën më të gjerë teorike të marrëdhënieve midis arkitekturave totalitare, konkretisht fashiste dhe socialiste me ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet tyre. Së dyti, krijon lidhje midis praktikave dhe strukturave të së shkuarës me ato të së tashmes, të lidhura me konceptimin dhe zhvillimin e arkitekturës aktuale. Pyetja e dytë përqendrohet në implementimin e arkitekturës Staliniste në Shqipëri dhe synon të japë një përshkrim të mënyrave me të cilat kjo e fundit u zbatua në qytetet e themeluara shqiptare të kësaj periudhe. Këtu fokusi kryesor është identifikimi dhe diskutimi i modeleve dhe kombinimeve të filozofive që ndikuan në projektimin e strukturave urbane përmes planeve për industrializimin dhe organizimit social komunist. Kjo çon në pyetjen përfundimtare, e cila synon të theksojë ndryshimet dhe sfidat e qyteteve ish komuniste dhe të ardhmen e tyre të qëndrueshme. Adresimi i këtyre pyetjeve do të japë kontribut të rëndësishëm mbi një çështje me rëndësi siç është arkitektura e realizmit socialist në Shqipëri, duke shërbyer njëkohësisht si një model i parë analize integrale mbi çështje që kanë të bëjnë me arkitekturën dhe urbanistikën për periudhën kur u aplikua regjimi komunist në Shqipëri.

1.3. Përkufizime

Në Shqipëri, arkitektura e periudhës Staliniste nuk është studjuar shumë madje shpeshherë as nuk është parë e ndarë nga arkitektura e socializmit realist. Këto të dyja janë parë pak a shumë si një objekt i vetëm studimi, edhe pse është kritikuar gjatë dhe pas gjithë periudhës së regjimit totalitar socialist. Në të njëjtën kohë realizmi socialist është ndarë në dy kategori të ndryshme. Shqiptarët përdorën termin ‘arkitekturë socialiste’. Sipas Maks Velos edhe Rusët nuk e përdorën termin ‘realizëm’ por vetëm ‘socialist’ (Velo, 2013; 138). Të gjithë qytetet apo ndërtesat e reja u konsideruan si prodhime të socializmit. Në këtë pjesë të tezës do të mundohem të përcaktoj konceptet kryesore të përdorura këtu si psh. ‘realizmi socialist’, ‘arkitektura Staliniste’ dhe ‘qytetet e reja socialiste’. Edhe pse të gjithë këto terma janë të ndërlidhur me njëra-tjetrën, përsëri është e rëndësishme të bëhet ky dallim pasi për të njëjtin term mund të ketë kuptime të ndryshme jo vetëm në studimet mes Lindjes dhe Perëndimit por edhe

midis studimeve arkitektonike mes Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë. Arkitektura Staliniste është një fushë e gjerë me shumë alternativa teorike dhe empirike për të ndjekur dhe boshllëqe për të mbushur. Megjithatë, pashmangshmërisht, ngritja e një projekti kohërent kërkimor do të thotë se duhen bërë disa zgjedhje të cilat lënë një numër gurësh të palëvizur dhe u japin përparësi aspekteve ose çështjeve të caktuara mbi të tjerat.

Nga pikpamja historike 'realizmi socialist' nisi zyrtarisht në të njëjtën kohë me aplikimin e stilit arkitektonik stalinist. Siç thekson Dehaan, në vitin 1934, Stalini mandatoi Realizmin Socialist si një parim estetik, duke këmbëngulur në një stil monumental në të cilin konstruktivistët Sovjetikë të Unionit të Arkitektëve natyrisht e kundërshtonin. Në vitet 1934-1935, shteti mbylli studiot e dizajnit privat, të cilat u konsideruan si 'artizanale', një formë e vjetruar dhe kapitaliste e punës [...] Tashmë, planifikuesit nuk do të ishin më përkthyes arbitrar të ideve shtetërore, po një zgjatim i imazhit vizual të shtetit, imazh i bërë njësh me punën e tyre dhe me unën e tyre profesional (Dehaan, Heather, 2013; 89). Në Kongresin e parë të arkitektëve Sovjetikë më 1937 u konfirmua Realizmi Socialist si 'metodë të arkitekturës Sovjetike' pa u munduar më tej të hidhte dritë mbi implikimet e saj profesionale. Kaganovich shpjegon se ideja ishte se "proletariati nuk kërkon më që ndërtesat të jenë thjesht të bukura. Nuk kërkon thjesht të jetojë në mënyrë komode. *Kërkon që ndërtesat e tij të jenë të mrekullueshme*. Dhe kërkon që shtëpitë, arkitektura dhe qytetet e tij të jenë më të bukura se në çdo vend tjetër të Amerikës dhe Europës." (Bown & Taylor, 1993; 99). Arkitektët e Moskës e quajtën arkitekturën e realizmit socialist si 'arkitekturë bashkëkohore'. Sipas tyre, "arkitektura bashkëkohore duhet të punojë me një numër relativisht të vogël prototipesh, secili duke i shërbyer një qëllimi të veçantë funksional" (Gutnov et al, 1968; 147). Është gjithashtu e vërtetë që në Bashkimin Sovjetik arkitektura staliniste filloi më parë sesa mbajtja e Kongresit të Parë të Arkitektëve. Në Shqipëri u aplikua trembëdhjetë vjet më vonë, pas vitit 1948 kur u vendosën marrëdhëniet direkte me Moskën.

Në Bashkimin Sovjetik, arkitektura Staliniste ishte shumë historike dhe u kufizua gati tërësisht në detaje dhe dekor. Ndonjëherë studjuesit i referohen asaj si 'Stili Stalinist Perandorak', apo edhe 'Klasicizëm Socialist'. Gjithçka duhej të ishte më madhështore se më parë. Siç shpjegon Czepczynski, Moska u bë një model i përsosur i qytetit socialist, prandaj shumë projekte dhe kontradikta pasuan modelin e qytetit më të madh socialist. Kjo arkitekturë ishte rezultat i mënyrës se si shteti komunikoi me masat nëpërmjet ndërtimeve, duke i përdorur ato si një shprehje e pushtetit shtetëror. Kombinimi i monumentalizmit të sfidës së hijshme, dekorimit të artit patriotik dhe motiveve tradicionale u bë një nga shembujt më të gjallë të kontributit sovjetik në arkitekturë (Czepczynski, 2008; 90). Bëhet fjalë për shprehjetpara të arkitekturës populiste e cila kulturalisht mbështetet totalisht mbi traditë por duke ndërruar destinacionin e përdoruesit. Shumë janë përpjekur ta klasifikojnë arkitekturën staliniste duke parë pas në jetën e Stalinit. Fakti që ai "ndoqi një seminar në një kishë ortodokse ruse, e cila e ndihmoi atë të bëhej dogmatik" (Pauley, 2015; 53) dhe mëpas ekzili i tij në Vjenë, rriti interesin e tij për madhështinë e arkitekturës neoklasike. Sigurisht, ai ishte një përkthyes i marksizmit dhe leninizmit që e solli në pushtet, ndonëse retorika e arkitekturës së tij mbetet e ngjashme me liturgjitë kishtarë mbushur me retorikë që kishte dëgjuar në seminarët ortodokse.

Gjithashtu ekzistonte edhe një aksiomë ose postulat i njohur, që shërbeu si një premisë ose pikënisje e të menduarit të arkitekturës staliniste që duhej pranuar si e

vërtetë pa polemika. Kjo ishte ideja se arkitektura e re duhej të ishte “*socialiste në përmbajtje dhe në formë kombëtare*”. Kjo u shpreh gjithashtu në statutin e Arkitektëve Sovjetik në vitin 1937 ku thuhet se “sfera e realizmit socialist në arkitekturë nënkupton bashkimin intim të shprehjes ideologjike dhe asaj artistike”(Kopp, 1987; 234). Sipas Molnar “praktikisht, kjo nënkupton ringjalljen e monumentalitetit dhe të repertorit formal të arkitekturës historike (konkretisht duke vizatuar mbi traditat kombëtare, ‘progresive’) plotësuar me tema që lartësojnë jetën e përditshme të punëtorëve dhe fshatarëve”(Molnar, 2013; 115). Kjo filozofi u përkthye me specifikat e veta edhe në realitetin socialist shqiptar. Në një nga fjalimet e tij të fundit, Enver Hoxha rekomandon: "Partia vazhdimisht na ka urdhëruar që në duhet jo vetëm të mbështetemi në traditën lokale, por edhe ta kultivojmë atë, sepse tradita për në është edhe tradita e pasur e realizmit socialist [...] Në të gjitha fushat - letërsi, arkitekturë në kemi nevojë për të krijuar vepra që janë të dashura, të kuptueshme dhe të ndjera nga njerëzi"(Mosko & Sukaj,1986;3). Kjo nënkuptonte dy gjëra. Së pari, sipas Hoxhës nënkuptonte se tradita lokale shqiptare të eliminohej nga arkitektura zyrtare dhe lejohej vetëm tradita e realizmit socialist dhe siç kam shpjeguar më tej, kjo ishte më e dukshme në vitet e fundit të regjimit socialist në Shqipëri. Së dyti, eliminimin e traditave socialiste të vendeve të tjera, kryesisht sovjetike, duke i konsideruar ato si imperialiste. Por kjo ndodhi pas vitit 1961, kur Hoxha filloi të tensiononte marrëdhëniet me ish-Bashkimin Sovjetik duke refuzuar politikën revizioniste.

Pjesa e "realizmit" është gjithashtu e rëndësishme për t'u përcaktuar sipas ideologjisë socialiste. “Stalini i përshkroi praktikuesit e realizmit socialist si 'inxhinierë të shpirtit'. Arti sovjetik në këtë kohë kishte për qëllim të përshkruante punonjësën siç ishte në të vërtetë, duke mbajtur mjetet e tij të punës. Sidoqoftë, admirimi i tij për ndërtesat pompoze, kitç dhe dekorimin neoklasik, mermeret dhe kristalet, kolonat dhe skulpturat u kopjuan nga ndjekës të shumtë në pothuajse çdo vend të Bllokut Lindor”(Czeczynski, 2008; 91). Kjo ishte gjithashtu e vërtetë në Shqipëri, por ende disa autorë refuzojnë ta quajnë 'realizëm' pasi nga realiteti që përshkruante mungojnë shumë gjëra. Për shembull, autori shqiptar Gezim Qëndro e quan atë "surrealizëm socialist". Sipas tij, “në pothuajse gjysmë shekulli në Shqipëri në peizazhet e pikturës ishte e ndaluar të pikturoje rënien e shiut. Vetëm bora u autorizua të përdoret në peizazhet e realizmit socialist. Paratë u ndaluan gjithashtu nga parajsa komuniste. Kjo do të thoshte se të gjitha marrëdhëniet e tregut ishin të ndaluara për t'u përshkruar në piktura”(Qendro, 2010). Ndërsa në rang ndërkombëtar Groyes është kundër përdorimit të termit 'realizëm socialist' sikurse edhe 'surrealizëm socialist', ndërsa shpjegon se “imazhet e realizmit socialist shfaqin të njëjtën neutralitet, impersonalitet, mediokritet dhe mungesë të shprehjes artistike të gjetur në imazhet e artit nacional socialist [...] Në këtë mënyrë ato dallojnë nga imazhet e surrealizmit apo realizmit magjik, të cilët të dy po ashtu përdorën një teknikë pikturimi gati-fotografike për të krijuar efektin e një realiteti virtual - *një fotografi të një ëndrre*. Por arti i surrealizmit gjithsesi përputhet me kërkesën tradicionale për origjinalitetin artistik, ndërsa arti totalitar me vetëdije përpiket për impersonalitetin të shprehur. [...] arti i epokës së stalinizmit donte të dukej i papërcaktuar, jo formal, i panjohur, për të shmangur akuzat e formalizmit dhe për të siguruar që ajo nuk përfundonte në arkivin e kontrollit ideologjik. [...] vetë imazhi fillon të gjykojë spektatorin; shikuesi humbet perspektivën e tij të jashtme dhe autonominë, është transplantuar në imazh dhe bëhet pjesë e tij”(Dobrenko & Naiman 2003;110). Në këtë mënyrë boshllikun që krijonte tregu i lirë në shoqërinë socialiste e zëvendësoi figura e liderit dhe propaganda rreth tij.

Arkitektura Staliniste mund të konsiderohet si një stil specifik i arkitekturës brenda trendit të realizmit socialist dhe që i referohet një periudhë të caktuar kohore. Dhe ndërkohë që arkitektura Staliniste ishte një stil, krijimi i qyteteve të reja socialiste mund të konsiderohet si një vendim politiko-ideologjik. Rossi sqaron se “një qytet e përmbush vetveten përmes vetë idesë së tij për qytetin”(Rossi, 1982; 23). Kështu, rasti studimor i zgjedhur për këtë tezë, si edhe disa nga shembujt krahasimor mund të konsiderohen si qytete edhe pse i mungojnë shumë referenca të një qyteti të vërtetë. Kur nisa të shkruaja këtë tezë, kisha shumë dyshime për klasifikimin e tyre, por realiteti është se ideologjia komuniste i përkufizonte ato si qytete dhe i krijoi ato për këtë qëllim. Siç tregon Godoli duke ju referuar Moskës “plani i vitit 1935 nuk ka udhëhequr vetëm zhvillimin e kryeqytetit sovjetik, por deri në vitin 1960 u imponua si një model i zbatueshëm për të gjitha qytetet e mëdha të Bashkimit Sovjetik dhe pas Luftës së Dytë Botërore për rindërtimin e Bashkimit Sovjetik dhe shteteve të tjera komuniste”(Godoli, 2014; 99-113). Karakteristika e tyre kryesore është lidhja midis industrisë së ndërtimit dhe industrisë së prodhimit të rëndë apo tjetër sipas astit. Gutnov në fund të kësaj periudhe shkruan se “proceset e krijimit të qytetit ideal komunist, nënvizojnë faktin se deri më sot historia e arkitekturës ka qenë një histori e planifikimit dhe ndërtimit të ndërtesave individuale. Për të dizenuar Njësinë e Re të Vendbanimit, nuk mjaftonte të dije se si të planifikojë një ndërtesë. Një hapësirë totale e unifikuar duhet të projektohet duke përdorur një sistem në të cilin ndërtesat përbëjnë një variabël të ndryshueshëm hapësinor dhe formojnë një komunitet total”(Gutnov et al, 1968;164).

Një tjetër aspekt i rëndësishëm për t'u përmendur është gjithashtu kulti i personalitetit të liderit, në rastin sovjetik Stalin dhe influenca e figurës qëndrore në qytetin e ri socialist. Kjo tezë nuk përputhet plotësisht me kontekstin shqiptar, pasi kulti i personalitetit të Hoxhës u zhvillua më vonë në kohë. Për këtë arsye, u mor si kult modeli i Stalinit dhe monumentet e tij u ndërtuan në qytetet e reja të themeluara. Shumë shpesh realiteti fshihej pas maskës së propagandës, e cila shfaqej nëpërmjet arkitekturës së objekteve të veçanta. Vetë ndërtesa u përdor si një mjet për të edukuar njerëzit. Siç do të përshkruaj në pjesë të tjera të kësaj teze, në pjesën e jashtme, ndërtesa duhej të shprehte një arkitekturë konform parimeve socialiste, ndërsa brenda saj duhej të përfshinte hapësirat organizative për krijimin e jetës së re dhe të ‘njeriut të ri’. Kopp shpjegon se “kjo lloj arkitekture, nuk kërkonte të shprehte realitetin, por në të kundërtën përdorte mundësitë teknike dhe industriale për detyra irracionale dhe që ishin në kundërshtim absolut me përdorimin fillestar të ndërtimit të tyre”(Kopp, 1987; 236). Arkitektura Staliniste nuk u influencua vetëm nga ideologjia socialiste, por ishte gjithashtu një trend kundër modernizmit të arkitekturës Perëndimore por, gjithashtu pati limitet e veta. Shumë arkitektë të Lindjes ankohëshin për mungesë materiale, ndërsa Kopp liston jo vetëm mungesën e materialeve, por gjithashtu edhe “mungesën e eksperiencës” (Kopp, 1987; 242) dhe edukimit bazë.

1.4. Kufinj të dhe limitet

Theksi kryesor në këtë tezë do të pozicionohet mbi konditat dhe karakteristikat e veçanta që bënë të mundur aplikimin e arkitekturës socialiste në Shqipëri me fokus të veçantë në të ashtuquajturën ‘arkitekturë staliniste’, klasifikim ky i veçantë sipas të cilit u implementua projekti për ish-Kombinatit e Tekstileve në Tiranë. Kjo në thelb do të thotë se shumë forma të tjera bashkëkohore të arkitekturës si (konstruktivistët, funksionalistët, modernizmi dhe postmodernizmi) pozicionohen jashtë fushës së studimit, edhe pse shpesh ceken, pjesërisht nga ky studim për efekt krahasimi. Një vëmendje e veçantë do t'i jepet ndikimit të arkitekturës së periudhës së Zogut dhe asaj

fashiste në Shqipëri, e cila do të ndihmojë në analizimin e ndikimit të kontekstit egzistues në themelimit e qyteteve të reja gjatë socializmit.

Ky para së gjithash, është një studim i arkitekturës së qyteteve të reja socialiste në kontekstin e aplikimit të arkitekturës së soc-realizmit në Shqipëri duke ju referuar veçanërisht rastit kryesor që ishte ish-Kombinati i Tekstileve në Tiranë, pa lenë jashtë vëmendjes zhvillimet e tjera gjatë kësaj periudhe. Arsyeja e kësaj zgjedhje është se kjo arkitekturë, edhe pse u zbatua vetëm brenda jo më shumë se një dhjetëvjeçari, modeli që la pas pati një ndikim të thellë në zhvillimet e mëvonëshme. Në shkallë globale është shkruar relativisht shumë mbi perspektivat dhe problemet e arkitekturës së realizmit socialist, ndërsa në Shqipëri, përgjigjet rreth arsyeve dhe ndikimit të kësaj periudhe në zhvillimet arkitekturore, janë ende të paplota dhe shpesh bazohen në të dhëna skematike, anekdotike ose analiza të pamjaftueshme për të hedhur bazat për një studim shkencor të mirëfilltë. Nga ana tjetër, kjo zgjedhje mund të motivohet lehtësisht edhe me domosdoshmërinë e kufizimit të fushëveprimit. Një vëmendje më e pakët që do t'i kushtohet aspekteve të lidhura me krijimin e qyteteve të tjera socialiste, të krijuara në Shqipëri pas aplikimit të arkitekturës staliniste, dmth. pas vitit 1956, duke qenë i vetëdijshëm për dimensionin që do të kishte një studim vertikal i gjithë periudhës së socializmit 1945-90, për të cilin gjukojmë se nuk janë pjekur ende kushtet.

Ka shumë ide mbi atë që përfaqëson më mirë arkitekturën Staliniste në Shqipëri. Zakonisht, arkitektët shqiptarë përmendin ndërtesa të veçanta si “Kinostudio Shqiperia e Re' (Studio filmike 'Shqipëria e Re'), Hyrja e Kombinit të Tekstileve Stalin, Shtypshkronja 'Mihal Duri', Blloku i banimit afër sheshit Skënderbej (sot Qendra VeVe), kinema 'Partizani', një shkollë çerdhe, bllok strehimi 'Agimi', Komiteti Qendror i Partisë në Tiranë, Muzeu Lenin në Tiranë, Fakulteti i Gjuhëve dhe Historisë në Tiranë, Fakulteti i Natyrës Shkencave, Parlamenti etj.”(Velo, 2013; 133). Përkundër kësaj liste, përmenden edhe disa objekte në qytete të tjera. Megjithatë, Maks Velo mendon se “numri i objekteve në qytete të tjera është më i vogël se në Tiranë”(Velo, 2013;134). Si qytete të tëra të arkitekturës stalinist, ai përmend Maliqin, pranë Korçës. “Ky është qyteti i parë i ndërtuar krejtësisht në një mënyrë socialiste. Pas kësaj u ndërtuan qytete të tjera si Ballshi, Kuçova, Laci, Selenica, Perrenjasi, por asnjëri prej tyre nuk ruan të gjitha karakteristikat e kohës socialiste si Maliqi. Të gjitha projektet ishin ruse dhe të gjitha ato janë shembuj të përsosur të realizmit socialist”(Velo, 2013; 134). Ndërkohë që gjatë kryerjes së studimit materiali i siguruar mbi qytetën e Maliqit u verifikua i pakët dhe jo-cilesor për të kryer një studim në shkallën e temës, Ish-Kombinati i Tekstileve Stalin i cili u ndërtua paralelisht në të njejtën kohë përmban nje arkive dokumentacioni më të pasur edhe pse duhet thene se projektet origjinale nuk janë gjetur ende dhe studimi i referohet kryesisht rivizatimeve të kryera mbi projektin origjinal nga inxhinjere dhe arkitektë shqiptar të asaj periudhe. Krahasimi midis faktit dhe projektit fillestar është kryer mbi një bazë të ngushtë të dhënash që disponohen deri më tani, duke qenë tërësisht i vetëdijshëm për influencën që mund të kish patur në këtë studim disponimi i projektit origjinal, do të mbetet kohës verifikimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i koncepteve të shfaqura në këtë temë.

Një nga supozimet kryesore të tezës është se themelet e këtyre qyteteve mund të analizohen edhe si skica të para të një projekti modernist, edhe pse ato përfshihen në kuadrin e një ideologjie totalitare. Shumë autorë kanë argumentuar se "lidhja më e ngushtë mes modernes dhe modernizimit mund të gjendet në ditët e para të formimit

të Bashkimit Sovjetik, kur “për disa vite mbizotëroi një ndjenjë euforie në lidhje me premtimin e shoqërisë së re komuniste. Për këta njerëz dhe për Konstruktivistët e ngjashëm me ta, jeta e fabrikës duhej të gjente shprehjen e saj në forma kubiste, në strukturat e hapura të çelikut dhe në mungesën e referencave historike” (Ching et al, 2011;727). Edhe pse Konstruktivizmi për rrethana historike e gjeografike nuk u aplikua në Shqipëri, argumenti im kryesor këtu është se themelimi i qyteteve të para mund të konsiderohet si një projekt modernizues. Ching et al. gjithashtu diferencon ‘modernen’ dhe ‘modernizmin’ ndërsa theksojnë se “modernia në të vërtetë mbizotëron modernizmin: ky është rezultat i Revolucionit Industrial të shekullit të 19-të, me zhvendosjen e tij nga ekonomia bujqësore tek fabrika. Pasojat përfshinë sekularizimin e shoqërisë, shfaqjen e një klase profesionale dhe racionalizimin e industrive të ndërtimit [...] politika e shoqëruar me modernizimin ka ndryshuar nga totalitarizmi dhe diktatura, në republikanizëm dhe demokraci” (Ching et al, 2011;726). Për këtë arsye, zakonisht sistemi socialist në propagandën e tij ishte kundër projektit modernist, por nuk ishte kundër modernizimit si proces. Shpesh modernizimi u konsiderua si i barabartë me Revolucionin Teknik dhe Shkencor dhe kjo u përkthye edhe në arkitekturën socialiste.

Megjithëse një pjesë e këtyre projekteve mund të konsiderohen si 'utopike', nuk do të përcaktohen këtu si të tilla për faktin se këto qytete funksionojnë akoma sot edhe pse diku pjesërisht diku në mënyrë tërësore. Themelimi i tyre u bë i domosdoshëm prej industrive të vendosura pranë tyre, ndërsa ekzistenca e tyre sot është në rrezik pikërisht prej mbylljes së tyre. Duke përdorur teorinë e Lefebvrit, mund të studjohen këto qytete si mundësi për eksperimentim dhe rishpikje të tyre brenda kontekstit aktual. Ai paraqet kërkimin mbi “të mundshmen në dialektike me të pamundshmen, një lëvizje që kërkon analizimin e kushteve të mundësive, si dhe gjetjen e portave të asaj që mund të ishte” (Pinder, 2013; 42). Prandaj, Lefebvri mohoi konotacionet e egra përkeqësuese të utopisë [...] ai favorizoi më shumë 'eksplorime konkrete' për atë që ishte e mundur dhe rrënjësor në jetën dhe hapësirën e së përditshmes” (Pinder, 2013; 32). Stanek shpjegon se “në kundërshtim me ‘utopitë abstrakte’ duke ekstrapoluar nga status quo-ja, ‘utopizmat konkrete’ janë modele të zhvillimit të mundshëm: mënyra operative të testimit të hipotezave që tregojnë për realitetin kompleks dhe rastësor, dhe për këtë nuk janë shteruese dhe gjithmonë kërkojnë një konfrontim me modelet e tjera” (Stanek, 2011; 15).

Teza do të përfshijë gjithashtu analiza e fakte në lidhje me periudhën e industrializimit në Shqipëri, situatën e njësive të projektimit si dhe zhvillimet lidhur me industrinë e ndërtimit. Përgjatë ekzistencës së tyre, qytetet e ndërtuara gjatë socializmit kanë pësuar edhe shumë ndryshime. Megjithatë, gjatë socializmit tre janë transformimet kryesore që mund të përmenden: "periudha e hershme staliniste u karakterizua nga industrializimi i shpejtë, i përqendruar në industri të rënda dhe në rindërtimet e pas-luftës. Peizazhi triumfalist i kësaj periudhë shprehu fitoren e sistemit të sapokrijuar, si dhe besimin e thellë në një botë më të mirë që supozohej do të përfaqësonte. Liberalizimi Post-Stalinist paraqiti fazën e dytë të socializmit të qyteteve: International Style dhe blloqet konstruktiviste [...] Pejsazhi u shndërrua disi më pak ideologjik e më tepër funksional në vitet '70. [...] Faza përfundimtare vjen si pasojë e falimentimit të projektit modernist dhe ekonomive inefficente”. (Czepczynski, 2008; 88). Në këtë temë do të përfshihen kryesisht analiza të pasojave të implementimit të fazës së parë, asaj staliniste, e cila do të përfshijë gjithashtu kritikën kryesore ndaj stilit. Kritikën filluan së pari në Bashkimin Sovjetik dhe më pas në vendet e tjera komuniste të Evropës Lindore. Ndërsa Shqipëria pati kursin e vet për

këtë. Së pari, u kritikua vetëm arkitektura staliniste dhe pas shkëputjes nga Bashkimi Sovjetik, (si reflektim i marrëdhënieve të përkeqësuar Sino-Sovjetike), liderët komunistë shqiptarë u kthyen kundëra të gjitha projekteve sovjetike në Shqipëri. Megjithatë, u arrit artificialisht të shkëputej modeli arkitekturor i cili u konsiderua si “sovjetik”, nga modeli politik i liderit komunist Stalin, i cili nuk u refuzua kurrë nga udhëheqësit e Partisë Komuniste dhe për këtë arsye ndonjëherë regjimi komunist në Shqipëri karakterizohet si regjim i modelit stalinist. Ky është një kufizim i mëtejshëm, i cili përbën një shkëputje terminologjiko-aplikative si pasojë e kontekstit të veçantë politik.

Në pjesën e fundit të tezës, do të përqendrohem më shumë në një analizë post-socialiste sesa postmoderne. Gjatë viteve të fundit, ka gjurmë të një arkitekture post-moderniste, por vetëm në nivel ndërtesash të veçuara dhe asnjëherë në nivel qyteti. Zakonisht postmodernizmi u përcaktua si refuzim ndaj modernizmit, megjithatë si Ching et al. shpjegojnë “fjala postmodernizëm nuk i referohet një stili veçanërisht të përcaktuar ndaj është shumë ndryshe nga emërtimet e tjera [...] Gjithnjë e më shumë kritikë filluan të lidhnin modernizmin me kapitalizmin, burokracinë dhe sidomos me totalitarizmin. Sidoqoftë, postmodernizmi nuk ishte në asnjë mënyrë një fushë e vetme e unifikuar e prodhimit, as nuk nënkuptonte gjithmonë një refuzim të modernizmit” (Ching et al, 2011;783). Në Shqipëri është më e dukshme një arkitekturë post-socialiste sesa post-moderniste, por mund të konsiderohet gjithashtu si një arkitekturë post-totalitare. Peizazhi i qyteteve përbëhet kryesisht nga arkitektura ish-socialiste e totalitare, të cila përshtaten funksionalisht me rrethanat e reja. Njëkohësisht vihet re një përpjekje për të rimarrë identitetet historiko-kulturore, e shpesh edhe ato krahinore të cilat u rishfaqën intensivisht pas proibicionizmit gati gjysëm-shekullor.

1.5. Metodat e përdorura

Ky studim fillimisht u frymezua nga projektit european ATRIUM, qëllimi kryesor i të cilit ishte menaxhimi i zgjuar, ruajtja, ripërdorimi dhe rivlerësimi i arkitekturës së regjimit totalitar të shek. XX. Si e tillë, kjo tezë kërkon të japë përgjigje për të gjitha pyetjet themelore të këtij projekti si psh: “Çfarë lloj vizionesh planifikimi dhe arkitekture u rikrijuan në strukturat materiale? Përse këto struktura materiale përshtateshin veçanërisht me ideologjinë dominuese? A iu nënshtuan ideuesit e strukturave materiale në mënyrë të ndërgjegjshme përcaktimeve ideologjike - dhe nëse po, deri në ç'masë? Apo ata ndoqën trendet dominuese urbanistike dhe arkitektonike të epokës së tyre? Si u mbushën nga njerëzit këto struktura materiale dhe jeta e tyre brenda kontekstit të regjimit (specifik) totalitar?”(Zupancic, et.al, 2013; fq.5). Megjithatë, bazuar në pyetjet kryesore të kërkimit, mund të argumentohet se studimi kërkon të shfaqë një koncept më të gjerë lidhur me arkitekturën dhe peizazhin urban të qyteteve të para socialiste, të cilat përkojnë me periudhën ku u implementua stili stalinist në Shqipëri. Ndërtesat e kësaj periudhe tashmë manifestohen në kujtesën kolektive, njohuritë, traditën dhe kanë qenë subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme duke i përshtatur diku më shumë e diku më pak me mënyrat lokale të jetesës. Së dyti, përdorimi i objekteve të periudhës socialiste ka të bëjë me procese që orientojnë publikun drejt njohjes, kuptimit dhe veprimit. Por veprimi, nuk është gjithmonë i orjentuar drejt ruajtjes. Siç do të tregohet në pjesën e fundit të kësaj teze, shpesh lidhet edhe me eliminimin e memorjeve të padëshiruara nëpërmjet eliminimit të kontekstit fizik, sikurëse shumë shpesh edhe thjesht për arsye spekulimi ndërtimor duke qenë se këto objekte përgjithësisht janë ndërtuar mbi territor të strukturuar urban.

Materialet e përdorura në këtë studim mund të grupohen në këtë formë:

1. *Materiale arkivore nga arkiva e projekteve të ish-instituteve të projektimit, sot AQTN (Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit), ku përfshihen projekte origjinale të skanuara/fotografuara të asaj periudhe, foto historike, relacione e raporte të planeve urbane dhe projekteve arkitektonike.*
2. *Materialet që kanë të bëjnë me historinë e arkitekturës sovjetike në Shqipëri. Këto libra dhe artikuj janë të përbërë kryesisht nga monografitë dhe biografitë e arkitektëve shqiptarë të periudhës së socializmit. Ky është një burim shumë i mirë informacioni praktik, edhe pse në shumicën e rasteve mungon teorizimi rreth koncepteve kryesore që ata kanë praktikuar dhe zhvilluar, si dhe të dhënat shpesh paraqesin mospërputhje apo personalizime.*
3. *Raportet, librat dhe dokumentat në lidhje me aktivitetin e autoriteteve qeveritare të regjimit socialist në Shqipëri dhe pas rënies së tij. Edhe pse shpesh dokumentat dhe raportet e regjimit socialist shpesh janë një propagandë e vërtetë, megjithatë duke i zhveshur prej propagandës, thelbi i tyre mund të kuptohet lehtë duke bërë të mundur krahasimin e politikave midis regjimeve dhe tendencave kryesore të tyre.*
4. *Materialet në lidhje me historinë shqiptare të periudhës së Zogut, italiane dhe të ndikimit sovjetik duke ju referuar burimeve të ndryshme. Studimi bazohet kryesisht në metodën e analizës empirike dhe perfundimeve llogjike, me hulumtimin e bërë nga materialet arkivore që u finalizua në mars të vitit 2017.*
5. *Vizita në terren dhe studime me studentë në vite me kurse te Analizes Urbane dhe Vendbanimeve viti 2006-2009, kurset e Teorisë së Arkitekturës dhe Urbanistikës në vitet 2013-2019, arkiva personale, si dhe komunikime të vazhdueshme me arkitekte dhe ish-funksionar të periudhës së komunizmit, të cilët përtej rezervimit të kuptueshëm, me dashje apo pa dashje kanë dhënë indikacione të cilat kanë patur një rol thelbësor në ngritjen e hipotezave dhe pasurimin e këtij materiali.*

Studimet e kësaj fushe ofrojnë informata jo vetëm në fushën e urbanizmit dhe arkitekturës, por edhe në fusha të tjera të tilla si politikat e qeverisjes së territorit, shkencat sociale dhe ekonomike, arti dhe kultura, etj. Por pavarësisht përafrimit në horizont të gjerë shkencor, i cili bëhet i nevojshëm për trajtimin e çështjeve të tilla, në këtë tezë do të përqendrohemi më shumë në elementet që janë thelbësore për pyetjet kërkimore të sjella mësipër siç mund të jenë:

- *Informacion kontekstual – si kultura e vendit, dimensionit, projekti;*
- *Roli që luajti ideologjia totalitare – procesi politik dhe influenca të tjera;*
- *Roli i pjesmarrësve kryesor – arkitekti, urbanisti, vizioni i Partisë shtet, influenca Sovjetike;*
- *Buxheti – Buxheti fillestar, kostot përfundimtare (aty ku janë të njohura), arsytet për ndryshime nëse ka patur të tilla;*
- *Procesi i zbatimit – vështirësitë kontekstuale, problemet dhe mësimet e nxjerra;*
- *Problematikat dhe zgjidhjet –problematika të ndryshme që dolën gjatë dhe pas projekteve, si dhe sa këto ishin të parashikueshme;*
- *Funksioni dhe përdorimi aktual i strukturave materiale;*
- *Probleme të menaxhimit dhe mirmbajtjes nëse ka;*
- *Perceptimi dhe domethënia – si perceptohet dhe vlerësohet vendi nga banorët e tij;*
- *Koha – si e përballon qyteti kalimin e kohës dhe si ndikon vjetërimi i strukturave?*
- *Kufizimet e qytetit;*
- *Si i shërben qyteti komunitetit?*
- *Si i shërben qytetit vendit apo rajonit?*

- *Impakti në profesionin e arkitektit/urbanistit dhe edukimi i popullatës.*
- *Impakti në infrastrukturë.*
- *Kritikat dhe komentet e jashtme – ekspertët, përdoruesit, media e lire, politikanët etj.*

Të gjitha pyetjet e mësipërme do të hetohen me metoda të ndryshme të studimit duke i përdorur ato në brendësi të strukturës së tekstit pa futur në krizë rrjedhshmëri dhe leximit. Pas krijimit të një sfondi të gjerë teorik, konceptet e nxjerra do të aplikohen për studimin e rastit kryesor studimor i cili i referohet ish- Kombinimit të Tekstileve Tiranë duke hulumtuar atë si në aspektin cilësor ashtu edhe atë sasior. Së dyti, kërkimi do të përfshijë gjithashtu perspektiva krahasuese dhe korrelacione midis studimeve të rasteve të ndryshme. Për të bërë një analizë të hollësishme do të përdoren të dhëna sasimore ndihmëse si statistika demografike, informacione të shkëputura nga botime të mëparshme, si dhe do të ketë gjithashtu një qasje më të ngushtë empirike të realizuar nga udhëtime në terren me fotografi përfaqësuese të ndërtimeve më domethënëse. Kryqëzimi i metodave është parë si mënyra e vetme për të perballuar në mënyrë më bindëse një temë kaq komplekse dhe ende të patrajtuar mjaftueshëm as në disiplinen konkrete sikurse as edhe në fusha paralele.

Analiza kryesore do të bazohet në teoritë e urbanizimit të Henri Lefebvre. Shqetësimi i tij kryesor nuk lidhet me analizën konvencionale historike të transformimeve urbane, por me “identifikimin e tendencave dhe orjentimeve, vazhdimësitë si dhe ndërprerjet relative, në të cilat virtualja mundëson ekzaminimin e reales dhe në të cilën 'fushat e verbra' që parandalojnë realitetin emergjent urban nga të qenit të kuptuar në mënyrë adekuate, sfidohen”(Pinder, 2013; 33). Kjo do të jetë gjithashtu korniza kryesore teorike e kësaj teze. Qëllimi kryesor është se kushdo që dëshiron të njihet me ndryshimet kryesore të ish-qyteteve socialiste, mund ta bëjë këtë vetëm duke i parë ato si entitete që ndryshojnë vazhdimisht dhe me mundësi për zhvillim dhe inovacion të mëtejshëm. Teza gjithashtu shpreh kontrastin e thellë mes kategorizimit individual dhe kolektiv, midis ndërtesave më të vjetra dhe atyre të reja, midis 'një' dhe 'shumë', mes 'mitit' dhe 'realitetit'. Sipas Rossit, këto lloj kontrastesh dalin "nga qyteti dhe nga ndërtimi i tij, nga vetë arkitektura e tij". Ai thekson se “kontrasti është një nga këndvështrimet kryesore nga të cilat qyteti mund të studiohet. Ai manifestohet në mënyra të ndryshme: në marrëdhëniet ndërmjet sferës publike dhe private, midis ndërtesave publike dhe private, midis dizajnit racional të arkitekturës urbane dhe vlerave të lokusit apo vendit”(Rossi, 1982; 21). Për atë “lokusi është një marrëdhënie midis një vendodhje specifike dhe ndërtesave që janë në të. Është në të njëjtën kohë unik dhe universal [...]Përzgjedhja e vendndodhjes për çdo ndërtesë, ashtu si edhe për qytetet, kishte rëndësi parësore në botën klasike”(Rossi, 1982; 103). Lokusi i qyteteve të para socialiste ishte gjithashtu shumë i rëndësishëm dhe zakonisht përbënte një vendim strategjik –influencuar nga ideologjia socialiste por gjithashtu edhe nga frikërat sureale të Luftës së Ftohtë.

Një pjesë gjithashtu e rëndësishme e tezës, bazohet në shqyrtimin e literaturës së arkitekturës staliniste, realizmit socialist, modernizmit, historisë shqiptare të arkitekturës, ideologjive komuniste dhe fashiste, arkitekturës dhe ideve urbane të qyteteve industriale, arkitekturës post-socialiste dhe postmoderne. Janë përfshirë këtu edhe tema të tjera të rëndësishme si globalizimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm sepse “studiuesit e qyteteve në Evropën Lindore dhe Lindore janë gjithashtu plotësisht të vetëdijshëm për faktin se zhvillimet dhe politikat urbane dhe rajonale në vende të ndryshme ish-socialiste kanë ndryshuar shumë. Kjo pjesërisht për shkak të strukturave të trashëguara dhe të ndryshme urbane dhe rajonale të vendeve, të kohëzgjatjes së

ndryshme të sundimit të regjimit komunist, por edhe për shkak të qasjeve të ndryshme ideologjike ndaj qyteteve.”(Musil, 2005; 26-28). Megjithatë, një kornizë e përgjithshme referimi nga autorët e Evropës Lindore mund të zbatohet edhe për qytetet shqiptare, pa harruar të përmend karakteristikat specifike. "Ne mund ta studiojmë qytetin nga një numër i caktuar kendveshtrimesh, por ai ngrihet autonom vetëm kur e marrim si një e dhënë themelore, si një ndërtim apo si një arkitekturë, vetëm kur analizojmë artefaktet urbane për atë që janë në të vërtetë, rezultati përfundimtar i ndërtimit është një operacioni kompleks, duke marrë parasysh të gjitha faktet e këtij operacioni të cilat nuk mund të përqafohen nga historia e arkitekturës, sociologjisë apo shkencave të tjera”(Rossi, 1982; 22). Teoria rrosiane e percepton qytetin si një qenie komplekse njëjtë me njeriun i cili studiohet prej shkencave mjeksore të ngritura mbi parime të shkencave bazë si biologji, kimi apo matematikë. Para se të jap një pamje të plotë të ideologjisë socialiste që ndikoi në krijimin e qyteteve të reja industriale në Shqipëri, do të përpiqem të vendos disa përkufizime dhe të qartësoj më mirë kuptimin e termave që do të përdoren. Gjithashtu, një përshkrim i hollësishëm i zhvillimeve historike të arkitekturës moderne shqiptare është i nevojshëm të bëhet në kërkim të vazhdimësive dhe ndërprerjeve midis kohëve të ndryshme, kushteve dhe ideologjive brenda të cilave ato zhvillohen. Më tepër se një kornizë teorike në këtë tezë do të parashtrahet imagjinata ideologjike e 'qytetit të ri socialist' dhe konceptimi i tij në teori dhe në praktikë.

2. SFONDI HISTORIK I ARKITEKTURËS SHQIPTARE (1912 – 1944)

Arkitektura shqiptare në vetvete mund të konsiderohet edhe si një fjalë e zbrazët nëse do ti referoheshim në terma stilistike. Kjo për shumë arsye, por kryesisht për shkak të historisë së trazuar që ka patur i gjithë territori ballkanik sidomos gjatë gjysmëshekullit të pushtimit osman. Gjatë kësaj periudhe nuk u promovua mjaftueshëm zhvillimi konsolidimi i qyteteve të cilat vijnë sot me një moshë relativisht të re dhe jo kompakte nëse i referohemi eksperiencës mesdhetare. Trashëgimia arkitekturore e qyteteve shqiptare sot përbëhet nga një traditë e gjatë ndërtimore që i përket periudhës së sundimit osman, një periudhë e shkurtër por mbreslënëse e ndërtimeve italiane të cilës ju mbivendosën rreth katër dekada të urbanistikës socialiste, si dhe strukturat post-socialiste dhe postmoderniste të viteve të fundit. Për shkak të ndjeshmerisë së pakët ndaj kontekstit që ka karakterizuar këtë histori transformimi urban, realiti sot na vjen i miksuar në menyrë gati mekanike dhe pa zgjidhje vazhdimësie.

Studimi dhe analiza e zhvillimeve historike urbane bëhet e nevojshme për disa arsye që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt ose të anasjelltë me arkitekturën socialiste. Nëse i referohemi arkitekturës shqiptare në këndvështrimin stilistik, atëherë automatikisht do të thotë që po kërkojmë riprodhime materialiste të strukturave që i përkasin ideologjive, kryesisht jo-demokratike dhe me karakter totalitar të cilat kanë dominuar periudha të ndryshme prej Shpalljes së Pavarësisë në 1912. Sejcili prej këtyre regjimeve totalitare, pati një raportim sa të veçante aq edhe të ngjashëm me arkitekturën tradicionale, kryesisht duke e sfiduar atë por në raste të veçanta, edhe duke e përfshirë brenda shkallës urbane në rritje. Me tej ky studim tregon se regjimet totalitare ndërkohe që kundërshtonin me forcë të vjetrën si të degraduar moralisht dhe fizikisht, në të njëjtën kohë përfshijnë elementë tradicional të përzgjedhur prej folklorit duke e përdorur atë në aspektin simbolik-komunikativ brenda ndërhyrjeve urbane radikale. Në Shqipëri raporti i sistemit komunist me traditën karakterizohet nga afrime dhe largime në vijim të sfumaturave politike që pati vetë sistemi. Kështu, përafrimi tradicionalist i arkitekturës staliniste shuhet ngadalë duke kaluar së pari nëpër trajtat e sovjetizmit Hrushovian e duke u pasuar prej një funksionalizmi gati mekanik të periudhës së parimeve të Revolucionit Kulturor Kinëz. Prej mesit të viteve 70' dhe në vazhdim të viteve 80', vihet re një lloj rizgjimi të folkut dhe rilindje të motiveve nacionaliste të përfshira brenda një impianti arkitektonik të modernizmit socialist, që karakterizoi kryesisht periudhën e projektëve për qendrat urbane. Në këto kushte, analiza historike e disa prej etapave kryesore që kishin formëzuar traditën e ndërtimit bëhet e rëndësishme për të kuptuar, jo vetëm sfondin e qyteteve ashtu siç u shfaq tëk njerëzit në fillim të sistemit komunist, por edhe për të hedhur dritë mbi karakteristikat e këtij raportimi sa të vështirë aq edhe të nevojshëm për mbijetesën e regjimeve totalitare.

2.1. Arkitektura tradicionale shqiptare

Studimet mbi arkitekturën tradicionale shqiptare kanë filluar filluar në mënyrë të moderuar në kohën e Zogut në vitet 30', por zhvillim më të madh patën prej viteve 70' gjatë periudhës së socializmit kur u prodhuan disa botime të rëndësishme të cilat e kanë dokumentuar atë gjerësisht, ndoshta më tepër së çdo fushë tjetër. Kjo periudhë koinçidon edhe me një rritje të interesit politik ndaj çështjeve kombëtare dhe nacionalizmit, pas një periudhe "internacionalizimi socialist", që karakterizon

pesëmbëdhjetë vjeçarin e raporteve me ish-Bashkimin Sovjetik. Fundi i viteve 60' dhe fillimi i viteve 70' është periudha kur janë hedhur bazat për studimin shkencor të historisë dhe kulturës së kombit shqiptar. Sot këto studime na vijnë kryesisht nëpërmjet ribotimesh të një brezi studiuesish që i përkasin themelimit të kësaj fushe. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe rivlerësimin e fenomenit shqiptar në rajon, studimet mbi traditën dhe etnografinë tashmë kanë kaluar kufirin nacional dhe zgjeruar kontekstin e debatit shkencor mbi këtë fushë.

Nëse flasim për arkitekturë tradicionale shqiptare, atëherë duhet ti referohemi banesës si hapësirën e organizimit familjar dhe zakonor. Në ndryshim nga arkitektura civile e cila ka qënë e diktuar nga mjediset kulturore më të gjera, banesa si kult i familjes dhe individit ka qënë më pak e ekspozuar ndaj ndikimeve të jashtme duke ju referuar më tepër traditës krahinore dhe zakoneve familiare. Gjatë komunizmit, klasifikimi më i zakonshëm i banesave tradicionale bëhet midis ndërtimeve qytetare dhe fshatare. Duke u përqëndruar në karakterin tipologjik dhe kompozicional studiuesi Emin Riza ka klasifikuar banesën tradicionale shqiptare në gjashtë kategori të ndryshme:

1. *Banesa me shtëpi zjarri përgjatë dy kateve (banesa tiranase);*
2. *Banesa me hajat;*
3. *Banesa me çardak;*
4. *Banesa e fortifikuar (banesa e gjirokastrite);*
5. *Kulla qytetare;*
6. *Shtëpia me një kënd" (Riza, 2009; 166)*

Sipas Rizës "Banesa me çardak, ka një përhapje shumë të gjerë; ajo ndërtohet thuajse në mbarë qytetet shqiptare të shek. XV-XIX: Shkodër, Prizren, Gjakovë, Prishtinë, Lezhë, Elbasan, Kavajë, Tiranë, Durrës, Korçë etj. Lidhur me kohën e përhapjes së këtij tipi, ne jemi të prirur ta shohim atë mjaft të lashtë në trojet tona" (Riza, 2009; 208) (fig.1). Sipas tij, ky tip banese " tregon qartë për lidhjen e qytetit me ekonominë bujqësore" dhe është përdorur kryesisht nga "shtresa e feudalëve të mëdhenj". Ai gjithashtu përmend se shumë studiues shqiptarë si Mark Krasniqi, Pirro Thomo, Fejaz Drancolli, Ali Muka, edhe më herët Franc Nopce, kanë



Fig.1 – Kalaja e Tiranës. Shtëpia e pritjes dhe banesa e Familjes Toptani. (burimi: autori)

mbështetur idenë "mbi lidhje gjenetike të banesës "çardak" me kullën"(Riza, 2009; 272) që është banesa e fortifikuar e veriut të Shqipërisë dhe Kosovës pozicionuar në atë që quhet Rrafshi i Dukagjinit. Kulla zakonisht përkufizohet si " banesa me tipare të theksuara mbrojtëse, dy, tre apo rrallë katërkatëshe, me ndarje të qartë funksionale sipas katesh dhe hapësira ndriçuese minimale, por në rritje prej katit përdhe drejt kateve të sipërm[...] dhe ndërtuar, përgjithësisht me gur"(Riza, 2009; 270). Një ish koordinator i strehimit dhe Kryetari i Komitetit Komunal të Strehimit për OKB në

Kosovë, arkitekti Sahar Rassam shprehet se "dizajni i saj [kullës], i cili është unik në këtë pjesë të rajonit, ndikohet nga nevojat shoqërore dhe kulturore të popullit, klimës dhe materialeve ndërtimore në dispozicion në nivel lokal'(Rassam, 2001). Ndërsa sipas stusiesit kosovar Fejaz Drançolli përveçse analizës së elementëve etnografik të lidhur ngushtë me funksionalitetin e ndërtesës dhe evoluimin e saj në vite, e lidh këtë objekt edhe me historinë institucionale të rajonit verior shqiptar, konkretisht duke ju referuar Junikut, një prej qendrave historike më të rëndësishme të krahinës së Rrafshit të Dukagjinit dhe Bjeshkëve të Namuna, ai shprehet "Oda e Junikut - kulla e Hoxhajve, pos vlerës konstruktive-arkitekturnale, funksionale, artistike e estetike pati edhe një rëndësi të posaçme. Oda e Junikut (fig.2) ishte institucion juridik, shoqëror e politik. Këtu u mbajtën tubime të ndryshme me rëndësi jo vetëm për Junikun, Rekën e Keqe, por edhe për tërë Kosovën. Në Odë u morën shumë vendime me interes shoqëror, politik e juridik, aty u pleqërua, u dënua, u pajtuan gjaqet, u zgjithën ngatërresa të ndryshme të junikasve dhe më gjerë. Oda kishte 12 odabash nga të gjitha mëhallët e Junikut. Me odabash kryesonte kryeplaku i Odës. Kryeplaku është zgjedhur nga 12 odabashët dhe kryesisht ky post i takonte plakut të Hoxhajve"(Drançolli, 2001). Ky lloj përdorimi që kalon kufi të familjes dhe është mishëruar në atë që tipologjikisht quhet si "Oda e burrave", gjendet i pasqyruar edhe në aspektin kompozicional dhe distributiv të arkitekturës së objektit. Ky ambjent pozicionohet përgjithësisht në katin e fundit dhe paiset me hyrje dhe shkallë të veçantë prej hapësirës së përdorimit familiar e cila pozicionohet në katet e poshtme. Gjithashtu kati i sipërm karakterizohet prej një apo disa daljesh volumore të quajtura "dyshekllek" të cilat shërbejnë kryesisht për vezhëgim dhe mbrojtje, por që së bashku me elementë të tjerë karakterizojnë edhe tipin dhe cilësinë ndërtimore të kullës së Rrafshit të Dukagjinit(fig.3).



Fig. 2– Junik, Kosovë - Kulla e Hoxhajve/ Oda e Junikut; Fig. 3- Kulla e Hoxhajve, Oda e burrave. (burimi: dtk.rks-gov.net)

Megjithatë një debat i ndezur egziston sot lidhur me prejardhjen zakonore dhe përkatësinë etnike në këtë lloj trashëgimie. Studiuesi, Prof. Emin Riza shprehet se "me banësë shqiptare do të cilësonin banesën e ndërtuar prej shqiptarëve për shqiptarët në trojet e tyre historike". Ai shkon më tej duke shpjeguar "se nuk egziston një lidhje e drejtpërdrejtë e etnisë me tipin e banesës" më tej shprehet se "kjo nuk do të thotë aspak se nuk mund të pohojmë qënien e banesës turke, greke apo shqiptare"(Riza, 2009;144). Ky përbën në një farë mënyre qëndrimin zyrtar shkencor që pak a shumë ndahet prej të gjithë studiuesve të arkitekturës tradicionale në

Shqipëri. Duke ju referuar edhe kontekstit ideologjik socialist kur janë realizuar shumica e studimeve etnografike dhe historike mbi banesën tradicionale shqiptare, vihet re një shmangie e përgjithshme në trajtimin e hapësirës së ndërtuar në lidhje me elementët antropologjik e kulturor që kanë ndikuar atë, duke lënë të paqartë evolucionin dhe kontributin e grupeve shoqërore e duke i konsideruar territorin si një entitet heterogjen objektsh të palidhura me identitetin shoqëror. Ndërkohë, etnografi Ali Muka mbron një tezë më liberalë duke sygjerruar se objektet e arkitekturës tradicionale duhet të jenë në rradhë të parë subjekt studimi etnografik pastaj tipologjik. Ai shprehet se në trajtimin që i është bërë historikut të arkitekturës tradicionale shqiptare "nuk kanë munguar dhe zbatim kriteresh formaliste [...] klasifikohet, fjala vjen, sipas materialit kryesor ndërtimor të përdorur në ngritjen e mureve të saj [...] në teknikën e ndërtimit [...] lloji i çatisë, struktura mbajtëse e saj, lloji i materialit të përdorur në mbulesë, forma e jashtme e mbulesës, apo numri i flegrave të kësaj mbulesë [...] numrin e kthinave të banimit apo dispozicionit planimetrik. [...] ekonomine e familjes: blegtorale, bujqësore. etj"(Muka, 2010; 511) sipas tij egziston edhe komponenti etnik dhe i kombësisë që duke marrë parasysh heterogjenitetin historik të territorit, ka influencuar ndjeshëm edhe mënyrën e ndërtimit. Banesa " pasqyron mënyrën e jetesës së familjes që banon në të. Në këtë rrafsh ajo mbetet objekt studimi etnologjik" sepse, vazhdon me tej "banesa është shfaqja më e dukshme e njëherazi më personalja, e tipareve etnike"(Muka, 2010; 513). Kështu ndër të tjera flet për "kultin e mikpritjes" që mishërohet tek prezenca e "odës së burrave" apo hapësirës së miqve në kullën shqiptare të Rrafshit të Dukagjinit. Këto zakone specifike të zonave të thella të vendit, kanë influencuar thellë në morfologjinë dhe sintaksën e arkitekturës popullore duke sygjerruar një analizë më ndërdisiplinore pasi fenomeni formal siç spjegohet edhe në pjesë të tjera të tekstit, nuk mund të analizohet saktë dhe bindshëm në mënyrë të ndarë prej traditës dhe trashëgimisë etnografike.

2.2. Arkitektura e qyteteve kryesore në fillim të shekullit XX'

Sipas Freely, qytetet mesjetare shqiptare u krijuan fillimisht pranë kështjellave (Krujë, Lezhë) ose rreth tyre (Shkodër, Berat, Gjirokastrë etj.). Në fillim, zhvillimi i tyre ishte spontan. Megjithatë Perandoria Bizantine zgjati më shumë se një mijë vjet, duke arritur kulmin e saj gjatë sundimit të Justinian I (r.528 -565)(Freely, 2011; 1), ndikimi i saj në qytetet shqiptare sot është pasqyruar kryesisht në kishat e kësaj epoke dhe ornamentimin e tyre ikonik. Sipas K.Mio, "për shkak të administrimit horizontal osman gjeografik të Shqipërisë, për mungesë mjetesh të përshtatshme komunikimi etj., zhvillimi ekonomik e shoqëror e, si rrjedhojë dhe evoluimi urbanistik, për qytete të ndryshëm paraqitej i ndryshëm"(Miho, 2003; 14). Gjatë periudhës otomane, qytetet fushore sidomos në Shqipërinë e Mesme "ndikimi osman ka qenë pa diskutim, zotërues. Ai pasqyrohej në: fragmentimin urban të ndërtimeve, bërthamat elementare qytet-formuese, të artikuluar rreth xhamive, siluetën eketyre të fundit, binomin banimpazar të ndarë nga njëri-tjetri, mohimi e vlerave të fasadës në raport me mjedisin e jashtëm, karakterin kryesisht utilitar e monoton të rrugëve dhe rrugicave të lakuara e pa krye'(Miho, 2003; 17). Sipas Freely edhe Perandoria Osmane pati tendencat e saj të ndërtimit. Kishin një periudhë klasike në të cilën xhamitë kishin përfshinin elemente që rrjidhnin nga traditë turke amtare përzier me elementë nga arkitektura bizantine'(Freely, 2011; 21). Më tej shprehet edhe për një periudhë baroke turke e cila "prodhoi shumë shatërvane të bukura"(Freely, 2011; 23). Qytetet shqiptare përmbajnë dëshmi të periudhës klasike turke më shumë se sa periudha baroke e saj. Xhamitë, ansamblet e pazareve (ato që i shpëtuan shkatërrimit të fundit të viteve 60')

përfaqësojnë sot shkëmbimet historiko-kulturore dhe transformimet gjatë pesë shekujve të sundimit otoman (fig.4).

Sipas arkitektit shqiptar Maks Velo, mund të gjejmë dallime apo përjashtime tek tipologjia e qytetit otoman, ai shkëput qytetin e Korçës që e përshkruan si " me një trashëgimi në vazhdimësi bizantine"(Velo, 2013; 334), kujtojmë këtu se në kohën e shkrimit ende nuk ishte restauruar pazari i vjetër i cili u la të degradoje duke spostuar qendrën qytetare në Korçën e 900', përgjate Bulevardit Republika. Edhe arkitektë të tjerë shqiptarë tregojnë një entuziazëm të caktuar për këtë qytet, dhe që është vërtet e bukur dhe e dallueshme ndër qytetet e tjera fushore. Korça ishte qyteti i parë që filloi të zbatojë planifikimin ortogonal për lagjet e reja . Sipas P.Thomo ka dokumente që tregojnë se Korça ka filluar këtë lloj planifikimi në 1859 dhe në fund të viteve 1870 struktura ortogonale e qytetit kishte krijuar një imazh tjetër për qytetin Thomo (2012; 192). Po sipas tij "Greqia ishte shteti i parë ballkanik i cili vendosi të përdorë planifikimin urban ortogonal për qytetet e saj ndërsa 'qeveria greke më 3 prill 1835 urdhëroi me anë të një dekreti se sistemi ortogonal ishte një detyrim ligjor për t'u zbatuar'(Thomo, 2012; 192). Kjo ishte një periudhe e rëndësishme edhe për Shqipërinë pavarësisht distancës kohore me shtetin fqinj, kur Luftës së Parë Botërore qendrave otomanë i bashkangjiten lagjet moderne, operacione që mund të kenë lindur qoftë si plane parcelizimi, apo si plane të mirëfillta si në rastin e Tiranës me planin inxhinjerit Koolher&Frashëri. "Shfaqja e rrjetit ortogonal - qoftë në një shkallë gjeografike, në nivel të një vendbanimi apo ndërtimi - është në përgjithësi shenja e planifikimit, është metoda më e përhapur e dizajnit e përdorur për strukturimin territorial. Rrjeti ortogonal bëhet i rëndësishëm në arkitekturën urbane, sepse, si një atribut urban, shfaqet në të gjithë vertikali tën e historisë kulturore urbane, pavarësisht nga koha, vendi apo kultura. Struktura ortogonale nuk është thjesht një formë, është një metodë e krijimit të një sistemi urban. Për shkak të thjeshtësisë dhe fleksibilitetit të madh, nga ndërtimi i gjerë i shtëpive deri në ndarjen individuale, është struktura më e përdorur në zgjidhjen e territoreve urbane gjerësisht të rritura, të shekullit të 20-të"(Fonyodi, 2008; 19).



Fig. 4– (Nga sipër në të majtë) Tirana, foto e rrugës "28 Nëntori"; Fig. 5- Ish-Legata Italiane, Tiranë ~1935; Fig.



6- Ish-ndërtesa e Parlamentit, Tiranë ~1930; Fig. 7- Pallati Mbretëror pas rikonstruksionit të vitit 1928, Tiranë ~1930; (burimi: AQSH)

Përdorimi i stileve ekletike në Shqipëri erdhi në formën e një zgjimi të vonuar duke iu referua kryesisht modeleve të arkitekturës europiane në fillimit të shekullit të 20', e cili dominohej prej stilit Art Nouveau dhe kishte ardhur në fazë të pjekur në fillim të viteve 1920 kur filloi të aplikohet në Shqipëri. Velo shprehet se Art Nouveau "në Shqipëri u duk me dhjetë vjet vonesë" (Velo, 2013; 91) për herë të parë në disa vila e pallate borgjeze që u ndërtuan në Tiranë gjatë periudhës së monarkisë, nga të cilat vijojnë të egzistojnë sot si Vila e Akademisë së Shkencave (ish-Pallat Mbretëror) (fig.7), Ndërtesa e Parlamentit (sot Teatri i Kukullave) (fig.6), Legata e Italisë (fig.5), Legata e Turqisë etj.

Velo shprehet se implementimi i Art Nouveau në Korçë (fig.8) pati një përhapje me të gjerë në popullsi dhe u implementua me më tepër varietete, sipas tij "është e veçantë sepse ka një bashkim, shkrirje dhe unifikim me artin popullor duke influencuar tërë dekorin qytetar" (Velo, 2013; 97). Velo mbështet idenë se kjo lloj arkitekture është asimiluar edhe nga popullsia lokale e Korçës dhe të cilët e kanë përzier brenda folkut duke e kthyer në si stil dekorativ edhe në objektet e rendësisë minore, duke e interpretuar sipas kushteve konkrete. Kështu simetria, mbulesat me çati vlezuese, dekoret me suva, hekuri i punuar, dysheme të dekoruara me derdhje dhe mozaik, afreskimi i tavaneve e faqeve, u shndërruan në pjesë të imazhit të ri urban të këtij qyteti duke u kthyer në motiv për tekste këngësh e serenata që trasetojnë sot Korçën e fillim shekullit. Edhe pse janë regjistruar ndërhyrje të shumta brenda qendrës historike ku ka patur alterime sidomos përse i perket shkallës urbane, Korça nuk ka njohur rritjen dhe zëvendësimin e strukturës urbane që ka patur Tirana. Trashëgimia urbane e Nentëqidës në Korçe mbetet ende kompakte dhe karakterizuese e imazhit të përgjithshëm të qytetit.



Korçë 1930





Fig. 8 – Korça, fotografi e viteve 30'; Kisha e Shëngjergjit, në krah Kinema "Majestik"; Kinema "Lluks" 1926; Hotel "Pallas". (burimi: <http://korcapedica.com>)

Në këtë pershkrim të zhvillimeve arkitektonike të shekullit 19', nuk mund të lihet papërmendur qyteti i Shkodrës, një ndër qytetet me te vjetra në rajon ku mpleksen bashkë gjurmët e të gjitha qytetereve që kanë jetuar në territorin shqiptar. Sikurse qytetet e tjera njohu zhvillim urban konsistent pas Shpalljes së Pavarësisë kur qyteti njohu një rizgjim intelektual dhe qytetarie që nuk kish njohur prej shekujsh gjate pushtimit osman. Personazhe të tilla si At Gjergj Fishta, Pjeter Marubi dhe në veçanti për arkitekturën Kolë Idromeno, janë dëshmi e hapjes shkembimeve të elitave që ka patur ky qytet në shekuj. Prej vitit 1914 ku Shkodra u ribashkua me Shqipërinë pas pushtimit nga Malazezët, qyteti kultivoi një masë intelektuale e cila pati ndikimin e vet edhe në urbanistikë. Proçeset e modernizimit dhe ristrukturimit me futjen e rrugëve të perziera tregëtare dhe residenciale brenda nukleve të ndara të binomit pazar - banim të qytetit otoman, krijuan sfondin për zhvillime të rëndësishme urbane ku zhvilloi aktivitetin Kolë Idromenos arkitekt. Ai u shkollua në Venezia 1875 si piktor, në Shkodër pranë priftërinjve françeskanë, si dhe në veçanti nga fotografi dhe arkitekti italian Pjetër Marubi. Idromeno ka kryes disa vepra të rëndësishme kryesisht në stil ekletik të nëntëqindës italiane duke e përzier me elementë nga tradita e zonës. Sipas M.Prenushit "si arkitekt dhe urbanist autodidakt, e kapërceu kufirin e banesës si krijimtari. Ai synoi krijimin e ansambleve me vlerë arkitekurore dhe urbanistike për qytetin" (Prenushi, 1984; 67). Vepra e tij më e spikatur është e ashtuquajtura "Rruga e madhe" që sot mban emrin e tij (fig.9). Këtu Idromeno u përfshi që prej konceptimit urban e deri tek projektet arkitektonike të objekteve të veçanta. Kjo promenade e re që rigjalleroi jetën urbane në Shkodrën e fillim shekullit lindi prej rrugës së mëparshme "Gjuhadori" e cila gjendej në mes të dy lagjeve të besimeve fetare të ndryshme, duke u kthyer në këtë menyrë një korridor urban që favorizoi integrimin në një kohë kur prapambetja dhe problemet e ndasive fetare kishin pushtuar qytetin.

Vepra më e rëndësishme e Koli Idromenos është "Kafja e Madhe" e cila është një prej monumenteve më të rëndësishme të qytetit të Shkodrës (fig.10;11). Asaj i dhanë famë fillimisht studentët që vinin nga jashtë dhe intelektualët e kohës duke e shndërruar në një pikë takimi gjatë kohëve të arta të Rilindjes Kombëtare. Në shembullin e 'caffè des artist' parisienë, objekti me dy nivele është realizuar në një stil ekletik neorilindas. Bazamenti ulet dukshëm për të sjelle sallën në një nivel me rrugën, ndërsa vettratat e mëdha në planin përdhe i kanë reduktuar kolonat në minimumin e nevojshëm në mënyrë që ekspozimi ndaj rrugës të ishte maksimal. Për Idromenon kafja duhej të ishte një zgjatim i ambientit urban dhe sipas këtij parimi i cili bëhet i dukshëm me analizën kompozicionale, fasada trajtohet si perde që bie lehtë mbi planin e lëvizjes. Trajtimi i hapjeve merr një sens progresiv rritje nga lart poshtë, zgjidhje që i jep

objektit një pamje të përgjithshme të lehtësuar dhe pa peshë. Ndërsa vetratat e planit përdhe mbyllen me hark të plotë si lozhat rilindase, plani i sipërm i cili strehon hotelin është zgjidhur me dritare të mëdha që përfundojnë me harqë të zbutura të një gustoje baroke. Zgjidhje interesante i është dhënë hollit të kafenesë në planin përdhe, i cili shtrihet në dy nivele duke përfitur edhe në thellësi shikueshmëri të mirë karshi rrugës. Gjatë periudhës së komunizmit qendra historike e Shkodrës u nxorr jashtë itinerareve ekonomike të qytetit dhe humbi vlerën e saj vitale për ambientin urban. Heqja e lirisë së fjalës e bëri kafenenë një ambient të pakuptimtë. Kafja e Madhe vazhdoi aktivitetin edhe pse humbi kuptimin e dikurshëm. Vitet e fundit, një debat i gjërë është zhvilluar nëpër media për restaurimin e këtij monumenti të kategorisë së parë, por akoma nuk ka patur asnjë hap konkret. Krahasuar me vendet e tjera të Evropës, Shqipëria ka qenë e përfshirë në ndërtimet moderne dhe dizajnin modern shumë vonë. Përdorimi i materialeve moderne të ndërtimit si beton, çelik, tullë filloi në dekadën e parë të shekullit 20'. Modernizimi si proces u pa si një tipar i pashmangshëm i shekullit të 20-të dhe Shqipëria e përqafoi në mënyrë të shpejtë. Siç shprehet Ching, "në arkitekturë, modernizmi shoqërohet me një ndërprerje radikale me format e së kaluarës" (Ching et al, 2011; 726).



Fig 9 –Rruga e madhe, Shkodër, fotografi e viteve 30'; Fig. 10- Kafja e Madhe, fotografi e viteve 30' (burimi: www.gazetaexpress.com);

Në Shqipëri modernizimi erdhi si një tipar perëndimor dhe u shfaq si shkëputje nga tradita e osmane. Velo shpjegon se "Perandoria Osmane nuk la asnjë rievim apo plan rregullues, për asnjë qytet. Të gjitha qytetet janë ngjizur në një mënyrë spontane, intuitive. Ishin inxhinierët e ushtrisë austriake që bënë rievimin e parë të Tiranës" (Velo, 2013;158), gjatë Luftës së Parë Botërore në 1914. Lidhur me situatën e institucioneve të urbanistikës në vend Koço Mio shkruan se "Në Tiranë, vendin e specialistit të zyrës urbanistike të bashkisë, deri në vitin 1924, e kanë pasë zënë inxhinierë të huaj.




Fig. 11- Kafja e Madhe, vizatim i fasadës kryesore nga Kolë Idromeno. (burimi; AQTN)

Të tillë kanë qenë edhe ata të Durrësit e të Vlorës, më pas, këtu ka punuar inxhinier S.Pashallari [...]. Po sipas tij, "Në vitin 1936, këtë vend e zë inxhinier V.Noçka, autor i projektit të urës së madhe mbi lumin e Lanës e i disa banesave.[...] Në vitin 1937, në krye të kësaj zyre, gjendej inxhinier arkitekt A.Lufi, autor i projekteve të disa banesave, i hotel Vjosës në qendër, etj". Po i njejt, duke ju referuar botimeve të kohës shkruan "zyra e parë urbanistike e Korçës, ka patur pranë saj arkitektin Kristo Sotiri. Më vonë, në vendin e tij erdhi inxhinieri Jovan Adami" ndersa në Durrës "nga viti 1928, në zyrën teknike të bashkisë punonte ark. K. Sotiri"(Miho, 2003; 69). Arkitekt Sotiri, për të cilin Maria Concetta Miglieccio shprehet se "zhvillontë në mënyrë të dyshimtë një gusto franceze në interiere"(Miglieccio në Godoli & Tramonti, 2012; 38) në përiudhën e qëndrimit në Durrës, angazhohet me projektin e Vilës Presidenciale të Durrësit në stil neogotik (fig.12), e cila në rrethana të paqarta u prish dhe u zëvendësua nga projekti i Di Faustos në 1928, e cila përkon me vitet para se Zogu të deklaronte veten Mbret dhe të shpallte me kushtetutë Shqipërinë si Monarki. K.Sotirit i atribuohen edhe projekte të tjera në fund të viteve 20', siç ishte Pallati i Priceshave në rrugën Luigj Gurakuqi të cilat dëshmojnë për preferueshmërinë që gëzonte arkitekti tek Zogu president, si dhe anashkalimin që i bëhet atij për ti lënë vendin një arkitekture të monopolizuar prej frymës fashiste. Edhe pse mund të evidentojmë disa projekte të shkeputura, si ish-Kinemaja Nacional (sot e prishur), Kisha e Shën Prokopit (sot e prishur) në Tiranë në 1936 (fig.13), që nga vitet 30' e deri pas luftës, nuk do të kemi më debutime me projekte nga arkitektët shqiptarë, të cilët vazhduan kontributin e tyre nën ombrellën e arkitektëve të huaj. Me tej në këtë tekst tregohet se edhe regjimi komunist mbajti qëndrime të ngjashme me këtë brez të parë arkitektësh shqiptarë me edukim perëndimor që i përkasin fazës së kalimit nga arkitektura eklektike tek ajo racionale, proces që ndodhi paralelisht më vendet e tjera europiane.



Fig 12 – Vila Presidenciale Durrës, Arkitekt K. Sotiri 1925. Burimi; Miho, K. Arkitekt Kristo Sotiri. Extra, Tiranë 2008;




Fig 13 - S. Luarasi mbi maketin e Kishë së Shën Prokopit 1938. Burimi: <https://sq.wikipedia.org>.

2.3. Arkitektura gjatë periudhës së protektoratit italian

Tirana është marrë si një model i reduktuar përshkrimor për të treguar shkallën dhe tipologjintë e zhvillimeve me arkitekturën në fillim të shekullit të kaluar. Pas shpalljes kryeqytet, Tirana hyri në një fazë transformimesh të njëpasnjëshme me natyrë kryesisht politike. Regjimet autoritare nuk u njehsuan kurrë me ambientin urban, por e transformuan atë në mënyrë radikale për ta përshtatur me ideologjinë. Kështu ndërsa politika është gjithmonë në kërkim të një identiteti të ri publik, konflikti urban në qytet qëndron ndezur edhe në këtë shekull të ri. Duke iu referuar Rossit, "Përvoja e përbashkët konfirmon atë që studimet më të thelluara kanë treguar: se një qytet ndryshon plotësisht çdo pesëdhjetë vjet.[...]Sigurisht, ka periudha të caktuara kohe në të cilat një qytet transformohet veçanërisht shpejt - Parisi nën Napoleonin e tretë, Roma kur u shpall kryeqytet i Italisë"(Rossi, 1982; 139). Tirana

ka hasur të dyja këto tempizma zhvillimi, nga një ngadalshmeri karakteristike e zhvillimeve urbane gjatë kohës osmane, në vullin e pandalshëm të transformimit urban modern. Shumë pranojnë se Tirana është e panjohur për atë që ishte pesëdhjetë vjet më parë. Për disa njerëz është e panjohur edhe për atë që ishte para 25 viteve. Tirana gjatë shekullit XX ka më tepër se 25 fishuar popullsinë e saj. Për fat të mirë, ende ekzistojnë disa shtresëzime historike të shprehura nëpërmjet ndërtesash të cilat edhe pse goditur rëndë nga historia, akoma ja dalin të tregojnë njëlloj vazhdimësie dhe persistence të identitetit urban.

Trashëgimia kryesore e Tiranës nga periudha e Perandorisë Osmane ishin pesë: Xhamia e Vjetër, Xhamia e Et'hem Beut, Kulla e Sahatit, Pazari i vjetër, Ura e Tabakëve. Me kalimin e kohës, përmbajtja funksionale e këtyre ndërtesave ka ndryshuar, disa prej tyre janë transformuar ndërsa disa nuk ekzistojnë më. "Xhamia e Vjetër i rezistoi kohës për 330 vjet, u dëmtua rëndë gjatë luftës, në nëntorin e vitit 1944, dhe u rrafshua në 1945, së bashku me varrin e Sulejman Pashës"(Bakui, 2014; 55) shprehet Bakui. Prishja e Xhamisë së Vjetër dhe varrit e themeluesit të qytetit, ishte akti i parë agresiv i regjimit komunist karshi trashëgimisë e memorjes urbane në këtë qytet. Më pas Pazari i Vjetër, siç do ta shpjegoj më vonë në këtë studim, u zëvendësua nga Pallati i Kulturës dhe parkun pas tij. Xhamia e Et'hem Beut dhe Kulla e Sahatit mbëten një konteks i izoluar në mungesë të pazarit dhe pas deklarimit të shtetit socialist laik. Ndërsa gjatë pushtimit fashist dhe regjimit komuniste u mbajt një qëndrim injorues dhe selektiv karshi trashëgimisë, periudha e mbretërisë së Zogut I me protektoratin italian, karakterizohet nga një qëndrim më përfshirës dhe transformues ndaj trashëgimisë. Sipas analistit Fatos Lubonja "Mbreti Zog e kishte prekur pak qendrën orientale të origjinës që kishte si strumbullar pazarin dhe disa xhami. Kishte kryer aty vetëm një akt simbolik: Kullës së Sahatit, që ishte ngjitur me Xhaminë e Et' hem Beut, i kishte hequr kapuçin me arkada të stilit oriental dhe i kishte vënë një kapuç piramidial të stilit venecian në emër të modernizimit dhe evropianizmit (Lubonja, 2007; 12). Në fakt, gjatë qeverisjes dhe më pas mbretërimit të Zogut u realizuan disa transformime të rëndësishme siç ishte hapja e aksit Nëna Mbretereshë (sot rr. e Barrikadave) e cila ishte rruga e pare tregtare dhe residenciale e modelit perendimor. Ndërtoi edhe një park që lidhte Xhaminë e Vjetër me Kalanë e Tiranës, ndërsa restauroi edhe hyrjen perëndimore të pazarit duke i shtuar dyqaneve një lozhë të ngushtë me kolona si element unifikues të koridoreve tregtare.

Mesi i viteve 20' dhe në vazhdim gjatë viteve 30' shënojnë një moment të rëndësishëm të Tiranës për zhvillimin urban të shekullit XX, që perkon me atë që quhet si periudha e arkitekturës italiane në Shqipëri. Eshte e mahnitshme sasia dhe cilësia e prodhimtarisë së kësaj periudhe e cila pavarësisht sfumaturave politike, ishte vendimtare në përcaktimin e strukturës urbane dhe karakterit të ardhshëm të qytetit. "Me themelimin në 1925 të Bankës Kombëtare Shqiptare, të administruar nga një komitet drejtues i përbërë prej dy pjesëtarësh italian dhe dy shqiptarë, dhe nëpërmjet SVEA(Shoqëri për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë), Italia u pajis me dy instrumentat më të rëndësishëm për penetrimin ekonomik-financiar në Shqipëri. SVEA-s i ishte besuar administrimi i huasë prej 50 milion frangash ari, e nxjerrë në 1925 nga qeveria italiane për ngritjen ekonomike të Shqipërisë, e kërkuar me vendosmëri prej Musolinit për zgjeruar ndërhyrjen politike në vend dhe për të nxitur kontrollin e ekonomisë dhe administratës prej Italisë"(Godoli & Tramonti, 2012; 59), shprehet Godoli në konferencën "Arkitektët dhe inxhinjerët italian në Shqipëri". Gjatë kësaj periudhe, investimet u fokusuan kryesisht tek ndërtimi i veprave publike ku, siç shpjegon historia amerikane Miranda Vickers "nga 11 milion franga ari

shqiptare të buxhetuara ndërmjet viteve 1928 dhe 1938, 75 përqind shkuan në ndërtimin e ndërtesave publike dhe të banimit në kryeqytet, i cili në atë kohë kishte një popullsi prej rreth 25,000 banorë"(Vickers, 2006; 125). Raporti midis dy vendeve do vazhdojë për gati tre dekada duke u shëndëruar nga një marrveshje dypalëshe, në pushtimin të Shqipërisë nga Italia në 1939 gjatë L2B. Këtë lloj raportimi ne thelb politik, e gjejmë të pasqyruar edhe në gjurmët e arkitekturës italiane në Tiranë ku mund të dallojme qartë ndryshimet midis arkitekturës romantike të Sheshit të Ministrive të ndërtuar në kohën e Mbretit Zog dhe protektoratit italian, me racionalizmin klasik të arkitekturës fashiste që karakterizon impiantin urban dhe arkitekturën e sheshit Nënë Tereza (ish- Piazza del' Littorio). Maks Velo, gjithashtu shpreh dallimin kur klasifikon përmbajtjen arkitekturore të qytetit teksa shprehet:"Në Tiranë dallohet qartë ndarja midis objekteve të ndërtuara në periudhën Osmane (xhamia e Et'hem Beut, Kulla e Sahatit, Ura e Tabakëve dhe banesat me qerpiç), objektet e ndërtuara në periudhën e mbretërisë (kryesisht ministrinë dhe shumë vila) dhe ato të ndërtuara në periudhën e arkitekturës italiane, para ose pas pushtimit fashist, me realizimin e aksit Veri-Jug të bulevardit të madh Dëshmoret e Kombit"(Velo, 2013; 127). Arkitektura e ndërtesave të ministrive si dëshmi e fazës së protektoratit, përfaqëson më shumë dëshirën e Zogut për të konsoliduar administratën shqiptare dhe formimin e shtetit komb. Punimet për ndërtimin e gjashtë ndërtesave administrative u kryen nga firma italo-shqiptare Staccioli-Fortuzi. Zogu gjithashtu vendosi kompeticion për financimin e këtij projekt duke marrë edhe një propozim të dytë për të cilin Maria Concetta Migliaccio shprehet se "Për realizimin e sheshit të Tiranës, ku do të pozicionoheshin ndërtesat ministrore, qeveria italiane duhet të paraqesë një plan financiar për të bërë të qëndrueshëm projektin e Di Fausto, i cili duhej të rezultonte shumë më konkurrues se sa plani i redaktuar nga gjermanët' (Migliccio në Godoli & Tramonti, 2012; 48).

Sipas Tramontit "Di Fausto ri-propozonte shumë nga temat e 'ruralizmit aulik' të Predapio-s, që në shkallë të madhe anon nga variacionet e 'barokut romak'. Ndërtesat e ministrive, në sheshin Skënderbej projektohen brenda një boshi urban, ku bëhej i nevojshëm krijimi i një ritmi zinxhir, i arritur me mjete gjuhësore dekorative dhe kromatike të hibridizuara me referime simbolike prej historisë lokale"(Godoli & Tramonti et al, 2012; 33). Para se të punonte me ndërtesat e qendrës së Tiranës, Di Fausto kultivoi stilin e tij në kolonitë greke të ishujve të Rodit dhe në Predappio ku arkitektura e tij manifeston elementë stilistik të ngjashëm, të cilat përshkruhen prej Tramontit si "ekletizëm rural" apo "gusto vernakulare" brenda një arkitekturë të monumentalizuar që sforcohet të tregojë se i përket një mesdhetarizmi të gjithin latin. Kështu impianti arkitektonik horizontal skanohet në vertikalishtet prej fashash të nxjerra nga volumi ku janë pozicionuar dritaret që vijnë duke u zvogeluar në katet e sipërme duke rritur në këtë menyrë efektin e perspektivës. Në mbyllje të objekteve të ministrive, janë pozicionuar në formën e një gjerdani të vazhduar basorelieve dhe altorelieve të figurave identifikuese nacionale si përkrenarja e Skenderbeut, koka Ilire në një gusto futuriste, apo shqiponja dykrenare mby hyrjen e ndërtesës së Bashkisë e cila u rrezua nga regjimi komunist në vitet 70' për ndërtimin e Muzeut Kombëtar. Duhet thënë se elementët nacional në këto arkitektura kanë më tepër një karakter simbolik ndërsa struktura në shkallë urbane dhe arkitektonike, ishte i huaj ndaj kontekstit dhe jo shumë miqësore duke gjykuar nga bazamentet e larta të objekteve dhe vendqëndrimet e rojeve, të cilat përbëjnë zbritje në shkallë që futet në limitet e groteskut. Nga ana tjetër është për tu vlerësuar qëndrimi kontekstual dhe korrekt arkitektonikisht, që është mbajtur lidhur me xhaminë e Et'hem Beut, duke respektuar

distancën e saj nga aksi i bulevardit për zgjerimin e hapësirës për sheshin e Ministrive (fig.14).



Fig. 14 –Sheshi Skënderbej. Tirana, fund vitesh 30' (burimi; AQSH);

Të katër objektet që egzistojnë sot nuk ngrihen më lart se kupola e xhamisë së Et'hem Beut. Tek dy objektet e gjata paralel me aksin, zgjidhja me hyrjet anësore monumentale gjallëron hapësirën ndërmjet objekteve dhe shërben si element rakordimi me xhaminë si në aspektin volumor, po ashtu edhe të shkallës së detajit. Arkitekti gjithashtu kujdesët të ruajnë nivelin e salles së lutjeve të xhamisë, nëpërmjet një kornizimi të ndërmjetëm që perimetron të gjithë hapësirën e sheshit duke përcaktuar njëkohësisht edhe lartësinë e dy kateve të para të cilat janë më të larta se kati i tretë. Fragmente të kësaj natyre argumentojnë përmbajtjen "tipike mesdhetare" të këtyre arkitekturave të cilat ndër të tjera, dëshmojnë për politikën urbane të

moderuar që u aplikua në qytetin e Tiranës në periudhën e Zogut, me një kontribut të pamohueshëm të tregëtarëve, intelektualëve dhe borgjezisë së asaj kohe.

2.4. Arkitektura dhe urbanistika gjatë periudhës së pushtimit fashist

Mes viteve 1939-1940, u shfaq një ndryshim thelbësor mes arkitektëve italianë të angazhuar në Shqipëri, një ndryshim që ndodh në të njejtën kohe me politikën e re të pushtimit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Më 7 prill 1939, trupat fashiste pushtuan Shqipërinë duke detyruar Mbretin Zog të jetonte në mërgim. Politika ekspansioniste e pushtetit fashist u përcaktua prej idesë së "mare nostrum" (deti jonë) për Mesdheun, e ngjashme me "Lebensraum" (hapësira vitale) për nazistët. " Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria u transformua në një version miniaturë i Italisë fashiste. Një gjeneral-leitenant përfaqësonte mbretin e Italisë, dhe fincioni i monarkisë kushtetuese u mbajt sërish"(Vickers, 2006; 134). Në lidhje me zhvillimet urbane, në 1939 u formua një institucion i centralizuar në rang vendi me zyra në Tiranë që u quajt "Zyra Qendrore e Edilicjes dhe Urbanistikës së Shqipnis" në krye të së cilës u caktua Gherardo Bosio - arkitekt fiorentin i cili vinte prej një eksperience të ngjashme në kolonitë fashiste të Afrikës Veriore. Bosio bashkë me Giovanni Michelucci në 1931, bëhen promotor të Grupit të Arkitektëve Toskan i cili projektoi stacionin e trenave "Santa Maria Novella" në Firenze në vitin 1933, vepër e cila së bashku me Casa del Faschio në Como të arkitektit Giuseppe Terragni, janë prej objekteve të para moderne të cilat thyen guximshëm kanonet e arkitekturës historiciste në Itali. Në këtë kohë u zhvillua një rrymë e vëçantë arkitekturore brenda modernizmit e cila u quajt "racionalizëm" term ky që edhe pse më i vjeter se 250 vjeçar me iluminizmin francez, rimerr formë brenda arkitekturës moderne italiane si variant më i kontekstualizuar dhe më i monumentalizuar, ndaj purizmit racional që aplikonte Le Corbusier dhe shkolla e Bauhause. Arkitektura rationale në vitet 20', u pa si mënyrë radikale për të shkëputur arkitekturën nga trashëgimia e gjatë ekletike e nëntëqindës. Në mes të këtij debati nga njëri krah qëndronin arkitektë tradicionalistë të grupit "Nëntëqinda" si G.Muzzio dhe G.Ponti dhe në krahun tjetër arkitektët racional të "Grupit 7" dhe M.I.A.R si G.Terragni, G.Pagano, A.Libera, etj. që ndjekin linjën futuriste. Me qëllim që të përhapte idealet e tij në masa, fashizmi zhvilloi një miks të dy rrymave duke krijuar një stil të impiantit klasik, të modernizuar me rregullat e arkitekturës rationale. Ky stil i cili nga propaganda u quajt "arkitekturë mesdhetare" u krijua dhe inspirua prej Marcello Piacentinit i cili ishte arkitekti i oborrit të Benito Musolinit prej 1924'. Nën drejtimin e tij dhe pjesëmarrjen e arkitektëve të tjerë që u përmendën më sipër, u përcaktuan kanonet e stilit të arkitekturës fashiste nëpërmjet projekteve më të famshme në vitet 30', si Qytetin Universitar dhe lagjen EUR të Romës e cila përfundoi në vitet 50'. Deri në 1939 në Shqipëri, inspiruar edhe nga monarkia e Zogut mbizotëronte kryesisht krahu i "nëntëqindës" me Di Fausto dhe Berte. Ikja e Zogut dhe ardhja në fuqi e mëkëmbësit të mbretit Jacomoni, shënon edhe një moment të rëndësishëm për plotësimin e kolazhit të arkitekturës italiane në Shqipëri dhe veçanërisht në Tiranë ku u krye edhe pjesa më e madhe e investimeve urbane. Është me vlerë të ndalemi së pari në planifikimin që ju bë qytetit në këtë periudhë, e cila krahasuar me fazat e mëparshme ka më tepër karakteristikat e një projekti 'total' mbi territor, i cili u ideua por implementua pjesërisht gjatë pushtimit fashist, por u vazhdua në masë integrale dhe me pak ndryshime edhe gjatë regjimit komunist.

Bosio, në dyvjeçarin intensiv të punës së tij në Shqipëri deri në 1941- kur pëson vdekje të parakohëshme, punoi mbi planet rregulluese të Tiranës, Vlorës dhe Elbasanit, të cilat edhe pse nuk arriti ti finalizojë deri në momentin e miratimit në

1943, përsëri ndikoi ndjeshëm dhe në mënyrë deçizive në këto projekte siç dëshmojnë konceptet e ngjashme urbane dhe unitariteti lingvistik i tyre. Maria Concetta Miglieccio shkruan se "personaliteti i Bosos duket se mund të garantojë atë karakter të modernes të pa ndarë nga një ndjenjë monumentalizmi klasik që qeveria italiane kërkon të ngulisë në arkitekturën e kryeqytetit të monarkisë shqiptarë"(Miglieccio në Godoli & Tramonti, 2012; 52). Për planin e Tiranës, Bosio-s fillimisht ju kërkuan dy variante. Njëri parashikonte një qytet komplet të ri me shtrirje në forme gjysëm unaze nga Perëndim deri në Lindje të qytetit egzistues, ndërsa varianti i dytë parashikonte ndërhyrje në brenda qytetit egzistues dhe zonës rreth tij. Sipas K.Miho në varintin e parë " Tirana egzistuese, me pak ndërtime dhe sistemime, do të mbetej gati siç ishte, me argumentimin e ruajtjes të karakterit të saj orjental"(Miho, 2003; 244). Përtej propozimeve utopike karakteristike të urbanistikës së regjimeve totalitare, të cilat shkasnin në absurditet në momentin që nuk bazohen mbi një projekt detyrë të ngritur mbi kërkesa konkrete tregu, në realitet i jepet prioritet variantit të dytë i cili shfaqej më realist dhe me efekt më imediat. Plani do të parashikonte në një periudhë 60 vjeçare dhe do të zhvillohej mbi një sipërfaqe prej rreth 3500 hektar, me një skenar popullsie prej vetëm 180 mijë banorësh. Qyteti zhvillohet rreth trajektoreve gjeneruese historike dhe kompaktësohet sipas një skeme rrugore unazore, ndërsa brendësia e kuartalleve rikonfigurohet tërësisht duke prpozuar blloqe të mbyllura me oborre të brendshme në modelin e qytetit të tetëqindës. Sipas K. Miho i cili i referohet relacionit të planit, objektivat kryesore të planit ishin tre:

- *Krijimin e një qendre të re të qytetit, sipas autorëve, 'të denjë për kryeqytetin e një vendi në zhvillim të plotë';*

- *Përmirësimin e një zoningu funksional të strukturës të qytetit, për bashkërendimin e veprimtarive e shërbimeve heterogjene urbane, me qëllim krijimin e mjediseve të përshtatshme e të kushteve normale për jetën e punën e banorëve;*

- *Organizimin më të mirë të rrjetit rrugor ekzistues, me shtesa e sistemime rrugësh të reja dhe ngritjen e tij në nivelin e një sistemi të avancuar rrezor-unazor."*(Miho, 2003; 246)

Analiza mbi përmbushjen e objektivave në këtë rast do të ishte e tepërt nëse konsiderojmë faktin se fashizmi kapitulloi vetëm pak muaj më vonë miratimit të planit. Gjithsesi, siç u shprehëm më sipër plani i 43'-shit shërbeu si guidë e mëvonëshme e cila u përfshi në projektet e periudhës së socializmit. Kështu bëhet fakt sistemi radial unazor dhe pjesa me e madhe e rrugëve dytësore brenda unazës, pozicionimi i qendrave si dhe zonimi i përgjithshëm vijnë sot me pak ndryshime që erdhen si pasojë e përafrimeve të ndryshme që patën dy sistemet lidhur me ekonomine dhe kapitalin. Në veçanti mund t'i referohemi propozimit për sheshin qëndror i cili rikompozohet duke i dhënë prioritet Bulevardit Musolini - sot rruga e Kavajës, aks i cili përkontë masivisht me "dekumanum" të urbanistikës romake. Kjo shprehet nëpërmjet formes së ngushtë e të zgjatur drejt perëndimit që merr sheshi qëndror i propozuar prej Bosios (fig.15). Ky operacion radikal kryhej duke prishur ndër të tjera ndërtesa Pazarin e Vjetër, Katedralen Ortodokse dhe ish-Bashkisë e cila kish mbetur e vetmuar deri në këtë moment prej pamundësisë për të përfunduar sheshin e Di Faustos në pjesën që prekte hyrjen e pazarit.



Fig. 15 –Propozim për sistemimin e sheshit Skënderbej. G.Bosio. Tiranë 1941 (burimi; AQTN); Fig. 16 –Evolucioni i qendrës së Tiranës sipas rievimeve në 1917, 1957, 1986 (burimi; AKPT);

Sipas M.C.Migliccio "zgjerimi i ri tërthor i bulevardit, i cili vepron gjithashtu si një lidhje midis qytetit të vjetër dhe ministrive, është zinxhiri lidhës midis ndërtimeve të një të shkuare të largët dhe të afërt, të cilat rezultojnë kaq të izoluar nga struktura e re urbane, që nëpërmjet rekonstruksionit të njësisë të boshtit të bulevardit, përfundon me ekzaltimin e pikës fundore të tij, sheshit në të cilin qëndrojnë selitë e Pallatit Litoral, Operas Dopolavoro dhe Rinisë Litorale, të cilat formojnë qendrën reale të re të pushtetit politik në Shqipëri nën tutelën e Italisë." (Migliccio në Godoli & Tramonti, 2012; 53) Projekti i Bosios për sheshin përcakton një rregull të ri duke ju mbivendosur strukturës egzistuese jo vetëm otomane por edhe atë që u zhvillua në periudhën e Protektoratit dhe Mbretit Zog, duke sjell një gjuhë arkitektonike e cila edhe pse propagandon kontekstualizëm, në fakt nuk bën gjë tjetër përveç se riprodhon në mënyrë besnike stilin zyrtar si në aspekte të stilit po ashtu edhe në përmbajtjen simbolike. Primi i ndërtimit të një realiteti të ri urban duke ju mbivendosur egzistuesit e duke prishur objekte përfaqësuese të pushteteve të mëparshme, do të gjej zbatim gjatë ndërhyrjeve në kohën e regjimit komunist kur do të shembet Pazarit i Vjetër për ndërtimin e Pallatit të Kulturës, ish-ndërtesa e Bashkisë së vitit 1931 pjesë e kompleksit të ministrive (në atë kohë Komiteti Egzekutiv) për ndërtimin e Muzeut Kombëtar, si dhe Kishën Ortodokse për ndërtimin e Hotel Tiranës duke përmbushur kështu transformimin total të Sheshit Skenderbej në vitet 80' të shekullit të kaluar (fig. 16).

Nëse i referohemi dy objektivave të tjera që kanë të bëjnë me zonimit funksional dhe rrjetin rrugor, komunistet prej ardhjes në pushtet eliminuan gradualisht ekonomine private duke adoptuar modele urbane të qytetit kompakt marrë nga Lindja. Zonimi dhe programimi i rigjid i hapësirës karakterizoi qytetin gjatë diktaturës komuniste, ndërsa strukturat mikse me lozha e harkada të plota, taracat private të "qytetit kopësht" që imagjinonte Bosio u shndërruan në blloqe godinash tip me shërbime të centralizuara në modelin e superblokut sovietik. Dendësia e parashikuar e popullsisë, për të cilën u llogarit rrjeti rrugor u tregua gjithashtu e pasaktë me kalimin e kohës, por nuk u vu re në gjatë komunizmit sepse numri i automjeteve ishte i kufizuar. Koço Miho duke ju referuar afatit 60 vjeçar të planit të 43' sqaron se "në qytetin e Tiranës, vetëm diçka më pak se ky afat, mbi një truall prej dy mijë hektarësh banon një popullsi prej më shumë se 400 mijë banorësh"(Miho, 2003; 258). Ky trend rritje popullsie ka vazhduar në të njëjtin ritëm gjatë komunizmit dhe periudhës së tranzicionit duke futur Tiranën në qytetet europiane me rritjen më të shpejtë në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullsisë së vendit. Në këto rrethana (duhet thënë që të pritshme edhe për kohën kur u zhvillua plani) një sistem urban më fleksibël në modelin e planeve të urbanistikës modernë, qoftë ajo e qyteteve amerikane të cilat Bosio i kishtë vizituar në 1928 si praktikant "në studion e Mc Kim, Mead & White"(Miglieccio në Godoli & Tramonti, 2012; 81), qoftë sipas modelit të babait të urbanistikës moderne Ildefonsi Cerda dhe modelit të tij Barcelonës. Plani i Bosios për Tiranën qëndron më afër principeve të urbanistikës "Beaux-Art" me forcën e aksit qëndror dhe sheshet monumentale në skaje e parë në një çelës linguistik të modernizmit racionalist. Kjo demonstron edhe në obsesionin e arkitekturës totalitare për përmasat madhështore, simetrinë dhe materiale ndërtimi të qëndrueshme.

Megjithatë, disa zgjedhje taktike që burojnë nga analizat gjeografike dhe ambientale, shfaqen korrekte dhe koherente, siç ishin përcaktimi i zonave industriale në fund të Bulevardit Musolini përgjatë së cilës do ngrihet më vonë Kombinati i Tekstileve që do ti japi zhvillim qytetit në këtë drejtim, si dhe përgjatë lumit të Tiranës në pjesën veriore ku më vonë u pozicionuan industritë për prodhimin e materialeve të ndërtimit. Me ndryshimin e regjimeve vejmë re edhe shmangie disi të qëllimshme të disa zgjidhjeve që mund të kishin patur efekt pozitiv në zhvillimin e qytetit, siç ishte hekurudha Durrës -Elbasan nëpërmjet Tiranës me një stacion treni tangencial në zonën e Tiranës së Re aty ku sot ndodhet sheshi Wilson. Fashizmi ndoqi politikë pushtuese ekspansive më ambicie për të vazhduar drejt Greqisë, ndërsa komunizmi ndoqi politikë izoluese difensive duke i shmangur lidhjet direkte me kryeqytetin, kështu lidhja e shpejtë me Elbasanin u bë vetëm gjatë tranzicionit në fazë të vonë, ndërsa Tirana trashëgoi prej periudhës së socializmit një stacion koke, duke e lënë qytetin jashtë trafikut hekurudhor ballkanik e duke e shndërruar në një xhep me destinacion unik.

Ndërsa planifikimi i kësaj periudhe tregon pamundësitë reale të njohjes dhe analizimit të realitetit të huaj, vepra arkitektonike dhe urbane e Bosios paraqitet më e artikuluar dhe e plotë përse i përket shprehjes gjuhësore arkitektonike. Pasi u vendos për avancimin sipas variantit të dytë të planit rregullues për të cilin flitet më sipër, paralelisht Bosio merr detyrën për projektin e detajuar të Vialle del'Impero (sot Bulevardi Dëshmorët e Kombit) dhe Piazza del Littorio (sot Sheshi Nënë Teresa) bashkë me ndërtesat përfaqesuese të regjimit fashist (fig.17). Qendra e re politike dhe ushtarake u vendos e veçuar prej qendrës administrative ku vazhdoi të qëndrojë qeveria kolaboracioniste lokale, duke u pozicionuar në fundin Jugor të aksit monumental (propozuar fillimisht prej Brasinit në trajta baroke në 1927) në të njëjtin

pozicion ku më parë ishte planifikuar Pallati Presidencial gjatë periudhës presidenciale të Zogut. Projektet përfunduan brenda një viti nga 1939-40 dhe pa humbur kohë filluan punimet për realizimin e polit të ri administrativ dhe sportiv i cili përbëhet prej Casa del Fascio (Pallati Litoral) - sot Universiteti Politeknik i Tiranës si mbyllje qëndrore e aksit monumental, ndërsa në krahun perëndimor Opera e Dopolavoros Shqiptare - ODA, sot Universiteti i Arteve dhe përballë tij organizohet poli sportiv me objektin për Rininë Litorale Shqiptare - GLA e cila lidh sheshin politiko-administrativ me zonën sportive ku u pozicionua ish-stadiumi Qemal Stafa, sot Arena Kombëtare. Urbanistika e sheshit është e thjeshtë dhe komunikuese. Në mënyrë të ngjashme me propozimin për Sheshin Skënderbej, kompozimi hapësinor karakterizohet nga prezenca e një aksi të dytë që pret në mënyrë të tërthortë dhe të menjëhershme aksin kryesor, duke përcaktuar një sekuencë hapësirash në total 5 të shtrira në drejtimin Perëndim-Lindje. Një seri platformash në kuota të ndryshme përcaktojnë së bashku me objektet një hierarki të fortë hapësinore. Platforma qëndrore e konceptuar si foltore mban pozicionin me të lartë e dominues kundrejt sheshit, për të vazhduar në nivel më të ulët me dy platforma në formë xhepoch anësore të vendosura pak këmbë shkalle mbi nivelin e sheshit, në të cilat janë pozicionuar ODA dhe GLA. Sheshi i cili përbën planin më të ulët, përcakton gjeometrinë e tij racionale nëpërmjet një perimetri shkallësh dhe platformash të konceptuara për skulptura që janë vendosur në katër anët e tij.

Sheshi litoral në aspektin arkitektonik karakterizohet prej një hierarchie të qartë volumore e cila mbizotërohet prej Pallatit Litoral me volumin e tij të rëndë e monumental që ngrihet mbi një shkallare e cila ndjek profilin e kodrës ku është vendosur, duke shfrytëzuar maksimalisht pozicionin dominues mbi qytetin. Volumi qëndror persa i përket kompozimit dhe proporcionimit ngjan më Palazzo della Civiltà Italiana (EUR) të Guerrini, Lapadula, Romano i vitit 1937, në drejt finalizimit të ndërtimit në periudhën që po analizojmë. Por, përta i përket trajtimit të fasadës vëmë re ndryshime thelbësore. Nderkohë që EUR në thelb konsiston në një dopje mbështjelle të inspiruar prej Koloseumit të cilën arkitektët e interpretojnë në një çelës modern me gjuhe të pastër racionale duke lehtësuar volumin imponent, Bosio insiston mbi peshën e objektit duke aplikuar çarje të reduktuara dhe veshur volumin me gur artificial, punuar në formën e "bugnato" me një influencë të dukshme me arkitekturën mesjetare fiorentine të cilën e hasim edhe në prezantimin e ballkonit qëndror dhe tek përdorimi i lozhës në hyrje apo në trajtimin e nivelit të sipërm të objektit.

Në lidhje me këtë tipologji Simona Storchi shkruan "ishte një ndërtesë, funksioni kryesor i së cilës ishte selia e partisë në qytetin që e pret atë. Megjithatë, struktura, pozicioni dhe estetika e tyre nuk ishin vetëm në funksion të qëllimit burokratik, por edhe në rolin pedagogjik dhe propagandistik.





Fig. 17 – Sheshi Litoral. Plan dhe vizatime në perspektivë. G.Bosio. Tiranë, 1940. (burimi; AQTN)

Për këto arsye, hierarkia e partisë fashiste këmbënguli në krijimin e një aspekti simbolik për vetë ndërtesat'(Storchi, 2007; 235).Më tej ajo spjegon se këto objekte zakonisht karakterizohen nga prania e 'torre littoria', një kullë që simulonte kullat e këmbanareve që adhurojnë qytetet mesjetare me këmbanaret e tyre që konkurrenin këmbanat e kishave'(Storchi, 2007; 235), ndërsa shpjegon "se modeli për rastin e Casa del Fascio është përpunuar më 1932, kur filluan të ndjekin modelin e pallatit komunal të zhvilluar në Italinë Veriore ndërmjet shekujve XII dhe XIV (Storchi, 2007; 235). Në rastin e Tiranës, "kulla litorale" njehsohet me Pallatin Litoral duke marrë ai vetë rolin e objektit më të lartë në qytet. Në këto kushte mund të flasim më tepër për vlera simbolike të lidhura me sistemin , se sa vlera të mirëfillta tipologjike të cilat sygjerojnë më tepër shtrirje horizontale të objektit. Sipas Storchi eksperiencia hapësinore ishte më e rëndësishme së përdorimi, duke analizuar arkitekturën e Casa del Fascio në Como ajo shprehet se nëpërmjet saj "eksplorohet konfigurimi i Terragnit për nocionin e hapësirës monumentale si një hapësirë në të cilën individi falsifikohet çdo ditë si një subjekt kombëtar dhe si pjesë e fenomenit të kolektivizmit fashist. Në konceptimin e arkitektit kjo u arrit nëpërmjet një eksperience hapësinore vizuale dhe shqisore, e cila bashkonte nocionet e shtëpisë, tempullit dhe monumentit. Ky efekt duhej të merrej përmes krijimit të një ndjenje të re të klasikes që përfshinte shënjesit e traditës dhe modernitetit dhe e bënte historinë të pranishme përmes vizualizimit të saj hapësinor simbolik(Storchi, 2007;.231).

Dy objektet e tjera që kufizojnë sheshin qëndrojnë përballë dhe në janë thuajse e kundërta e njëra-tjetrës . ODA dhe GLA kanë një gjuhë kompozicionale që karakterizohet nga kontraste të forta ndërmjet boshit dhe plotit. ODA shfaqet si një mur i vazhduar në anën Perëndimore me një fasadë të zhvilluar horizontalisht sipas një aksi simetrie qëndrore. Fasada në dy skajet e saj skanohet nga një ritëm vertikal

dritarësh të ngushta e të larta të cilat përsëriten në sekuenca me nga 5 elementë, i njëjti ritëm që përdoret edhe në fasadën qendrore të Casa del Fascio. Po ashtu hyrja qendrore prezanton një lozhë të gërmohet brenda fasadës qendrore pa çarje. Përsëri këtu jemi në prezencë të zgjidhjeve arkitekturore të diktuara prej ideologjisë së sistemit pasi kjo zgjidhje duket e panevojshme dhe problematike nga ana distributive e funksionale, pasi salla e shfaqjeve e cila duhet të trajtohet si volum i mbyllur, ndodhet më e tërhequr në brendësi të parcelës. Në aspektin komunikativ për masat, planet e mbushura të fasadave të objekteve përfaqësuese u përdorën për postera dhe simbole referuese të ideologjisë së sistemit. Ndërsa objekti i GLA-së, karakterizohet nga një qëndrim kompozicional i kundërt duke u prezantuar si dy volume në formë "L" të lidhura me njëra-tjetrën nëpërmjet një kolonade me 9 hapësira që shoqëron të gjithë lartësinë e objektit si një lloj ekrani transparent që ndan dhe njëkohësisht bashkon sheshin administrativ me sheshin sportiv i cili kulminon me hyrjen me shkallaren monumentale të Stadiumit. Nga pikpamja e materialeve të përdorura, Pallti Litoral dhe Stadiumi ndajnë të njëjtin material veshës me blloqe "bugnato finto", ndërsa GLA dhe ODA janë veshur në travertin të bardhë rroman i cili është përdorur edhe në shtrimin e platformave për secilin prej objekteve. Nëse i referohemi gjuhës kompozicionale volumore dhe elementëve të përdorur, gjejmë ngjashmëri edhe pse në shkallë të zvogëluar, me e Città Universitaria (sot La Sapienza), me përjashtim të sekuenca të ritmit e cila në rastin e kryeqendrës së pushtetit ka 7 elementë.

Pas çlirimit dhe vendosjes së regjimit komunist, një jete e re nisi për sheshin dhe objektet monumentale ashtu si për të gjithë trashëgiminë e arkitekturës italiane. Funkcionet e tyre u transformuan sipas dy principësh kryesore, disa prej tyre ndryshuan përdorim në mënyrë radikale shoqëruar me një sens ironie krahasuese karshi përdorimit fillestar, si psh. Casa del Fascio në Universitetin e Tiranës, apo Dopolavoro fillimisht në sallë kongresesh politike e më vonë në Universitet të Arteve, GLA në bibliotekë, muze arkeologjik të qytetit, një palestër stërvitore që u përfundua më vonë, apo Vila Mbretërore në Pallat Brigadash partizane, ndërkohë që disa të tjera ndërjuan vetëm simbologjinë dhe vazhduan funksionin e për të cilin ishin projektuar si psh. Kompleksi i Ministrive, Hotel Dajti apo Zyra Luogotenenciale që u konvertua në Kryeministri. Arkitektura e tyre sot shërben si një dëshmi më tepër për ngjashmërinë që mbartin në thelb regjimet totalitare të shekullit XX. Edhe pse në momentin e ideimit këto arkitektura janë udhëhequr prej parimeve totalitare antidemokratike, duke mohuar kryesisht traditën apo duke e rikornizuar atë brenda arkitekturës për interesa të politikës së kohës, megjithë kontradiktat që ato mbartin të ngurtësuara brenda arkitekturës së tyre, këto objekte sot janë pjesë e çmuar e fondit të trashëgimisë arkitekturore që formon qendrën historike të Tiranës duke luajtur një rol të rëndësishëm në kultivimin e shijeve ndaj arkitekturës moderne të racionalizmit Italian.

3. QYTETI I RI SOCIALIST DHE APLIKIMI I TIJ NË SHQIPËRI

Krijimi i qytetit të ri socialist më tepër se ndërtimin e tij si proces, përfaqëson pikëpamjen e plotë të ideologjisë totalitare si në terma të arkitekturës, po ashtu edhe të organizimit të jetës së përditshme. Ideologjia në atë kohë nuk përbënte thjesht një teori, ajo u shndërrua në praktikë gjithashtu, e cila u zhvillua bashkë me urbanistikën e qytetit duke përcaktuar pejsazhin e dallueshëm të qytetit socialist. Në çdo sistem egziston një tendencë për të treguar forcën mbi shoqërinë dhe pejsazhin urban, por ajo bëhet akoma më e dukshme në regjimet totalitare dhe jo-demokratike. Për regjimin komunist, ndërtimi i qyteteve të reja përfaqësonte ndërtimin e jetës së re, proces i cili zyrtarisht propagandohej si ndërtimi i “Shqipërisë së re”. Ashtu si edhe në shtete e tjera të lindjes, në Shqipëri marksizëm-leninizmi bazohej në përplasjen e egër mes dualizmave, kontraste që shpreh edhe A.Rossi në teonë e tij për qytetin, si psh “e re” dhe e “vjetër”, “individuale- kolektive”, “një dhe shumë”, “unike dhe universale”, duke treguar mjaft qartë se çfarë ishte “e drejta” dhe në të njëjtën kohë cila ishte “e gabuara”. Dialektika marksiste-leniniste konsistoi në një përplasje të vazhdueshme midis të kundërtave me qëllim prodhimin e një mënyrë të menduar homogjen. Mes këtyre dualizmave u zgjodh “jeta e re kolektive” e bazuar në teorinë e masave, e cila në praktikë rezultoi në hierarkizimin vertikal të pushtetit të përqëndruar tek një individ dhe kasta drejtuese pranë tij. Vitet 50’ të shekullit të kaluar të cilat përbëjnë edhe fokusin e këtij studimi, i përkasin periudhës së shpresave të mëdha për rezultatet që pritej të sillnin politikën socialiste jo vetëm në frontin lindor, por edhe në vendet perendimore të cilat gjithashtu vuanin pasojat e varfërimit të shtresës së ulët të popullsisë dhe rritjes së diferencave me shtresat e larta.

Në ish-Bashkimin Sovietik dhe më pas në vendet e tjera të frontit lindor, industrializimi dhe urbanizimi i territorit filloi pas viteve 20’ të shekullit të kaluar. Ky proces pati rëndësi të veçantë për modernizimin e shoqërisë e cila vuante plagët e së kaluarës dhe prapambetjes së thellë të periudhës feudale dhe asaj cariste e cila përqëndroi zhvillimin në disa qendra urbane të rangut të parë si St. Petersburg, Moskë, etj. Ndryshimi rrënjësor u tentua përmes ndërtimit të qyteteve të reja dhe ndërhyrjeve radikale brënda qytetit egzistues, duke shndërruar ambientin e ndërtuar pasqyre të ideologjisë dhe politikave të kohës. Në fakt, të gjitha regjimet totalitare të shekullit 20’, i kushtuan vëmendje të veçantë shndërrimit të qyteteve në një “botë të re, më të mirë”. Sipas Czepczynski: “të ndërtoje një qytet të ri shpesh krahasohej me krijimin e universit”(Czepczynski, 2008; 78) dhe kjo nënkupton kompleksitetin e përfshirë në tërësinë materiale dhe kulturore që i atribuohet kësaj sipërmarrje sublime, e cila shihej si një faktor kryesor në emancipimin e shoqërisë nëpërmjet industrializimit dhe urbanizimit. Ndonëse nisma për krijimin e një bote të re kishte origjinë iluministe dhe mëpas u përçua edhe nëpërmjet Utopistëve të shek.18’, roli dhe rëndësia që i jepet arkitekturës në ndërtimin e qyteteve të reja socialiste zgjeron konceptin teorik dhe aplikativ duke përcaktuar qartë fushën e përfshirjes së kësaj disipline në jetën e përditshme. Sipas Aldo Rossi-t “arkitektura lindi së bashku me gjurmët e para të qytetit; ajo është thellësisht e rrënjësor në formimin e qytetërimit dhe është një artefakt i kahershëm, universal dhe i domosdoshëm”(Rossi, 1982; 21). Historia gjithashtu ka njohur edhe periudha të evolimit gradual të cilat kanë ndryshuar arkitekturën e qytetit por jo besimin dhe vlerat e tij sociale, por në ndryshim nga arkitektura liberale - arkitektura totalitare dhe në veçanti arkitektura socialiste, nën motivimin e krijimit të një shoqërie të re bazuar tek njeriu ideal i Marksit, që përpiqet të shkëpusë të gjitha lidhjet me të kaluarën. Anatemimi i referencave historike,

sidomos i kulturës feudalo-borgjeze shihej në atë kohë edhe si një domosdoshmëri taktike për të zhbërë kontekstin krahasimor, pasi në realitet dhe siç do të tregohet në vijim, arkitektura e realizmit socialist nuk arriti të shkojë përtej ndoshta një surealizmi social i cili në vetvete u materializua duke përdorur referenca historike, të cilat në mënyrë sistematike u alienizuan dhe propaganduan si shprehje të njeriut të ri socialist.

Në Shqipëri, si në çdo fushë tjetër edhe në arkitekturë regjimi ushtroi presion të vazhdueshëm në përmbushjen e politikave të centralizuara lidhur me artin dhe kulturën. Sipas Mosko & Sukaj, në botimin e tyre të shkruar vetëm në vitet e fundit të regjimit dhe deridiku të influencuar edhe nga politika nacional socialiste e atyre viteve, ata pasi vlerësojnë rolin e arkitekturës në edukimin ‘ideo-artistik’ të masave shprehen: “Që në vitin 1948 shoku Enver Hoxha i porosiste arkitektët që “të kenë parasyshtë stilin popullor. Të përpiqen që të krijojnë një stil të përshtatshëm me karakteristikat e vëndit tonë” (Enver Hoxha, Vepra, Vëll. 4 fq.455) ndërsa në Kongresin e VII-të të Partisë, theksohet se “Prapambetja që vihet re në realizimin e frymës e të fizionomisë kombëtare në disa lloje të artit e sidomos në arkitekturë kërkon që të ndërmerren më shumë studime e të bëhet një punë më e madhe kërkimore”(Mosko & Sukaj, 1986; 58). Mosko & Sukaj interpretojnë direktivat dhe kritikën politike si obligim për arkitektët të cilët duhej të ishin në tentativë të vazhdueshme për krijimin e një ‘stili kombëtar’ i cili duhej të përputhej me karakteristikat tradicionale të shtetit Shqiptar por që në fakt realizimi konkret i këtij objektivit tepër madhor, rezultoi disi utopik dhe pothuaj i pamundur duke konsideruar kushtet konkrete kulturore dhe predispozitat e nevojshme për të krijuar një identitet gjuhësor arkitektonik. Në vitet e para të shtetit socialist, pothuaj të gjitha projektet madhore për ndërtimin e qyteteve të reja në Shqipëri u importuan së bashku me financimet nga Bashkimi Sovjetik dhe si të tilla, ju referuan me përpikmëri stilit zyrtar të Realizmit Socialist apo siç ndryshe trajtohet edhe në këtë studim – Stilit Stalinist. Si në këto projekte gjithashtu edhe në projektet e prodhuara nga arkitektët vendas të kësaj periudhë, integrimi i elementëve kombëtar u kufizua vetëm në përmbajtjen dekorative të arkitekturës dhe jo në një rikonceptimin më të thellë të saj. Impianti i përgjithshëm kompozicional ruajti me ortodoksi trajtat e akademike që karakterizuan stilin zyrtar të cilat u implementuan pa shumë ndryshime në të gjitha vendet e Paktit të Varshavës.

3.1. Ngjashmëri dhe ndryshime midis qyteteve të reja socialiste dhe atyre kapitaliste.

Qytetet e para socialiste të quajtura ndryshe “Sotsgorod”, u planifikuan me ndihmën e disa prej arkitektëve idealistë me pikpamje të majta të shkolles perëndimore ndër këta Ernst May, Hannes Meyer, Mart Stam, etj. Këto qytete që i perkasin kulturës moderniste-konstruktiviste të fillim shekullit XX, shfaqin shumë ngjashmëri me qytetet industriale perëndimore edhe si pasoje e influencës që pati levizja gjermane Neue Sachlichkeit (Objektivizmi i ri) dhe shkolla e Frankfurtit. Qyteti i ri socialist u krijua si përgjigje ndaj mendimit se sistemi kapitalist dhe ideologjia e zhvilluar gjatë shek. të 19, ishin në kontradiktë me njëri-tjetrin. Kontradikta mund të zgjidhej vetëm duke rrëzuar ideologjinë borgjeze dhe duke e zëvendësuar atë me ideologjinë e re Marksiste. Sipas Kargon & Molella duke ju referuar qyteteve të reja socialiste: “Techno-Qytetet ishin pasardhësit e shekullit të njëzet të qyteteve të punëtorëve të Revolucionit Industrial”, më tej vazhdojnë “për shkak se ata janë ndërtuar të lidhura me projekte të mëdha teknologjike ose industriale, techno-qytetet janë vecanërisht interesante për të kuptuar marrëdhënien komplekse midis teknologjisë dhe mjedisit të tij social në epokën industriale dhe post

industriale”(Kargon & Molella, 2008;12). Sipas interpretimit të tyre të historisë botërore, Marksistët e quanin veten progresistë dhe bazonin progresin tek shoqëria drejt ambientit të ndërtuar, duke ju kundërvënë Utopistëve të cilët shikonin zgjidhjen të krijimi i ambientit për emancipimin e shoqërisë. Në realitet, siç do të shprehet më poshtë nuk pati shumë ndryshim midis teorive sepse utopizmi karakterizon edhe zhvillimet në qytetin socialist.

Në thelb, axhenda për industrializimin i kategorizon këto qytete si projekte moderniste, perfshi këtu tiparet utopike të cilat u shfaqën në sfumatura të ndryshme edhe në sferën perëndimore përgjatë viteve të para të industrializimit. Në Shqipëri, pas Luftës së II Botërore, qeveria e re komuniste duke analizuar situatën konkrete, kuptoi se vendi kishte humbur pjesën më të madhe të zbulimeve teknologjike e shkencore të botës së zhvilluar. Si pasojë, vihet re një rendje e paprecedentë drejt zhvillimit industrial e cila kërkonte të prekte çdo pjesë të shoqërisë. Dukej sikur kërkonin të prezantonin njëherësh dhe sëbashku Revolucionin e Parë dhe Revolucionin e Dytë industrial duke u fokusuar fillimisht tek industria e lehtë si ajo tekstile dhe ushqimore, për të kaluar më pas tek industria e rëndë e prodhimit të energjisë elektrike, prodhimit të çelikut e për të vazhduar me industrinë e prodhimit në masë dhe në seri duke u përpjekur të ndjekin me përpikmeri hapat e zhvillimit në vendet e tjera të Lindjes, pa marrë parasysh rrethanat dhe nevojat konkrete të ekonomisë dhe zhvillimit. Kjo karakteristikë utopike e regjimit socialist në Shqipëri u bë akoma me dukshme me përparimin e sistemit dhe sidomos gjate fazës së vetizolimit nga mesi i viteve 70’ kur edhe pse egzistonte tashmë një treg shumë i reduktuar, sektori industrial sforcohej të mbante hapur prodhimin në seri.

Edhe pse i përkasin të njëjtës periudhë, asaj të industrializimit, është e vështirë të gjesh ngjashmëri në thelb të qyteteve industriale socialiste me modelet e qytetit industrial kapitalist. Qyteti Kopësht i teorizuar prej Ebenezer Howard në vitin 1890 është ndoshta modeli më përfaqësues i cili shërbeu si bazë për projektet e qyteteve industriale të botës perëndimore dhe siç do të tregohet më pas edhe për qytetin industrial socialist. Në publikimin e tij “To-morrow: a peaceful path to real reform” (E nesërmja: një shteg paqësor drejt reformës së vërtetë) të 1889, nëpërmjet modelit të “qytetit kopësht” jepet një metodë kontrolli për rritjen e papërmbajtshme të Londrës në epokën e industrializimit. Rrugëzgjdhja për të ishte një nga modelet e para të decentralizimit apo “disurbanizimit” siç quhej në atë kohë. Kjo arrihej nëpërmjet ndërtimit të disa qendrave urbane në formë “satelitësh”, të shkëputura prej njëra-tjetrës të cilat shiheshin si një kombinim i qytetit me fshatin duke përzier natyrën brenda një territori të urbanizuar me dendësi të ulët. Pavarësisht rezultateve që sjell ky model në rritjen e standartëve të jetësës për klasën punonëtore, në thelb konsistoi në një model shpërhapje spekulative në territor i cili konsumonte resursin truall dhe rriste në menyrë të ndjeshme kostot e transportit nga qendra e banuar në qëndrën e punës.

Qyteti socialist në realitet kërkon të krijojë një antitezë ndaj modelit të njohur perëndimor. Siç shkruan Miljutin: “mjedisi urban socialist do të jetë më ndryshe nga ai i cili vëmë re sot në qytetet apo fshatrat tona. Nuk do të jetë as kjo e as ajo [...] Në momentin që heqim përqëndrimin e industrive do të pushojë së ekzistuari edhe qyteti i mbipopulluar dhe për pasojë nuk do të ketë më arsye që të ekzistojë ideja e ‘qytetit - kopësht’, apo të qytetit të gjelbërt”(Miljutin, 1971;62). Në fakt të dy këto modele flasin për decentralizim dhe shmangien e përqëndrimit të popullsisë rreth qytetit historik duke përfaqësuar në thelb një reforme territoriale të bazuar mbi teorinë Marksiste të kolektivizmit, por në ndryshim nga qyteti socialist - qyteti kopësht është ndërtuar i shkëputur prej zonave industriale të përqëndruara. Ndërsa qyteti socialist e

konsideron zonën industriale si vetë thelbin e qytetit të ri i cili ndërtohet pranë saj dhe për atë duke e konsideruar fabrikën si pjesë të vazhdueshme të ambientit urban. Ky koncept i cili lindi gjatë kulturës konstruktiviste, njohu vazhdimësi edhe gjatë viteve të regjimit stalinist kur u zhvillua më së tepërmi ideja e qyteteve mono-industriale dhe kur qyteti personifikohëj nëpërmjet industrisë. *Karakteristikë tipike e qytetit socialist është organizimi i tij si njësi prodhimi ku ndërtesat rezidenciale dhe njësitë industriale janë ekonomikisht dhe kulturalisht të integruara.* Sipas Miljutin “çdo industri e re duhet lidhur racionalisht me zonën rezidenciale dhe me impiantet ndihmëse të prodhimit” (Miljutin, 1971;66). Vetë Miljutin në librin e tij prezanton si alternativë modelin e *qytetit linear* i cili karakterizohet nga një zhvillim i qytetit në formë shiriti linear të vazhduar duke i dhënë prioritet lëvizjes, koncept të cilin e gjejmë fillimisht tek urbanisti spanjoll Sorya Y Mata në vitin 1882. Qyteti linear në thelb konsiston në një zhvillim policentrik i cili lidh disa pole prodhimi apo banimi në vazhdimësi të një aksi levizje. Ky model për kohën shihet si një antiteze ndaj qytetit tradicional i cili koncentron vlerat në një qendër të vetme apo siç mund të quhet ndryshe qyteti monocentrik. Projekti për qytetin e ri socialist ishte projekti për qytetin e së ardhmes. Ëndrra marksiste siç përshkruhet nga Miljutin, bazohej në afrimin gradual të qytetit dhe të fshatit dhe kjo do të realizohej nëpërmjet mekanizimit të industrisë agrare. Në Shqipëri ishte shumë e përhapur shprehja e asaj kohë “ta bëjme fshatin si qyteti”, shprehje e cila mbeti brenda kontureve të propagandës pasi diferenca ndërmjet të dyjave erdhi duke u shtuar me maturimin e sistemit dhe qyteti mbeti një ënderr e përgjithshme migrimi.

Në ndryshim nga qyteti industrial perëndimor, në implementimin e projekteve për qytetet socialiste shteti luan një rol qëndror, sipas Kopp “shteti u bë i vetmi përgjegjës lidhur me çdo gjë që kishte të bënte me rezidencën e banimit, urbanistikën dhe organizimin e territorit” (Kopp, 1987; 31), dhe si i tillë vetë qyteti shërbeu si promotor i propagandës së regjimit. Grupi i arkitektëve nga Universiteti i Moskës në fund të viteve pesëdhjetë e përshkruajnë qytetin socialist si kulminimin më sipëror të të gjitha vlerave kulturore që ka një shoqëri, konkretisht ata shkruajnë “*qyteti materializon arritjet më të larta të kulturës sonë materiale dhe shpirtërore: si një organizim gjithpërfshirës, ai lidh rezidencën me fabrikën, të kaluarën me të ardhmen, individin dhe shoqërinë*” (Gutnov et al, 1968; 5), ndërkohë qytetet industriale perëndimore janë parë më tepër si një politikë që pati lidhje me pasurinë e patundshme dhe me mundësinë për zgjerim të qyteteve egzistuese, duke mos ju kundërvënë në asnjë moment trashëgimisë kulturore të qyteteve historike. Ndërsa në perspektivën e qytetit socialist, e veçanta i nënshtrohej vlerave të kolektives duke dënuar rëndë çdo lloj deviacioni. Në tërë këtë totalitet kolektiv, e veçanta ishte diçka e harruar dhe e humbur mes vlerave të konsideruara më të rëndësishme sipas rankimit të teorisë Marksiste. Sipas Czepczynski: “Qyteti socialist ose *socgorod* nuk ishte projektuar për të jetuar një jetë më të mirë, por mbi të gjitha për të mbështetur zhvillimin industrial” (Czepczynski, 2008; 78). Në arkitekturë kjo u përkthye me godinën e veçuar e cila riprodhoi të njëjtin trend në vazhdimësi duke vene me tepër theksin mbi unitetin organizativ të qytetit, sesa mbi arkitekturën në veçanti.

Së fundmi është me rëndësi të theksohet mungesa e informacionit dhe analizave teorike mbi qytetin industrial socialist, sidomos kjo krahasuar me rastet perëndimore të cilat gjenden gjerësisht të dokumentuara në literaturë. Ky ishte dhe fokusi i punës French dhe Hamilton (1979). Ata tërhoqën vëmendjen tek neglizhenca ndaj qyteteve të botës socialiste, krahasuar me literaturën voluminoze mbi strukturën urbane në Amerikën e Veriut dhe Europën Perëndimore. Edhe pse më vonë shkrimet mbi urbanizimin dhe arkitekturën në Europën Lindore dhe Bashkimin Sovjetik u

zgjerman më pas me autorët si Bator (1980) Andrusz (1984), Morton dhe Stuart (1984), por siç thekson më vonë French (1987), “gjeografia e brendshme e Qytetit [socialist] gjithsesi mori një vëmendje të kufizuar”(Smith, 1996; 71).

3.2. Evolucion i konceptit urban tek qytetet e reja socialiste.

Një rol të rëndësishëm në konturimin teorik të kulturës urbane socialiste, pati edhe pakti i domosdoshëm me *funksionalizmin* i cili gjen origjinën e tij që prej fillimeve të lëvizjes konstruktiviste duke u shndërruar në vazhdim në kohën e Stalinit në të ashtuquajturin *realizëm socialist*. Formulimi teorik i funksionalizmit në objektet e ndërtimit mund të gjurmohet që në treshen e famëshme vitruviane, ku 'utilitas' (ndryshe përkthyer si 'përdorim' apo 'dobishmëri') qëndron pranë 'venustas' (bukurisë) dhe 'firmitas' (qëndrueshmërisë), si një nga tre qëllimet klasike të arkitekturës. Pikëpamjet funksionaliste ishin tipike edhe për disa arkitektë të revolucionit gotik të cilët në thelb nuk pranonin asnjë dekor në objekt nëse nuk shërbente për vlerësimin e përfunduar të strukturës. Pas Luftës së Parë Botërore, lindi një lëvizje ndërkombëtare arkitektonike funksionaliste si pjesë e një vale të modernizimit që pushtoi të gjitha shtetet e industrializuara. Idetë u frymëzuan në masë të madhe nga nevoja për të ndërtuar një botë të re dhe më të mirë për njerëzit, të shprehur gjerësisht dhe fuqishëm nga lëvizjet shoqërore dhe politike të Evropës së pas luftës. Në këtë drejtim, arkitektura funksionale shpesh lidhet me konceptin politik të socializmit dhe humanizmit modern. Mbi këtë subjekt Groys vë në dukje se “realizmi socialist nuk pati për qëllim të pëlqej nga masat – ai kërkonte të krijonte masa që do ta pëlqenin atë” dhe më tej vazhdon “Marksizmi ndau shoqërinë jo në raca, por në klasa – kështu që vendi ku qenia njerëzore ishte pozicionuar në kuadër të procesit teknologjik të prodhimit, u bë më i rëndësishëm se habitati natyror i njeriut.[...] Në traditën më të mirë Hegelianë, qenia njerëzore konsiderohej si potencial i pastër nga ideologjia sovjetike, si një asgjë e lëngshme që bëhet diçka vetëm nëse i jepet një funksion të caktuar, një rol në procesin e ndërtimit të jetës socialiste”(Groys, 2011; 122). Planifikimi socialist në vetvete, pati si synim racionalizimin e përdorimit të truallit dhe resurseve dhe kjo u realizua nëpërmjet ndarjes së ambientit urban në mënyrë funksionale mbi bazë e përcipeve të zonimit rigjid, i cili u aplikuar gjerësisht në qytetin socialist jo vetëm në fazën e parë të modernizimit siç ndodhi në shtetet perëndimore, por edhe në vazhdimësi. Pavarësisht kësaj specialistët sovjetikë shprehin objektiva edhe më të larta, siç ishte konceptimi më organik e metabolik i territorit duke ju referuar parimeve më të mira të teorisë Marksiste, përpjekje që në fakt në rastin e Shqipërisë, duke ju referuar planeve urbanistike të Tiranës në vite, nuk u verifikuan as në rastet e para dhe as në vazhdimësi të regjimit. Historiani Ching, i cili bën një përmbledhje të pikëpamjeve teorike të lëvizjeve kulturore moderne në Bashkimin Sovjetik të pasrevolucionit, duke ju referuar konstruktivizmit rus shprehet se: " Edhe pse shumica e arkitektëve Rusë u dalluan nga disa prej funksionalistëve Evropian, duke argumentuar se arkitektët duhet të punojnë në një plan më të lartë se ai i funksionit të pastër, ka pasur goxha debate rreth kuptimit dhe vlerës së saktë të teorisë estetike dhe marrëdhënieve të saj me teknologjinë, politikën dhe funksionin”(Ching et al, 2011;715). Po ashtu, vetë arkitektët dhe urbanistët moskovitë në vitin 1967 pranojnë se: “funksionalizmi luajti një rol revolucionar në historinë e arkitekturës. Megjithatë, duke qartësuar atë që është thënë më parë, funksionalizmi (pavarësisht nga risia e koncepteve të tij) është në njëfarë kuptimi arritja kurorëzuese e arkitekturës klasike. Revolucion i vërtetë vjen me planifikimin e një mjedisi urban të unifikuar”(Gutnov et al, 1968; 166).

Që në fillim të viteve 30', qyteti socialist shfaq karakteristikat e veta organizative të karakterit produktivist, të cilat vinin në plan të parë binomin kolektiv-prodhimin. Ky qëndrim i cili u kthye edhe koncept urban, shihej si një menyrë me efektive dhe racionale për organizimin e prodhimit se sa principi i grupimit të industrive në bazë të cilit funksiononte qyteti kopësht. N.A.Miljutin, politikan-arkitekt-urbanist, përfaqësues i fazës së parë të ndërtimit të qyteteve socialiste, në traktatin e tij të urbanistikës - Socgorod botuar në vitin 1930 shprehet: “ Ndërtimi i ri sovjetik duhet të tentojë në realizimin e një kompleksi prodhimi unitar dhe ekonomikisht të integruar [...]. Përveç kësaj, çdo industri e re duhet të lidhet në mënyrë racionale me një zonë banimi dhe me impjantet ndihmese përkatëse (ferma, stalla, baxho, etj.) [...] nuk behet fjalë të ndërtohen qendra industriale apo të tipit tjetër, por të krijohen nukle ekonomik-prodhues, të cilave mund t'i bashkohet edhe një qendër banimi e paisur me shërbime, institucione kulturore, sociale, shkencore dhe edukative, përfshi impiante prodhimi ndihmese ”(Miljutin, 1971; 66). Më tej duke hyr në specifika të zonave të vëçanta të qytetit industrial, Miljutin thekson se: “zona residenciale e qendrës së banuar duhet vendosur paralelisht me zonën e destinuar për aparatet e prodhimit dhe të ndahet prej saj me anë të një fashe gjelberimi e cila nuk duhet të jetë me pak se 500 metra”(Miljutin, 1971;78). Në këtë mënyrë sipas tij, sigurohet një proksimitet i nevojshëm midis fabrikës dhe qendrës së banuar i cili bën të mundur lëvizjen në këmbë pa patur nevojë për mjetet e transportit privat apo publik (fig.18;19). Përgjatë të gjithë tekstit, duket se i vetmi preokupim i rëndësishëm për planifikuesit duhej të ishte racionalizimi absolut i resurseve dhe përqendrimi në një territor të kufizuar industrive shpesh herë tepër ndotëse me zonat e banuara. Në realitet, shumë shpesh kushteve teknike minimale të përcaktuara i mbivendoseshin rrethana fizike por edhe politike, duke krijuar ambiente urbane aspak kompaktibër për zhvillimin normal të kërkesave jetësore. Në Shqipëri, mund të përmendim shume raste të zonave industriale problematike në lidhje me ndotjen e zonave të banuara si psh. Kombinati i Tekstileve Stalin i cili do të analizohet më vonë, por edhe raste të tjera si Rrafineria e Naftes Cerrik, Kombinati i Perpunimit të Naftës në Ballsh, apo rasti më flagrant ai i Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit mbi të cilin ka rekorde të shumëta mbi parametrat e ndotjes në zonat e banuara.





Fig 18 – Skema e planifikimit të fabrikës së traktorëve të Stalingradit, sipas sistemit funksional “zinxhir”. Fig 19 – Vendbanimi i klasës punëtore i propozuar nga OSA - qyteti linear konstruktivist. Ivan Leonidov, Magnitogorsk. 1930 (burimi: Socgorod. fq.90;145)

Në vitet në vijim teoria urbane miljutiniane e ngritur nën guidat e përgjithshme të teorisë marksiste, pati evolucion të konsiderueshëm edhe pse në thelb mbetën të njëjtat principe të cilat synonin në ndërtimin e binomit njeri-prodhim. Në 1957, një

grup i akademikëve të arkitekturës nga Universiteti i Moskës botoi një libër të quajtur *Novye Elementy Rasseleniia* ose "Elemente të reja të banimit" (fig.20). Ky ekip i arkitektëve dhe planifikuesve socialistë i kryesuar nga Alexei Gutnov, u bë i njohur si "Grupi NER" ("*New Element of Settlement*"). Një dhjetëvjeçar më vonë, vitin 1968 ata u ftuan në Triennalen e Milanos nga Giancarlo de Carlo për të prezantuar planet e tyre për një qytet ideal komunist. Në bashkëpunim me një grup urbanistësh të rinj, arkitektësh dhe sociologësh, ata krijuan një edicion italian të librit të tyre nën titullin "Ide për Qytetin Komunist". Siç shpjegon Gutnov mbi këtë projekt "Njësia e Re e Banimit (NER) mund të krahasohet me një organizëm të gjallë, që ka si tru ashtu edhe një zemër. Lidhjet funksionale mund të realizohen plotësisht. Hapësira në këtë lloj të ri qyteti reflekton harmoninë dhe racionalitetin e strukturës sociale dhe ekonomike." (Gutnov et al, 1968; 154). Me tej, në lidhje me arkitekturën ata shprehen: "Një organizim i unifikuar shoqëror, një bazë e unifikuar teknike dhe industriale dhe një përbërje artistike e unifikuar janë elementet që përbëjnë mjedisin tonë urban. Është detyrë e arkitekturës të flasë me njerëzit në gjuhën e formës, ngjyrës, dritës dhe hapësirës. Kjo gjuhë ka një ndikim emocional në të gjithë njerëzit dhe nuk mund të reduktohet si nënprodukt i planifikimit arkitekturor. Ajo është përmbajtja autentike e arkitekturës." (Gutnov et al, 1968; 156)

Këto ide tepër novatore për kohën, mund ti gjejmë pothuaj paralelisht në kohë dhe tek Stukturalistët europianë apo Metabolistët japonezë, por jo me një artikulacion të tillë në shkallë planifikimi. Nderkohë që SHBA ishte impenjuar kryesisht në çështje që trajtonin raportin me historisë dhe kontemporanitetit brenda një simbolike populiste të cilat artikuloreshin përmes gjuhës së Postmodernistëve, urbanistika sovietike në këtë kohe shënon një avancim të rëndësishëm duke kaluar prej konceptimit funksionalist linear i cili pasqyrohet në privipet e zonimit tradicional, tek perceptimi në kompleks i organizimit hapësinor duke ju referuar organizmave urban të veçuar dhe komunikimit ndërmjet tyre. Ky konceptim i strukturuar në një shkallë të tillë planifikimi bëhej kryesisht i mundur si pasojë e organizimit të përgjithshëm të ekonomisë së planifikuar e cila gjatë këtyre viteve i jep preçedence absolute sistemit të centralizuar përkundrejt liberalizmit karakteristik perëndimor (fig 21-23).

Nëse futemi në detaje të konceptit të grupit NER, mund të përmendim se propozohen tre sisteme/ nivele të ndërveprimit social:

1. *Kompleksi kërkimor*: një kombinim i laboratorëve, projekte eksperimentale në kultivimin e kafshëve dhe bimëve, klasat, bibliotekat dhe ndërtesat për personelin administrativ;
2. *Kompleksi rezidencial*: banesa, çerdhe, kopshte, shkolla fillore dhe të mesme, parqe komunitare me objekte dhe zona per kohën e lirë, si dhe shërbime të tjera publike.
3. *Kompleksi industrial*, i cili gjithashtu përfshin prodhimin e organizuar bujqësor.

Legjenda;

1. Njësitë e banimit
2. Shkolla dhe zona sportive
3. Transporti i shpejtë mbi nivelin e këmbësorëve
4. Autostrada
5. Qendra e Komunitetit e NUS

Sektorët janë planifikuar si rreze rreth qendrës së NUS, e cila përqëndron vëmendjen tek parku i madh i komunitetit dhe në qendrën social-kulturore. Këto së bashku zënë një sipërfaqe prej 200 acra (8ha). Sektorët e banimit janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe me komplekset industriale të vendosura tre deri në katër milje larg nga një sistemi i transportit publik. Trafiku i motorizuar qarkullon në një autostradë periferike, me përjashtim të rrugës që i kalon apërmes dhe merr për në qendër. Rrugët që degëzohen nga kjo mundësojnë hyrjen në të, por të nuk ndërpresin zonat e banimit, arsimore dhe rekreative.




Fig.20 – Diagrama e NUS. (burimi: Qyteti IdealKomunist, fq.118)




Fig 21 – Grupi NER, strukturë rezidenciale p...no, nga
arkiva e egrupit NER. Burimi: <http://grahamfoundation.org/grantees/5455-paper-cities>
Fig 22 – Grupi NER në Institutin e arkitekturës së MOSKES (MARKHI) (burimi:
<http://grahamfoundation.org/grantees/5455-paper-cities>)




Fig 23 – Grupi NER, maket i qendrës urbane përgjatë kanalit të transportit. 1968 Triennale Milano, nga arkiva e e grupit NER. (burimi: <http://grahamfoundation.org/grantees/5455-paper-cities>)

Ajo që në propozojmë, janë tekstura vendbanimi që bazohen në grupime popullesie. Duke vepruar në këtë menyrë, ne po i përgjigjemi tendencës së përgjithshme që shkon drejt disintegrimit funksional tek qytetet moderne”(Gutnov et al, 1968; 28). Organizimi i qytetit në zona komplekse shihet nga arkitektët sovietike në këtë kohë, si një përgjigje që tenton drejt një organizmi urban më të integruar se sa struktura qendër-periferi e qytetit përëndimor e cila, sipas tyre shkakton probleme të përdorimit të zonave me orare, mbingarkesë qarkullimi dhe diferencim hirarkik të popullsisë. Ndërkohë që komplekset sipas NER, ishin konceptuar për një përmbajtje të diversifikuar të popullsisë ku do të banonin nga klasat drejtuese tek klasat punëtore. Qyteti i Alexei Gutnov dhe ekipit të tij, sot mund të shihet si një axhendë hapësinore konkrete për marksizmin, e ngjashme me inisiativa paraprake të Socgorodeve Miljutiniane por në një shkallë më të evoluar, duke parashikuar dimensione më të medha qytetesh dhe integrueshmeri më të mirë territoriale. Ndërkohë kritika përëndimore shokon me rezerva këto arritje. Sipas Smith “në projektet urbane Sovietike, rezidencat mikse do të zgjidhnin çdo tendencë të ndarjes së shtresave sociale apo shfaqjen e sjelljeve borgjeze, të paktën sipas lagjeve apo akoma më mirë sipas blloqeve të banimit. Dëshmitë e forta mbi shkallën në të cilën është arritur kjo përzierje janë të rralla, por ndoshta ishte më pak se sa ideali socialist”(Smith et al, 1996; 83). Më tej sipas Gutnov etj.: “Parimet themelore që rregullojnë NUS ishin:

1. *Lëvizshmëri e barabartë për të gjithë* – zonat rezidenciale janë në një distancë këmbësore të barabartë nga qendra dhe nga pyjet dhe parqet që i rrethojnë ato.
2. *Distancat janë projektuar në shkallën e këmbësorëve* – asnjë shtëpi nuk është aq larg nga qendra apo nga zona e parkut sa të mos arrihet në mënyrë të arsyeshme nga një ecje e shkurtër.
3. *Eliminimi i rrezikut nga trafiku i automjeteve.* Transporti i shpejtë publik që vepron jashtë zonës së këmbësorëve sërisht është i lidhur me qendrën e NUS .

4. *Brezat e gjelbërt*. Çdo sektor është i rrethuar të paktën nga dy anë nga hapësirë e hapur.’(Gutnov et al, 1968; 117)

Sipas parimit marksist të barazisë dhe horizontalitetit, por edhe qëllimit konkret të minimizimit të kostove për infrastruktura transporti, urbanistika socialiste ishte idealisht kundër krijimit të periferive. Por, me kalimin e kohës ky objektiv u tregua utopik dhe i përcaktueshëm dhe me dobësimin e sistemit vihet re avancimi i procesit të urbanizimit nëpërmjet zgjerimit të qendrave egzistuese. Edhe pse fillimisht mendohej se qyteti i ri socialist, u bazua në idenë e Qytetit Kopësht, me kalimin e kohës u transformua në një qytet industrial pa një zonë periferike, ndërkohe që në teorinë e Qytetit Kopësht nuk egzistonte ideja e eliminimit të periferisë. Kjo zgjidhje që lidhej me mobilitetin dhe përdorimin racional të resurseve, efektivisht përkon me zgjidhje të ngjashme për qytetet industriale të periudhës premoderne ku njerëzit banonin afër fabrikës. Pra, ndërkohë që Gutnov etj. hedhin konsiderata mbi qenien biologjike dhe nevojat fiziologjike të njeriut, ai nuk jep një zgjidhje konkrete lidhur me konfortin ambiental të qendrave të banuara dhe në këtë pike nuk përbejnë evoluim të konsiderueshëm në krahasi me qytetin linear të Miljutin. Gjithsesi parimet që u shfaqën në atë kohë të cilat bazohen mbi një sfond parimor humanist me origjinë prej Iluminizmit, në i ndajme gjerësisht edhe sot, pa dallim sistemi dhe kohë. Planifikimi i qyteteve duke ju referuar në menyrë të drejtperdrejtë resurseve, kursimi i territorit urban, nxitja e popullsisë drejt një jete komunitare, kombinimi i hapësirave funksionale sipas parimeve të proksimitetit dhe shmangia e shtrirjes së egzagjuar të periferive, janë objektiva gjithmonë aktuale të cilat bëhen akoma më të nevojshme me maturimin e modernitetit dhe shtimit të popullsisë globale. Siç shprehet Kumriski, për grupin e akademikëve të arkitekturës nga Universiteti i Moskës “shqetësimi kryesor i planifikuesit ishte siguri i barazisë sociale. Kjo u pa tek preferenca e tyre për transportin publik ndaj automjeteve private, banesa me dendësi të lartë ndaj shtëpive private të shkëputura duke maksimizuar zonat e përbashkëta. Kritikat për shpërhapjen suburbane kanë njëfarë rezonance në shkrimet e planifikuesve që mbrojnë rritjen inteligjente (smart growth) edhe sot. Të dy shohin përfitime tek strehimi me densitet të lartë. Ata argumentojnë se kështu është më e barabartë që të gjithë, pa marrë parasysh se çfarë klase sociale i përkasin, mund të jetojnë në të njëjtën tipologji ndërtesash. Sot, gjithashtu disa pjesëtare të New Urbanism pëlqejnë idenë e komuniteteve me të ardhura të përziera. Përveç kësaj, të dy grupimet e shohin komunitetin e tyre ideal duke shfrytëzuar zhvillimin e përdorimit të përzier, duke u siguruar njerëzve akses të lehtë në shërbimet publike si për nevojat ditore, restorantet dhe parqet, duke krijuar më pak nevojë për hapësira private. Në mënyrë të ngjashme, New Urbanist-et pohojnë gjithashtu se zhvillimet e tyre të planifikuara do të nxisin një ndjenjë më të mirë të komunitetit”(Kumriski, 2015).

Projekti për qytetet e reja në Rusi mund të shikohet edhe si i lidhur me operacionet e deurbanizimit të cilat kanë qënë pjesë e një ideologjie globale me origjinë marksiste, e cila gjeti tentativa për aplikacione të shumta edhe në botën perëndimore, por që në thelb mbartin gjithmonë një lloj utopie e cila provokohet prej reduktimit në pak arsye të vetë egzistencës së qytetit. Manfredo Tafuri mbi këtë çështje shprehet: “mund të vërehet se utopitë anti-urbane kanë një vazhdimësi të tyre historike që prej propozimeve të Iluminizmit - dhe në këtë drejtim, nuk duhet të harrojmë se teoritë e para anarkiste mbi nevojën për “shpërbërjen e qyteteve” shfaqen në gjysmën e dytë të viteve 1700 – arrijmë tek teoria e qytetit kopësht, tek deurbanizmi sovjetik, tek modeli i Siedlung, tek rajonalizmi i Shoqatës së Planifikimit Rajonal të Amerikës (RPAA), qyteti Broadacre i Frank Lloyd Wright [...] ajo që shprehet është një nostalgji e thellë për sektin fetar alien ndaj organizimeve të

jashtme, për një bashkim subjektsh që nuk njohin ankthin e tjetërsimit metropolitan” (Tafuri, 2007; 110), jo pa konotacione marksiste të mendimit të tij teorik, analizon këtë trend si një reagim ndaj kushteve të metropolit bashkohor, i cili si i tille nuk sjell një kendveshtrim origjinal përtej utopise së “komunitetit organik” të sociologut gjerman Ferdinand Tönnies. Duke konkluduar ai shprehet “Ideologjia antiurbane, sigurisht, paraqet një fytyre anti-kapitaliste [...]. Por, ankthi i saj i drejtuar kundër “metropolit çnjerëzor” të dominuar prej fluksit të parasë, nuk është tjetër veçse nostalgji, refuzim i niveleve më të larta të organizimit kapitalist, aspiratë për regres drejt femijerisë së njerzimit.”(Tafuri, 2007;112) Edhe pse elemente te deurbanizimit kishin filluar më parë në hapësirën perëndimore, fenomeni masiv në hapësirën sovjetike u shfaq pas viteve 30’ të shekullit të kaluar. Shumë ndarje ideologjike në këtë periudhë donin të shkëputeshin nga e kaluara dhe të krijonin diçka të re. Siç shprehet edhe Tafuri në citimet mësipër i cili flet për “sekt fetar”, në rastin e Rusisë ideja e progresistëve ishte të krijonin një shoqëri urbane artificiale e cila do të bënte të mund krijimin e *njeriut të ri* , një qenie aliene ndaj historisë dhe trashëgimisë, e brumosur me idetë dhe parimet e reja të bazuara në idealet komuniste.

Shembujt më tipik të qyteteve të reja, në vendet socialiste të Bllokut Lindor në fund të Luftës së Dytë Botërore, përfaqësohen nga Qyteti i Nová Dubnica në Slloveni (fig.24), si dhe Dimitrovgrad në Bullgari (fig.25) . Ndërkohë Magnitogorsk, Traktorstroy dhe rreth 1000 qytete të reja u ndërtuan në kohën e Stalinit në Bashkimin Sovjetik (1924-1953). Ndryshe nga fashistët, bolshevikët dhe, më vonë, partitë komuniste, deklarohen hapur kundër çdo forme fetare. Nuk ka kisha në qytetet e reja, dhe ato në qytetet dhe fshatrat ekzistuese u shkatërruar dhe braktisën. Në këtë kontekst, roli i ndërtesave publike, si teatri ose stadiumi, përmbysen nga shoqëria e re socialiste dhe forma të reja të ndërtesave klubi i punëtorëve, klubet e librit, pallatet e kulturës e kështu me radhë marrin formë. Siç mund të vërehet edhe në fotot e mëposhtme, këto qytete karakterizohen nga organizimi strikt aksial qofshin këto në formë rrezore të orjentuar drejt një qendre qofshin këto akse-kuadratike e të rregullta. Në të dyja rastet objektet kanë lartësi dhe volume të përgjithshme gati të njëjta 5 deri në 7kate dhe hapësirat ndërmjet tyre janë të barabarta ose më të mëdha se shuma e lartësisë së tyre. Në këtë mënyrë hapësirat janë të gjëra dhe impersonale, përgjithësisht të ndërtuara në kufinjte e boshit. Në foton e qytetit Ostrava Poruba (fig. 26) ngjashmëritë me zonat e arkitekturës së socrealizmit në Tiranës janë të mëdha. Nësë përmasat e hapësirës zmadhohen ndjeshëm në disa raste, raporti dhe ndjesia e hapësirës se gjerë e monumentale jane aty, pa harruar edhe detajet e ndërtimit rreth kryqëzimeve me shmangien tipike të objektit për formimin e një minisheshi përkrah një rrethrotullimi apo kryqëzimi. Një shembull i ngjashëm në Tiranë është banesa përkarshi ish hotel Arbërisë, sot Ministria e Drejtesise, apo kompleksi i pallateve Shallvare i cili trajtohet më tej.



Fig. 24. Jiří Kroha, Nová Dubnica, model, 1951. (burimi: <http://jsah.ucpress.edu>)

Fig. 25. Dimitrovgrad, Bullgari. Foto nga arkivi i bashkise. (burimi:<http://www.evoit.it/atriumroute>)



Fig.26. Ostrava-Poruba, Repubblica Ceke. (burimi: <https://www.orbitakpostcard.cz>)

3.3. Analiza teorike mbi modelin e qytetit socialist

“Regjimet totalitare tregojnë një preferencë për planifikim urban në shkallë të gjerë për arsye të ndryshme. Para së gjithash, kjo i lejon të krijojnë dhe ndërtojnë vendbanime të mëdha me qëllim manifestimin e forcës dhe autoritetit të qeverisë, superioritetin e saj ideologjik dhe dominimin e saj mbi shoqërinë dhe natyrën. Ndërtimi i vendbanimeve të reja me një zonim të paracaktuar, një hierarki hapësinore dhe një "rend të ri" të paracaktuar, demonstruan në mënyrë të qartë autoritetin e pushtetit. Ky demonstrim i hierarkisë politiko-qeveritare dhe shoqërore është një nga mjetet kryesore që përdoren për të afirmuar fuqinë e regjimit-monopartiak. Gjatë diktaturave totalitare, koncepti i "qytetit ideal", zhvilluar shekuj më parë, gjen terren pjellor për t'u rritur dhe manifestuar.” (Atrium, 2013;142) Shembulli praktik i aplikimit të qytetit ideal në vendet nën regjim totalitar, njehësohet me ndërtimin e qyteteve të reja apo siç quhen ndryshe, të themeluara. Qytetet e themeluara kanë si karakteristike faktin që lindin prej asgjëse, pra “ex-novo”. Për këtë arsye elementet që përcaktuan strukturën e tyre urbane nuk janë frut i vazhdimësisë me struktura urbane parardhëse, por rezultat i një komunikimi të drejtpërdrejtë me strukturën e prodhimit dhe atë territoriale.

Duke qënë se urbanizimi në Frontin Socialist lidhej ngushtësisht me planet për industrizimin edhe në rastet kur u implementuar brenda një mjedisi urban ekzistues aplikoi të njëjtin standart pa marrë parasysh rrethanat pronësore, kontekstuale e kulturore. Efekti në pejsazhin urban ekzistues filloi të vihet re direkt pas ardhjes në fuqi. Në rastin Shqiptar, fillimi i viteve 50' shënoi ndërtimin e Bllokut të Shallvareve e pallatet Agimi në Tiranë që do të analizohen më poshtë. Sipas (Gutnov et al, 1968; 25) “situata aktuale tregon se format e reja komuniste të marrëdhënieve sociale po zhvillohen brenda një mjedisi urban të trashëguar. Madje edhe projektet e objekteve të ndërtuara tani rrallë shprehin kriterin struktural.” Kjo është e kuptueshme në një periudhë tranzicioni, ku funksionet e reja, të cilat ende nuk kanë gjetur formën e përshtatshme të tyre, detyrohen të veshin (forma) të vjetra. Ky mendim përforcohet gjithashtu nga Dehaan i cili shkruan se “planifikuesit nuk e kishin luksin të merreshin vetëm me zgjidhjen e ideve dhe planeve abstrakte. Ata merreshin me një qytet real, merreshin me njerëz, ngjarje dhe materiale. Ata jetonin në këtë qytet, një hapësirë e anëtarëve të Partisë dhe të njerëzve të thjeshtë të cilët shpesh i bënin rezistencë ideve

dhe veprimeve të tyre.” (Dehaan, 2013;13) Ai vazhdon dhe thekson se përkundër ‘qytetit të prezantuar’ (p.sh. qyteti siç përshkruhet në hartë ose tekst), hapësira urbane parashtronte atë që Henri Lefebvre e quan “hapësira absolute”, e cila përfshin ato aspekte të jetës të cilat nuk mund të shihen lehtë, të përshkruhen apo të kapen në një tekst analitik apo portret vizual. Një hapësirë e tillë absolute parashtronte një sfidë të vazhdueshme për planifikuesit e qyteteve Sovjetike, të cilët përpiqeshin të lidhnin kompleksitetin e tij me funksione analitike të përcaktuara të cilat mund ti manipulonin shkencërisht. Fatkeqësisht, drita e analizave shkencore ndricoi vetëm aspekte të veçanta të jetës urbane, duke lënë në hije fushat e tjera.[...] Përhumbja në errësirë ishte e nevojshme, edhe pse objektivat e planifikuesëve nuk mund të arriheshin në mënyrë abstrakte. Ata duhet ti sillnin në jetë në hapësirën e rrëmujshme të absolutes, në një skenë urbane ku direktivat e drejtorit të skenës së Partisë, përgjigjja e audiencës Sovjetike dhe sjellja e aktorëve të tjerë, i jepnin kuptim dorëshkrimit Marksist-Leninnist. Në fakt, duke patur parasysh natyrën e kontestueshme të hapësirës urbane, puna e planifikuesëve duhej vlerësuar nga pikpamja e performancës. Duhej të shihej jo vetëm si art pamor, por si një art dramatik. Edhe modelet shkencore dhe teorike të planifikuesëve, i përkisnin jo vetëm botës së prezantimit pamor, por gjithashtu edhe të asaj që Lefebvre quante “zona e politikave”, modele të konfirmuara nga opinioni, autoriteti dhe pushtetit. Ata inskenuan një pushtet dhe fuqi për agjencitë dhe planifikuesit që merreshin me një botë prej qëniesh të gjalla, një vend më kompleks nga sa ata mund të perceptonin, prezantonin, apo kuptonin, por mbi të cilin dhe në të cilin ata gjithsesi duhej të vepronin. Edhe pse regjimi socialist në Shqipëri ishte nga më të egrit në botë, ai nuk kishte një pushtet absolut mbi territorin. Qyteti Shqiptar socialist kishte shumë zona të errta dhe të pakontrollueshme. Sipas arkitektit shqiptar Shkreli “të gjithë jemi dakord, se qyteti shqiptar socialist, nuk ishte cilësor, dhe nuk mund të përfshihet as në historinë e mendimit urbanistik të vendeve socialist të Europës Lindore. Në Shqipëri, politika urbane nuk udhëhiqej nga parime të urbanistikës”(Shkreli & Gjoni, 1997; 121). Ai thekson se “arketipi urban i qytetit Shqipëtar rezultoi pa karakteristika kulturore, gjeografike dhe historike (për qëllimin e eliminimit të së vjetrës cereku i shembur në emër të së resë dhe në “luftë ndaj asaj që kish mbetur nga e kaluara” pa ngarkesa emocionale (për shkak të programit atrofik të shpirtit krijues), dhe akoma më tej , pa një fizionomi të qartë urbane në kuptimin kompleks të termit. Në përgjithësi, pjesa më e madhe e tyre ishin të zymta, por në një farë mënyre konsistente, të pastra dhe pak a shumë në linjë me normat urbane të përcaktuara nga ligji”(Shkreli & Gjoni, 1997;122). Edhe pse ligjet ishin bërë nga regjimi i asaj kohë dhe si do të tregoj më poshtë, planet urbane kishin edhe një karakter te tipit ndëshkues i cili mbante gjallë urrejtjen klasore e cila ishte materia bazë mbi të cilën sistemi motivoi masat, kjo është dhe një prej arsyeve pse prodhimitaria e asaj perudhe përmban një lloj kontroversialiteti dhe shkaktonte debat shoqëror. Shpesh e hasim të klasifikuar si “dark modernism” (modernizmi i erret), apo trashëgimi kontroverse, duke i veshur kësaj prodhimitarie arkitektonike një lloj misteri i cili shpesh përbën të vetmen pikë interesi më kohën e sotme, kënaqësinë e adrenalines që përçon tek shikuesi një film horror i cili zhvillohet në një botë të panjohur e të zhytur në mister. Pra nëse i referohemi Rossi-it i cili bazon teorinë e tij mbi raportin midis njohjes dhe ndjenjës, duke përfshirë fenomenin e nostalgjisë që lind, misteri është shpesh një nga arsyet e egzistencës së trashëgimisë së arkitekturës të periudhës totalitare dhe asaj socialiste në veçanti.

3.4. Proçesi i industrializimit në ekonominë e planifikuar në Shqipëri.

Pavarësia e Shqipërisë në vitin 1912 gjeti shumicën e popullsisë (më shumë se 80%) të jetonin në fshat. Ky trend demografik do të ndryshojë shumë pak me kalimin e kohës dhe Mbreti Zog nuk do të paraqesë ndonjë politikë specifike për të ndryshuar këto shifra, siç do të bëjë regjimi socialist. Raporti demografik midis ndarjes rurale dhe urbane do të fillojë të ndryshojë me themelimin e qyteteve të para socialiste në fillim të viteve 1950. Projektet e para të qyteteve industriale kishin si qëllim kryesor të ndërtonin proletariatin, i cili gjatë dekadës së parë të revolucionit komunist mungonte. Krijimi i proletariatit përshkruhej si një çështje urgjente e cila ishte e nevojshme të trajtohej sa më shpejt të ishte e mundur. Lidhur me këtë proces Dehaan shprehet se: “në Bashkimin Sovjetik të 1930-ës, rezultatet dhe shpejtësia kishin më tepër rëndësi sesa kërkimi i kujdesshëm apo edhe se mirqënia e njeriut”(Dehaan, 2013; 9). Ndërsa Bown and Taylor të cilët analizojnë aspektet propagandistike të qytetit socialist, shprehen: “qyteti – si – makinë ishte një model i përshtatshëm për qytetet industriale, dhe u përdor aty. Për qendrën e aspiratave dhe të fuqisë politike, fokusi ishte të qëndrojnë në perspektivën e përdoruesit të qytetit, si një formë tre-dimensionale që komunikonte një mesazh ideologjik optimist” (Bown, 1993; 99).

Ekzistojnë shumë kundërthënie në zbatimin e ideve komuniste për rastin e Shqipërisë. Nga njëra anë, Manifesti Komunist deklaroi se " e gjithë historia ka qenë histori e luftës së klasave"(Marks & Engels,1968; 8) dhe se proletariati ishte klasa kryesore e shoqërisë. Nga ana tjetër, në vitin 1945 kur komunistët erdhën në fuqi, në Shqipëri nuk kishte asnjë klasë punëtore dhe punëtorët përbënin më pak se 10% të popullsisë. Siç përshkruan (Vickers, 2006), shteti shqiptar u portretizua në botimet shtetërore si "shprehje qeveritare e diktaturës së klasës punëtore, edhe pse nuk kishte asnjë klasë punëtore për të cilën mund të flisje. Disa nga anëtarët kryesorë komunistë në Shqipëri, përfshirë vetë Hoxhën, erdhën më shumë nga klasa borgjeze sesa nga punëtorët apo fshatarët. Marksi vetë, kishte pikëpamje të ndryshme mbi rolin e fshatarësisë në revolucionin komunist, në varësi të traditave lokale të vendit. Kështu, ai ishte më optimist për sa i përket potencialit të fshatarësisë në Rusi se sa në Francë. E gjithë ideja komuniste u bazua në rolin e masave dhe kishte një bazë shumë të madhe mbështetëse nga populli. Megjithatë regjimi socialist në Shqipëri kishte politika demografike të centralizuara dhe rregulla shumë strikte për transferimin e njerëzve nga fshatrat në qytete. Ata ishin kundër edhe rritjes së numrit të qytetarëve në qytet. Kur shkruan librin e tyre mbi “Qytetin Ideal Komunist”, arkitektët sovjetikë (Gutnov et al, 1968) shpjegojnë gjithashtu politikën e shtimit të popullsisë urbane. Siç thonë ata, me kapitalizmin në epokën e konkurrencës së lirë, dominimi i marrëdhënieve ekonomike (dmth. ndjekja e fitimit privat të menjëhershëm dhe zhvillimi intensiv i tregut) u bë shkak kryesor për rritjen spontane dhe malinje të qytetit industrial. Duke ndodhur në kurriz të fshatit dhe qytetit jo industrial, kjo çoi në shpërbërjen e fshatrave të ndarë në fabrika dhe komunitete fermash. Edhe pse në teori marksizmi propagandonte një revolucion masiv të proletariatit, praktika urbane ishte e qendëruar dhe ekletiste. Në fillim me krijimin e qyteteve të para socialiste, fshatarësia u shndërrua në klasë punëtore, por me kalimin e kohës, u vu re jo vetëm në Shqipëri por edhe në vendet e tjera komuniste, një luftë klasore midis punëtorëve dhe fshatarëve dhe për klasën fshatare u bë gjithmonë e më e vështirë të shpërngulehin në zona urbane e të shndërroheshin në klasë punëtore. Në Shqipëri inspiruar prej revolucionit kulturor kinez, në dekadat e fundit të regjimit socialist qarkulloi postulati “ta bëjmë fshatin si qytetin”, objektiv i cili indirekt demotivonte popullsinë rurale të lëvizte drejt qytetit. Siç shprehet përshkruhet nga arkitekti shqiptar Bego “edhe për

fshatrat u hartuan plane rregulluese me qëllim që të sistemoheshin brenda vijash të verdha ku qenë përfshirë dhe parcelat për ndërtimet private, madhësia e të cilave ishte caktuar me ligj që zbatohet” (Bego, 2009; 5). Sidoqoftë faza e parë e industrializimit në Shqipëri ashtu si në vende të tjera të lindjes, u karakterizua nga politika tv shpopullimit të fshatrave dhe popullimit të qyteteve periudhë e cila zgjati pothuaj dy dekada.

Me prezantimin e shtetit socialist dhe përfshirjen në frontin e lindjes, ndërtimi po ashtu si fushat e tjera të ekonomisë ju nënshtroa politikave dhe organizimit sipas direktivave të Planit 5 Vjeçar. Në Shqipëri u aplikua fillimisht sistemi i planifikimit 2 Vjeçar, i cili u financua me mjete nga Bashkimi Sovietik, si edhe me nivel teknik dhe ekspertizë të kualifikuar. Industria e ndërtimit u përqëndrua kryesisht në ndërtimin e objekteve industriale dhe qyteteve të reja pranë tyre. Dallohen dy strategji zhvillimi të industrisë dhe impiantit urban, nëpërmjet qyteteve satelite siç ishte rasti i Kombinatit të Tekstileve në Tiranë dhe të qyteteve të reja siç ishte Maliqi pranë Korçës, Cërriku në perëndim të Elbasanit, Memaliaj në afërsi të Tepelenës etj. Në këtë kontekst politik, qyteti i ri u shpreh në të gjithë dimensionin dhe kompleksitetin e tij edhe pse në një formë më të thjeshtuar nga qyteti historik. Industrializimi dhe urbanizimi ishin fjalët e ditës. Siç shprehet Anatole Kopp: “një aspekt i rëndësishëm i arkitekturës industriale Sovjetike ishte se fabrikat u krijuan *ex nihilo* ose nga fillimi. Përkundrazi, fabrikat dhe komplekset industriale në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara pas prezantimit të epokës së industrializimit, ishin vazhdimisht në transformim dhe në zgjerim. Komplekset industriale sovjetike mund të konsiderohen si arkitekturë pasi ato u konceptuan që në fillim si organizma unitar, dhe për këtë arsye ato përbëjnë një vepër arkitektonike. Projektet e tyre mund të konsiderohen si transkriptimi racional i proceseve industriale që ndodhin në to; mjedisi i tyre lehtëson vetëdijen e fshatarit të vjetër, duke e ndihmuar atë të fitojë një dinjitet të ri. Në fund, qendrat industriale Sovjetike janë elemente të rëndësishme të peisazhit urban” (Kopp, 1987; 175). Themeli kryesor i ekonomisë socialiste ishte fabrika dhe jo tregu si në vendet perëndimore. Në këto kushte gjuha e komunikimit estetik duhej të promovonte një imazh populist, të thjeshtë, funksional dhe i mundshëm për t’u prodhuar në mënyrë të përshpejtuar, krejt e kundërta e një konteksti urban dhe ekonomik të krijuar në vazhdimësi historike.

Socializmi nuk nisi menjëherë në Shqipëri, edhe pse zhvillimi i tij ishte mjaft i shpejtë nëse e krahasojmë me periudhat parardhëse të zhvillimit ekonomik dhe zakonor. Për të kuptuar zhvillimet e veçanta në fushat e ekonomisë dhe rolin që ato patën në vitet e para të shtetit socialist, duhen vëzhguar parashikimet e sistemit të planifikimit ekonomik. Në Shqipëri, Plani i parë 5 Vjeçar u prezantua në vitin 1950 ndërsa para tij ishte në fuqi Plani 2 Vjeçar për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendit 1949 – 1950. Sipas historisë zyrtare të Partisë së Punës “ky plan përgatiste rrugën për zhvillimin ekonomik në terma afatgjata. Rëndësi primare i kushtohej industrisë ku ishin investuar 47% e të gjithë investimeve të Planit 2 Vjeçar. Në fillim qëndronin materialet minerare, kryesisht nafta dhe bitumet. Në vend të dytë qëndronte industria e lehtë. Në këtë Plan 2 Vjeçar u parashikuan ndërtimi i Fabrika e Tekstileve në Tiranë, Fabrika e Sheqerit në Maliq, impianti i ujit i Selitës dhe vepra të tjera industriale.” (Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, 1981; 243). Më tej tregohet: “Vetëm më 1950 Shqipëria ndërmori një program më ambicioz drejt elektrifikimit dhe industrializimit” (M. Vickers, 2006; 176). Një ekonomi e planifikuar në realitetin Shqiptar nënkuptonte se të gjitha vendimet lidhur me prodhimin dhe investimet ishin mishëruar në një plan të formuluar nga një autoritet qëndror. Në literaturë ky realitet

njihet gjithashtu me termin “ekonomi e komanduar”. Në mënyrë të ngjashme, e njëjta praktikë u aplikuar në vende të tjera të Europës Qendrore dhe Lindore, menjëherë pas Luftës së II Botërore, në kohën kur nisi planifikimi socialist me prezantimin e planeve të rindërtimit, zakonisht me një kohëzgjatje prej 2-3 vjetësh. “Më pas erdhën planet 5 Vjecare. Planet zhvendosën investimet dhe krahun e punës drejt industrisë, kryesisht në sektorin e industrisë së rëndë në dëm të prodhimit bujqësor dhe të mallrave të konsumit. Në këtë drejtim, parashikohëshin rritje masive të prodhimit në industri, ndërtim dhe bujqësi [...] planet kombëtare, rajonale dhe sektoriale u hartuan në formën e akteve ligjore dhe u shndërruan në mjetin kryesor të rregullimit të tregut, ndërkohë që sistemi u konvertua në një planifikim të centralizuar të ekonomisë dhe të shoqërisë. Meqenëse teknikisht çdo gjë duhej të planifikohej, u krijuan role specifikesht të ndara për urbanistët, projektuesit dhe arkitektët e realitetit të ri ekonomik.” (Czeczynski, 2008; 66).

Në librin lidhur me historinë e Partisë së Punës Shqiptare publikuar më 1981, shfaqen edhe disa aspekte të kritikuara të Planit 2 vjeçar 1949- 1950, edhe pse nuk hidhet totalisht poshtë, si përshembull propaganda zyrtare e shfaqti si dështim faktin se plani nuk ishte realizuar 100%. Ata shkruajnë se “Plani 2 Vjeçar u realizua vetëm 91%. Gjithsesi rritja mesatare e përgjithshme e ekonomisë vjetore ishte 10.5%, fakt i cili mund të konsiderohej një sukses i madh konsideruar kushtet e vështirësisë ekstreme”(Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste,1981; 243). Ky libër karakterizohet nga një frymë optimiste e ngjashme me teorinë Marksist-Leniniste e përdorur për të edukuar masat. Edhe pse në realitet gjëndja mund të konsiderohej si katastrofike, njerëzit sidomos të shpërngulurit nga zonat rurale, shihnin progres nëse krahasonin treguesit e vitit 1950 me ato të vitit 1938, kur mbreti Zog ishte akoma në pushtet. Sipas mendimit të asaj periudhë “në 1950 norma e prodhimit industrial ishte katër herë më e lartë se ajo e vitit 1938 [...] por prodhimi bujqësor gjatë Planit 2 Vjeçar 1949-1950 u rrit me një normë të ulët, përkatësisht 2 dhe 2.2%” (Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste,1981; 263). Gjithsesi, duhet nënvizuar fakti se këto nuk ishin as shifrat dhe as vështirësitë reale të zbatimit Planit 2 Vjeçar 1949 -1950 dhe të Planit të parë 5 Vjeçar 1950 -1955 në Shqipëri. Ashtu siç thekson edhe P. F. Pauley duke analizuar ekonominë socialiste, “thembra e Akilit e ekonomisë Sovjetike ishte gjithmonë bujqësia” (Pauley, 2015; 78). Përqëndrimi i forcës punëtore drejt industrisë së rëndë, industrializimi i shpejtë, migrimi i brendshëm nga zonat rurale në zonat urbane, ndikoi drejtpërdrejt në sektorin e bujqësisë dhe prodhimtarinë e saj. Sipas Vickers, Plani i parë 5 Vjeçar 1950-1955 “i cili kishte si qëllim primar të lehtësonte mungesat akute dhe të forconte ekonominë në përgjithësi, tregoi se ishte tepër ambicioz, duke mospërfillur realitetin e rëndë Shqiptar të mungesës në: makineri të përshtatshme, mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe mungesës së një rrjeti të zhvilluar të infrastrukturës rrugore e të komunikimit. Gjithsesi u arrit të ndërtohej fabrika e çimentos në Vlorë, një fabrikë e sheqerit, fabrikën e përpunimit të duhanit në Shkoder, dhe kombinati i tekstileve në Tiranë, plus disa traktorë dhe makineri korreë.”(Vickers, 2006; 176) Në këtë kohë erdhën edhe disa kritika nga Bashkimi Sovjetik lidhur me çështjet e planifikimit të industrisë, por këto nuk u morën në konsideratë nga Enver Hoxha. Siç përshkruan mëtej Vickers, vëmëndje mjaft të madhe iu kushtua shfrytëzimit të pasurive minerare të Shqipërisë, përfshirë këtu kromin, naftën, nikelin, qymyrin dhe bakrin, pa marrë parasysh kontestimet nga Moska. Propaganda socialiste justifikoi përlllogaritjet e gabuara të Planit të Parë 5 Vjeçar me faktin se ai ishte bazuar në burime natyrore të brendshme dhe në eksperiencën e specialistëve vendas. Në fakt, plani u bazua kryesisht në ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste dukë mos sjell një ndryshim real

nga qeverisja e Zogut e cila gjithashtu u karakterizua nga vartësia ndaj kapitalit të huaj.

Përderisa baza e ekonomisë së komanduar ishte prodhimi, arkitektura u lidh ngushtë me të dhe iu nënshtrua organizimit të centralizuar të prodhimit. Arkitektura si një objekt i ekonomisë së planifikuar përfaqëson kryesisht përpjekjen për të organizuar qytetin në përputhje me ideologjinë Marksiste-Leniniste. Siç theksohet nga Tafuri, nëse arkitektura është sinonim i *prodhimit*, është gjithashtu e vërtetë se faktorë të tjerë përcaktues janë *shpërndarja* dhe *konsumi*. Sipas tij “për të ndërtuar një qytet industrial ishte e domosdoshme të shkatërrohej hierarkia e hapësirës egzistuese. Universi teknologjik injoron [...] të gjithë hapësirën njerëzore, sepse ishte vetë mjedisi natyror i veprimtarisë arkitektonike”(Tafuri, M. (2007). *Progetto e utopia*. Roma: Editori Laterza fq. 118). Ndërsa Graham & Marvin e çojnë më tej konceptin e pejsazhit të qyteteve industriale duke e parë atë si zhvillim në shkallë të gjerë në mënyrë të ngjashme me koncepte futuriste të shfaqura në levizjet avantguard të fillim shekullit XX”, ata shprehen: “Fluksi konstant i këtyre proceseve urbane përbëhet nga mbivendosja e shumë ‘peisazheve’ infrastrukture sa të kontestuara aq edhe të ndërlidhura. Këto sigurojnë ndërmjetësimin midis natyrës, kulturës dhe prodhimit të "qytetit". Aty ndodhet “electropolis” i fuqisë energjitike. Aty ndodhet “hydropolis” i ujit dhe i mbetjeve. Aty ndodhet “informacioni” ose “cybercity” i komunikimeve elektronike. Aty ndodhet “autocity” i peisazheve rrugore të motorizuara dhe të teknologjive të lidhura me të. E kështu me rradhë. Gjithsesi është e rëndësishme të theksohet se këto peisazhe infrastrukture nuk janë të veçuara dhe autonome; ato varen tek njëra tjetra dhe bashkë-evolojnë ngushtë në ndërmarrdhëniet e tyre me zhvillimin urban dhe hapësirën urbane”(Graham & Marvin, 2001; 8). Gjatë zhvillimit të socializmit në Shqipëri, u vu re qartë ky kombinim i identitetit të qytetit të kombinuar me funksionin e veçantë brenda ekonomisë së centralizuar si psh, Maliqi – qyteti i sheqerit, Kinostudio – qyteti i filmit, Kombinati Stalin-qyteti i tekstileve, Kuçova – qyteti i naftetareve, Bulqiza-qyteti i Kromit, Fierza – qyteti i energjisë etj. Industria e kinematografisë dhe propagandës luajti gjithashtu një rol domethënës në formimin e identiteve të qyteteve industriale duke promovuar vazhdimisht lidhjen e tyre me industrinë e veçantë të prodhimit.

Qëllimi kryesor i Partisë së Punës gjatë kësaj periudhe të parë të ndërtimit të industrisë socialiste, ishte prodhimi i mjeteve të punës dhe prodhimit, që do të thotë se kushtet për revolucionin marksist në Shqipëri ishin në atë kohë inekzistente sepse nuk kishte një proletariat të mirëfilltë përderisa nuk egzistonte një sektor industrial i mirëfilltë. Komunistët në Shqipëri morën pushtetin, për të formuar mëpas bazën e nevojshme proletare që do të çonte më pas drejt revolucionit të vërtet Marksist. Sipas (Pauley, 2015), qëllimi thelbësor i tyre ishte propaganda psikologjike dhe regjimi as nuk e priste realizimin e objektivave të planit. Në Historinë e Partisë së Punës Shqiptare deklarohet se ‘implementimi i Planit të parë 5 Vjeçar ndeshi pengesa që nuk u parashikuan si duhej. “Plani i zhvillimit të ekonomisë për vitet 1951 – 1952 u përmbush[...] ndërkohë rezultoi se hendeku midis industrisë dhe bujqësisë vazhdoi të zgjerohej”(Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, 1981; 274 – 275). U listuan gjithashtu disa kritika të tjera si psh. “prodhimi industrial u shtri përtej kapaciteteve të fuqisë punëtore. Shpejtësia e përcaktuar për të përfunduar disa vepra madhore rezultoi e papërbalueshme. Ndërtimi i këtyre veprave industriale kërkonte një zgjerim shumë më të madh të forcës punëtore mesatarisht 26 000 persona në vit. Nxjerrja e një numri të tillë punëtorësh shkaktoi largimin e një numri të madh fshatarësh nga bujqësia’(Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, 1981; 275). Dështimet e para të Planit të parë 5 Vjeçar në Shqipëri u përdorën disa herë si justifikim për të luftuar

armiqtë politikë të Enver Hoxhës brenda dhe jasht Partisë, ndërsa me konsolidimin e fuqisë së tij politike dhe me ngritjen e kultit të personalitetit kritikati u zvogëluar dhe shifra të fallsifikuara u përdorën për të shfaqur përmbushjen e Planeve të tjera 5 Vjecare.

3.5. Kultura urbane Sovietike dhe raportimi me kontekstin Shqiptar në fillim të viteve 50'

Prezantimi zyrtar i arkitekturës Staliniste u shoqërua me mohimin e të gjithë stileve të tjera si avantgarde, konstruktivizmi Rus, moderni racionalist. Në përpjekjet për të mospranuar atë që u konsiderua si dështim i praktikës në periudhën mes viteve 1920s dhe 1930, arkitektura Staliniste u përpoq t'u vinte ndesh shijeve të masës duke treguar një stil pompoz. "Duke imponuar unitetin estetik në rang shteti, ndërkohë që ndërtesat më madhështore rezervoheshin për Moskën, estetika e re e përshkroi të gjithë Bashkimin Sovjetik si një dorë të vetme, një unitet hapësinor të përcaktuar nga ngjashmëria dhe vazhdimësia e estetikës mbi trajtat e gjera të territorit.[...] Kjo arkitekturë neo-perandorake imitoi stile të vjetra klasike dhe gotike, duke i dhënë atyre përmasa madhështore,[...] stili i ri shërbeu qartësisht për të përfaqësuar autoritetin e Stalinit. Ashtu si arkitektura perandorake ruse, ajo përdorte peizazhin si një zonë të projeksionit të pushtetit shtetëror"(Dehaan, 2013; 90). Edhe sipas Velos duket se kjo është një nga karakteristikat e Realizmit Socialist. "Çdo gjë përpiqej të ishte një pallat, sepse këto ishin ndërtesat që çdo fshatar, punëtor dhe revolucionar ëndërronte. Emblema e evolucionit të ri arkitektonik u bë pallati"(Velo, 2013;129). Stili Stalinist i arkitekturës u prezantua si një rend total i cili duhej të prekte të gjithë llojet e ndërtimeve duke krijuar një unitet midis zonës rezidenciale dhe asaj të prodhimit. Fabrika konceptualisht shihej si një zgjatim i banesës individuale. Kjo shprehej më qartë në organizimin e arkitekturës totale të qyteteve të reja edhe pse gjendej e pranishme edhe në ndërtesa të veçanta që ishin pjesë e qytetit ekzistues. Në Shqipëri kishte të njëjtin karakter si në Bashkimin Sovjetik edhe pse zhvillohej në një territor shumë të ndryshëm kulturor dhe gjeografik. Elementi ornamental në një farë mënyre ishte unifikuesi total. Sipas Groys "arkitektura e epokës së Stalinit në përgjithësi lidhet me një theks në dekorim dhe fasadë. Por kritikët arkitektonikë të kësaj epoke bënë një betejë të vështirë kundër "fasadizmit", domethënë kundër magjepsjes me dekorimin në arkitekturë, duke argumentuar në vend të kësaj funksionalitetin dhe jetueshmërinë e ndërtesave që do të korrespondonin me nevojat njerëzore. Megjithatë, kjo nuk do të thotë, se ndërtesat duhej të dukeshin teknologjike dhe të ftohta apo thjesht funksionaliste dhe ç'njerëzore. Ideja për t'i shërbyer popullit që kërkohëj nga çdo arkitekt sovjetik në të vërtetë nënkuptonte lidhje emocionale: ndërtesa socialiste duhej të dukej monumentale, por në të njëjtën kohë intime, njerëzore, komode. [...] disa analistë të arkitekturës staliniste kanë arritur në përfundimin se kërkesat e kritikëve të bëra ndaj arkitektëve ishin shumë paradoksale për t'u përmbushur. [...] Me sa duket, këto kërkesa nënkuptonin asgjë më pak sesa nënshtrimin e plotë të arkitektëve në shijet e udhëheqjes së Partisë' (Dobrenko, Naiman, 2003).

Që në vitet 800' një arkitekt ushtarak Francesco Milizia në traktatin e tij shprehu disa ide mbi arkitekturën e qytetit dhe sipas tij duhej të ishte "madhështia e totalit është e ndarë në një bukuri të pafundme të detajeve, të gjitha ato të ndryshme, kurrë të njëjtat objekte dhe në çdo rrethë do të jetë diçka e re, e vetme dhe e habitshme. Duhet të mbretërojë rendi, por edhe një lloj konfuzioni [...] dhe në të gjitha pjesët e rregullta të

duhet të jetë gjithashtu një ide e parregullsi dhe kaosit, e cili është e përshtatshme për qytetet e mëdha [...] rend dhe kaos, rregullsi dhe parregullsi, organike dhe inkohërence” (Tafuri, 2007; 23). Ideja kryesore ishte që të kishte një unitet në variacion dhe të mos përsëritej e njëjta gjë uniforme. Kjo ide ishte e kundërta e asaj çfarë kërkonin komunistët prej qytetit, rregulli utopik i qytetit socialist nuk duhej të linte vend për gabim. Nga fundi i viteve 1940 deri në rënien e regjimeve socialiste në Evropën

Një nga temat më interesante për tu trajtuar në studimet për arkitekturën e socrealizmit është koncepti i asaj që Rossi quan me “ndertim”, apo siç e gjejmë në arkitekturën socialiste të kësaj periudhë me konceptin e “hapësirës së unifikuar” apo të qytetit si një entitet ku arkitektura është pjesë përbërëse e tij. Czepczynski në fazën e parë të zhvillimit të Stilit Stalinist e përshkruan si art: “Qyteti socialist, kryesisht në fazat e tij fillestare të formës Staliniste, duhej shndërruar në një *Gesamtkunstwerk*: një vepër arti totale, që mbështetej në ndërveprimin ‘harmonik’ midis kompozimit urban, arkitekturës dhe arteve të tjera, ose, siç mund ta quajmë sot, aspekti tërësor i peisazhit kulturor [...] Kërkesa për një të kaluar ‘të asimilueshme’ përshkruar nga realizmi socialist si e vetmja mënyrë për ta bërë qytetin të lexueshëm nga masat, çoi në lindjen e disa ndërhyrjeve arkitektonike shpesh herë të çuditshme, si përshembull ndërlidhja e pseudo-barokut me dekorin e rilindjes. Peisazhet e reja të qytetit të ri socialist u transformuan nga ndërtesat vertikale, si kundërpeshat moderne të kullave dhe majave të kështjellave dhe kishave antike” (Czepczynski, 2008; 79). Sipas Gutnov et al. “koncepti i hapësirës së unifikuar ndryshoi themelet e vërteta që përkufizonin punën e arkitektit. I jep fjalës ‘arkitekturë’ një kuptim të ri. Megjithatë, trashëgimia e mrekullueshme e traditës arkitektonike nuk duhet lënë mënjanë. Vlerat e saj qëndrojnë. Metodat e zhvilluara nga arkitektura klasike vazhdojnë të jenë ende të dobishme brenda një game shumë të gjerë. Teoria e re nuk dëmton metodat e vjetra por vetëm përcakton kufinj të përdorimit të tyre” (Gutnov et al, 1968). Duke bërë një retrospektivë të sistemeve të ndryshme të arkitekturës të përdorura më përpara, më pas Gutnov et al. arrijnë në përfundimin se: “ndërtesat gjatë mesjetës u bënë duke mos të lidhur volumin fasadën me funksionet e brendshme [...] Arkitektët e Rilindjes përdorën vecanërisht perspektivën të krijuar duke i dhënë drejtim fushëpamjeve të ngushta e të mbyllura [...] gjatë epokës neoklasike u ngritën pallate gjigande dhe madje i gjithë sistemi i ndërtesës u organizua në bazë të një hierarchie mjaft rigoroze arkitektonike dhe urbanistike. Arkitekti kërkonte të unifikonte kompozimin e një kompleksi duke përdorur një koncept vizual unik, dhe kjo kërkonte një përdorim maksimal të fuqive perceptuale. Ritmet hapësinore nuk u krijuan nga përsëritja e një elementi të vetëm por nga artikulimi i të gjithë fasadës. Ndryshimi i dezajnit të fasadave duke bërë ndryshime progresive në rëndësi arkitektonike, nga rilindja tek neoklasikja, u shndërrua në një preokupim estetik primar të arkitekturës.” (Gutnov et al, 1968; 137). Sipas Tafurit, Revolucioni Kulturor vendosi një nevojë precize: krijimin e një hapsire katalitike, e cila nuk ishte një pasqyrim i thjeshtë i peisazhit rrethues apo sfondi i ‘agjitacionit të masave’, por hapësira rezultante e një seti objektesh me të cilat mund të vendosje një marrëdhënie të përditshme (Tafuri, 2007). Ai shton se arkitektura gjithashtu mund të përpiket të mbajë një plotësi që mund ta ruajë atë nga shpërbërja totale. Por kjo përpjekje dekurajohet nga assemblazhi i pjesëzave arkitektonike brenda qytetit. Dhe është në qytet vendi ku ato absorbohen brutalisht dhe privohen nga çdo autonomi. Unifikimi i peisazhit urban ishte qëllimi primar i arkitektures së socrealizmit. Duke qenë qytete të reja, komuniteti heterogjen kishte nevojë për një guidë kulturore për tu përshtatur në ambientin e ri të përbashkët.

Dekori Stalinist shërbente si një filter i ftohtë njehsues për shoqërinë emergjente dhe u përdor si mjet për trasmetimin e propagandës.



Fig. 27 - Pamje nga Plani për Rikonstruksionin e Moskës, zonim dhe skema e qarkullimit. 1935.
(burimi <https://commons.wikimedia.org>)

Debati mbi qytetin socialist nuk mund të zhvillohet pa u ndalur në shembullin më përfaqësues të tij që është Plani për Rikonstruksionin e Moskës i vitit 1935. Siç shpjegon Zevi “pas disfatës së pikepamjeve të Erst May e Hannes Meyer, në vitin 1935 u lançua plani rregullues i Moskës që mban skemen radiocentrike duke theksuar rrugët kilometriket dhe sheshet skenografike” (Zevi, 2001; 149) (fig.7). Referuar Mikhaïl Pavlovič Tsapenko tek Godoli “Përvoja e planit të Moskës ka luajtur dhe ka ende një rol të madh në sjelljen e të gjithë planifikimit tonë urban në një nivel të lartë. [...] Një nga mësimet më frytdhënëse nga përvoja e rindërtimit të Moskës, qëndron në faktin se ka qartësuar në mënyrë teorike dhe praktike mënyrat për t'u ndjekur për të eliminuar kontrastin midis qendrës dhe periferisë. Kjo nuk arrihet duke ndërtuar në mënyrë të njëanshme vetëm lagjet periferike, por duke transformuar së bashku të gjithë qytetin: qendrën dhe periferinë. Ky transformim i qytetit duke përmirësuar kushtet e strehimit të popullsisë në ish-lagjet periferike, duke ndryshuar pamjen e tyre në tërësi, gjithsesi nuk sollti në një nivel qendrën dhe periferinë duke i zhdukur ato si pjesë të veçanta. Nuk mund të ketë një barazim të tillë, sepse qendra, duke qenë pika kryesore e përqendrimit të jetës administrative, sociale dhe kulturore të qytetit, shfaqet si një kategori arkitekturore me peshë më të madhe, si sektori me rezonancën më të rëndësishme të përfaqësimit.[...]Njësia arkitektonike-urbane e qytetit nuk përjashton, por supozon, strukturën e saj heterogjene. [...]Projekti i rindërtimit të Moskës së Stalinit me kusht për një ndryshim të plotë të qendrës historike, krijimi i një sërë rrugësh dhe sheshesh të gjëra, si dhe ndërtimin e ndërtesave vërtetë gjigante, për shembull, Pallati i sovjetikëve, me një lartësi prej 400 metra.” (Godoli, 2014) Duke vazhduar mëtej Godoli shkruan se, Plani i vitit 1935 jo vetëm që drejtoi zhvillimin e kryeqytetit sovjetik deri në fillimin e viteve 1960 , por doli edhe si një model i zbatueshëm për të gjitha qytetet e mëdha të Bashkimit Sovjetik dhe, pas luftës edhe për rindërtimin e qyteteve të BRSS dhe vëndeve komuniste të Evropës Lindore. Referencat në idenë e tij të "super bllokut " si një strukturë funksionale e socializmit dhe si një element formal përfaqësues i idesë së urbanizimit socialist, mund të gjenden në disa prej qyteteve të reja më përfaqësuese apo në shtesat urbane ndërtuar në

vendet e bllokut sovjetik në epokën Stalinit: nga pjesa qendrore e Nowa Huta-s, qytet i ri industrial ndërtuar rreth Krakov-ias (në reputacionin e të cilit ka ndihmuar filmi me njeriun e mermerit Andrzej Wajda-së) tek Nova Ostrava, zgjerimi i ri i kryeqytetit të Moravia-Silesia, deri tek lagja e "Kombinat-it" në periferi të Tiranës. Plani i vitit 1935 mund të konsiderohet si një manifest i "realizmit stalinist", pika kryesore e referimit për rindërtimin e qyteteve të socializmit real.

Ngjashmeritë me Tiranën vijnë jo vetëm me implementimin e "super bllokut" si tipologji urbane të re, por edhe me elementë të tjerë si psh: unifikimi i standartit të objekteve të banimit për strehimin e shtesave sociale në masë me qëllim eliminimin e diferencave mes klasave; shtetëzimin masiv dhe eliminimin e pronës private me qëllim implementimin e një plani radikal zhvillimi; investimi dhe përqendrimi i vëmendjes veçanërisht tek akset rrugore monumentale, etj. Ky tipar i fundit në Tiranë nuk vinte për herë të parë me planin soc-realist, pasi implementimi i planit fashist për Tiranën kishte hapur ndërkohë bulevardin kryesor të Tiranës, si dhe akset e tjera radiale që konvergjonin në qëndër ishin ravijëzuar tashmë, po ashtu sistemimi i Lumit të Lanës nisi që në këtë periudhë dhe u rimor e u vazhdua edhe nga planet e periudhës së socializmit, ndoshta si një parakusht i pashprehur për një kryeqytet Europian – apo më mirë për një qytet "simotër" e Moskës, sistemim i lumit Vollga të së cilës luajti një rol primar në drejtimin e zhvillimit të qytetit dhe element kyç në planin e saj të 1935. Në këtë mënyrë në qytetin e Tiranës vlen të konfrontohen gjurmët e këtyre dy ideologjive totalitare të cilat nga pikpamja e koncepteve urbanistike të aplikuara sjellin një rast të vecantë, gati unik në literaturën e qytetit socialist dhe të arkitekturës totalitare.

Dehaan sjell në vëmendje faktin se nga viti 1935 deri në vitin 1938 në Bashkimin Sovjetik, u zbatua "planifikimi ikonografik". "Ashtu si ikonografët, planifikuesit hoqën dorë nga krijimtaria individuale, riprodhimi i formave të shenjtëruara të mishëruara nga Moska ishte "hyjnizuar", një fushë materiale shndërrohej jo përmes hirit hyjnor (si në shndërrimin e ortodoksëve), por përmes identifikimit të tij me personalitetin e Stalinit dhe nëpërmjet tij, me Leninin. Ashtu si ikonografët kopjuan me besnikëri forma të shenjta, duke shfaqur kreativitet vetëm në nuancat e tyre të tonit, ngjyrës dhe goditjes së furçave, kështu që planifikuesit e qytetit sovjetik duhej të riprodhonin me besnikëri formën e shenjtë urbanistike të Moskës" (Dehaan, 2013). Kjo politikë urbane u zbatua fillimisht në Qytetin e Gorkit. Imazhi i pushtetit jo vetëm që shtrihej horizontalisht në të gjithë Bashkimin Sovjetik, por edhe vertikalisht, duke formësuar mënyrën në të cilën ishin strukturuar qytetet sovjetike.

Sipas (Dehaan, 2013), duke i bërë jehonë përqasjes së Moskës për pushtet qendror, qyteti i fabrikës i lëshoi rrugë qendrave urbane të organizuara në mënyrë hierarkike. Ashtu si plani i qytetit të Moskës i vitit 1935, i cili shërbeu si model i këtij dizajni të ri, të gjitha qytetet sovjetike filluan të shfaqnin një strukturë lagjeje dhe kuartalli, një element përcaktues i planifikimit të qytetit sovjetik deri në kolapsin e Bashkimit Sovjetik më 1991. Në këtë sistem, lagja rezidenciale u bë njësi themelore shoqërore. Këtu, banorët mund të kenë shërbime të nevojshme: dyqane ushqimore, lavanderi, institucione të fëmijëve, shkolla, klube, lokale dhe parqe. Disa nga këto lagje u kombinuan për të formuar një distrikt, objektet kulturore dhe administrative të të cilit shërbyen për të gjitha lagjet brenda kufijve të saj. Në kulmin e sistemit qëndron qendra e qytetit, e cila shërbente për të gjithë zonën komunale. Aq praktik sa një sistem i tillë shërbimesh mund të ketë qenë, ai i bëri jehonë dhe përforcoi zhvendosjen më të gjerë drejt hierarkisë administrative, shoqërore dhe politike, duke i bërë jehonë vertikalisht në organizimin e qytetit. Si qytet në krye të kësaj hierarkie shteti, Moska shërbeu si një stad dramatik i pushtetit. Plani i qytetit i vitit 1935 hapi pejsazhin

urban, duke e ekspozuar atë në një dritë kendëgjyesh, me hapësirën dhe vendin për dizajn monumental. Plani zgjeroi rrugët historike të Moskës dhe vendosi një ansambël të madh arkitektonik përgjatë lumit Moskë. [...] Megjithë abstraksionin utopik, kjo përjasje e re për planifikimin e qytetit nuk ishte asgjë përpara planifikimit vizionar të avangardes. [...] Imazhet e një të ardhmeje të ndritshme mbushën të përditshmen me një ndjenjë të socializmit në rritje. Në imazhe të tilla, e tashmja u shkri, u shpërbë dhe u defamiliarizua nga vizionet e një të ardhmeje rrezatuese. Arkitektët kudo u udhëzuan të diskutonin kolektivisht direktivat e planit të Moskës. “Pas urdhërave, arkitektët, inxhinierët, menaxherët e industrisë dhe planifikuesit u mbledhën për të diskutuar planin me zyrtarët e partisë dhe të shtetit në tetor 1935 [...] sidomos duke pasur parasysh se çdo keqinterpretim nga ana e tyre mund të rezultojë në spastrim ose arrestim.” (Dehaan, 2013; 109) [...] Plani Pesëvjeçar i Stalinit, i nisur më 1928, nganjëherë quhet 'revolucion i dytë bolshevik'. Për të kryer këtë, Stalini praktikisht i shpalli luftë vendit të tij duke ulur gjysmën e të ardhurave për frymë. Ndërkohë nuk mungonte edhe shembulli i mirë: Ndërtuesit e metrosë - u quajtën heronjtë e kulturës së re. Poezitë, romanet dhe dramat u shkruan rreth tyre. Filma u bënë rreth tyre. Gazetat u mbushën me njoftime për përparimin e metrosë. Delegatët nga ndërtuesit e metrosë morën pjesë në të gjitha ngjarjet e rëndësishme politike dhe morën të gjitha llojet e dekoratave dhe medaljeve ' (Dobrenko, Naiman, 2003; 118)

Plani i Moskës së bashku me veprat monumentale u bë disi i nevojshëm edhe për shkak të kushteve në të cilat gjendej kryeqyteti i Bashkimit Sovietik. Miljutin në vitet 30', pak para imponimit zyrtar të stilit Stalinist dhe ndalimit të debatit arkitektonik, duke bërë një analizë mbi gjëndjen aktuale të kryeqytetit sovjetik, konstatoi se Moskë akoma nuk kishte krijuar një fizionomi të vetën urbane dhe se akoma vazhdonte të gravitonte rreth qytetit Kinez dhe markatës së vjetër në qendër të tij. Sipas tij, “Tentativa për të braktisur këto tipe e modele, për të kaluar tek qiellgërvishësi, është ekuivalente në substancë me kopjimin mekanik të formave të stukturave urbane karakteristike të botës kapitaliste. Qiellgërvishësi është kulmi i një kurbe dhe kënga e mjellmës së kapitalizmit. Futur brenda një qyteti të vjetër, qiellgërvishësi nuk do të ndryshojë asgjë në jetën e saj të përditshme, as arsimimin e saj dhe as prodhimin. Qiellgërvishësi, shpreh dhe realizon idenë e përqendrimit kapitalist, të zbatuar përmes përqendrimit të tregtisë dhe industrisë në konglomeratet kryesore urbane.” Megjithatë, në fund të faqes ai ka hedhur një shënim të tijin në të cilin shpjegon se: "Unë duhet të pranoj se nuk mund të refuzojmë absolutisht qiellgërvishësin si tipologji dhe metode ndërtimi, sepse ka raste kur teknikisht dhe ekonomikisht është e racionale përshtatja për të liruara zona që duhen përdorur për hapësira të gjelbra. Kjo veçanërisht mund të ndodhi kur duhet të aplikohet rindërtimi apo ristrukturimi mbi bazë të parimeve radikalisht novatore, të metropoleve të mëdha moderne.” (Miljutin, 1971; 47) Këtu sigurisht i referohet eksperiencës së arkitekturës moderne dhe ideve për qytetin bashkohor të Le Corbusier dhe parimeve të Kartës së Athinës. Por regjimi stalinist për Moskën kishte plane të tjera, të ndërtonte lart por jo në një gjuhë arkitektonike moderne. Në vend të përqafimit të arkitekturës bashkohore, u ndërtua një trajektore historike e të pakohshme për të dhënë një lloj perjetësie të sforcuar. Shembulli më përfaqësues i këtyre mega objekteve do të njihen si “The Seven Sisters” të ndërtuara në vitet 1947-1953 me nota të stilit Barok dhe Gotik (fig.28). Ndërkohë që këto objekte sot përbëjnë pikat fokale të organizimit urban dhe përfaqësimit arkitektonik të qytetit, ashtu si do të vërtetohet më vonë, objektet e larta të banimit nuk rezultuan të suksesshme në Bashkimin Sovjetik për sa i përket funksionalitetit të tyre dhe përshtatjes me jetën në komunitet dhe në familje, ai në

aspektin arkitekturor ashtu edhe atë teknologjik që lidhet me cilësinë e realizimit, kushteve teknike të ndërtimit, etj.




Fig 28. Plani i qiellgërvishtësve për Moskën 1930. Legjenda: 1 — Universiteti Shtetëror i Moskës; 2 — Hotel Ukraina; 3 — Kudrinskaya Square Building; 4 — Ministria e Punëve të Jashtme; 5 — Pallati i Sovjetikëve (i pandërtuar); 6 — Objekti Administrativ Zaryadye (i pandërtuar); 7 — Hotel Leningradskaya; 8 — Porta e kuqe; 9 — Objekti Kotelnicheskaya. Burimi: <https://russiau.com>

Influenca sovjetike në planifikimin e qytetit sipas stilit Stalinist udhëtoi deri në Tiranë nëpërmjet eksperiencës së studentëve shqipëtar që studjuan në Moskë. Shembull për këtë është propozimi i të riut arkitekt Gani Strazimirit, të sapo diplomuar për arkitekturë në Moskë. Fotot e mëposhtme janë burim i Arkivit të Shtetit ndërkohë një dëshmi interesante na vjen nëpërmjet letërkëmbimeve të mbajtura mes tij dhe Tiranës administrative përsëri nga ASH duke i cituar këtu përmes botimit të historianit E.Mëhilli *“From Stalin to Mao – Albania and the Socialist World”*, Cornell University Press. 2017. Kështu, aty nënvizohet fakti se për tezën e studimeve në Moskë, Strazimiri vendosi të projektojë një plan të ri urbanistik për Tiranën. Në korrespondencën e shkruar Strazimiri kërkonte nga zv. ministri i ndërtimit skicat, planet, dhe studimet e lëna pas nga italianët, si dhe fotografi të gjendjes aktuale të kryeqytetit. “Ti e din fare mirë se në ç’far kondita un do të punoj nesër në Tiranë”, shkruan ai në qershor të 49-ës, “ku do të jemë pothuaj se vetë në një degë ku asht vështirë të punojsh po të mos kesh baza të shëndosha”. Strazimiri arkitekt i ri e ndoshta nën influencën e profesorëve sovjetikë, e quan ambientin intelektual në Shqipëri si të shkretë nga ana profesionale, ndërkohë që siç jemi shprehur në Kap.2, një pjesë e mirë e intelektualëve të kohës së Zogut kishin studiuar në perëndim e në shkolla prestigjioze dhe këtu mund ti referohemi të paktën arkitektëve me më tepër përvojë si S.Luarasi apo A.Lufi, si dhe profesionistët e shkollës teknike Harry Fulls që ishte themeluar prej Kryqit të Kuq i të Rinjve Amerikanë ne 1921.

Strazimiri me vizatimet e tij, sfidon planin italian duke futur kryesisht konceptin e organizimit sipas planit moskovit në akse monumentale, gjeometri të rregullt drejtkëndore dhe kompozim të teksturës urbane nëpërmjet "superbllokut" (fig.29). Sipas E. Mëhillit: “Plani shoqërohej me një dokumentacion të shkurtër të Degës së Urbanistikës, çuar për shqyrtim në Kryeministri, tek Enver Hoxha. Ky sqaronte se autori i kishte refuzuar zgjidhjet urbanistike të italianëve, që afërmendsh nuk mund të shiheshin si të përshtatshme për një rend socialist. Italianët që në fillim të

studimit”, sqarohej aty, “u nisën nga parimi se Tirana nuk mund t’ish veq se një qytet i kolonive Italiane. Mirëpo aksin e madh veri-jug, apo edhe unazat e Tiranës, plani i Strazimirit, në fakt, i pranonte” (Mëhilli, 2018). Përveç paraqitjes grafike dhe vizatimeve që konkurojnë denjësisht ato të Bosios, nuk vërejmë ndryshime të dukshme lidhur me planin Italian për sa i përket dimensionit të qytetit, lartësisë së objekteve apo sistemeve rugore të cilat përkohjnë si në rastin e aksit monumental apo të radialeve kryesore. Si në planin e Bosios, ashtu edhe në këtë rast qëndrimi ndaj zonës historike të qytetit është i ngjashëm, tekstura e re urbane mbivendoset pa asnjë kriter ndërveprimi dhe karakterizuar prej një qëndrimi utopik.



Fig. 29. Masterplan i diplomës së Gani Strazimirit. Planimetria e aksit në pjesën jugore dhe veriore. (burimi: AQSH)

Strazimiri në planin e tij ndryshe nga Bosio, mbyll aksesin në sheshin e qendrës të dy rrugë historike siç ishin rruga e Dibrës dhe rruga e Kavajës (e quajtur Vialle Mussolini gjatë pushtimit), duke i derdhur ato në një unazë të ndërmjetme e cila

propozohej edhe nga plani i Bosios e qv u morr në vazhdim edhe nga planet e tjera por që ende sot është e pa implementuar. Në këtë mënyre Strazimiri rrit kufinj të qendrës e duke përshtatur planin italian për një sistem ku ndalohej automjeti privat. Ai gjithashtu krijon një koridor të gjelbert ndërmjet qendrës dhe unazës së siperpërmendur, i cili lidh qendrat e blloqeve perimetrale duke krijuar një seri parqesh me gjeometri dhe dimensione të ndryshme të cilat duket se përbëjnë risinë e vërtetë të projektit të tij.

Megjithatë, mund të thuhet se kjo shtrirje hapësinore me këtë konfiguracion urban, nëse i referohemi planeve të mëparshme, ngjan më tepër me vizatimet utopike të Brasinit sesa me vizionet moderne të planit të Bosios, me ndryshimin që ndërsa Brasini propozonte aksin e tij monumental në një zonë të pazhvilluar të qytetit, Strazimiri dhe metoda sovietike parashikonte zëvendësimin total të qendrës dhe qytetit egzistues në një realitet urban krejt të ri, të ngjashëm me qytetet e socrealizmit të planifikuara ex-novo në këto vite në sejcilen prej republikave sovietike (fig.30). Duket qartë në këtë plan optimizmi i rendit të ri për të shndërruar krejtësisht realitetin e vjetër, me anë të një koncepti të ri urban që përshkon me përpikmëri rregullat standarte të realizmit socialist, sigurisht duke shpresuar në ndihmën e nevojshme sovietike, e cila për fat të keq apo të mirë, nuk u verifikua në masën që shpresohej dhe nderhyrjet urbanë të kësaj kohe, sikurse ndodhi edhe në periudhën e fashizmit, u reduktuan në disa zona të shkëputura të cilat nuk arritën të krijojnë konglomeratin homogjen që karakterizon qytetet e tjera te socrealizmit stalinist, por sigurisht që skena u plotësua në vitet e mëvonëshme duke ndjekur parime të ngjashme që bëjnë sot që Tirana të ketë pamjen e një qyteti ish-socialist.



Fig. 30. Projektim aksometrik i qendrës ku vihet re zëvendësimi i godinave të Bankës dhe të Bashkisë. (burimi: AQSH).




Fig. 31. Diploma e Gani Strazimirit. Pallati Qeveritar me shtatoren e Stalinit (ku gjendet sot pallati i Kulturës). Pamje ballore, 1952. (burimi: AQSH).

Trajtimi i hapësirës qendrore në planin e Strazimirit është një tjetër pasqyrë e politikës së centralizuar të sistemit dhe që paraqet dallime të qënësishme në krahasim me planin e Bosios. Paralelisht me propozimin për prishje të godinës së ish- Casa del Fascio që mbyll aksin monumental dhe kurorëzon hapësirën politiko - administrative të fashizmit, qendra politike propozohet të spostohet në sheshin qendror me Pallatin Qeveritar si ndërtesën me imponuese e cila propozohet të ndërtohet në vend të Pallatit të Kulturës-sot, me prishjen e Pazarit të vjetër. Fasada e paraqitur nga Strazimiri, rimerr në menyrë të mjegullt linjat e objektit të Postes propozuar nga Bosio, duke i shtuar dy krahe të zgjatur dhe simetrik të cilat permasojnë dimensionin e zgjeruar të sheshit qendror (fig. 31). Ripropozohet gjithashtu sistemi i lozhave, kesaj here sipas një kompozimi hirarkik me theksin në volumin qendror ku lozhat propozohen në dyfishin e lartësisë në numër tek duke lenë vendin qendror për statujen e Stalinit. I gjithë kompozimi i frontalitetit mbyllet me një volum gjashtëkëndor i cili paraqet në faqen nga sheshi stemen e republikës me një yll të zmadhuar në qendër. Më vonë, udhëheqja e kohës do ta vendosi statujën e Stalinit në krahun e majtë të sheshit dhe në qendër të aksit monumental deri në 1968 kur do të zevendësohet me Monumentin e Skënderbeut dhe shtatorja e Stalinit do të spostohet përfundimisht në Kombinat deri në rënien e sistemit.

Prezenca e rëndë e autoritetit qeverisës në shesh tenton të animohet nëpërmjet pozicionimit të godinës së teatrit në qendër të hapësirës në krahun perëndimor të tij. Ky objekt, ashtu siç është paraqitur, duket më tepër si një katedrale me transeptet e tërhequra nga sheshi drejt fasadës ballore, ndërsa rrethohet prej perdeshe të pandërprera ndërtimore të përshkueshme vetëm nëpërmjet Aleve të stilit Housmanian. Duhet thënë se këto vizatime duhet të kenë shërbyer si model dimensional për konturimin e mëvonshëm të sheshit me pozicionimin e Pallatit të Kulturës i cili do të zevendësojë më vonë idenë e pallatit qeveritar në sheshin aktual Skënderbej, ndërsa qendra politike nuk do të variojë shumë nga ajo e qytetit fashist, duke ripërdorur të njëjtat objekte të arkitekturës fashiste qëndron disi e distancuar prej qendrës urbane, kësaj here ndoshta me një arësye më tepër që ka të bëjë me pozicionimin në afërsi të lagjes “Blloku i Byrosë” ku gjendeshin residencat e anëtarëve të byrosë politike.

3.6. Planifikimi i qendrave të banimit - influenca në shoqëri dhe pejsazhin urban.

Sipas Czepczynski, në vitet pas luftës “industrializimi dhe urbanizimi masiv në të gjithë Evropën Qendrore krijoi një kërkesë masive për strehim.[...] Qytete dhe lagje të reja ishin ndërtuar jo vetëm për të akomoduar popullsinë e re në rritje, por edhe për të përfaqësuar fuqi të reja e marrëdhënie të reja shoqërore”(Czepczynski, 2008; 77). Ndërsa në Evropën Perëndimore sidomos pas viteve 50’, përpjekja për ti bërë ballë ekspansionit të qyteteve arriti të marrë në konsideratë edhe diversifikimin e ofertës për banim, në Evropën Lindore duket se emergjenca kthehet në sfidë të vazhdueshme e cila duhej patjetër bërë pjesë në analizën e perceptimit të realitetit. Gjatë sistemit Stalinist, u shkruajt relativisht pak lidhur me arkitekturën dhe urbanistikë për arsye që kanë të bëjnë me presjonin e jashtzakonshëm politik që ushtrohej mbi studjuesit. Kjo situatë ndryshoi ndjeshëm me de-stalinizimin e inicjuar prej Hrushovit. Studimet morrën një tonalitet më shkencor duke i dhënë hov një lloj intelektualizmi revolucionar që gjendej mëparë edhe në filozofinë e Konstruktivizmit. Në librin Qyteti Ideal Komunist, grupi i arkitektëve nga Universiteti i Moskës kryesuar nga Gutnov kanë kryer një analizë të hollesishme të projektit socialist për qytetin. Megjithëse është shkruar me vonë në kohë, ata reflektojnë qartë parimet e urbanistikës dhe arkitekturës socialiste duke ju referuar teorisë marksiste në vazhdimësi të mendimit Milutinian. Një prej çështjeve kryesore në teorinë marksiste që ka të bëjë me *barazinë shoqërore* dhe korespondencën me njësinë e banimit, në sejcilin prej autorëve trajtohet me anë të një oferte tipikisht të reduktuara që karakterizon të gjithë prodhimin ndërtimor të frontit socialist. Gutnov et.al redukton diversitetin e kërkesës së përgjithshme për banim duke sygjerruar “vetëm tri prototipe bazë banimi: një për individin e vetëm (me ose pa fëmijë); për një çift (me ose pa fëmijë) dhe një për dy çifte (një brez të moshuarish, një çift të ri dhe fëmijët). Ky tip i fundit përfaqëson, në thelb, një kombinim të dy njësive të tipit të dytë,[...] Në këto kushte, nuk është e nevojshme të bëhet dallim ndërmjet godinave me apartamente të ndryshme.”(Gutnov et al, 1968; 72)(fig.32). Më tej ata shprehen se ndërsa edukimi publik zhvillohet, numri i tipeve të apartamenteve do të reduktohet masivisht. Pra, varietetet përta i përket jetës publike dhe standarte të minimale për jetën private. Nuk mund të shpëtojë pa u vënë re ngjashmëria me skicat ambientaliste të Le Corbusier për njësinë e banimit në Marsejë (fig.33).




Fig 32 – Përshkrim skematik i tipizimit dhe parametrave të objektit. (burimi: The ideal communist city. Fq 72)




Fig. 33- Unite d'Habitaiton. Le Courbusier 1945-1952 (burimi: W.Boesiger (1977).Le Corbusier. Zanichelli. Bologna. Fq. 188)

Banesat tip përcaktuan standartin e lejuar edhe në Shqipëri, ndoshta duke insistuar edhe më tej në njësimin e tipit shprehur ky edhe në aspektin teknologjik dhe mënyrës së ndërtimit. Referuar Mauricio Begos i cili në botimin e tij bën një katalogim të mirë të tipeve të banimit përgjate sistemit komunist: “Planifikimi i banesave caktohej në numër apartamentesh për t’u ndërtuar gjatë një pesëvjeçari që sanksionohej në kongreset e partisë por pa caktuar tipin e tyre. Planifikimi vjetor bëhej nga komisioni i planit i cili për të ‘vënë në jetë’ numrat e kongresit me fondin disponibël, që ishte gjithmonë defiqitar ndaj kërkesave, detyrohej të caktonte % e ap. 1+1 më tepër se kërkesa e propozuar, duke zvogëluar % e numrit të ap.2+1 dhe 3+1.” (Bego, 2009; 58) Sipas tij kjo disbalancë e krijuar me një stok të apartamentëve të vogla ishte antiproduktive sepse strehonte më pak banorë për njësi sipërfaqeje, por pavarësisht faktit, ishte vëndimarrja politike që përcaktonte politikat e strehimit duke marrë nën vlerësim vetëm aspektin ekonomik të tyre. Në këtë mënyre niveli i sipërm i qeverisjes gradualisht krijoi shkëputje prej realitetit dhe kerkesë konkrete për banim. (Paperny, 2002) arrin në konkluzionin se, jetesa kolektive, siç nënkuptohet nga të gjitha ndërtesat kolektive të realizuara dhe të porealizuara të viteve 1920, bazohej në barazinë e të gjithë anëtarëve të kolektivit; prandaj autorët e këtyre propozimeve ishin kundër llojit të kolektivit në të cilin rolet janë të pabarabarta – siç ishte familja tradicionale. Struktura shoqërore kishte kolektivin si njësi administrimi dhe çdo kolektiv kishte përfaqësuesin e vet të veçantë. Siç shprehet më tej Paperny “Stalini përfaqësonte kolektivin e gjithë vendit: Ai ishte ekuivalenti i gjithë vëndit dhe çdo njëres prej pjesëve të tij [...] Kolektivi (ose *brigada*, nëse ju pëlqen) përballet me armikun si një person i vetëm. Për autoritetet, çdo kolektiv përfaqësohej nga brigadieri i tij [...]. Çdo lider, dëshironte të komunikonte me brigadierin individual dhe jo me kolektivin e brigadës. Jeta e brendëshme e brigadës, zakonisht nuk i intresonte atij” (Paperny, 2002; 116).

Dëshira për ndërtimin e botës së re nëpërmjet ndërtimit të qyteteve të reja, ishte një politike e cila nuk mund të kuptohej dhe vlerësohej pa shpallur njëkohësisht edhe ‘armikun’ e sistemit i cili në këtë rast përfaqësohej nga *qyteti historik*. Ndërkohë që, edhe pse verifikohet se kanë egzistuar përpjekje e rëndësishme për ndërtimin e qyteteve të reja, duhet thënë se ishin qytetet historike që vazhduan të rriten me ritme

më të shpejta se sa qytetet e reja socialiste. Qyteti i punëtorëve në realitet iu bashkangjiti qytetit historik si një periferi industriale, duke penetruar dhunshëm brenda nukleve egzistuese dhe duke formuar periferi të reja brenda qendrës. Miljutin mbi këtë çështje shkruan "në të njëjtën kohë jemi para problemit të riorganizimit radikal të qyteteve dhe nevojës për të parandaluar që anarkia shkatërruese që karakterizon botën kapitaliste të jetë pjesë e zhvillimeve urbane. Mjedisi i ri urbanistik sovjetik duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të mos përjetësojë akoma për shumë vite format e jetës kundër të cilave luftojmë, por për të krijuar kushtet për organizimin e një ekzistence të re kolektive socialiste"(Miljutin, 1971; 46) dhe mëtej ai vazhdon të shtojë se ndërtimi i fabrikave të reja, qendrave teknologjike etj, në qendrat ekzistuese të banuara vetëm nëse, kishin një lidhje të drejtpërdrejtë me prodhimin.

Qyteti i ri për jetën e re kolektive, ndryshe nga qyteti historik bazohet në standartizmin e thellë të tipologjive ndërtimore, duke ndikuar kështu në përcaktimin e imazhit të përgjithshëm urban, i cili mbizoterohej nga kompozime të përsëritura deri në monoton. Ndërkohë që në vendet e tjera të Europës Lindore si ish-Gjermaninë Lindore, Poloni, Rumani, Çekosllovakia etj, në vijim të viteve 60' vihet re një qëndrim më bashkohor në trajtimin e arkitekturës së banesës dhe zonave të banimit, në Shqipëri arkitektura socialiste e qëndres së banimit ruajti në vazhdimësi *parimet radikale të qytetit funksionalist* të orjentuar tek ekonomia e ndërtimit më tepër se nga përmbajtja. Për të kuptuar më mirë se çfarë përfaqesonte teoria radikale dhe në thelb simpliciste e qyteti funksionalist, mund t'i referohemi teoricienit Manfredo Tafuri i cili e quan ndryshe edhe "qytet makinë" gjatë analizës së tekstit të Ludwig Hilberseimer "Arkitektura e qyteteve të mëdha" (Großstadtarchitektur), botuar në Shtutgart në 1927. Sipas teorisë urbane të Hilberseimer: "Arkitektura e qytetit të madh varet thelbësisht prej zgjidhjes që i jepet dy faktorve: *njësia elementare dhe kompleksi i organizimit urban*. Kthina e veçantë si element përberës i banesës do të përcaktojë pamjen e saj, dhe duke qënë se banesat me njëra-tjetrën formojnë blloqet urbane, kthina do të shndërrohet në faktor të konfigurimit urban, por ajo që përbën vërtet qëllimin e arkitekturës; dhe ndersjelltazi, struktura planimetricke e qytetit do të ketë influencë thelbësore në projektimin e banesës dhe të kthinës së veçante"(Tafuri, 2007; 95). Tafuri shpreh rezerva të forta ndaj kësaj teorie e cila redukton problemet komplekse të qytetit brënda një gustoje mekanike e cila vizualizohet nëpërmjet objekteve abstrakte në domethënie. Ai shkruan se qeliza ndërtimore, sipas kësaj llogjike, përfaqëson strukturën bazë të programit të prodhimit, e cila është përjashtuar prej çdo komponenti tipologjik. Ndërtesa njësi, tashmë nuk është më një "objekt", është vetëm vendi ku merr formë fizike montimi elementar i celulave të veçanta. Sipas këtij artikulli të hekurit të planit të prodhimit, zhduket arkitektura, të paktën në kuptimin e saj tradicional. Sepse 'e veçantë' në krahasim me homogjenitetin e qytetit, objekti arkitektonik shpërbëhet tërësisht. Asistojmë kështu në një ndryshim radikal që i bëhet koncepteve si vend, hapësirë, komunitet të cilat janë shfaqur dhe zhvilluar në mënyrë organike në qytetin historik. Eksperiencia tregoi se qyteti socialist shndërron konceptin e gjerë të *tipologjisë* arkitektonike, në thjesht '*tip*' ndërtimor i përsëritur në pafundësi. Kështu mund të gjejmë të nejtën godinë me apartamente tip si në Tiranë, në Kukës apo në Sarandë pa marrë parasysh aspak kontekstin por duke ju referuar kryesisht elementeve fizik e ambiental të parcelës ndërtimore. Çështja kryesore ku çalonte teoria funksionaliste kishte të bënte me pamundësinë e gjetjes së një balance natyrale midis qelizës elementare, organizimit të kompleksit urban dhe procesit të prodhimit, sfidë kjo e vështirë për tu arritur në kushtet e artificialitetit tipik që manifestonte ambienti i ri urban. Urbanistika staliniste tentoi të zgjidhi unifikimin

e pëlhurës urbane nëpërmjet përdorimit të njësisë bazë të Super-blokut, i cili në fakt si strukturë urbane e ka origjinën prej City Beautiful Movement i lindur në SHBA në fillim të viteve 1900 dhe u përdor gjërësisht gjatë viteve 50' në vendet perëndimore. Bëhet fjalë për një sipërfaqe të përgjithshme blloku që i kalon 6 hektarët dhe është një tipologji urbane e aplikuar kryesisht në qytete të mëdha. Raste të njohura të arkitekturës moderne me super-bloqe i hasim në planin rregullues të Chandigarh në Indi i cili u projektua nga Le Corbusier në 1952, apo Brasilia projektuar nga Lucio Costa në 1956 (Ching et al , 2011; 756). Në Rusi tipologjia e blloqeve urbane ka origjinë prej viteve 1920' gjatë industrializimit kur kërkoheshin zgjidhje urbane për ekspansionin e shpejtë të qyteteve. Ky model u imitua prej modelit perëndimor amerikan dhe britanik i cili u transmetua prej Suedisë. Gjatë viteve 30', komplekset residenciale sovietike rritën dimensionet e blloqeve urbane dhe u standartizuan në përmasa deri 5-6 hektarë. Këto struktura urbane që njihen me emrin “super-block” zakonisht përmbajnë godina banimi të cilat janë të vendosura në perimetër, ndërsa brendësia përmban objekte shërbimi të nevojës së parë dhe objekte banimi. I gjithë ky sistem bazohet në principin e arritshmërisë së shërbimeve pa përdorimin e mjeteve të transportit. Në vitin 1958, me futjen e normave të reja të planifikimit nga Krushovi ndryshoi edhe emri i kësaj strukturë që tashmë do të quhej “mikrorajon” si dhe ndryshuan dimensionet të cilat shkuan në mbi 10 ha (fig.34).




Fig 34 - Distrikti Krasnogvareisky. (burimi: Volume n.21, 2009, "The Block", <http://greatersp.blogspot.al/2010/10/every-day-life.html>)

Mikrorajonët që përbëjnë qytetin sovjetik kanë një planvendosje standarde. Ato përbëhen nga një numër blloqesh të mëdha urbane, ose kuartalle të ndara nga rrugë kryesore dhe dytësore. Qendra e kuartallit formohet nga shkolla dhe kopshte. Rreth shkollave janë blloqet e strehimit me hyrje të vendosura brenda oborrit dhe dalin nga rrugë të vogla sekondare. Edhe pse rregullat e ngurta bazuar në llogaritje, struktura lë hapësirë për një liri të caktuar në shpërndarjen e funksioneve brenda një mikrorajoni. Rrjedhimisht ka konfigurime në të cilat të gjitha objektet arsimore dhe komerciale janë të përqendruara, ndërsa ekzistojnë shembuj të tjerë në të cilët ato shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjithë hapësirën.

Duke krahasuar sistemet socialiste dhe perëndimore, mund të shohim se aspektet politike, ekonomike dhe sociale të ndërtimit të banesave në masë ishin shumë të ngjashme si në Lindje ashtu dhe në Perëndim. Bota perëndimore u përpoq të ndërtonte një shtet të mirëqenies sociale ndërkohë bota socialiste "ndërtoi komunizmin". Shembujt e rasteve perëndimore të programeve sociale janë të ndryshëm, përmendim këtu programin "Million Apartments" në Suedi, programin francez Operacioni Million, i cili solli mijëra blloqe betoni të përforcuar rreth Parisit dhe Marsejës etj. Teknologjia e banesave të parafabrikuara Camus prej viteve 50' udhëtoi nëpër pothuaj gjithë globin përfshi Shqipërinë ku u shfaq në 1971 si teknologji e importuar prej

Kinës (fig.35;36) . Kështu socializmi kishte diçka për të mësuar, ai u modernizua, nëpërmjet shembujve të suksesshëm të Perëndimit, prandaj edhe industrializimi i Hrushovit mund të konsiderohet si një lloj "programi për mirëqenien sociale" sovjetike. Në fund të fundit, reformat në arkitekturën dhe ndërtimin e Bashkimit Sovjetik në vitin 1955 nuk ishin iniciuar për shkak të arkitektëve të guximshëm e të frustruar nga socrealizmi në Bashkimin Sovjetik, por ky ishte një vendim shumë i qartë politik, që u bë e mundur vetëm pas vdekjes së Josef Stalinit.



Fig 35 – Sistemi i parafabrikimit të pasluftes në Francëne viteve 50', i njohur si "Camus" sipas emrit të prodhuesit (shenim i autorit) (burimi: <http://postwarbuildingmaterials.be/material/heavy-prefab-systems/>). **Fig 36** – Godinë banimi e parafabrikuar e viteve 70'. Tiranë, zona e Laprakës 2010 (burimi: autori)

Gjatë regjimit komunist dhe planifikimit të centralizuar, komitetet egzekutive ishin organet që patën kompetenca të plota për rregullimin e territorit. Sipas arkitektit M.Bego "Banesat e tipizuara, që përbënin volumin më të madh të ndërtimeve civile, financoheshin e ndërtoheshin nga shteti[...]. Shteti kishte monopolin e ndërtimeve me anë të ndërmarrjeve shtetërore, shpronësonte pa pengesa për sigurimin e shesheve ndërtimore. Ishte porositësi dhe njëkohësisht pronar i banesave të përfunduara. Si porositës jepte udhëzimet për hartimin e seksioneve tipe me llojet e apartamenteve që do të përmbanin, caktonte masat sipërfaqësore etj. E meta që se këto jepeshin pa u thelluar, por me rutinën e tahminase të shefit urdhërues e përsëriteshin vit për vit me ndonjë ndryshim të vogël që lidhej me koniukturat e rastit ose zbatimin e ndonjë porosie nga lart." (Bego, 2009; 58) Per me shumë se 40 vjet, planifikimi i zonave të banimit u bë prej 'Komisionit të Planit' pa shënuar një evolucion domethënës në konceptimin e banesës dhe për këtë arsye, tipologjitë e apartamenteve ishin të ngjashme dhe ripetitive. Kjo situatë e evidentë, rriti akoma më tepër vlerën e objekteve historike siç ishin shtëpitë e ndërtuara privatisht por edhe godinat me apartamente ndërtuar prej italianëve. Në fakt pjesa më e madhe e këtij fondi ndërtimor siç ishin banesat e borgjezisë apo ato të ndërtuara gjatë regjimit fashist, pasi u konfiskua u ripërdorën prej kastës drejtuese të kohës. Sipas (Bego 2009; 59):"Zhvillimi i seksioneve tipe ishte i lidhur me mundësitë reale buxhetore, të materialeve e teknikave ndërtimore të kohës. Para së gjithash, zgjidhja e tyre duhej të që sa më racionale për të plotësuar kërkesat strehimore. Si tip banëse fillestare bazë u zgjodh tipi i apartamentit 2dh+k duke pranuar faktikisht që në të mund të strehoeshin dy familje" Në frymën e standartizimit dhe të ndërtimit vetëm të minimumit të hapësirës jetike, u riorganizua duke u unifikuar edhe hapësira e ndenjes dhe e gatimit. Sipas analizës që bënte Miljutin kur teorizonte fillimisht qytetin socialist:"Centralizimi i

shërbimeve shtëpiake do të garantojë avantazhet pasuese:1. Emancipimin e gruas nga puna shtëpiake;2. Reduktimi dhe, në disa raste, eliminimi i nevojës për të thirrur forca të reja punëtore në qendrat urbane;3. Zvogëlimi i kërkesës për banesa të reja;4. Rritja e produktivitetit në punë;5. Përmirësimi i standardit jetësor të popullatës punëtore;6. Ngritja e nivelit kulturor të qytetarëve. Kjo zgjidhje atëhere nënkupton futjen me detyrim të ushqimit kolektiv dhe të edukimit kolektiv të fëmijës së shkeputur prej perkujdesjes prindërore?”(Miljutin, 1971; 102). Kësaj pyetje me shije futuriste, Miljutin edhe pse i përgjigjet negativisht dhe në favor të familjes, e shikon këtë vizion shoqëror si të parakohshëm dhe jo aktual për gjëndjen e qytetit socialist duke konsideruar se në asnjë mënyre ky proces nuk mund të zhvillohet mekanikisht. Në Tiranë vetë pas shtetëzimit të çfarëdolloj aktiviteti privat, në 1968 u ngrit me vendim të Keshillit të Ministrave NSHUS- Ndermarrja shtetërore e ushqimit social e cila ishte një përpjekje për të kolektivizuar ushqimin dhe për tja shkeputur këtë funksion banesës. Tentativa në fakt, sidomos në qytetet egzistuese nuk tregoi rezultate më të ndryshme përdorimi përtej menciave të punëtorëve. Përgatitja dhe të ushqyerit mbetet sërisht një proces që zhvillohet brenda familjes edhe për shkak se cilesia e shërbimeve ishte krahasimisht shumë më e ulët nga produkti i amvisave edhe pse nën presionin e ekonomisë së varfer. Në qytetet e reja industriale ky organizim që më i sukseshëm edhe prej faktit se nuk egzistonte alternativë tjetër për shkaktë impenjimit të gruas në punë prodhuese. Brenda territorit të fabrikes u pozicionua godina e menciave e cila është një prej tipologjive përberëse të qytetit socialist.

Ndër shembujt më të njohur të ndërtimit të banesave gjatë periudhës kur u aplikua stili Stalinist në Shqipëri dhe që përcaktuan arkitekturën e akteve kryesore të kryeqytetit, ishin kompleksi “Shallvare” (fig. 37;38) dhe pallatet “Agimi”, të cilat filluan nga ndërtimi në fillim të viteve 50’. Sipas M.Velos “ Arkitekti projektues ishte Gani Strazimiri i sapo kthyer nga B.S. Ai bëri një zgjedhje tërësisht ruse, të periudhës së artë socialiste, me xokolatura, dritare të vogla, erkerë, kolona, frontone, korniza dhe tunele kalimi si ato të Leningradit ” më pas shprehet “ishte një dështim i plotë por sikur nuk mjaftoi kjo, u projektua edhe ana tjetër përmbi Lanë, Blloku i Shallvareve, por në qendër me shtatë kate, sigurisht pa ashensorë”(Velo, 2013;141). Kolevica gjithashtu thekson se kishte arkitektë dhe ai përmend në veçanti Gani Strazimiri i cili kishte studiuar në Bashkimin Sovjetik dhe të cilët sipas tij e “njihnin arkitekturën staliniste në mënyrë të përkryer”(Kolevica, 2004; 39).

Kompozimi i bllokut të pallateve Agimi shfaq synimet formale dhe monumentale që ishin në bazë të arkitekturës së periudhës së socrealizmit. Orjentimi nga Veriu bëhet i domosdoshëm në kete rast për mbylljen e lagjes më të famshme në Tiranë, asaj të Bllokut. Këto pallate janë konceptuar si mure që pa shkeputje bllokun e vilave që qëndron në brendësi. Nëse në rastin e Shallvareve kompozimi urban shfaq karakteristikat e superbllokut duke dhënë mundësi të zhvillimit në brendësi të parces, pallatet Agimi janë si një mbyllje e fortë e qytetit nga ai krah (fig. 39). Sipas dëshmisë të Ing.Orhan Sakiqi: “Në këtë dekadë ndërtimet u mbështetën mbi huazime, imitime tipike të nxitura nga ideologjia e kohës, nën ndikimin e Bashkimit Sovjetik. Ndërtimi i pallateve të Shallvareve, si dhe mjaft të tjera, u referohen dhjetëvjeçarit ’50-’60, deri kur marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik u ndërpre. Apartamente të larta, që dallohen për stilin barok, fasada të rënda, dritare të vogla, pa ose me ballkone false. Bashkë me bllokun e Shallvares, pallatet “Agimi”, ishin edhe Pallatet e Oficerëve në Rugën e Durrësit. Janë vite ku rritet në mënyrë progresive e të shpejtë numri i popullsisë së Tiranës dhe pikërisht në atë periudhë kërkesa për ndërtimin e pallateve, shtimin i apartamenteve, ishte imediate. Duke shfrytëzuar sërish terrenin e lirë, sapo përfundoi objekti i pallatit të Shallvareve, në vitet 1953- 55 u punua për

ndërtimin e atyre “Agimi”, paralel në krahun tjetër përgjatë Lanës, që ishin si një vazhdimësi e pallateve të Shallvareve, pasi edhe për to u aplikua e njëjta strukturë arkitektonike. Me pamje krejtësisht veriore, ai bllok ndërtimesh ishte pranë Bllokut të udhëheqjes. Morën emrin “Agimi” si simbolin që përfaqëson kjo fjalë. Ndryshe nga Shallvaret, si krah pune u përdorën rreth 500-600 të burgosur që kanë punuar për ndërtimin e pallateve “Agimi”. Madje, gjatë punës pati edhe një tentativë arratisjeje, u rrethua e gjithë lagjja, deri sa e kapën të larguarin.” (Sakiqi, 2017) (fig.40)



Fig.37– Kompleksi “Shallvare” krahun jugor, gjatë ndërtimit.Tiranë ~1 954; **Fig.38** Kompleksi “Shallvare” nga rr.Ibrahim Rrugova.Tiranë ~1954; **Fig.39** Pallatet “Agimi”, Tiranë ~1954; **Fig.40** Foto nga kantjeri i pallateve “Agimi” ku dallohet moshja e re e punëtorëve (shenim i autorit) (burimi. AQSH).

Siç përshkruhet në një përmbledhje të eseve të quajtur *'Arkitektura e frikës'*, autori Flusty shpjegon në artikullin e tij *'Ndërtimi i paranojës'* së lagjet bllok, kanë qenë shquar prej kohësh për nivelin e lartë të kimit, shpesh për komunitete me të ardhura të ulëta anembanë qytetit. Në këto lagje shtëpitë rriten gradualisht me dritare të mbyllura dhe gardhe të guximshme me porta të mbyllura për të siguruar siguri relative ndaj sulmuesve dhe dhunës së rrugës. Në ekstremin e tjetër, një prani e gjere e lagjeve bllok haset edhe në lagje të pasura urbane si Beverly Hills, ku pallate të mëdha që përmbajnë pasuri të konsiderueshme sigurohen kundër të huajve nëpërmjet mureve të larta dhe mbrojtjeve të padepërtueshme (Flusty, 1997; 21). Kështu, në vendet perëndimore - lagjet bllok – i hasim në të dyja rastet, edhe në versionin “geto” po ashtu edhe në versionin e ashtu quajtur “gated community”. Ndërsa në vendet ish-socialiste dhe në rastin e Shqipërisë në veçanti, ato përfaqësonin një mënyrë artificiale të jetuarit, të imponuar nga lart dhe të mbrojtur me rregulla strikte. Blloku i Tiranës u shpall si zonë e ndaluar ku jetonin funksionar të shtetit prej vitit 1961. Një këndvështrim interesant mbi temën e banimit dhe standartin e diferencuar ndërmjet udhëheqjes/ ish-Byrosë Politike të nomeklaturës, kryen edhe sociologu Enis Sulstarova. Ai shprehet “Në Tiranë vendi i banimit të udhëheqjes ishte ‘Blloku’, fjalë kjo që kishte kuptimin e një lagjeje apo sektori urbanistik, por edhe kuptimin e një

vendi të bllokuar, ku s'mund të hyje.”(Sulstarova, 2005; 102). Sistemi ndërtoi residencën qeveritare mbi një zonë vilash borgjeze të periudhës së Zogut e cila krijoi edhe nuklin qëndror të lagjes së quajtur “Tirana e re”. Gjatë viteve 1970 dhe 1980 u ndërtuan edhe zona të tjera “bllok” në vende të ndryshme anembanë Shqipërisë, kryesisht në formën e bllokut rezidencial turistik për udhëheqjen, këtu mund të përmendim rezidencat e udhëheqjes në plazhin e Durrësit apo rezidencat në Vlorë tek Uji i Ftohtë, Pogradec, Korçë, Shkodër etj. Gjatë periudhës së regjimit komunist, kjo hapësirë për masat ishte si një kala pa mure brenda territorit urban, e panjohur dhe e padepërtueshme nga flukset urbane. Pas viteve 90’, kurioziteti dhe statusi që kishte futuar kjo zonë gjatë viteve të monizmit, pati një rol të rëndësishëm mbi marketimin urban të kësaj hapësire dhe pozicionimin në majë të trendit metropolitan.

3.7. Industrializimi dhe shoqëria

Qytetet industriale u konceptuan me idenë se përparimet teknologjike do të lehtësojnë jetën e shoqërisë. Si Gutnov etj. përshkruan në librin e tyre “Elektrifikimi, automatizimi, metoda efikase të prodhimit dhe një ditë të reduktuar e punës. Prodhimi me sa duket përbëhet nga tre sektorë themelorë: 1. Industria e automatizuar; 2. Hulumtimi shkencor dhe përdorimi i makinave; 3. Arsimimi masiv - formimi i njeriut komunist”. Ideja kryesore ishte se “elektrifikimi zvogëlon nevojën për punë fizike [...] lind një marrëdhënie të re: mes njeriut dhe pajisjes automatike”(Gutnov et al, 1968; 33-34.). Gutnov etj. vazhdojnë përshkrimin e tyre në lidhje me institucionet shkencore të cilat sipas tyre kërkojnë krijimin e qendrave kërkimore të centralizuara. Ata shprehen se një organizatë e tillë kërkon një sistem të centralizuar të komunikimit për të lejuar personelin e instituteve të ndryshme të mbledhin me shpejtësi maksimale në çdo moment dhe si një kolektivitet i vetëm, të shkëmbejnë informata nga laboratorët dhe institucionet e lidhura në ato.

Automatizimi i industrisë dhe disa politika socialiste solli disa suksese në lidhje me rolin e grave në shoqëri. Enzo Godoli (2014) - studiues i historisë dhe teorise se arkitekturës pranë Universitetit të Firences, ka bërë një studim lidhur me futjen e stilit të ri të jetësës në ish vendet socialiste. Ai shkruan se u studiuan në detaj modelet origjinale të llojeve të banimit, me financim adekuat të shërbimeve të komunitetit, të cilat mund të kontribuonin për të futur në rrugë të reja jetën socialiste dhe për të emancipuar gruan nga ngarkesa me punët e shtëpisë e për ta aftësuar për të hyrë në ciklin e prodhimit. Në të njëjtën kohë studimi u shtri tek ndërtesat kolektive, si për shembull klubi i punëtorëve, të cilët kishin funksionin e katalizatorëve të jetës shoqërore. Megjithëse në disa raste rezultatet ishin pozitive, tradita shqiptare ka treguar se në përgjithësi roli i grave gjatë socializmit u përkeqësua. Megjithëse u futën politika të reja socialiste, normat patriarkale ishin të pranishme dhe kështu gratë punonin në fabrikë dhe gjithashtu bënë detyrat e brendshme shtëpiake. Propaganda kryesore socialiste i referohej kulturës dhe normave tradicionale dhe imazhin publik të grave që u maskulinizua në figuracionin e saj artistik duke e krahasuar atë me burrat nën të njejtin kendveshtrim, atë të ndertimit të socializmit.

Stalini në fillim të regjimit të tij dhe gjatë planifikimit të procesit të industrializimit të vendit është shprehur: “Ne jemi 50-100 vjet mbrapa vendeve të perparuara. në duhet ta përshkojmë këtë distancë për 10 vjet. Ose e bëjmë këtë, ose jemi të thyer. Kjo është ajo që na diktojnë detyrimet tona ndaj punëtorëve dhe fshatarëve të Bashkimit Sovjetik.”² . në fakt prej vitit 1927 nëpermjet dy planeve të

²Marre nga: <http://fishki.net/anti/2391805-stalinskaja-industrializacija-sssr.html>.

para pesëvjeçare, shkalla e industrializimit u rrit me ritme shumë të shpejta derisa në fund te viteve 30' ekonomia dhe shkalla e industrializimit të BS-se e rendit at ë në vendin e tretë pas USA dhe Gjermanisë, por kjo siç dihet u arrit me një kosto shumë të madhe në njerëz dhe sakrificat të popullit të ish-Bashkimit Sovietik. Si rrjedhim ky proces i cili u propagandua gjerësisht edhe jasht vendit, instaloi përfundimisht regjimin Stalinist deri në vdekjen e diktatorit.

Ndërtimi i objekteve industriale, në varësi edhe të kërkesave të veçanta teknologjike gjithashtu iu nënshtua rregullave të Stilit Stalinist me në bazë principin e arkitekturës totale që është shpjeguar mëtej në këtë teze. Stili stalinist i arkitekturës u prezantua në të gjitha llojet e ndërtimeve dhe kishte një karakter të veçantë përse i përket ndërtesave të prodhimit industrial. Ajo u shpreh më qartë në arkitekturën e përgjithshme të qyteteve të reja. Në Shqipëri, ajo kishte të njëjtin karakter si në Bashkimin Sovjetik edhe pse në një lloj tjetër territori dhe klime shumë më të ndryshme. Dy karakteristikat kryesore të ndërtesave industriale të periudhës Staliniste ishin shtrirja e madhe horizontale dhe vëllimi i madh, zgjidhje arkitektonike që vinin si pasoje e nevojës për forcë punëtore dhe teknologjizimin e pakët të procesit industrial. Siç shpjegon Kopp (1987), në propozimet e planifikuesëve të Bashkimit Sovjetik, erdhën elementë të cilët më vonë do të kodifikoheshin në Kartën e Athinës por ishte gjithashtu themelore ideja se qyteti socialist duhet të ishte rrënjësisht i ndryshëm nga qyteti i vjetër kapitalist. Megjithatë, sipas tij, “të gjitha qytetet ku u konceptuan fabrikat dhe qendrat industriale u bazuan dhe u ndërtuan në topografi të panjohura dhe nganjëherë ishin të panjohura edhe burimet natyrore për të cilat ato ishin ndërtuar.”(Kopp, 1987; 182). Kritikët e qytetit industrial socialist, “socgorodit” të Miljutin bazoheshin në faktin se të dyja si Konstruktivistët rusë edhe socrealizmi ishin të prirura të mendonin territorin për ndërtesat industriale si absolutisht të sheshtë. Sipas tij ata harruan se shumë faza të ciklit prodhues mund të zgjidhen me nivele vertikale ose dysheme të pjerrët [...] Lirshmëria duhet të përfaqësojë një ndihmë jo një kufizim për inxhinierin apo arkitektin inteligjent”(Miljutin, 1971; 83). Sipas (Tafurit, 2007) për të dy, Konstruktivistët rusë dhe arkitektët Stalinistë, tema kryesore është ajo e një të ardhme në të cilën projektohet e gjithë e tashmja, një dominim i 'racionales' dhe eliminimi i të gjitha rreziqeve që mund të përfshijë e ardhmja.

Shëmbuj të arkitekturës industriale staliniste në Shqipëri, mund të përmendet shtypshkronja "Mihal Duri", e cila u ndërtua në Tiranë më 1949. Sipas Velo-s, “kjo ndërtesë është projektuar sipas parimeve dhe stilit të arkitekturës socialiste tipike ruse. Elementet bazë janë huazuar nga klasicizmi dhe modernizmi i kastruar me një stil socialist: Kati përdhes është trajtuar si një gji gjigant i jashtëm i Rilindjes, me kolona gjigante që nuk mbajnë asgjë, dritare të cilat janë futur në gjurmë të harkut, ballkone pa asnjë qëllim, korniza me njëqind thellime, fronti paraqitet si një masë e fortë.”(Velo, 2013; 106). Por, gjithsesi, Velo vëren se kjo është ndërtesa e parë për prodhim industrial brenda qytetit të Tiranës. Ndërtesa e dytë e përshkruar nga Velo është Kinostudio (fig.41) e cila është gjithashtu një model përfaqësues i ndërtesave industriale në Shqipëri dhe dedikohet industrisë së filmit dhe nuk është rastësi që ndërtesat e para të prodhimit në Tiranë iu atribuon prodhimit të mesazhit propagandistik. Si Velo thekson: “Kinostudio është shembulli i përsosur i arkitekturës së Realizmit Socialist dhe si i tillë duhet të ruhet me kujdesin më të madh, edhe më shumë për shkak të faktit se ajo është ruajtur me dëmtime të vogla”. Megjithatë, sipas tij “hyrja qendrore e ndërtesës është një absurditet i palogjikshëm, krejtësisht i remë, që imponon respekt dhe frikë formale dhe që në këtë rast janë të panevojshme [...]

hyrja krijoi një tempull, por jo një institucion të lirë me qëllimet artistike”(Velo, (2013; 130). Më tej vazhdon “Ideologjia u imponua nga jashtë. Katër kolona gjigante të stilit korintas kanë një dekor të projektuar dhe ekzekutuar me kujdes. Ky prodhim voluminoz i akseve qendrore me dy krahë anësor, në mënyrë simetrike, të përforcuar me dy kolona të përbëra, dy kolona rrethore dhe katrore, si dhe Corinthike, me një basen përpara. Ndërtesa shtrihet me një plan të mbyllur simetrik, bazuar në dy kate dhe ka një çati. Brenda është korridori në mes, me objekte në të dy anët”(Velo, (2013; 130). (fig.42)



Fig.41- Kinostudio Shqipëria e re, foto e vitit 1952.(burimi: AQSH); **Fig.42-** Leninfilm. Moske. (burimi:wikipedia)

3.8. Shtëpitë dhe Pallatet e Kulturës.

Shkrija e projekteve për qytetin me planet ekonomike për industrializimin ishte një ëndërr e vjetër e Revolucionit Teknik-Shkencor. Filozofitë e ndryshme të së majtës dhe së djathtës e bënë atë pjesë të programeve të tyre politike. Në këtë kontekst arkitektura luante një rol të veçantë, ndaj një tipologji e re objekti arkitektonik lindi si rrjedhojë e kësaj kërkese. Arkitektët e Konstruktivizmit Rus sipas në vitet 20' besonin se njerëzit mund të transformoheshin duke jetuar në ato që ata quanin “kondensatorët e rinj social”: klubet, shtëpitë kolektive, teatrot masive, të cilat ata projektin vazhdimisht por që vetëm rrallë ndërtoheshin. Në fakt, “kondensatori social” kryesor i kësaj periudhë do të ishte fabrika. Do të ishte ajo, pasi në momentin që, industrializimi i vendit është problemi më kritik, fabrika do të ishte një nga mjetet kryesore të urbanizimit. Edhe pse jeta e një qyteti industrial socialist rrallë shkonte përtej fabrikës ku shpënzoheshin periudha me e madhe e jetës, në koncept ideja së ndërtesa si kondensator social i jepte një rol shumë të rëndësishëm arkitekturës e cila duhej të kishte aftësinë të influenconte sjelljen kolektive. Akoma më tepër, qëllimi i kondensatorëve socialë ishte të influenconin nëpërmjet dizajnit e hapësirës, rrëzimit e hierarkisë së klasave dhe krijimit e barazisë sociale. Edhe pse arkitektura sovjetike e konstruktivizmit ndryshoi radikalisht trajektoren me prezantimin e stilit Stalinist, ideja e kondensatorëve socialë nuk shteroi por u vu në praktikë me ndryshime të vogla përgjatë gjithë sistemit. OMA, një partneritet internacional në praktikën e arkitekturës, urbanizimit, dhe analizave kulturore me në krye Rem Koolhaas kryen akoma studime mbi këtë konceptim të arkitekturës. Për të “social condenser” është: “shtresëzim programatik mbi terrenin vakant për të nxitur bashkekzistencën dinamike të aktiviteteve dhe të gjenerimit përmes interferencave të tyre, ngjarje të paprecedenta”(Koolhaas et al, 2004; 73). Që herët në fundvitet 70' ai shprehet në librin e tij *Delirious New York* se kondensatori social e gjeti realizimin e tij më të arritur në qiellgervishtësin Amerikan. Duke e përshkruar kondensatorin social si në metodë për implementimin e teorisë së konxhestionit urban si konditë e

domosdoshme për të gjeneruar kolektivitet apo masë konsumi në rastin e ekonomisë kapitaliste.

Ristrukturimi i ekonomisë mbi bazat e parimeve socialiste solli rrjedhimisht riorganizimin e jetës kulturore. Për shtetin socialist kultura zinte një vend të veçantë në politikën për rregullimin e territorit dhe kjo argumentohet me sistematicitetin e ndërtimit të këtyre godinave në qendrat e banuara. Qyteti socialist nuk mund të kuptohet pa prezencën e pallatit apo shtëpisë së kulturës të cilat ishin ndër objektet e veçanta polifunksionale që gjallëronin qendrat e qyteteve socialiste. Sipas Czepczynski “qëndrat e rëndësishme të kultures të njohura si ‘pallate’ apo ‘shtëpi’ kulture përbënin përfaqesimin kryesor zyrtar të “kultit të kulturës”. Këto stuktura të rëndësishme i gjejmë pothuajse në çdo qytet të madh socialist”(Czepczynski, 2008; 72). Në të gjithë frontin e lindjes përfshi Shqipërinë, objektet për kulturen njohën zhvillim dhe përhapje të shpejte. Duke ju nënshtruar kërkesave dhe kushteve konkrete lindi edhe një seri variacionesh që japin një panoramë të gjerë dhe me shumë domethenie lidhur me evoluimin e arkitekturës së sistemit socialist. Në rastet që studiojmë në vijim Kombinati i Tekstileve apo edhe në Maliq, shtëpia apo pallat kulture së bashku me zonën sportive përbënin një prej komponenteve më të rëndësishëm të jetës publike dhe të çlodhjes. Propaganda e kohës i konsideronte këto godina si një instrument thelbësor për emancipimin shoqëror përmes aktivizimit të individit në jetën shoqërore. Sipas Kopp (1987), klubi korespondon me një koncept kulture që mbi të gjitha nuk është për eliten por për masën, jo te asaj që mund të përftohet nën qetësinë e studios personale duke mësuar, por në një grup të lidhur me interesat të përbashkëta dhe të ndërgjegjshëm për nevojën për tu kulturuar. Vete emertimet e para që ju bënë kësaj tipologjie tregojnë lidhjen organike që ky objekt ka me shoqërinë, sipas Miljutin “Klubi i punëtorëve ose siç u quajtën nga konstruktivistët “kondensatori social” pritej të “kondensonte” shpirtin revolucionar, ti jepte atij një qasje kolektive dhe mundësinë për pjesmarrje të gjërë të shoqërisë”(Miljutin, 1971; 18). Gjatë viteve 30’ kjo tipologji mori shumë epitete të cilat në thelb evokojnë të njëjtin koncept, psh. El Lisickij- pjesëtar i rëndësishëm i lëvizjes konstruktiviste i quante “oficina sociale” apo “atelie për transformimin e njeriut”, duke i konsideruar në një farë mënyre si makineri për prodhim kulture për masat. Edhe pse në realitet ishte evidente klima entuziaste e shoqëruar shpesh me diletantizëm, pavaresisht këtij fakti kjo tipologji luajti një rol të rëndësishëm në përhapjen e kulturës dhe dijes duke konsideruar analfabetizmin masiv të asaj kohë.

Në teori dhe praktikë, klubet ishin parardhës të shtëpive apo pallateve të kulturës. Ato inspiroheshin prej aftësisë për të gjeneruar shoqërizim të kinemave italiane të periudhës së futurizmit, por egzistonin edhe shembuj të mëparshëm si teatri anglez, por e veçanta në rastin e shtetit socialist ishte se këto ndërtesa i drejtoheshin masave dhe si të tilla, perjetimi i hapësirave dhe evolucioni arkitektonik i tyre shpreh orjentim të ndryshëm karshi shembujve perendimor. A.Kopp shprehet se, klubet e para sociale kishin influencë italiane me llozha, skena të vogla dhe reduktime të panevojshme. Në thelb u projektuan si auditore ku institucionet artistike të lëvizshme do të prezantonin repertorin e tyre para spektatorëve pasiv. Në fakt klubet do tejkalonin funksionin e tyre thjesht si vend për grupimin e njerëzve duke u shëndrruar në një institucion kompleks ku vetë spektatorët bëhen aktorë, organizatorë dhe animatorë. Hapësira kulturore shihej nga politika totalitare si një mjet për aktivizimin e individit në jetën shoqërore, duke e konsideruar atë si qenie që evoluon nën presionin e vazhdueshëm të revolucionit kulturor, por duhet theksuar këtu se duke ju referuar ideologjisë së kohës, njëkohësisht përbënin edhe një instrument shumë efikas

kontrolli mbi bindjet politike të individit, nëpërmjet kontrollit politik të kohës së lire. Më tej Kopp vazhdon: “Që në muajt e parë të pushtetit sovjetik filluan të shfaqeshin klube të shumta që drejtoheshin kryesisht nga grupet e sindikatave politike dhe tregtare; ato ishin të vendosura në vende të braktisura, në kisha të çshenjtëruara, në depo, u përhapen gati në çdo vend dhe projektimi i këtyre ndërtesave do të ishte një nga detyrat e para të arkitektëve sovjetik pas revolucionit.”(Kopp, 1987; 138)

Në Shqipëri gjithashtu ndodhi i njejti fenomen. Fillimisht u ripërdorën për qëndra kulturore ish pronat e borgjezisë, siç ishte rasti i Pallatit të Pioniereve në Tirane që u pozicionua tek banesa e Mbretit Zog. Pas viteve 60', kur feja u ndalua me kushtetute e njejta gje ndodh me objektet e kultit që i shpetuan shëmbies. Dy prej arkitekteve të atij sistemi në botimin e tyre në vitet e fundit të sistemit shprehen se: “Në vitet e para, në përputhje me mundësitë e kohës, për to u përdorën shtëpitë më të mëdha e të bukura të çdo qyteti, të cilat iu shtetëzuan klasave të përmbysura”(Mosko & Sukaj, 1986; 50). në të vërtete këto objekte nuk u përdoren vetëm provizorisht por definitivisht. Ndër konfiskimet më emblematisht të kohës ishte ish- rezidenca Mbretërore e arkitektit Bossio e cila u konvertua në Pallatin e Brigadave, një ngjarje kjo që shprehet në mënyrë tepër artistike me filmin “Krevati i Perandorit” të vitit 1973 me skenar të Dritëro Agollit. Fillimi i sistemit e gjen proletariatin në Shqipëri me të njejta kërkesa estetike me ish-borgjesinë, duke marrë në zotërim atë që kishte lakmuar historikisht, pa u preokupuar për eksenin stilistik dhe konfliktin që egzistonte lidhur me estetikën teorike të sistemit. Në këtë mënyrë shpjegohet edhe pranimi me entuziazëm i stilit klasik Stalinist në vitet e para të pushtetit, ku për shkak të distancës kohore ishte më i nevojshëm konfrontimi stilistik me të shkuarën se me të ardhmen që do të karakterizoje më tepër arkitekturën socialiste të pas viteve 60'.

Që në fillimet e tij modeli i ri i klubit konstruktivist, shfaqet si një model i sofistikuar i cili pati jehone edhe në pjesën tjetër të Europës. Këto ndërtesa prezantoheshin si tepër revolucionare në të gjitha botimet periodike të periudhës së lëvizjeve avangardë, në kohën kur idete e arkitekteve Konstruktiviste mbizoteronin skenën arkitekturore moderne. Prej vitit 1925 klubi filloi të krijonte si tipologjinë e tij, ashtu edhe një arkitekturë të çliruar nga stereotipet e së të kaluarës. Në themel të krijimit të tij ishin parimet e decentralizimit dhe aksesibilitetit të stukturave për kulturën, ai u ngjiz i lidhur me lagjen apo fabrikat dhe i lidhur me vendin e punës. Klubi i punëtorëve përveç se një strukturë urbane e shtuar konglomeratit të qytetit socialist, në fakt shihej edhe si një shfrytëzim për zonat e banimit të cilat shpesh ishin të mbipopulluara brënda ambienteve të vogla që ofronin strukturat për banim. në këtë mënyrë tentohej të ofrohej në sferën kolektive ajo që mungonte në sferën private duke bërë të shpjegueshëm edhe frekuentimin e lartë që patën këto objekte. Ndër rastet më të famshme që i perkasin kësaj tipologjie mund të rëndisim Klubin e Oficinave Kauçuk i 1927-ës apo Klubin Russakov i 1927-ës në Moskë, të dyja nga arkitekti Kostantin Melnikov apo Klubi Zuev i 1928-ës nga Ilya Golosov (fig.43) të dy këta arkitekta nga themeluesit e Konstruktivizmit të cilët pas qasjes zyrtare ndaj Stilit Stalinist, u tërhoqën nga vemendja në skenën arkitektonike. Të gjitha këto raste prezantojnë një qasje linguistike formale që shkon në të njejtin llogjikë me arkitekturën industriale, afër imazhit të fabrikës e cila ishte dhe vetë shkaku i egzistencës së qytetit socialist. Arkitektura konstruktiviste e spektaklit konsiderohej si një performance volumore dramatike e cila kërkonte të krijonte habi nëpërmjet risise arkitektonike shpesh të shprehur përmes raporteve bosh-plot, përdorimit të konsolave të shtyra apo zgjidhjeve volumore me cepa të mprehte. Në varësi të vendodhjes, nuk mungonin gjithashtu edhe kerkime mbi monumentalitetin e arkitekturës simetrike me

fasada të vazhduara dhe ritëm repetitiv siç është rasti i Klubit Kauçuk i cili prezanton një volum cilindrik me një akses qëndror në formën e shkallares se dyzuar si tek pallatet neoklasike. Mirepo edhe pse ky klub ‘konstruktivist’ nuk përbënte më tepër risi se objekte të tjera të kësaj periudhë, e cila karakterizohet prej monumentalitetit dinamik më tepër se simetrisë aksiale, u përzgjedh pikërisht ky objekt, për t’u konsideruar e vlerësuar nga regjimi Stalinist duke e nxjerre atë nga harresa që pllakosi pjesën tjetër të arkitekturës Konstruktiviste.




Fig.43 – Ilya Golosov, Klubi Zuev në Moskë 1927. Pamje e zgjidhjes këndore, plane dhe prerje, (burimi:wikipedia)

Për rastin e Shqipërisë në botimin e (Mosko & Sukaj, 1986) gjejme disa të dhena sasiore mbi përhapjen e këtyre tipologjive në territorin Shqiptar deri në vitet 60’, ata shprehen se deri në këtë periudhë funksiononin në qytete rreth 30 kinoklube e shtëpi kulture, ndërsa në fshatra rreth 1300 vatra dhe shtëpi kulture përgjithësisht jo të mëdha, ndërsa më tej vazhdojnë “ndërsa në vitin 1950 ishin rreth 140, në vitin 1960 arriti në mbi 1300 ndërsa sot funksionojnë mbi 2100 të tilla, nga të cilat rreth 1650 vatra kulturore në fshatrat e veçantë, rreth 450 shtëpi kulture dhe kinoklube në fshatrat e bashkuara, qendrat e banuara të ndërmarrjeve bujqësore e të atyre minerare e industriale si dhe rreth 80 kinoklube, shtëpi e pallate kulture në të gjitha qytetet e vëndit” (Mosko & Sukaj, 1986; 53). Siç theksohet më tej në këtë botim, rreth pozicionimit dhe aspektit urban, ato u vendosën në qendër të qyteteve dhe fshatrave. Një vendosje e tillë u përgjigjet më mirë kërkesave funksionale, veprimtarisë së tyre të larmishme dhe krijon mundësi për një frekuentim më masiv. Edhe pse në disa raste specifike siç permendet shtëpia e kulturës në Çorovodë e cila është vendosur në parkun pranë zonës së banuar, nga pikpamja politike preferohet pozicionimi në qendër të qytetit., Mosko&Sukaj në botimin e tyre të 1986-ës përcaktojnë tre tipologji objektesh për veprimtari kulturore shoqerore të cilat dallojnë përse i përket madhësisë, programit dhe raporteve ndërmjet funksioneve edhe pse në përmbajtje janë te ngjashme: “vatra, shtëpi apo pallate kulture, teatro apo kinoteatro, kinema apo kinoklube. Por siç ka vërtetuar jeta, kinoklubet nuk kane ndryshime thelbesore nga shtëpitë apo pallate kulture, teatro apo kinoteatro, kinema apo kinoklube”(Mosko & Sukaj, 1986; 4). Ndërsa teatrot dhe kinemate ishin struktura që ishin shfaqur në Shqipëri në kohën e monarkisë së Mbretit Zog, metej u zhvilluan gjatë protektoratit

italian e pushtimit, shtëpите dhe pallatet e kulturës edhe pse gjejme një lloj vazhdimësie me këto të parat përbëjnë një tipologji të re e cila u shfaq për herë të parë me qytetin socialist. Pallatet e kulturës të ndërtuara fillimisht në Shqipëri, i perkasin stilit Stalinist të arkitekturës. Rastet e para të aplikimit të kësaj tipologjie ishin projekte sovietike, si ai i Pallatit të Kulturës Maliq sot Teatri “Dhimitër Orgoçka” (fig.44;45) apo Pallati i Kulturës Orikum sot ndërtesa e bashkisë (fig.46;47). Këto dy raste për shkak të politikave nuk përmenden fare në këtë tekst edhe pse përbëjnë raste të para të aplikimit të kësaj tipologjie në Shqipëri. Këta autorë më tej shkruajnë: “Prototipet e tyre u ngritën së pari pranë qendrave të reja industriale siç ishin Maliqi, Cerriku, Patosi, Rubiku, Kombinati Tekstilit Stalin në Tiranë etj. dhe u quajten kinoklube” (Mosko & Sukaj, 1986; 51). Në rastin e Shqipërisë kjo tipologji u prezantua pas vitit 1948 me projekte të importuara dhe financuara prej Bashkimit Sovjetik në formën e ndihmës për Planin e Dytë Dytëvjeçar. Ndër rastet më të famshme të këtyre strukturave në stil Stalinist dhe njëkohësisht të para të llojit të vet në Shqipëri, mund të konsiderohet Pallati i Kulturës në Maliq i vitit 1952. Ky objekt paraqet një paraqet një trajtim stilistik të ndryshëm prej çdo objekti tjetër në qytet. I trajtuar me suva dhe dekore klasike, kollona e kapitetele kompozite të cilat simbolizojnë destinacionin kulturor, Pallati i Kulturës qëndron i shkeputur prej kontekstit të përgjithshëm duke komunikuar me objektin e shkolles, bashkë me të cilin percaktojnë hapësirën e qendrës civile. Objekti prezanton një volum kompakt me fasadë balllore të gërryer prej volumit të llozhes e cila zvillohet në mënyrë simetrike në lartësinë e dy kateve. Fasada dominohet prej monumentalitetit të harkut të plotë, i cili konsiderohej nga projektuesit sovietikë si element i arkitekturës tradicionale mesdhetare dhe është përdorur edhe në ish - Kombinatit e Tekstileve Stalin. në kundërshtim me llogjikën e propagandës për monumentalitet, mbetet interesant fakti se objekti është vendosur mbi një bazament të lehtë, i cili pozicionon lehtë ndërtesën mbi truall. Kjo ulje e objektit është bërë nëpërmjet zgjidhjes së fasadës me një ballkonatë në nivelin e sipërm e cili kryente funksionet e tribunes qendrore për tubime apo komunikime masive. Kjo ulje aksesin për në brëndësi duke e ulur atë në nivelin e kembësorit.



Fig.44 – Teatri i Dhimitër Orgoçka. Maliq 2013. **Fig.45**- Detaj i kapitelit. Maliq 2013.(burimi:autori).



Fig.46- Ish-pallati i kulturës Orikum (sot Bashkia), Vlorë 2018; **Fig.47-** Orikum, foto detaj i basorelievit. Vlorë 2018; (burimi:autori).

Përsa i përket programit arkitektonik “inkubatorët shoqëror” kishin dy objektiva kryesore: zbatimjen dhe shpërndarjen e klasës punëtore në një mënyrë të kulturuar duke shpërndarë njohuri dhe duke nxitur aktivizim. Në funksion të këtij qëllimi egzistonte një program preciz i cili duhej të përgjigjej kërkesave për shfaqje filmash, interpretime pjesësh teatrale apo muzikore, ekspozita, atelie arti (apo ‘rrethe’ siç quheshin ndryshe), laboratore për përvetësimin e paisjeve dhe teknikave dhe ndonjëherë kishin të përfshira edhe hapësira të dedikuara për botanikën eksperimentale apo zoologjinë. Nuk mungonin as rastet kur programi i objektit përfshinte edhe zyra të ndërmarrjeve apo kooperativave bujqësore duke shtuar edhe me shumë gamen e funksioneve të cilat shpesh krijonin probleme për funksionimin e aktiviteteve në mënyrë simultane.

Përveç përdorimit kulturor egzistonte edhe një objektiv tjetër me i rëndësishëm që duhej të përmbushnin këto godina, ato duhej të krijonin mundësinë për zhvillimin e aktivitetit politik. Shfaqja e propagandës së sistemit rezultoi në vite më e rëndësishme, duke mbizotëruar gradualisht ndaj aktivitetit kulturor. Në këto kushte arkitektura e humbet domethenien e saj publike, duke u larguar prej njeriut për të cilin është krijuar me qëllimin sublim të gjenerimit të shoqërisë urbane. Në fakt, salla e shfaqjeve përbën elementin dominues në plan. Në vitet e para të pushtetit komunist preferoheshin salla shkallare të shoqëruara me lozha dhe ballkone në nivelin e sipërm. Pas viteve 60’ mbizotëron me teper plani i lire me hapësirë salla në një nivel. Ishte gjithashtu e nevojshme për këtë qëllim holli apo hapësira për ekspozita në të cilat ekspozoheshin posterat dhe simbole të propagandës, kuotime në formë direktivash të liderëve suprem, fushata për promovimin e jetës së re socialiste, rezultate mbi arritjet e ndryshme në fushën e prodhimit, por egzistonte edhe një kënd i caktuar ku propaganda luftonte segmentet që devijonin. Çdo mëngjes kryhej lexim kolektiv i gazetave zyrtare shoqëruar me komente ideologjike mbi artikujt e veçantë. Gjithashtu nuk mungonin edhe banalizimet, sidomos në zonat rurale kur kishte raste që hapësira për ekspozitat shndërrohej në një shoë të veglave të punës që përdornin çdo ditë. Pra konstatojmë se shtëpia e kulturës duke përfshirë të gjitha variacionet e kësaj tipologjie, kishte rolin e ures ideologjike ndërmjet pushtetit dhe popullit por nuk ishte e vetmja, hapësira tjetër e komunikimit ishte hapësira e punës.

Me prishjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, rezultoi dhe pezullimi i ndërtimit të shumë objekteve që ishin në ndërtim në atë kohë. Shumë arkitektë, inxhinierë dhe specialiste sovjetikë u detyruar të largohen nga Shqipëria. Një nga projektet më të rëndësishme plot mister dhe joshje që ngurtëson këtë periudhë në

materie arkitektonike është Pallati i Kulturës i Tiranës i cili u ndërtua pas prishjes së Pazarit të Vjetër. Në një artikull të botuar në gazetën zyrtare të regjimit - Zëri i Popullit të datës 20 dhjetor 1961 gjëndet e rindërtuar historia e kësaj ndërtese dhe mosmarrëveshjet me sovietikët gjate projektimit dhe ndertimit te veprës arkitekturore me te rëndësishme te sistemit. Nën titullin “E vërteta rreth çështjes së Pallatit të Kulturës” shpjegohet se: "Nëpërmjet një vendimi të janarit 1959 të Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, u parashikua ndertimi i një pallati kulture në qytetin e Tiranës si dhuratë e Bashkimit Sovjetik për popullin shqiptar. Ndërtimi i pallatit duhej të kryhej gjatë viteve 1961-1962. Në mars-prill 1959, përfaqësuesit e palës sovjetike erdhën në Shqipëri për të diskutuar rreth kushteve të sipërmarrjes së ndërtimit të pallatit nga Ndërmarrja Shtetërore e Ndërtimit “21 dhjetori”. Në prill të vitit 1960, projektuesit sovjetikë sollën në Tiranë disa vizatime nga projekti i pallatit. Së bashku me projektet në Tiranë erdhi drejtori i Mosproject, A. A. Osmer, dhe autori i dizajnit V. A. Butuzov. Këto projekte u diskutuan gjërësisht nga Këshilli Teknik i Ministrise së Ndërtimit dhe në fund projekti, në te cilin insistonin edhe arkitektet Sovietik dhe që ishte aprovuar nga Gosstroj (Komiteti i Ndërtimit të Shtetit nën Këshillin e Ministrave të BRSS), nga GKE dhe Këshilli i Planifikimit Arkitektonik-Urbanistik të Mosproject, u miratua. Protokollin i miratimit i projektit është nënshkruar nga Ministri i Ndërtimitarisë, Josif Pashko, në Apri 1 23, 1960 dhe iu dorëzua drejtorit të Mosproject, A. A. Osmer. Në Maj 1960 planet kryesore për kryerjen e ndërtesës E Pallatit të Kulturës u miratuan nga Qeveria Shqipëtare”(Hoxha, 1964; fq.58). Sipas edhe shpjegimit zyrtar të publikuar në gazetën Zëri i Popullit “pala shqiptare bëri disa vërejtje të cilat u konsideruan të sakta nga projektuesit sovjetikë. Këto vërejtje kishin të bënin kryesisht me ekzekutimin arkitektonik të punëve, duke sugjeruar një rritje të vogël të madhësisë së projektit në dy vende: të shtonin pesë deri në gjashtë dhoma në kafene dhe dy holle për teatrin. Përveç kësaj, në fund të protokollit të mësipërm thuhet se "Të gjitha modifikimet dhe plotësimet e mësipërme duhet të bëhen në bazë të shfrytëzimit më racional të pjesëve të ndryshme të Pallatit të Kulturës. Më 29 maj 1960 filloi mbjellja e pilotave për ndërtesën. Më 6 qershor 1960 kishte filluar puna ndërtimore, dhe më 14 korrik 1960, u përfundua betonimi i parë në projekt. Pala shqiptare mori të gjitha hapat dhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 1960 ritmi i punës ishte shumë i shpejtë dhe përparonim përpara afatit. Kjo punë është kryer në bazë të programit të miratuar nga përfaqësuesit e Bashkimit Sovjetik dhe Ndërmarrjes Shtetërore Ndërtimore të Tiranës "21 Dhjetor". Duke filluar nga dhjetori puna u ngadalësua dhe në janar të vitit 1961 pala sovjetike kishte ndaluar plotësisht furnizimet për ndërtimin e pallatit, si dizenjot dhe materialet, edhe pse deri në atë kohë vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre ishte dorëzuar." (Hoxha, 1964; fq.58). Pas më tepër se 3 muajsh replika të ndersjellta dhe kur ndertimi kishte avancuar situata behet e qarte se duhet nje vendim politik per avancimin e objektit, në shkrimin e tij Hoxha shprehet: “Përballë një situatë të tillë, kur puna ndërtimore u pezullua për faj të palës sovjetike dhe ky projekt i madh në qendër të kryeqytetit mbeti me themele të hapura që dëmtonin ndjenjat e thella të miqësisë së popullit shqiptar ndaj popujve vëllazërore të Bashkimit Sovjetik, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, më 5 maj 1961, me të drejtë mori vendimin për të financuar ndërtimin e pallatit dhe u kërkoi organizatave tona të projektimit hartimin e projekteve të përshtatshme” (Hoxha, 1964; fq.60). Maks Velo, është i pari autor që shkruan mbi këtë histori pas ardhjes se demokracisë. Sipas tij, V.A.Butuzov-autori dhe njekohësisht Kryetari i Bashkimit të Arkitekteve Sovietik, kishte paraqitur nje variant të meparshem i cili konceptonte pallatin e kultures si tre objekte të ndara. “Kishte tre ndërtesa: një opera, një pavion ekspozues dhe një bibliotekë. Megjithatë, diktatori ynë donte një ndërtesë

të vetme dhe një tribunë për parada ushtarake që duhej të ishin të arritshme për tanket”(Velo, 2013; 194). në fakt, edhe me pare Bosio me planin rregullues të 1939 parashikonte një frontalitet të shkeputur për faqen lindore të sheshit skenderbej, duke respektuar vazhdimësinë e natyrshme të rruges historike të Dibrës, e cila perfundonte në sheshin qendror nëpërmjet një kolonade e cila mbyllte fasaden veriore. Unifikimi me zgjidhje arkitektonike të një problematike në fakt të natyrës urbane, shkaktoi një deformim me zmadhim të qendrës së kryeqytetit, duke u implementuar perfundimisht me pozicionimin e ndërtesës së Muzeut Kombëtar në fillim të viteve 70’(fig.48).



Fig.48 – Pallati i Madh i Kulturës. Tiranë ~1980 (burimi:AQSH)

Arkitekti Maks Velo, i cili siç njihet ishte tepër aktiv për kohën, pohon në një intervistë nga Domus Magazine se: "(...) diktatori ynë donte një ndërtesë të vetme dhe një tribunë për parada ushtarake të cilat mund të aksesoheshin nga tanket”(Velo, 2013; 193). Në një film propagandistik të vitit 1966 vlerësohet se përveç "sabotazhit" nga revisionistët sovjetikë që braktisën realizimin e projektit, ata arritën të përfundonin ndërtimin duke dyfishuar volumin e përgjithshëm të ndërtesës nga 65 në 115 mijë metra kub. Për regjimin komunist "madhështia" ishte kuptimi i së mirës, të fortës dhe të bukurës, dhe ky nocion shkon edhe për hapësirën përfaqësuese publike e cila duhet të jetë mjaft e madhe për të mbajtur manifestime të lavdishme të turmës. Megjithatë Pallati i Kulturës përdor llozhën si një tipar kryesor të shprehjes, ndryshe nga propozimi i Bosio-s, llozha tani qëndron e ngritur në një platformë me shkallare që ndan ndërtesën nga sheshi duke e bërë atë jo lehtësisht të arritshme, në të njëjtin model me shkallaren e sheshit Nënë Tereza, duke e bërë Tiranën me dy qendra administrative por pa një qendër civile.

Arkitektura totalitare e regjimeve, ashtu siç theksohet në raste të tjera në këtë tekst, ka shfaqur në vazhdimësi një interes të veçantë për fasadën e strukturuar sipas arketipit “tempull”. Aplikimet e saj kanë qenë të vazhdueshme dhe të pandërprera në historinë si të arkitekturës perëndimore ashtu edhe lindore. Mjaft këtu të përmendim Memorialin e Linkoln në Washington, e 1922, vepër në një stil dorik e arkitektit Henry Bacon, por sidomos në vitet direkt pas luftës, arkitektura pushtohet nga dëshira për fasada me kolona të rradhitura, duke përcaktuar ndikimet që pati edhe stili internacional në arkitekturën monumentale përfaqësuese. Ndërsa në Europë ringjallja e arkitekturës përfaqësuese të shek. XX, lind si një nevojë e sistemeve totalitare për të ngritur monumentet e tyre përfaqësuese. Kështu mund të vërejmë komunikime

linguistike të dukshme me rastin tonë nga arkitektura e periudhës së fashizmit me Pallatin e Kongreseve të A.Libera, projekt i vitit 1938 por që perfundoi pas luftës në 1954 (fig.49). Ngjashmëritë në lidhje me kompozimin e fasadës me këtv rast janë të dukshme janë të dukshme, në ndryshim Pallati i Kulturës zgjerohet me 17 hapësira kundrejt 11 të Pallatit të Kongreseve të Romës, ndërkohë që shmang gjithashtu mbylljen e lozhës nga anët. Në këtë drejtim, zgjidhja arkitektonike afron më tepër me interpretimin sovietik që i bëhet tipologjisë disa vite më vonë. Pallati i Shtetit në Kremlin i vitit 1961 u ndërtua me iniciativë të N.Krushov në 1961, me udheheqës grupi të projektimit Ark.Mikhail Posokhin (fig.50). Kjo ndërtesë madhështore u konceptua si shtëpia e Partisë Komuniste, ku do të zhvilloheshin kongresët, takime por edhe një seri funksionësh të tjera kulturore të njejta më pallatet e kulturës. Jashtë komunikimeve evidente, në dallim nga dy rastet Pallati i Kulturës nuk zhvillon një plan simetrik ku salla mban pozicionin qendror si hapësira e shërbyer, pavarësisht së edhe në këtë rast ajo mund të gjykohej si produkti më i rëndësishëm e i domosdoshëm i ndërhyrjes. Kjo ndoshta edhe për efekt të programit të grupuar në mënyrë artificiale, i cili në përgjigje të nevojave të kohës, apo me një prapavijë më tinzare për kamuflimin e arsyes së vërtetë të riformunimit të qendrës së kryeqytetit, ka shkaktuar një lloj shproporcionimi arkitekturor i cili i shton peshën vizuale objektit. Në rastin shqiptar, ajo që mbizotëron është skena arkitektonike më tepër së ajo që zhvillohet brenda saj, edhe pse duhet pranuar se në sejcilin prej rasteve të mësipërm qëllimi dhe mjeti ndryshojnë fare pak dhe në dallim prej modelit racionalist, risitë janë fare të pakta konsideruar distanca kohore 20-vjeçare.



Fig.49 – Pallati i Kongreseve, Lagjia EUR. Ark. Adalberto Libera. Roma 1938-1954 (burimi:wikipedia).

Fig.50 – Pallati i Shtetit në Kremlin. Ark. Mikhail Posokhin & grup projektimi. Moskë 1961 (burimi:wikipedia)

Gjithashtu, egzistojne disa kundërshti të cilat evidentohen brenda një konflikti mbi projektin e objektit të cilin arkitektët shqiptar e morën në dorëzim në faze të avancuar. Sipas Mosko&Sukaj, Pallati i Kulturës Tirane përfundoi ndërtimin në 1964 me një projekt që mban autoresinë e një grupi autoresh të cilët i perkisnin Ndermarrjes Projekti dhe Katedrës së Arkitekturës ndër të cilët E.Dobi, S.Mosko, B.Daja, H.Dauti, F.Stermasi. Konkretisht ata shprehen se:“ai u projektua dhe u ndërtua tërësisht me forcat dhe mjetet tona dhe shumë më i madh e më i bukur nga sa ishte parashikuar duke u bërë gjithashtu godina më e madhe social-kulturore e vendit”(Mosko & Sukaj, 1986; 72). Duke krahasuar me qëndrimin zyretar mbi këtë çështje, egziston qartazi një mosperputhje. Dilemat mbi këtë histori të pashkruar do të zgjidhën përfundimisht me njohjen e plote të projektit fillestar të ekspozuar në atë kohë në godinën e Komitetit në Sheshin Skenderbej. Gjithashtu do të përbënte interes të veçantë për konfrontimin e arkitekturës me ideologjinë e sistemit, njohja e varianteve të propozuara prej studios

moskovite dhe zbardhja e plote e raporteve mbi projektin të cilat ende sot mbulohen nga misteri. Deri në atë moment, analiza mbetet e kufizuar brenda paraqitjes së parametrave sasior duke bërë të pamundur çdo analizë formale, programatike, arkitektoniko-ideologjike të cilat do të ishin të pasakta dhe plot hije dyshimi. Gjithsesi, pavarësisht kontradiktave mbi autoresinë dhe rilevancën e nderhyrjes së arkitekteve Shqipëtare mbi projektin origjinal, në të vertetë Pallati i Kulturës Tiranë mbetet një ndër ndërtesat që më mirë përfaqësojnë arkitekturën e socializmit klasik në Shqipëri, stil ky që materializon në vetvete një seri disonancash por edhe paralelizmash ideologjik karakteristike të “modernizmit të erret”. Siç thekson Rossi "Vepra të caktuara që marrin pjesë në formimin e qytetit si ngjarje origjinale, durojnë dhe bëhen karakteristike me kalimin e kohës, duke transformuar apo mohuar funksionin e tyre fillestar, dhe më në fund duke u kthyer në një fragment të qytetit - aq shumë sa që në tentojmë t'i konsiderojmë ato më shumë nga pikëpamja urbane se sa edhe arkitektonike" (Rossi, 1982; 115) Projekti madhor i lënë në themelë nga sovjetiket në vitin 1961, mobilizoi institucionet e projektimit vendase në një sfidë padyshim të vështirë duke konsideruar kompleksitetin strukturor të një ndërtese të madhe, të cilën duhet thënë se e përballuan me sukses duke konsideruar faktin se objekti i Pallatit të Kulturës Tirane qëndron ende sot integral dhe i padëmtuar.

3.9. Njesite e Projektimit në Shqipërinë e viteve 50-60'

Siç ndodhi edhe në Bashkimin Sovjetik, të gjitha studiot arkitekturore private u centralizuan në një ndërmarrje të qeverisur nga partia-shtet. Në Shqipëri, zyrat e arkitekturës dhe të planifikimit u shtetëzuan që në vitin 1948 me një vendim të Këshillit të Ministrave. Shtetëzimi i dha fund praktikës së arkitekturës si një profesion i lirë. Zyrat e reja të projektimit në pronësi të shtetit u ri-organizuan në bazë të modelit sovjetik në ndërmarrje fillimisht dhe institute projektimi mëpas. Ato ishin organizata të mëdha dhe burokratike, shpesh duke punësuar dhjetëra arkitektë. Molnar përshkruan shembullin hungarez duke theksuar se "kompetencat e tyre janë nxjerrë nga një ndarje paksa mekanike e punës. [...] Për shembull, në të gjithë vendin, një zyrë planifikimi ishte përgjegjëse për hartimin e projekteve për strehim publik, një për dizajnin e objekteve industriale, një për projektimin e ndërtesave publike dhe një për planifikimin urban" (Molnar, 2013; 109). Ndërsa sipas Groys (2011), në Bashkimin Sovjetik procesi filloi me një vendim të Komitetit Qendror në 23 prill 1932, i cili shpërbëu të gjitha grupet artistike dhe deklaroi se të gjithë sovjetikët e cilësuar “punëtorë kreativë”, do të organizoheshin sipas profesionit në “sindikatat krijuese” të formuar nga artistë, arkitektë dhe me radhë. Ky dekret i partisë, është miratuar gjatë planit të parë 5-vjeçar, qëllimet e të cilit përfshinin industrializimin e përshpejtuar të udhëhequr nga një plan i vetëm rigoroz dhe i centralizuar, një program i kolektivizimit të detyruar që mund të konsiderohet si revolucioni i dytë stalinist [...] i cili u shoqërua me një rritje të shpejtë të ndikimit të organeve të sigurisë. Ndërkohë që Zevi lidhur me levizjet kryesore kulturore në BS e viteve 30', shprehet se: “tradicionalistët, racionalistët dhe realistët ishin të detyruar të hynin në SSA (Federata e Arkitektëve Sovjetikë); dhe drejtimi i revistës së vetme arkitektonike i ishte përcaktuar përfaqësuesit neoklasik Karo Alabyan, përgjegjës i teatrit të ushtrisë së kuqe në Moskë” (Zevi, 2001; 147). Një nga funksionet më të rëndësishme të shoqatës së re të profesionistëve ishte natyrisht siguri i komunikimit me administratën, udhëheqësit e Partisë Komuniste dhe arkitektët profesionistë. Sipas Czepczynski (2008), zyrat e projektimit në shumicën e vendeve socialiste ishin përfshirë në "Sindikatat e mëdha të ndërtimit" për të racionalizuar procesin e planifikimit. Efekti i drejtpërdrejtë i bashkimit ishte standardizimi i çdo aspekti të procesit të planifikimit

dhe ndërtimit, dhe projektimi identik i një blloku mund të gjendet në shumë qytete brenda një shteti.

Të etur për të nxitur interesin popullor, shtypi i përditshëm mbulontë të gjitha çështjet e lidhura me planifikimin, madje edhe ato të cilat ishin të sigurta se do të ngjallnin pakënaqësi dhe opozicion, ndërkohë që shtypi i dedikuar çështjeve të projektimit dhe ndërtimit mungonte gjatë dhjetëvjeçarit të parë e tv dytë të sistemit. Në shtypin shqipëtar të kohës vihet re rëndësia që zë sektori ndërtimit për kohën duke mos e ndarë veprimtarinë prodhuese nga ajo projektuese dhe duke e parë procesin si pjesë të veprimtarisë shtetformuese. Parulla "Të ndërtojmë Shqipërinë e Re" ishte një nga motot më të përhapura për kohën. Kjo nismë, sidomos në planet e para 5 vjeçare konsistoi kryesisht në ndërtimin e infrastrukturës së prodhimit, duke lënë pak ose aspak hapësirë për zhvillimin e industrisë së ndërtimit të banesave apo tipologjive të tjera shoqërore duke krijuar një prapambetje të theksuar në këtë drejtim si përsa i përket specialistë projektues, po ashtu edhe teknologjisë së ndërtimit në vetvete. Në këto terma shprehet edhe Anatole Kopp duke analizuar zhvillimet me arkitekturën në BS e viteve 30' pas një periudhe të lumtur të lëvizjes Konstruktiviste, ai thekson se, arkitektura moderne kishte pësuar një humbje të qartë, që në fakt ishte humbja e tërë arkitekturës. Pa fonde, pa burime, shpesh pa program dhe pa direktivat preçize, mund të prisje nga arkitektët të gjetnin sistemin magjik si të ndërtonin shtëpi, klube, teatro, shkolla dhe kopshte në numër të mjaftueshëm për një epokë në të cilën materialet, krahu i punës dhe mjetet financiare ishin të destinuara kryesisht për industrializim? (Kopp, 1987). Sigurisht që në këto kushte emergjence totale, arkitekti nuk mund të ishte përveç se një hallke e zinxhirit të prodhimit dhe si i tillë, as që mund të bëhej fjalë për pavarësi intelektuale apo eksperimentim personal që sjell avancimin kulturor të disiplinës. Ai ishte i detyruar të ndiqte politikën qendrore, pa interpretuar ato, por duke ju nënshtruar në mënyrë automatike diktatit nën presionin e vazhdueshëm të gabuarit i cili mund të interpretohej si deviacion ndaj politikave të përgjithshme.

Në Shqipëri e pas vitit 1948' dhe vendimit për centralizimin dhe shtetëzimin e aktivitetit të projektuesve, institucioni qendror që do të merrej me planifikim dhe arkitekturë ishte ndërmarrja 'Projekti'. Mëpas mbi bazën e ndërmarrjes 'Projekti', u krijuan Institutet e Projektimit të cilët u specializuan në projektim e arkitekturës mbi bazë tipologjike. Përveç instituteve, zyra të vogla projektimi u hapën edhe pranë Komiteteve Egzekutive të rretheve dhe në vitet 70' pranë Katedrës së Projektimit në Fakultetin e Inxhinjerisë së Ndërtimit. Në kujtimet e tij arkitekti shqiptar Petraq Kolevica si një anëtar i mëvonshëm i kësaj ndërmarrje, shprehet se arkitektura socialiste u zbatua nga dy breza të ndryshëm arkitektësh dhe inxhinjerësh në fillimet e saj në Shqipëri. Disa prej tyre, brezi më i vjetër kishin edhe përvojë të mëparshme me arkitekturën, në kohën e monarkisë dhe i përkisnin kryesisht shkollës austriake të arkitekturës, siç ishin Skender Luarasi dhe Anton Lufi. Brezi më i ri i përkiste shkollave lindore dhe kishte nga ata arkitektë " që kishin studiuar në Bullgari, Rumanë e Çekosllovakë, por në kohën kur edhe në këto vende sundonte stili i arkitekturës sovjetike." (Kolevica, 2004; 69). Pothuaj të gjithë arkitektët gjatë viteve 50', nën presionin e politikës aplikuan kanonet e arkitekturës staliniste, përfshi këtu ata që kishin studiuar në përfundim. Por, siç vihet re në disa projekte të kësaj periudhe, egzistojnë edhe disa raste kur stili zyrtar u interpretua në një gjuhë më moderne, përfshi këtu përshtatshmërinë me karakteristikat lokale. Kujtojmë këtu se karakteristikat e arkitekturës moderne europiane, kishin të benin kryesisht me gjuhën e emancipuar avantgardiste, tendencën për të shmangur tipologjitë standarte duke eksperimentuar mbi ato me qëllim përshtatjen me kërkesat e reja programatike që

lindën gjatë periudhës moderne, thjeshtëzimin dhe teknologjizimin e komponentëve të projektit, komunikimin forme-funksion duke i dhënë prioritet sinqeritetit të strukturës. Në disa kontekste të caktuar dhe sidomos gjatë periudhës së modernizmit të vonë e cila përkon me periudhën prej viteve 40' deri në vitet 60', brenda gjuhës moderne integrohen me sukses dhe në mënyrë novatore edhe elemente të traditës lokale, sidomos përsa i përket materialeve të vendit, të cilat u përfshinë brenda projektit modern edhe nga vetë le Corbusier për herë të parë në projektet për Afrikën që prodhoi gjatë luftës së dytë botërore. Në Shqipëri, pavarësisht kushteve të disfavorshme dhe kontekstit të prapambetur kulturor, egziston një përpjekje serioze që vihet re në disa prej arkitektëve shqiptar që punuan në periudhën e dy luftërave e cila pati jehonë edhe gjatë viteve të para të regjimit komunist. Mund të veçojmë këtu Spitalin e Gjirokastrës i vitit 1949 të arkitektit Skënder Luarasi i cili për kohën e projektimit dhe ndërtimit me sa duket i ka shpëtuar revizionimit stilistik që i kaloi të gjitha veprave pas viteve 50' (fig.51). Kjo vepër e cila ngrihet mbi një pjese themelesh egzistuese të një projekti të mëparshëm i cili është ende i panjohur, paraqet karakteristika të arkitekturës racionaliste me zgjidhje të pasura dhe elastike përsa i përket gjuhës kompozicionale. Objekti i konceptuar në formën "L", tenton të shpërbëjë masën volumore nëpërmjet një serie procedimesh formale të aplikuara mbi fasada në mënyrë që të rrisi shkallën e fragmentimit. Në këtë mënyrë, duke u përshtatur më teper me kontekstin historik të qytetit. Kështu ndryshe nga objektet masive të formatit neoklasik që përbënin stilin zyrtar të kësaj periudhe, Spitali i Gjirokastrës paraqet artikulime elementësh të lirë me dritare, lozha e sektore volumore të cilat organizohen në mënyrë të lirshme sipas një shije me ndikime abstrakte duke na sjell ndërmend arkitektura të ngjashme të periudhës së ekspresionizmit, përzier ky me elemente të arkitekturës tradicionale të cilat verifikohen me përdorimin e çatisë, hyrjes e cila është trajtuar me lozha me harqe, apo të bazamentit të gurtë i cili kryen shkrirjen e objektit me terrenin shkëmbor. Konsiderime të ngjashme mund të kryhen edhe mbi një projekt tjetër të një dhjetëvjeçari më vonë, nga i njejti arkitekt i cili tashmë kishtë argumentuar aftësinë profesionale për të trajtuar tipologjinë e objekteve spitalore. I referohemi konkretisht projektit për Senatoriumin e Tiranës përfunduar në vitin 1959 (fig.52). Ky objekt është organizuara në grupe kompozicionale të cilat komunikojnë si me principet e arkitekturës së "nenteqindes" italiane, ashtu edhe me principet e arkitekturës së "objektivizmit të ri" gjerman, duke sjelle një vepër e cila duke u krahasuar me zhvillimet e mëpasme, tregon qartë shkallën e zhvillimit dhe kapacitetin profesional të arkitektëve në Shqipëri para vendosjes së regjimit totalitar.



Fig 51– Spitali Rajonal i Gjirokastrës, 1949. Ark. Skender Luarasi. (burimi: "Spitalet - Vështrim tipologjik mbi arkitekturën shqiptre 1945-1990". fq 36)



Fig 52 –Senatoriumi Shefqet Ndroqi, Tiranë 1959. Ark. Skender Luarasi. (burimi: "Spitalet - Vështrim tipologjik mbi arkitekturën shqiptre 1945-1990". fq 162)

Shumë arkitektë shqiptarë kanë përmendur në autobiografitë e tyre disa probleme me të cilat janë përballur gjatë zbatimit të projekteve të ndryshme. Kjo për shkak të ndërhyrjes politike nga ana e anëtarëve të Partisë të cilët ishin edhe pjesë e Qeverisë. Ata sygjeronin zgjidhje arkitektonike jo të bazuara në pikëpamje profesionale, por mbi parimet politike të konceptuarit të arkitekturës në socializëm. Për shembull, arkitekti shqiptar Kolevica në faqen e parë të librit të tij "Arkitektura dhe diktatura" ka vënë një kryq të kuq në projektin për Bibliotekën e Korçës projektuar nga ai në fund të viteve 60' e realizuar në 1975 (fig.53). Për atë ky kapak simbolizon çensurimin e arkitekturës përgjatë periudhës së errët. "Sipas rrëfimit të autorit ky kryq ishte bërë nga dora e Mehmet Shehut"(Kolevica, 2004). Pas këtij kryqi, arkitekti, i cili ishte gjithashtu një poet, pësoi një dënim të gjatë duke u spostuar nga projektimi në prodhim, denim ky i zakonshëm për intelektualët të cilët përcaktoheshin si problematik dhe me tendenca devijuese karshi parametrave të vendosur prej sistemit. Dënimi i arkitektëve ka qenë i zakonshëm në të gjitha vendet ish-komuniste, sipas (Groys, 2011), shumë shpesh ata kanë paguar me jetën e tyre për një formulim të papërshtatshëm, dhe kjo sigurisht rriste edhe më shumë përgjegjësinë e tyre për çdo fjalë që thonin.



Fig 53 – Biblioteka Thimi Mitko, Korçë 1975. Ark. Petraq Kolevica. (burimi: Arkitektura dhe diktatura. Logoreci. Tirana fq. 194)

Përvojë tjetër e persekutimit akoma më brutal ishte ajo e arkitektit Maks Velo. Në librat dhe artikujt e tij ai shkruan jo vetëm për problemet e arkitekturës, por edhe për vuajtjet e tij në burg pas dënimit nga regjimi komunist. Ai thotë se "Enver Hoxha dhe regjimi komunist vari, pushkatoi dhe burgosi me dhjetra inxhinierë nga më të zotet që nga grupi i Maliqit deri tek ata të Naftës. Edhe unë kam në akt-akuzën e denimit të tilla akuza." (Velo, 2013; 19) Me tej lidhur me këtë çështje ai vazhdon "Dua të kujtoj se jam kritikuar në Konferencën e Arkitekturës më 1975-ën, ndërsa u arrestova në 1979-ën. Në akt-akuzën e ngritur kundër meje [...] ndër të tjera ishte thuhej: në vazhden e veprimtarive armiqësore, edhe në arkitekturë, është kapur pas formes, është prirur nga "arkitektura e lirë", nga pikëpamjet estetizante. Per te gjitha akuzat mora dhjetë vjet burg" (Velo, 2013; 39). Arkitektet e kësaj kohë kanë zhvilluar profesionin nën presionin e vazhdueshëm të kastes drejtuese dhe ky ishte një fenomen i lindur fillimisht në Bashkimin Sovietik. Siç thekson Groys: "kritika zyrtare e artit i trajtoi arkitektët sovjetike ashpër dhe pa kompromise. Të gjitha pozicionet dhe arritjet e këtyre arkitektëve, të çdo lloji të veçantë, janë portretizuar si të pamjaftueshme, nëse jo plotësisht të gabuara apo edhe të dëmshme. [...] në leximin e kësaj kritike të përgjithshme, lexuesi edhe sot mbulohet nga një ndjenjë frustrimi. Dikush nuk mund të imagjinojë se si mund të jetë ndërtuar ose krijuar në një situatë të tillë" (Dobrenko & Naiman, 2003; 111). Ideja kryesore zyrtare ishte, ashtu si Gutnov (1968) e përshkruan, për të dhënë lirinë arkitektit për të hartuar brenda kufijve të tij. Ndërsa Maurizio Bego, arkitekt tjetër shqiptar i kritikuar në të njëjtën kohë me Petraq Kolevicën, po ashtu edhe ky i transferuar në ndermarrje prodhimi, përshkruan gjendjen e krijimtarisë gjatë komunizmit me këto fjalë: "arkitektët ishin me kushte projektimi të paracaktuara e mundësine e kërkimit të së resë ishin minimalisht të kufizuara për objektet e zakonshme. Natyrisht që kishte edhe vepra me porosira të veçanta që trajtoheshin ndryshe" (Bego, 2009; 8). Ai vazhdon për të shtuar se çdo devijim demaskohej si antisovietizëm dhe dënohej. Masa ndëshkimore kushtëzohej nga perbërja klasore e subjektit, besueshmeria e tij politike apo urdhëri i dhënë nga lart, sepse ishte udhëheqja ajo së cilës 'i binin në sy' të tilla të meta. Ideja kryesore

ishte se arkitektët nuk duhej të cënonin në asnjë moment produktivitetin, arkitektura konsiderohej si një copëz e industrisë ndërtimore dhe si e tille duhej ti pergjigjej një parimi të përgjithshëm që kishte realizimin e planin si objektiv primar. Ndërkohë që çdo projekt duhej të ishte i zbatueshëm në praktikë dhe eksperimentimi ishte i ndaluar. Sipas (Paperny 2002; 58) në regjimin socialist të Kultures së Dytë siç e quan ai kohën e udhëheqjes staliniane “gjithmonë aplikonin shprehjen ‘projekte në letër’ për projektet e përcaktuara të viteve 20”, dhe e përdori këtë në një kuptim tejet negativ: “Nuk ka asgjë më të dëmshme në punën e arkitektit se një projekt në letër”, duke nënkuptuar vizatimet me përmbajtje utopike të lëvizjeve avanguardiste. Ndërkohë që (Groys, 2011; 3) shprehet mbi rregullat rigjide si karakteristike thelbësore e të gjithë artit të totalitarizmit dhe ai shkruan: “Kur e gjithë jeta ekonomike, sociale dhe çdo ditë e kombit është e rregulluar totalisht nga një autoritet i vetëm planifikimi i porositur për të rregulluar, të harmonizuar, dhe për të krijuar një tërësi të vetme deri në detajet me të vogla, ky autoritet - udhëheqja e partisë komuniste - u shndërrua në një lloj artisti, materiali i të cilit ishte e gjithë bota dhe qëllimi ishte kapërcimi i çdo rezistence të materialit për t'a bërë atë të përpunueshëm, të lakueshëm, të aftë për të marrë çdo formë të dëshiruar”. Ky shtrëngim i padobishem për punën e një arkitekti, domosdoshmerisht pati pasqyren e vet në realitetin urban edhe në Shqipëri në atyre viteve. Sipas Velos “arti i realizimit socialist u dallua për mungesën e origjinalitetit dhe shprehjes artistike. Veprat tona më të mëdha si: Pallatin e Kulturës, Piramida, Pallati i Kongreseve, Hotel Tirana, Muzeu i Krujës, kanë inkohërenca stilistike dhe mangësi të theksuara funksionale”(Velo, 2013; 58). Megjithëse duhen pranuar vështirësitë që vinin kryesisht prej izolimit kulturor, por edhe ekonomia e dobët e cila orjentoj arkitekturën totalisht drejt tipeve standarte të aprovuara duke kufizuar mundësitë për kërkim vetjak nga ana e arkitektëve, duhet pranuar edhe një lloj qëndrimi populist i cili orjentonte prodhimin ekskluzivisht kundrejt kërkesave të kontekstit nacional duke shmangur kështu nevojën e komunikimit kulturor me vende të tjera, qofshin këto edhe brenda bllokut socialist.

Ishte e zakonshme në vendet socialiste të përfshinin arkitekturën së bashku me fushat e arteve dhe letërsisë. Kështu funksionoi edhe në Shqipëri edhe pse jo në mënyrë zyrtare. Në vitin 1956 me vendim të Këshillit të Ministrave u krijua "Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë" e cila organizuar sipas modelit sovjetik, u konceptua si një organ i centralizuar për monitorimin dhe përcaktimin e agendës artistike në funksion të propagandës. Ishin këto vite që përkojnë edhe me kufizimin dhe heqjen e lirisë krijuese në të gjitha artet, ku mund të përfshijme edhe arkitekturë për atë pjesë që mund të quhet art. Ndërsa Fakulteti i Inxhinjerisë së Ndërtimit ka filluar aktivitetin prej vitit 1951 si pjesë e Universitetit të Tiranës, vetëm në mes të viteve 70' u krijua një degë e veçantë për arkitekturën. Pas perkeqesimit deri në ndërprerje të raporteve me Bashkimin Sovjetik në vitet 1960, shumë arkitektë shqiptarë u përpoqën të futnin arkitekturë moderne të lirë dhe bashkëkohore në Shqipëri, por siç përkrauan Kolevica "në vend të përkrahjes gjetën përpara murin ideologjik dhe pësuan denime" (Kolevica, 2004; 141). Nga ana tjetër po i njejtë autor ve në dukje edhe mungesën e përgatitjes, pamjaftueshmerine në literaturë apo mungesën e shkëmbimit të eksperiencës me vende të tjera. Në librin e tij shpjegohet psh. rasti i projektit për Hotel Tiranën, me kryetare grupi Valentina Pistolin, ai shprehet mbi pjesëtarët e grupit të projektimit të cilët ishin izoluar në punë individuale duke shfaqur mungesë të dukshme komunikimi profesional profesional. Ai shkruan “të gjithë pranuan mangësinë e madhe që kishim: në që do projektonim hotelin e madh të Tiranës, nuk kishim parë asnjë hotel turistik të vërtetë” (Kolevica, 2004; 172).

Literatura për arkitekturën ishte vërtetë e pakët në vitet e para të ndërtimit të sistemit komunist në Shqipëri. Pak materiale që kishin mbetur prej para luftes, apo periudhës së studimeve jashtë, mbaheshin në fshehtësi nga arkitektet të veçantë. Ndërsa për institucionet shtetërore të projektimit, ndërmarrja Projekti konkretisht, Kolevica shprehet se “Arkitektura SSSR” ishte e vetmja reviste profesionale që qarkullonte. Pas refuzimit të stilit stalinist i cili u zyretarizua në fillim të viteve 60’, u prezantuan edhe revista të tjera nga Blloku Lindor. Kolevica gjithashtu tregon një histori në lidhje me ardhjen në Institut në vitin 1965 të një numri të revistes franceze 'L'ingeniere'. Ai shprehet se ishte ndër të shumtë i lumtur që gjeti një numër të kësaj reviste, ndërsa shkante t'ja tregonte njërit prej kolegëve të tij që kishte studiuar më parë në Itali për të cilin shkruan “Për habinë e time e pa, e pa i dëshpëruar, nuk e mori ta shfletonte, por e shtyu me kurrizin e dorës e më tha: “Faleminderit. Ka më se njëzet vjet që nuk e kam lexuar këtë revistë. Nuk e hap, se s’dua të tmerrohem kur të shoh se sa prapa kam mbetur” (Kolevica, 2004; 66). Siç thekson Molnari, shkëmbimi intelektual midis Lindjes (socialiste) dhe Perëndimit (kapitalist) ishte minimal gjatë Luftës së Ftohtë. Megjithatë ai shkruan se “arkitektët hungarezë vazhduan të shikojnë në Perëndim për modelet kulturore edhe gjatë kësaj periudhë” (Molnar, 2013; 110). Pra, pavaresisht murit midis dy kraheve pati edhe shkëmbime të cilat mund të konsiderohen minimale përderisa mbetet thjesht në literature dhe jo me gjërë, në shkencë dhe prodhim. Arkitektët shqiptarë të asaj kohë, tregojnë për udhëtime që ata bënë në perëndim për të kërkuar modele për të imituar veçanërisht në vitet 70’ – 80’. Pra jo të gjitha dyert u mbyllën edhe për Shqipërinë. Qeveria e asaj kohë mori pjesë në panairë ndërkombëtare të organizuara në Perëndim dhe arkitektët kishin rolin e tyre në organizimin e qosheve shqiptarë atje sidomos në lidhje me turizmin ku për propagandë paraqiteshin arritjet në fushën e turizmit duke reklamuar edhe investimet që filluan të beheshin lidhur me hotelet e turizmit. Kolevica kujton se gjatë në vitin 1972 “Ishte bërë edhe takimi i parë kombëtar i arkitektëve. [...] Në këtë kohë, pushteti komunist donte të bënte diçka që të dukej, të bënte përshtypje në popull e në ata pak të huajve që vinin. Si mjet efikas u gjend ndërtimi i hoteleve (gjoja turistike) nëpër qendrat e qyteteve kryesore”(Kolevica, 2004; 171). Një grup arkitektësh Shqiptarë u dërgua në vendet e tjera të rajonit për të marrë prej tyre atë që ishte konsideruar si e përshtatshme për t'u realizuar edhe në Shqipëri, dhe vetëm në vitet 80’ filluan diskutimet rreth arkitekturës bashkëkohore apo kombëtare siç quhej në atë kohë.

Nuk është e thjeshtë të bësh një klasifikim të rrymave arkitekturore që janë aplikuar në Shqipëri gjatë periudhës së socializmit, për shkak të mungesës së shkrimeve dhe debatit teorik deri në mes të viteve 80’, duke përcaktuar një ndërprerje të analizës dhe orjentimit teorik për gati gjysëm shekulli. Duke qenë gjithashtu koshient se në një atmosferë ku mungonte thellimi i lirisë teorike nuk mund të kishin një rryme të mirëpërcaktuar në aspektin kulturor, referuar situatave politike të kohës dhe fakteve të ndërtuara në qytet Velo përpiqet të bëjë një klasifikim të arkitekturës së socrealizmit në Shqipëri duke e ndare atë në 10 vjeçarë, ai shprehet: “1945-55’, është periudha e artë e sovjetizmit pallatokolonadë; 1955-65’, është periudha e një sovjetizmi hrushovian me hibridë arkitekturore; 1965-75’, në mungesë të eksperiences kineze [...], bëjnë koktejin surrogato eurososjetikombëtar; 1975-85’ epoka e “bllokarkitekturës” [...] Per këtë u çel edhe Fakulteti i Arkitekturës.”(Velo, 2013; 132). Ndërsa Maurizio Bega vendos një rend me të imet i cili në fakt është edhe i verifikueshëm konkretisht. Sipas tij periudha direkt pas çlirimit deri në 1948 kur filluan marrëdhëniet me Sovietiket, u karakterizua nga një lloj lirie stilistike e cila gjente mbështetje në marrëdhëniet me Jugosllavinë por edhe në punën e meparshme të

atyre arkitekteve te paket qe vepronin qe prej kohës se perandorise se Mbretit Zog. Sipas tij “Keshtu shpjegohet ndonjë vepër e realizuar në ato vite si: spitali i Gjirokastrës nga ark.S.Luarasi” (Bego, 2009; 8). Metej pershkruan periudhën e “sovietizimit” që sipas tij fillon prej 1951-52’ me kthimin e studenteve te pare arkitekthe nga Bashkimi Sovietik deri në 56 kur ndodhi kthesa edhe në Shqipëri. Kjo periudhë pershkruhet si peridhe terheqje ndaj dekoreve te kota qe kishte paraqitur stili i meparshem i cili pershkruhej si arkaik dhe i vjeteruar. Mepas shkruan per “periudhën e banesave me pune vullnetare” e cila fillon prej 1967 pas termetit në Diber, ai shprehet “duhej te aktivizohej i gjithe populli në një ‘aksion’ që do të ishte i ‘vazhduar’ për ndërtimin e godinave ‘të thjeshta’, me ‘materiale rrethore’, me ritme ndertimi si në zonën e tërmetosur”(Bego, 2009; 14). Te dy keta autore, arkitekthe dhe shkrimtare, tentojne te bëjnë nje kategorizim teper rigjid te periudhave sipas specifikave qe mund te shprehin metode apo stil nëse mund te quhet po ti referohemi aspektit kulturor. Strukturimi i analizës në 10 vjeçar qe në fakt është një mënyrë e ngjashme me perëndimin, tek M.Bego paraqitet një përthyerje stilistike që ndodh në periudhën e rindertimit, e cila nuk mund të konsiderohet si ‘sovietizëm’. Pra, egzistojne mosperputhje te shumta përsa i përket dëshmimeve të atyre që kanë ushtruar arkitekturën nën sistemin komunist duke konsideruar që ky debat në realitet është më i gjerë se ç’është faktuar me shkrime deri më tani. Në të vërtete nëse analizojmë në aspektin politik, historia tregon se ka qenë e mbushur me ngjarje dhe zhvillime me nje frekuence te ndryshme dhe shpesh aksidentale per te lejua mundesine e nje strukturimi dhjetevjeçar te periudhave te influences. Problematika kryesore në kategorizimin e arkitekturës se periudhës komuniste qëndron në faktin qe debati teorik mbi arkitekturën ka qenë pothuaj inegzistent, ka filluar vone dhe pa referenca me vendet e tjera. E vetmja mënyrë shkencore mbetet analiza e projekteve konkrete e cila duhet te çojë në kadehorizimin e tyre jo vetëm sipas tipologjive por kryesisht sipas konfiguracionit stilistik arkitekturor. Kjo do te kerkonte digitalizimin në mënyrë sistematike te Arkivit Qëndror të Ndertimit dhe sigurimin e aksesit per studiuesit qe duhte ata te bëjnë kategorizimin. në kushtet aktuale percaktimi i sakte i nje legjende te arkitekturës shqipëtare te periudhës se modernizimit mbetet gjithmone nje sfide per shkak se edhe vete historia e asaj periudhë nuk është zbardhur teresisht. Ajo qe mund te percaktohet me me sakte si është periudha se ciles i kushtohet ky studim, por pavaresisht kësaj percaktimi i vetëm nje periudhë 10 vjeçare, do te vinte në dyshim thelbin e studimit nëse nuk shprehet per nje peridhe me afatgjate e cila në këtë rast është e kufizuar brenda 45 viteve te pushtetit komunist. Nëse perpiqemi te bëjmë nje dekompozim te historise së arkitekturës së kësaj periudhë duke ju referuar raporteve ndërmjet projektuesit dhe pushtetit, ngjarjeve dhe produktit arkitektonik të analizuara në këtë studim, mund te bëjmë një listim si më poshtë (tab.1):

Tabela 1 – Klasifikim i rrymave arkitektonike të periudhës së regjimit komunist.

KLASIFIKIM I RRYMAVE ARKITEKTURORE GJATË KOMUNIZMIT				
Periudha	Kadegorizimi stilistik	Ngjarje/ situata politike	Influenca	Vepra me influence
1945 – 1948	Stil Nacional Romantik	Ushtrohej ende aktiviteti privat	nën influencen e tradites moderne nacionale dhe fqinje, gjatë raporteve me ish-Jugosllavinë	Arkitektet me formim perendimor të periudhës së Zogut, Spitali i Gjirokastrës, etj.
1948 – 1956	Stili i Realizmit Socialist	Raportet me Bashkimin Sovjetik nën udhëheqjen e Stalinit.	Stili Stalinist si stil zyrtar	Kombinati i Tekstileve Tiranë, Maliqi, Cerriku, Komiteti Qëndror, Kinostudio, etj

1956 – 1964	Stili modern Sovietik Stil internacional komunist	Raportet me Bashkimin Sovjetik nën udhëheqjen e Krushovit deri në çështjen e Pallatit të Kulturës dhe përqendrimin të marrdhënieve.	Arkitektura bashkohore sovjetike dhe vendeve Europiane-Lindore.	Pallati i Kulturës Tirane, Presidenca, Radio Tirana, Shtëpia e Pushimit Dajt, etj.
1964 – 1975	Industrializimi, masivizimi dhe standartizimi i ndërtimit	Raportet me Kinën maoiste. Revolucioni kulturor.	Asistencë nga vendet aziatike si Kina, Koreja e Veriut, Vietnam, etj.	Impiante industriale, Pallatet parafabrikate, Qyteti Studenti, Ekspozita Shqipëria Sot. Bunkerët, etj.
1976 – 1985	Modernizimi i vone socialist	Hapja e degës së arkitekturës pranë Universitetit Politeknik të Tiranës	Influenca nga arkitektura e modernizimit evropian, nëpërmjet interpretimit prej shkollës lindore, përfshi elementë nacional.	Muzeu i Krujës, Muzeu Kombëtar, Hotel Tirana, Galeria Kombëtare, etj.
1985 – 1990	Arkitekturë socialiste bashkohore.	pas vdekjes së diktatorit E.Hoxha, vitet e fundit të sistemit.	Influenca postmoderne me nuanca nacionaliste.	Muzeu Enver Hoxha - Piramida, Pallati i Kongreseve.

4. KOMBINATI I TEKSTILEVE NË TIRANË

Ish Kombinati i Tekstileve Stalin është vepra urbane e parë madhore e ndërtuar nga regjimi komunist në vitet e pas luftës. Kjo vepër u konceptua në formën e një qyteze satelite e pozicionuar në perëndim të Tiranës. Nga pikëpamja propagandistike, ishte rasti i parë i implementimit të modelit të qytetit socialist stalinist dhe njëkohësisht shprehje e hapur e vizionit të shtetit komunist për qytetin i cili qëndroi në sfidë të hapur më zhvillimet e mëparshme në fushën e urbanizimit. Kjo vepër shërbeu si një pikë referimi për projektet e tjera për qytezat industriale të viteve 50-60'. Në Kombinat, në 1959 Hrushovi mbajti fjalimin përshendetes në sheshin Stalin në krah të monumentit të diktatorit sovietik nga i cili u distanca bujshëm në 1956-ën. Gjithashtu Zhivkov, Kim Il-Sung, Çu En Lai dhe lider të tjerë të botes socialiste janë shoqëruar për të vizituar edhe Kombinatin e Tekstileve si një nga arritjet më të mëdha të shtetit socialist të asaj kohe.

Duke ju referuar sistemit të planifikimit ekonomik të atyre viteve, Kombinati i Tekstileve është vepër e planit të dytë dyvjeçar për periudhën 1949'-50' me shtrirje edhe në planin e parë pesëvjeçar. Fondet për ndërtimin e tij u siguruan prej Bashkimit Sovietik në formën e grantit për ngritjen e industrisë së lehtë. Siç dihet prej historisë, kjo ndodhi pas ndërprerjes që pësuan marrdhëniet e Stalinit me Titon e Jugosllavisë në 1948-ën, që çuan edhe në ndryshimin e kursit të politikës zyrtare të Moskës duke riorjentuar interesat strategjike në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet Shqipërisë. Roli sovietik në këtë vepër ishte thelbësor, si nga pikëpamja e financimit po ashtu edhe ajo teknike. Me evoluimin e rrethanave historike, ky rol tentoi të suprimohet në vazhdimësi nga autoritetet vendase sidomos pas komplikimit të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Situata politike që pasoi, padyshim që influençoi disi në zbehjen e rëndësisë dhe ndalimin e promovimit të kësaj vepre pas viteve 60' dhe bashkë me të edhe veprat e tjera që i përkasin periudhës së aplikimit të stilit stalinist. Gradualisht ato u spostuan prej vëmendjes së publikut duke i zëvendësuar me propagandë mbi arritje të tjera të socializmit. Në një farë kuptimi, arkitektura e socrealizmit stalinist në Shqipëri u muzeumifikua brenda një 10 vjeçari nga fillimi i aplikimit, për të njejtat arsye politike që shkaktuan edhe prezantimin e saj në territor. Sot, kjo shprehi stilistike e veçantë dhe e dallueshme në pejsazhin e ngjeshur urban të arkitekturës, ky konglomerat i cili pozicionohet në zona të mirëpërcaktuara përben sot pas 60 vitësh një moment të rëndësishëm të mozaikut arkitekturor që përmban qyteti i Tiranës. Në një kontekst politik të ndryshëm, vëmendja e publikut po spostohet gradualisht drejt trashëgimisë urbane historike, qoftë kjo e periudhës së para çlirimit, e po ashtu atë të periudhës së socializmit e vendosur kjo brenda një përshkallëzimi i cili i referohet kryesisht moshës por edhe influencës dhe rolit që kanë luajtur ndërtesat gjatë historisë. Ky trend përparon ndërsa territori urban deidologjizohet dhe humbet kuptimin e vet historik dhe lidhjen e drejtperdrejt të arkitektures dhe arsyeve ideologjike që bënë të mundur krijimin e saj.

Nga pikëpamja e studimeve historike, një këndvështrim i ri bëhet i mundur nëpërmjet një përafrimi analitik ndërdisiplinor i cili e shikon këtë subjekt historik në rrethanat e një konteksti shoqëror më të hapur e të çliruar prej dogmave politike. Në këto rrethana, territori urban kthehet në një libër të hapur i cili shkruhet nëpërmjet një gjuhe që i përket arkitekturës, por që nuk kufizohet në shprehje vetëm brenda saj, përkundrazi është në një raport komunikimi të vazhdueshëm më zhvillimet politike të cilat gjejnë tek arkitektura mjetin e komunikimit perfekt. Në këtë këndvështrim,

urbanistika dhe arkitektura e ansamblit historik të ish-Kombinatit të Tekstileve përbën një rast studimor tejet interesant jo më tepër nga pikëpamja e vlerës absolute arkitektonike, se sa nga permbajtja historike ku ish-Kombinati shërben si pasqyre që prezanton një kornizë më të gjerë mbi realitetin shoqëror të asaj periudhe. Themelimi dhe transformimet e kësaj qyteze, shprehin në një formë të reduktuar objektivat e përgjithshme të cilat i hasim në thelb të zhvillimeve të qytetit socialist në të gjithë Shqipërinë e në këtë këndvështrim përbën një rast tepër të mirë studimor. Në vijim analiza e dokumentacionit të projektit dhe materialeve historike që kanë mbijetuar deri më sot, nxjerrin në pah një lexim në shkallë të ndryshme të strukturës urbane duke evidentuar faktet që pasqyrojnë më së tepërmi organizimin e ambientit të punës dhe jetesë, në raport me ideologjinë dhe përmbajtjen e saj në ambientin e ndërtuar.

4.1. Pozicionimi dhe raporti me kontekstin.

Punimet nisën në 31 Korrik 1949 dhe inagurimi i tyre u bë nga vetë Enver Hoxha duke vendosur simbolikisht gurin e parë teksta emëronte veprën “Kombinati i Tekstileve Stalin” në shenjë mirënjohje ndaj ndihmës sovjetike dhe babait të tij ideologjik. Ndërsa punimet për bonifikimin dhe sistemimin e terrenit kishin filluar rreth 6 muaj më parë sipas Gazetës Bashkimi të asaj kohe (Gazeta Bashkimi, 1949 në Za, 2012; fq.38.), punimet për ndërtimin e tij zgjatën rreth 2 vjet në fazën e parë e cila në fakt është edhe më e rëndësishmja nga pikëpamja studimore pasi përbën nuklin qëndror urban. Eventu i përrimit u bë me 8 Nëntor 1951, datë e përzgjedhur në mënyrë simbolike pasi përkonte edhe me 10 vjetorin e krijimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Në fakt, historia e ngritjes së industrisë së tekstilit në Tiranë dhe ndërtimi i kombinatit kishte filluar akoma më parë në vitin 1947, kur akoma raportet me Moskën zhvilloheshin nëpërmjet Beogradit. Në këtë kohë avancuan punimet për ndërtimin e tij në një pozicion tjetër në perëndim të Tiranës në afërsi të zonës së Laprakës. Në shtator 1948 ndërsa punimet vijonin, në mënyrë të beftë dhe jo krejtësisht të qartë gjatë një mbledhje të grupit të punës ku ishin prezent edhe specialistët sovjetikë, u arrit në konkluzion se duhej ndryshuar vendodhja e impiantit industrial nga Lapraka në fushën e fshatit Sharrë 7 km në perëndim të Tiranës. Sipas Luigi Za, i cili i referohet procesverbaleve të mbledhjes në dosjet e Arkivës Qendrore, ripozicionimi i Kombinatit ishte propozuar nga kryeinxhinjeri sovjetik - Dimitri Çunin, i cili e argumenton nevojën për ripozicionimin e Kombinatit me arsyetimin e nevojës së ndryshimeve që duheshin aplikuar në impiantin teknologjik të prodhimit të tekstilit i cili kërkonte ndër të tjera edhe ndërtimin e një termocentrali elektrik. Ky impiant i paplanifikuar mëparë ishte i domosdoshëm për të siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike dhe avullit për proceset e prodhimit (Za, 2012; 39). Në realitet gjendja e furnizimit me energji e Tiranës në fund të viteve 40’ ishte thuajse primitive, rrjeti egzistues e kishte të pamundur të mbulonte kërkesat e prodhimit të cilat gati dyfishonin konsumin e përgjithshëm të qytetit. Mbetën akoma mister arsyet pse nuk është marrë në analizë ky fakt për pozicionimin e mëparshëm të zonës industriale. Në këto kushte, sipas specialistit sovjetik, Lapraka si pozicion i parë duhej braktisur për shkak të ndotjes që mund të krijonte për qytetin e Tiranës pasi ndodhet në aks të luginës prej nga fryjnë edhe erërat dominuese. Për pasojë u vendos spostimi i impiantit industrial në perëndim të qytetit, në një zonë të lagësht dhe të pabonifikuar që zbriste drejt luginës së lumit Erzen. Pozicion ky që sipas analizave rezultonte me impakt me të ulët në ndotjen e zonës urbane. Ky është varianti “zyrtar” i cili justifikon një zgjedhje të gabuar pas së cilës qëndron një investim publik i gabuar.

Ndërkohë që sipas fakteve të përjetura, pozicioni aktual nuk u shfaq më i favorshëm për sa i përket impaktit ambiental. Dëshmi të kësaj periudhe trasetojne

eksperienca personale më ndotjen me gazra karboni e cila ndjehej në Tiranë sa herë ndizej termocentrali i Kombinatit. Përveç rastit konkret, edhe qytete industriale të tjera referohet të këne pasur probleme me ndotjen, kjo pasi zonat industriale u ndërtuan fare prane qendrave të banuara për të ulur shpenzimet e transportit. Në Bashkimin Sovjetik, Magnitogorsk - një nga qytetet e para të themeluara në fillim të viteve '30 për industrinë e çelikut, zona e banimit ndahet prej një prej industrive masive të çelikut prej një liqeni artificial i ngritur ky në funksion të industrisë. Në këtë kuptim, ndotja ambientale nuk mund të jetë një arsye kaq e fortë sa të detyronte ndryshimin e beftë, dhe ka të ngjarë se arsyeset e ndryshimit të planeve për ndërtimin e Kombinatit të jetë më tepër vendimarrje politike sesa e bazuar mbi parime të një analize ambientale e cila do të sygjeronte një pozicion domosdoshmërisht më të largët prej qytetit të Tiranës. Siç mund të verifikohet edhe nga zhvillimet e mëvonëshme, *përqëndrimi i zonave industriale përgjatë aksit lindje-perëndim* vazhdoi edhe më tej gjatë viteve 60', me pozicionimin e zonës industriale ushqimore duke u finalizuar me Kombinatin e Autotraktorëve "Enver Hoxha" në 1978 në lindje të Tiranës, i cili gjithashtu u inagurua në përvjetorin e rradhës të PKSH-së. Në këtë kuptim, intenerari që përbën aksin lindje-perëndim apo siç quhet rëndomtë "Kinostudio-Kombinat", shihej si një aks ideologjik ku do të ndjehej më fort prezenca e ndërtimeve të periudhës socialiste. Ndërkohë që aksi i projektuar veri-jug u definizua me ndërtime kryesisht gjatë periudhës para luftës dhe ruajti edhe në vazhdim një karakter kryesisht perfaqësues administrativ duke ju përmbajtur parashtrimeve të planit rregullues të 1943-shit, aksi historik veri-perëndimor që përkon me Rrugën e Durrësit aty ku ishin zhvilluar tashmë edhe industritë egzistuese, has në një lloj refuzimi anti-ekonomik nga sistemi, duke pozicionuar vetëm disa industri me pak interes nga pikëpamja strategjike si përpunim materiali ndërtimor e duke orjentuar zhvillimin territorit kryesisht tek bujqësia. Pozicionimi i Kombinatit në pjesën perëndimore bëri të nevojshëm edhe degëzimin e linjës hekurudhore e cila do të shërbente për transportin e qymyrit në pikën e saj fundore në afërsi të termocentralit (fig.54).

Analiza e pozicionimit të qyteteve të reja të kësaj periudhe nuk mund të zhvillohet duke konsideruar vetëm fakte teknike, rrugë e cila në shumicën e rasteve do të rezultonte pa një deduksion të qartë e të arësyeshem. Ashtu siç mund të haset edhe me qytete të tjera si Maliqi, Cerriku, Çorovoda, të cilat tërhiqen brenda relievit të thellë duke qëndruar pranë por pa u ekspozuar ndaj akseve të rëndësishme të komunikimit, qytetet industrial në Shqipëri u planifikua mbi të njëjtat parime mbrojtje siç pozicionoheshin qytetet mesjetare, por kesaj here mbi një hipotezë fiktive e të super-propagandizuar siç ishte Lufta e Ftohtë. Lugina në fshatin Sharrë ku u ngrit ish-Kombinati i Tekstileve Stalin plotësonte kushtet e domosdoshme të një zone në afërsi të Tiranës, e paisur me mbrojtje natyrore prej relievit kodrinor karakteristika këto që ishin analizuar nga kjo pikëpamje mëparë edhe nga ushtria italiane e cila kish pozicionuar një garnizon ushtarak. Ndërsa egziston një tendencë mbrojtje dhe fortifikimi si princip bazë i cili i bashkangjitet realitetit të perditshem dhe që shpesh tejkalon edhe llogjikën e planifikimit racional në qytetin socialist, në aspektin pejsazhistik, sot perben ndoshta një oportunitet nga pikëpamja pejsazhistike dhe integrimi i territorit. Ish-Kombinati i Tekstileve Stalin pozicionohet brenda një amfiteatri kodrash të buta që vijojnë në brendësi të territorit përgjatë luginës së lumit Erzen, një nga zonat me pejsazhet më mbreslënëse e me fshatra të begata të Tiranës. Pavarësisht arësyeve taktike që mund të kënen orjentuar vendimarrjen, zgjedhja e pozicionimit prane rr. së Kavajës në vend të rr. së Durrësit, në Tiranën e dominuar nga graviteti i akseve normale të rritjes, ngriti një pol të ri të rëndësishëm i cili ka

influencuar në zhvillimin e gjithë strukturës urbane në drejtimin Lindje-Perëndim të qytetit.



Fig 54 –Plani Mbështetës i qytetit të Tiranës, 1953. Pozicionimi i Kombinatit në Perëndim (burimi: AQTN)

4.2. Struktura Urbane

Analizat në shkallë urbane dhe zhvillimet e mëtejshme të konceptit referuar dokumentacionit në dispozicion, nxjerrin në pah një seri konfliktesh dhe vazhdimësishtë të cilat duke u vendosur në krahasim, ngrejnë një hipotezë teorike me baza të qëndrueshme dhe me potencial për t’ju përshtatur analizës së trashëgimisë të periudhës së socializmit. Megjithëse është e pranuar gjerësisht fakti që Kombinati i Tekstileve është projektuar dhe ndërtuar me kontributin sovjetik, ashtu si edhe në raste të tjera të investimeve të kësaj periudhe, nuk egzistojnë materiale te plota arkivore mbi projektet origjinale sovjetike. Siç është përmendur më parë në këtë teze, egziston ende sot një mister i thellë mbi të gjithë prodhimin ndërtimor të periudhës nga ‘48-’61, fakt ky që mbulon edhe raste të tjera, si plani i qytetit të Maliqit, apo në shkallë arkitektonike Kinostudio Shqipëria e Re, projekti fillestar të Pallatit të Kulturës, etj. Materialet arkivore të ruajtura deri më sot, konsistojnë në vizatime origjinale në shkallë të ndryshme, eliakopje të arkivuara dhe foto historike, të cilat në pjesën më të madhe janë në degradim. Mirëpo, edhe pse materialet e arkivuara paraqesin mangësi të konsiderueshme, kjo tezë përpiqet të nxjerrë në pah disa gjetje që dalin nëpërmjet analizës të atij dokumentacioni projekti që egziston, pa pretenduar për të qenë ezaurues, por të arrijë të ngrejv disa hipoteza të besueshme për ngritjen e një analize vertikale nga lart-poshte. Leximi i plotë dhe i qartë i mendimit, arsyeve dhe vendimeve mbi projektin e ish-Kombinatit të Tekstileve Stalin mund të bëhet vetëm në momentin e zbardhjes së plote të projektit dhe të fakteve që ende mbulojnë këtë periudhë tepër misterioze por edhe intriguese sepse fillimi i një epoke gati gjysëm shekullore të historisë së arkitekturës Shqipëtare.

Një nga fletët më interesante të projektit që ndodhet në dosjen ‘Plani Rregullues Viti 1965’ Moduli Nr.1/8, është një fletë e eliokopjuar dhe e rivizatuara pjesërisht dhe që në fakt nuk përmban as emërtim as specifikime mbi autorë apo datë hartimi (fig.54). Ajo që bëhet direkt e qartë në këtë vizatim që mendohet të ketë qenë plani urban fillestar i hartuar nga sovjetikët mbi të cilin janë ripunuar varjante të mëvonëshme, është detaji dhe saktësia e këtij vizatimi i cili parashikon ndërtimin e qytetit deri në detajet e hapësirave publike, kjo në vijim të teorisë të “urbanizmit total” mbi të cilën bazohet Stili Stalinist në arkitekturë, përfshi edhe në këtë aplikim të vonë të tij siç është rasti konkret. Eliokopjet e vizatimeve, janë prekur në fazë të mëpasshme duke rivizatuara pjesë të nuklit qendror i cili na bën të mendojmë se ka të bëjë me një lloj inventari ndërtesash të bërë në një moment të mëvonshëm të vlerësueshëm si i fillimit të viteve ’60, gjykuar prej zhvillimit të zonës industriale dhe shtrirjes së zonës rezidenciale (fig.55).




Fig. 54 – Plani Rregullues i Përgjithshëm, Shk. 1:2000. Pjesë nga projekti i vitit 1949.

Fig. 55 – Plan i rrjetit të transportit, Moskë 1960; (burimi: AQTN)

Forma e përgjithshme e qytetit shfaqet si një perzjerje ndërmjet linjave organike që ndjekin relievin e luginës dhe rrjetit kuadratik të blloqeve të strukturuar në forma drejtkendore teksa i afrohet rrugës së Kavajës. Kalimi nga qendra në periferi i cili interpretohet gjeometrisht si thyerje graduale e rregullit të gjeometrise ortogonale që karakterizon zonën e qendrës duke u zbutur e bërë më sinuoze e organike teksa i afrohet natyrës, na bën të mendojmë se kemi të bëjmë me një koncept fillestar i cili reflekton një qëndrim të tipit “piktorek” i cili tenton të kontekstualizojë impiantin rigjid që karakterizon qytetet Staliniste në përgjithësi. Kombinati i Tiranës është në fakt një nga projektet e soc-realizmit të vonë dhe si i tillë shërben si një shëmbull ku mund të dallojmë evolucionin në këtë drejtim, në krahasim me qytete të fazës së parë, duke konsideruar që Shqipëria ishte ndër të fundit vende të bllokut ku u investua për industrinë e lehtë. Nga ana tjetër, ky qëndrim disi i veçantë për kanonet e sistemit, shfaqet i aplikuar në këtë rast ndoshta për faktin se ishte projekti i parë që do të ndërtohej në territor mesdhetar, një pozicion gjeografik ky fuzionesh të kulturave më të rëndësishme europiano perëndimore me ato orjentalë. Në rastin e Tiranës kjo shprehet qartazi me arkitekturën pre-moderniste dhe racionaliste e cila mbizotëronte tashmë skenën për afro tre dekada. Ndër referenca kryesore të urbanizmit për qytetet e reja të kësaj periudhe për ndërtimin e qyteteve të reja, ishin “qytetet kopësht”. Në fillim të 900’-ës ato shërbyen gjerësisht si modele për tu inkorporuar brenda linjave monumentale të urbanizmit totalitar i cili merr hov gjatë kësaj periudhe. Egzistojnë shembuj të shumtë të aplikimeve të teorisë së qyteteve kopësht, por për rastin e veçantë mund të përmendet një nga rastet më të famshmet i cili ishte njëkohësisht

edhe rasti i parë i një qyteti “satelit” në Perëndim. Welwyn Garden City (fig.56) i themeluar nga Ebenezer Hoëard dhe i projektuar nga Louis de Soissons ne 1919 u vendos 32 km ne veri të Londrës, pak kilometra më afër se qyteti tjetër me famë - Letchworth Garden City. Ky qytet u konceptua nga themeluesi i levizjes për qytetet kopësht, si një qytet i ri apo “new town”. Ne revistën satirike Punch të 1920, qyteti i ri promovohet me këto fjale: “Nuk është mirë të harxhosh dy orë në ditë në trena dhe autobusë për dhe nga vendi i punës, duke mos lënë kohë dhe energji për të pushuar apo për rekreacion. Në Qytetin Kopshtin Welwyn, shtëpi e njeriut do të jetë pranë punës në një atmosferë të pastër dhe të shëndetshme”(Gossop, 2006). Edhe pse planifikimi i qyteteve të reja do të fillonte zyrtarisht në 1946 pas shpalljes së “New Towns Act”, Welwyn ishte rasti i parë i qytetit që kërkonte të kontribuonte në decentralizimin e industrisë britanike.



Fig.56- Welwyn, foto ajrore (burimi: <http://cashewnut.me.uk/WGCbooks/web-WGC-early-maps.php>)

Në të njëjtin koncept decetralizues zhvillohet edhe rasti i Kombinatit, si një qytet satelit me pavarësi të theksuar ndaj qendres urbane. Në të dyja rastet, pavarësia nuk rezultoi e plotë sepse qyteti i ri nuk arriti të jetoje i pavaruar. Në rastin e Welwyn, banorët vazhduan të bëjnë pendolarin drejt Londres, ndërsa në rastin e Kombinatit nuk mund të plotësohej kërkesa për punonjës dhe një pjese e tyre udhëtonin nga Tirana. Welwyn Garden City në ndryshim nga Kombinati është pozicionuar në territor krejtësisht të sheshtë, me shtrirje urbane më të madhe dhe me densitet të ulët, por gjejme ngjashmëri ndërmjet të dyve për nga struktura urban dhe diferencimi që i bëhet teksturës nga qendra në periferi. Modeli i parkut rrethor i cili përbën nuklin qëndror në modelin teorik të Howard, në rastin e Konbinatit është zëvendësuar prej aksit qendror monumental i cili mban drejtimin ortogonal me akset e rëndesishme të transportit, por po prap edhe ky i trajtuar me një lulishte qendrore e cila lidh dy sheshet skajore. Keto, ashtu si në rastin e qytetit kopësht, në një shije iluministe i dedikohen arsimit me shkollën profesionale nga ana e zonës industriale dhe shkollës fillore-elementare nga krahu i zones se banimit. Pra përmbajtja programatike dhe struktura funksionale e hapësirës qendrore nuk ndryshon në thelb prej modelit perëndimor të qytetit kopësht.

Përsa i përket teksturës dhe shtrirjes, impianti urban shfaq një strukturë të përzier ndërmjet qytetit kompakt të organizuar rreth hapësirës qendrore dhe qytetit linear, me shtrirje kryesisht përgjatë aksit të rrugës së Kavajës, nga ana që lidh me Tiranën (fig.57). Edhe pse në shikim të parë dhe nga analizat e bëra deri tani Kombinati përshkruhet si qytet kompakt, në fakt kemi të bëjmë me një berthame urbane të shtypur dhe të zgjatur në drejtimin Lindje-Perendim, forme kjo që shkon edhe sipas formës së luginës. Në Jug nga zhvillohet kryesisht zona e banimit bërthama urbane përcaktohet nga kufijtë natyror të kodrave përreth, ndërsa në pjesën e poshtme nga ana e fushës shtrihet në formë fashe të vazhduar zona industriale, sheshi qendror me hyrjen në fabrikë si dhe një zonë banimi e tipit ekstensiv e cila paraqitet në këtë hartë me një kufi të papercaktuar. Në fakt, intensiteti më i madh ndertimor që përfaqësohet prej katër blloqet rezidenciale dhe zonës industriale, kanë shtrirje lineare përgjatë aksit të rrugës së Kavajës, sot rruga Llazi Miho. Megjithatë, siç tregojnë edhe zhvillimet e mëvonëshme urbane, përqendrimi i rritjes brenda kufinjve të percaktuar të zonës së urbane, tregojnë për një zhvillim urban rreth një nukli monocentrik.

Sipas idesë fillestare në thelb të projektit urban ekziston një skemë e përgjithshme e cila vendos këtë lagje të re, të parën e llojit të vet në Shqipëri, në komunikim direkt me qytetin mëmë Tiranën. Si i tillë projekti i ri shfaq një interes të veçantë lidhur me tema që kanë të bëjnë me hapësirat përfaqësuese. Kemi edhe këtu të bëjmë me një strukturë urbane të organizuar rreth një aksi monumental i përfshirë ndërmjet dy sheshesh që ashtu si në rastin e Tiranës, kërkojnë të jenë esenca propagandistike e qytetit. Në Kombinat në të dyja skajet pozicionohen hapësira të gjelbra duke i dhënë këtij aksi rolin integruar si një koridor i gjelbëruar që përshkon të gjithë zonën e banimit. Përdorimi i gjelberimit në projektin urban që hasim tek “qyteti kopësht”, në të dyja rastet përbën një element kyç në integrimin e konglomeratit urban me hapësirën. Parku rekreativ pozicionohet në ekstremitetin jugor, përgjatë luginës në fund të së cilës gjendet edhe një liqen artificial, ndërsa në krahun verior shtrihet zona sportive e cila kombinohet me zonën industriale. Aksi qendror është konceptuar si një lulishte e vazhduar me gjërësi 20 m e cila kulminon me ish-sheshin Stalin në krahun verior dhe me sheshin e “Gastronomit” në krahun jugor. Me po të njëjtën “zemërgjerësi” në terma hapësinore është trajtuar edhe koridori i transportit, ortogonal me të aksin qendror. Dy fasha gjelberimi të gjëra 20 metra bëjnë ndarjen e blloqeve të banimit në të dyja krahët e aksit të transportit. Këto koridore përcaktojnë strukturën hipodamike tipike të qytetit socialist e cila organizon rrjetin e brendshëm të komunikimit dhe konfigurimin e zonave të ndryshme brenda territorit urban.




Fig. 57- Fletë nga Plani Rregullues i qendrës së banuar të Kombinatit Tekstil Stalin, Tiranë.
(burimi:AQTN)

Qytetet e socializmit në Shqipëri, për nga kushtet eksperimentale që u krijuan, sinteza e elementeve vital të qytetit të grupuara nëpërmjet një projekti që kërkon të japë zgjidhje të karakterit tërësor ndaj problemeve të veçanta bazuar kryesisht në konsiderimin e faktorve funksional që burojnë prej procesit të zonimit, shfaq edhe në këtë aplikim të vonë të arkitekturës tv realizmit socialist, trajtat e një “qyteti ideal” funksionalist, i cili sherbeu si baze për zhvillimet me arkitekturën e qyteteve të para socialiste në BS. Në krahasim me qytetin funksionalist perendimor, diferenca qëndron tek mpirja formale dhe mungesa e lirshmerisë eksperimentale që sillte politizimi i tepërt i procesit në krahun lindor. Si një rast me ngjashmeri strukturore e përmbajtje, por me ndryshimet e siperpermendura nga pikëpamja gjuhësore kompozicionale, mund të marrim si shembull krahasues bllokun residencial “Patkoi i kalit” apo Hufeisensiedlung të arkitektit ekspresionist Bruno Taut ndërtuar në Berlin në vitet 1925-33 (fig.58). Ky projekt ka luajtur një rol shumë domethënës për përkthimin në terma konkrete të arkitekturës moderne të koncepteve idealiste të lëvizjes për qytetin kopësht të E.Howard i cili gjithashtu organizohet rreth hapësirës së gjelbër qëndrore të kompozuar në tre evente të ndryshme të cilat pasojnë njëra-tjetrën sipas një vijimësie aksiale. Në krahasimin me këtë rast, duhet patur parasysh ndryshimin thelbësor që egziston ndërmjet dy modeleve: Hufeisensiedlung, është një lagje e re e zonës metropolitane të Berlinit, ndërsa Kombinati u konceptua si qytet satelit industrial me një autonomi të theksuar që ndikoi në konceptimin e një strukturë të plotë urbane më të plotësuar në aspektin tipologjik, edhe pse në thelb bëhet fjalë për të njëjtin numër banorësh. Gjithashtu edhe në aspektin kompozicional të formës urbane vihen re ndryshime ndërmjet dy rasteve. Në Hufeisensiedlung forma e lirë e zhvillimit të blloqeve urbane krijon një teksture më organike dhe më fleksibël ndaj kushteve reale të territorit, ndërsa projekti i lagjes së Kombinatit përben një interpretim më rigjid në strukturë urbane ku rregulli është kryefjala dhe faktori percaktues i kufinjve të hapësirës.




Fig.58- Masterplan i Hufeisensiedlung. B.Taut. Berlin 1929.(burimi:Wikipedia)

Modeli liberal e demokratik i lagjes Hufeisensiedlung trajton hapësirë qendrore në modelin e forumeve komunitare ku forma nuk shfaq hierarki, por diversitet, në rastin e Kombinatit vazhdimësia hapësirë e hapësirës qendrore shfaq një hierarki të theksuar që vendos në qendër të gjithçkaje hyrjen e fabrikës dhe ku zhvillimi linear i proceseve të prodhimit, kthehet në një guidë gjeometrike për të gjithë zhvillimin urban. Duhet konsideruar këtu, se në këtë periudhë në qytetet Shqipëtare kishin filluar të ndodhnin transformimet e para të qytetit orjental karakterizuar nga zhvillimet organike, me lagje të reja të cilat u karakterizuan nga zhvillime lineare. Në Tiranë kemi aplikimet e para të rrjetit hipodamik gjatë zgjerimeve të para të qytetit në fund të viteve 20' me planin e Koohler dhe idene e “Tiranës së re”. Në këtë rast kemi të bëjmë me urbanizime private të cilat krijonin paevitueshmërisht variacionin në shkallë arkitekturore tipik të lagjes borgjeze. Ndërsa rasti i aplikimit socialist të strukturës hipodamike si metodë që favorizon standartizimin dhe përdorimin e objekteve tip, shihet në rastin e Kombinatit si një para-konditë që favorizon uniformizimin e klasave shoqërore.

4.3. Manifestime të ideologjisë dhe propagandës nëpërmjet arkitekturës

Historicizmi që lexohet qartë në linguazhin arkitektonik të përdorur në Kombinat, reflekton një dëshirë persistente për “antikën fallso”, imazh ky prezent në të gjithë aktivitetin e arkitekturës staliniste. Siç është shprehur edhe më parë në këtë tekst, stili zyrtar adoptoi brenda repertorit të tij arkitektonik një seri formash dhe proporcionesh të marra në mënyrë gati integrale prej kontekstit historik evropian, në tentativa për krijimin e një identiteti globalist në thelb, por duke shfrytëzuar mjetet linguistike që jep tradita klasike. Nëpërmjet këtij klasiçizmi të vonuar, sistemi i ri dëshironte të aplikonte rrënjët e veta, në një farë mënyre, duke përshpejtuar procesin e historicizimit nëpërmjet një referencë të parë në stil “ritardato”. Në rastin e Kombinatit të Tekstileve Stalin në Tiranë, qendra urbane vjen në versionin e një qyteti mesjetar me porta, kulla dhe lozha të harkuara. Historicizimi i ambientit urban u pa si një zgjidhje e cila do të siguronte kohezionin të menjehershëm ndërmjet klasës së re puntore dhe qendrës urbane, si një kod stilistik i cili mund të **ndizte “efektin qytet”** duke i dhënë jetë formave materiale ndërkohë që unifikon ambientin e ndërtuar. Në këtë rast sfida nuk qëndron tek të kërkuarit e elementeve origjinal apo të novacionit arkitektonik siç mund të ndodhi me rastin e arkitektures moderne, por me

teper të menyres se perzierjes se amalgames historike dhe kompaktibilitetit apo mosperputhjeve gjuhësore qe egzistojnë midis perdorimit të formes arkitektonike dhe kuptimit programor qe ka objekti dhe hapësira urbane. Kombinati u konceptua si një shtrat për traditën komuniste dhe origjinën e njeriut të të ri, si i tillë përbënte paevitueshmërisht një model eksperimental ku mund të testoheshin aplikimet e politikave urbane dhe zhvillimet e raporteve shoqërore për t'u aplikuar në një rang më të gjerë.

Një nga karakteristikat e veçanta nga pikëpamja komunikative që u desh të zhvillojë e gjithë arkitektura totalitare e shekullit 20, është rendja për një ndërlidhja të modeleve zyrëtare internacionale me karakteristika të veçanta kontekstuale në tentativë të gjetjes së një stili nacional, e cila në fakt si në rastin e arkitekturës fashiste, shihej si një mjet penetrimi dhe kontekstualizimi shoqëror duke përdorur propagandën e stilit. Nga pikëpamja studimore kjo veçanti, nëse egziston dhe sipas një përpjekje të konsiderueshme, i jep këtij klasifikimi arkitekturor karakteristikat e veçanta që lindin nëpërmjet dialogut me kontekstin. Siç do të shihet prej rastit të Tiranës, arkitektura staliniste - ndryshe nga ajo fashiste e cila tregoi disa tëntativa të rëndësishme në këtë drejtim, shfaqti më tepër vështirësi në përshtatje duke reduktuar komponentin nacional në një rol më të përdorues. Me këtë qëndrim i cili u aplikua fillimisht në ish-republikat sovietike dhe pas LB2 në vendet e Europës lindore, synohej në përgjithësi më tepër zbehja e tendencave nacionaliste dhe krijimi i një fronti të vetëm kulturor socialist që buronte prej qendrës, së sa në ngritjen kulturore të territoreve të veçanta. Sllogani i famshëm **“kombëtar në formë, por socialist në përmbajtje”** i cili qëndroi në fuqi në të gjithë zonën e Bashkimit Sovietik prej viteve 1920' ashtu siç është analizuar edhe më parë, duket se edhe në rastin e Kombinatit gjen aplikime tepër të zbehta të cilat nuk arrijnë ta shkëpusin dot prej një skeme të importuar. Aplikimi i stilit arkitekturor tenton të qëndrojë brenda kornizave zyrëtare pa shfaqur lidhje direkte dhe të qëndrueshme me arkitekturën tradicionale shqiptare. Megjithatë, në një sfond studimor më të gjërë që konsideron ndërtimet fortifikuese të periudhës mesjetare, në mënyrë të vakët mund të hasim në ngjashmëri ndërmjet hyrjes monumentale të fabrikes tekstilit me kullat qytetare gjirokastrite konkretisht me **Shtëpinë e Zekateve**. Në rastin e Kombinatit mbetemi në kufinj të skenografisë, ku vulumet kullë të hyrjes nuk shkojnë përtej dëshirës për monumentalitet pasi nuk janë konceptuar si elementë volumor të lidhura funksionalisht me pjesën tjetër të ndërtesës, nga pikëpamja funksionale ato përbëjnë hapësira shërbimi, të pa aksesueshme për publikun. Ndërkohë që në **banesën gjirokastrite**, kulla është element i lidhur në mënyrë të pazgjithshme me brendinë e objekteve, në rastin e Kombinatit mbizotëron llogjika skenografike që shihet formën si mjet për spekullim vizual i cili imponon zgjidhje të pajustificueshme nga pikëpamja funksionale siç është pozicionimi i ballkoneve në pjesën e brendshme mbi çatime të hyrjes, të cilat shikojnë nga njëri-tjetri. Këto kulla qëndrojnë të shkeputura totalisht prej kontekstit dhe formes, ato raportohen vetëm me njëra-tjetrën duke imponuar në mënyrë monumentale prezencën e tyre në sheshin qëndror. Më tepër se një lidhje e monumentalizuar mes fabrikës dhe zonës urbane, këto volume japin idënë e kullave të survejimit, tipike të arkitekturës së fortifikuar e cila është aplikuar gjërësisht në fortifikimet shqiptare të mesjetës, si kulla në Kalanë e Krujës, apo Kulla e Sahatit në Kalanë e Gjirokastrës. Në të gjitha këto raste ngjashmëria është e vagët, por ajo që mbetet është fakti se në krahasim me trendin e përgjithshëm të horizontalitetit që haset në qytetet sovietike të kësaj periudhe, në rastin e Kombinatit hapësira qëndrore prezanton tipare të arkitekturës së glorifikuar nëpërmjet futjes së dimensionit vertikal në mënyrë të centralizuar. Ndoshta

në këtë qëndrim mund të ketë ndikuar edhe kompeticioni i natyrshëm ndaj Tiranës, ku gjithashtu sheshi Skenderbej konfigurohet nëpërmjet unicitetit formal që përmban Kulla e Sahatit.

Kombinati si periudhe projektimi dhe ndërtimi, nuk përkon në kohë me veprat sovietike për industrinë e tekstit të cilat u ndërtuan më tepër gjatë planeve të para pesevjeçare duke filluar në vitet 30'. Një ndër veprat më të përmendura gjatë kësaj periudhe ishte padyshim kombinati i tekstileve **Ramensky** në afërsi të Moskës i cili u cilësua me “Flamuri i Kuq” gjatë viteve të para të industrializimit. Për ndërtimin e kësaj vepre u thirr Erich Mendelson i cili projekttoi impjantin e përgjithshëm dhe një nga ndërtesat në 1926 inspiruar prej konstruktivizmit i cili që në akt në atë kohë, ndërsa vazhdimi i projektit i përket stilit Stalinist. Në krahasim me Kombinatin në Tiranë kemi të bëjmë me një zonë industriale kompakte dhe të zhvilluar në lartësi, por edhe në Ramensky ruhet principi i shtrirjes horizontale me volum të pandërprerë. Përsa i përket konfigurimit monumental të hapësirës nuk gjejmë në Ramensky një hyrje monumentale si në rastin e Kombinatis, por përsëri vihet re përdorimi i “kullave” që dalin prej volumit masiv edhe pse shume më pak determinuese në aspektin kompozicional. Në përgjithësi në qytetin stalinist të ish-hapësirës sovietike nuk haset konfigurimi i dyzuar i sheshit qëndror me hyrjen e zonës industriale. Qytetet industriale sovietike u themeluan me dimensione shume herë më të mëdha dhe kryesisht për industri të rëndë, në këto kushte zona industriale ishte më e distacuar, duke dalë prej limiteve të arritshmerisë me ecje. Në Kombinat përdorimi i hyrjes së zonës industriale si event gjenerues i hapësirës monumentale duke e përforcuar këtë me funksione të tjera qëndrore, është një rast i rrallë në aplikimin e kësaj tipologjie sheshi në vendet e tjera të lindjes.



Fig.59- Liqeni Borisoglebskoye; **Fig.60-** Fabrika Ramenskoe. Oblast, Moskë. (burimi: <http://phoenix-park.ru/photos/past/>)

Nga ana kompozicionale volumore mund të hasim një poetikë të ngjashme edhe në arkitekturën italiane të fundit të 800-es dhe fillimit të 900-es. Ky procedim kompozicional është përdorur kryesisht për ndërtesat e hapura publike, si Monumenti i Vittorio Emanuele II në Rome, apo “il **Vittoriano**” siç njihet gjërësisht. Kjo ishte vepra më madhore e mbretërisë italiane të asaj kohe e projektuar në vitin 1882 prej arkitektit Giuseppe Sacconi dhe mori 30 vjet për t’u ndërtuar. Në këtë rast volumet vertikale anësore hapin perspektivën e piazzales e cila kulminon shkallaren imponente që udheheq drejt monumentit qëndror. Edhe arkitektura e mëvonshme e fashizmit perdori gjerësisht poetiken e dy kullave që ngrihen në mënyrë simetrike prej volumit gjatësor, diku duke zgjeruar perspektivën për percaktimin e shesheve, diku duke u ngushtuar e simbolizuar një porte. Hyrja monumentale e kompleksit **Fiera del Levante** e vitit 1929 nga inxhinjer Augusto Corradini, tek ky objekt monumental hasim integrimin brenda stilit ekletik me derivacion Beaux Arts, të kulturave

dominante mesdhetare si ajo orjentale, bizantine, veneziane (fig.61). Porta në këtë rast simbolizon hapjen e Italisë fashiste ndaj ballkanit duke simbolizuar një ribashkim ndërmjet Romës dhe Bizantit. Në të dyja rastet, individualiteti i kullave vertikale shprehur në gjeometrinë e tyre personaliste shërben më tepër si një sinjal apo komunikim simbolik, se sa një llogjikë më e integruar arkitektonike, duke mbartur në vetvete formën autarkike të regjimeve. E parë në këtë këndvështrim dhe ndërthurrur me konceptin e aksit socialist Kinostudio-Kombinat të analizuar më sipër, nuk do habisteste të ketë egzistuar një simbolikë e ngjashme edhe në rastin e arkitekturës simbol të Kombinatit.



Fig. 61- Fiera del Levante, Bari 1929, ing. Augusto Corradini. (burimi: http://www.barinedita.it/public/foto_galleria/bariantica21.jpg)

Nga pikëpamja e përmbajtjes simbolike të arkitekturës, hyrja e Kombinat është trajtuar si një “hark triumfi”, me një harkadë qendrore të dekoruar në pjesën e brendëshme me kuti opo “casseton” duke i dhënë asaj një pamje sublime (fig.62). Një basoreliev në stil të realizmit socialist në qendër të kompozimit, kërkon ti japë kuptim dualizmin mesjetar të kullave nëpërmjet një simbolikë me kuptim social. Kompozimi paraqet në mënyrë metaforike një akt komunikimi midis klasës fshatare dhe klasës punëtore, ku njëra prodhon pambukun dhe tjetra fillin i cili buron simbolikisht nëpër një dritare rrethore. Në qendër të kompozimit, në pjesën më të lartë të tij, gjendet i pozicionuar ylli pesë cepësh i vendosur mbi një guackë rrezellitëse, që simbolikisht përcjellin dritën mbi kokat e punetorëve (fig.63). Në këtë rast promovohet kohezioni shoqëror i cili bënte të mundur prodhimin industrial dhe ngritjen e shtetit modern. Nga ana tjetër, dualizmi karakteristik mund të shihet edhe në krahun e atyre që projektuan veprën. Siç rezulton prej kronikave të asaj kohe, propaganda promovonte fuqishëm partneritetin “vllazëror” ndërmjet dy vendeve. Edhe pse nuk egzistojnë dokumenta për realizimin e këtij basorelievi, mund të hipotizohet se simbolika që përfaqësohet në dualitetin identik të kullave të ketë një përafrim të kësaj natyre. Gjithsesi, ajo që bëhet e evidente me kompozimin tërësor të fasadës së hyrjes dhe që finalizon kuptimin me prezantimin artistik të basorelievit, është një hierarki e fortë kompozicionale që zhvillohet në formë piramidale drejt

qendrës së aksit organizues të zonës industriale i cili fillonte me monumentin kushtuar Stalinit.



Fig 62 – Fragmente nga sheshi qendror i Kombinatit. Foto fillim vitesh 80’ (burimi: AQSH); **Fig 63** – Basorelievi i hyrjes në fabrike, Tiranë 2020. (burimi: autori)

Në krahun verior të sheshit gjendet e pozicionuar ish-Shkolla e Kuadrove të tekstilit (fig 64). Ajo zhvillon parime të kundërta për të gjeneruar kontrastin e duhur me hyrjen monumentale që përshkruhet më sipër. Godina kësaj here merr shtrirje horizontale duke prezantuar në shesh një front të tërhequr i cili thyhet nëpërmjet inserimit tërthorazi të volumit monumental të hyrjes së shkollës i cili mbyll aksin qendror Veri-Jug. Ngjashëm me hyrjen e fabrikës, hyrja e shkollës profesionale po ashtu trajtohet me një hark të plotë i cili projektohet në brendësi të volumit të trepjesëzuar duke formuar një lozhë të ngushtë e cila kulmon lart me tavanin e harkuar me kutiza të cilat janë prezente edhe në trajtimin e interiereve të objektit. Ndërsa faqja e tërhequr shfaq gjithashtu tematikën e dyzimit nëpërmjet dyerve dhe dy dritareve të harkuara që ndricojnë hollin në pjesën e brendëshme. Zona e mësimi mërr zhvillim në krahun perëndimor duke prezantuar nga sheshi një lozhe me kolona dorike të cilat kulmojnë me dhjetë harqe të plota. Kësaj here kemi të bëjmë me përdorim të arketipeve historike me origjinë religjioze të cilat evokojnë ndjeshëm ndjesinë hapësinore të manstireve të Rilindjes. Hyrja e shkollës më kompozimin trepalësh me hyrje qendrore dhe dy navatat anësore kërkon një evokacion të tille në fasade, por zhvillimi në pjesën e brendëshme paraqet një qëndrim atipologjik dhe të lidhur me funksionin e ri. Në rastin e Kombinat skenografia urbane përdor fragmente historike të cilat tentojnë të lidhen dhe të krijojnë një simbioze duke imituar sipas mënyrës sovietike qytetin historik mesdhetar. Nga ana tjetër, nuk mund të mos vihet re një lloj ngurtësie nga ana kompozicionale, në përzjerjen e elementëve të ndryshëm të cilët pozicionohen në skenën e sheshit pa kërkuar artikulum apo zgjidhje vazhdimësie. Tentativa për të historizuar në mënyrë artificiale, mbetet edhe në këtë rast një agregim midis fragmentesh evokative të shkëputura prej kuptimeve përkatëse historike, duke vjelur prej tyre vetëm monumentalizmin që ishte dhe materia kryesore e propagandës.

Ky mund të lexohet si një element kontekstulizues, pasi lozha ishte një element gjërësisht i përdorur në të gjithë arkitekturën mesdhetare përfshi këtu Tiranën ku ndër më historiket është lozha me tre harqe e xhamisë së Ethem Beut. Nëse kërkojmë krahasime, prezenca e 10 harkadave të plota, na sjell në mendje lozhën famoze “*Ospedale degli Innocenti*”, vepër e Filippo Brunelleschi-it në Sheshin Santissima Annunciata në Firenze. Ndryshe nga rregullat e strukture kompozicionale

klasike, ndertesat publike qe rrethojne sheshin qendror në Kombinat evitojnë perdorim e bazamentit, edhe pse ky mund te ishte i nevojshem teknologjikisht duke konsideruar qe ndertoreshin mbi nje zone te bonifikuar. Ato duket sikur mbijne direkt nga trualli duke dashur të theksojnë sfondin proletar të këtij qyteti, ndryshe nga Tirana politike ku arkitektura duket se nuk mund te shmange perdorimin e bazamentit, shpesh me nje rol te theksuar siç ishte rasti i lozhes së Pallatit të Kulturës e cila u ndertua një dhjetë vjeçar më vonë.



Fig 64 – Ekstrakte nga filmime gjatë ndvrtimit. Burimi: AQSHF

Monumentaliteti stoik i kësaj hapësire definohej kryesisht prej prezencës së shtatores së Stalinit (fig.66). Nëse bëjmë krahasime me projektin fillestar, do të vërejmë një ndryshim thelbësor i cili tregon shumë edhe mbi mënyrën si evoloi sistemi në Shqipëri. Sipas projektit sovietik, monumenti është pozicionuar në mes të sheshit. Në këtë rast lozha me harqe do të shërbente si sfond ritmik i cili i linte debut të plotë shtatores, teksa dy hyrjet ajo e fabrikës dhe e shkollës pozicionohen në sejcilin krah në vizibilitet të plotë. Duket se në një moment të dytë, kur tashmë ishte marrë vendimi për emrin dhe dedikimin e monumentit për Stalinin, bëhet spostimi nga pozicioni i parashikuar me projekt me rreth 20 m më në lindje, duke kapur aksin e shëtitorës së zonës së banimit dhe duke i dalë përpara hyrjes së shkollës së Kuadrove (fig.65). Siç dëshmojnë fotot historike, ndryshe nga projekti sovietik i cili parashikonte gjelbërimin të pozicionuar vetëm në jug të sheshit, si shkëputje prej aksit të trafikut, në realitet u ndërtuan dy lulishte me pemë simetrike në lidhje me hyrjen monumentale të cilat zbehen mëtej prezencën e lozhës, duke e kthyer sheshin në një hapësirë të komprimuar nga prezenca e dy polëve monumentale, ndryshe nga kompozimi fillestar i cili kërkonte një formë ekuilibri më të qartë ndërmjet pikave fokale dhe fasadave të vazhduara ritmike të cilat me ndrshimin e pozicionit të

monumentit qëndror humbasin llogjikën e tyre kompozicionale. Një lloj bujarie e shtyrë edhe përtej pritshmërive Sovjetike, pozicionon Stalinin në qendër të dy akseve kryesore urbane duke bërë monumentin reference vizuale edhe të zonës së banimit në jug. Monumentalizmi ekstrem mbetet një nga karakteristikat më dominuese të prodhimit arkitekturor të realizmit socialist klasik në Shqipëri. Njëpërmjet rikthimit në klasicizëm duke komprimuar historinë, regjimi përfitoi për të krijuar idënë e një rifillimi pompoz. Por në fakt ajo e cila serviret vërtet është një klasicizem i denatyrizuar i cili shkëput nga historia vetëm forma të veçuara prej përmbajtjes e ku gjithçka që ka rëndësi është skenografia si mundësi për të përcjellur mesazhin politik. Kështu një manastir me lozha bëhet shkollë laike dhe një derë e thjeshtë fabrike trajtohet si një hark triumfi, imazhe këto që nuk kishin asgjë të përbashkët me kushtet reale të jetës së përditshme të punëtorëve të Kombinatis.



Fig 65 – Ekstrakte nga kopja e masterplanit fillestar. (burimi: AQTN); **Fig 66** – Foto e Sheshit Garibaldi. Tiranë 2015 (burimi: autori)

4.4. Zona e banimit

Karakteristika më e spikatur e Kombinatis është stili unitar arkitekturor i përdorur në të gjitha objektet qoftë këto publike, te prodhimit apo banesat të cilat kanë qenë pjesë e projektit fillestarë dhe që sot identifikohen me nuklin historik. Kështu në mënyrë strikte, të gjitha objektet mbulohen me çati me të njejtën pjerresi dhe ngjyrosen me të njejtën nuancë të verdhë e cila ngjante me okren fiorentine. Gjithashtu është përdorur edhe ngjyra e kuqe e thellë e cila është vënë re më tepër në të çfarë ka mbetur prej zonës industriale, apo në fasadat e tullës së pasuvatuar të disa prej objekteve më përdorim publik brenda qendrës residenciale. Nga pikëpamja e kompozimit volumetrik, zona e banimit prezanton karakteristikat tipike të qytetit horizontal socialist, në këtë rast i realizuar njëpërmjet objekteve lineare me dy kate lartesi. Kjo tipologji residenciale u përdor me ndryshime të vogla edhe në qytetet industriale të ndërtuara në vazhdim të viteve '50. Mund të përmendim qytetin e Cerrikut, Memaliajt, por edhe zhvillimet e këtyre viteve përgjatë unazës së Tiranës në afersi të stadiumit Selman Stërmasi. Ndër këto, modeli i përdorur në Kombinatis është i pari dhe më i artikuluar nga pikëpamja arkitektonike dhe përdorimi i materiale të ndërtim më cilësore.

Ndërtimi i zonës residenciale në Kombinatis gjatë periudhës së socializmit është shtrirë deri në fillim të viteve '80, duke filluar me projektin sovjetik të 1949-ës dhe duke vazhduar me azhornime të planit të cilat dëndësuan blloqet egzistuese duke shkaktuar ndryshim të raporteve urbane në kurriz të hapësirës publike. Azhornimet e planeve, edhe psë me disa mangësi në të dhëna përsa i përket kohës kur janë kryer apo autorët që i kanë prodhuar, përbëjnë bazën më të vlefshme të materialit arkivor në dispozicion e që na lejon hulumtimin mbi zhvillimin e hapësirës në vite. Në

masterplanin e mësipërm (fig.67), i cili hamendësohet të jetë vizatuar në mes të viteve 60', ndër të tjera mund të vihet re përcaktimi i gjendjes egzistuese ku dallojnë strukturat e banimit në ngjyrë gri nga ato publike me ngjyrë bezhë. Ky është nukli historik i Kombinatit i cili u implementua mbi projektin unitar sovietik. Në dallim prej hapësirës qendrore, siç shihet në vizatim por edhe verifikohet prej faktit, implementimi i planeve të mëvonëshme urbane për dendësimin e qendrës së banimit, bëjnë të pamundur sot perceptimin e asaj që mund të këtë qenë esenca e projektit fillestar nga pikëpamja e raportit ndërtim - hapësirën në zonën rezidenciale. Megjithatë, fatmirësisht janë ruajtur mirë sot një pjesë e konsiderueshme e godinave të banimit që formonin nuklin historik të asaj periudhe, duke na transmetuar një pasqyrë të qartë të vlerave urbanë që mbart Kombinati, si një trashëgimi e plote urbane dhe arkitektonike e qytetit socialist në Shqipëri.



Fig 67 – Plan Rregullues i Kombinatit Tekstil. Tiranë ~1965. Burimi: AQTN

Zona rezidenciale është e strukturuar në vijim të gjeometrizimit të përgjithshëm ortogonal që karakterizon projektin, sipas dy akseve kryesore që zhvillohen në mënyrë ortogonale me rrugën e Kavajës, aksi qendror monumental që lidh qytetin me fabrikën e tekstit dhe aksin e ish-fabrikës së qelqit e cila mori zhvillim direkt pas ndërtimit të kombinatit. Aksi qendror në pjesën jugore përcaktohet prej dy blloqesh simetrike me zhvillim perimetral me të njejtën lartësi ndërtesash. Në të ngjitur të relievit, në dy krahët e sheshit të Gastranomit u pozicionuan grupe banesash të ulëta të vendosura në rradhe sipas linjave të relievit. Ndërsa në krahun e fabrikës së qelqit, mbi terreni i bonifikuar u ndërtuan zona rezidenciale më intensive me ndërtime deri 4 kat dhe hapësira publike me të reduktuara. Këtu vëmë re diferenca në aspektin e

cilesisë dhe hierarkisë hapsinore e cila shfaq diferencat e veta nga qendra në periferi duke devijuar nga ideja unitare e arkitekturës staliniste e cila në fakt nuk e pranonte egzistencën e periferive.

Dy blloqet e banimit që shtrihen në dy anët e shëtitores dhe godinat që e përcaktojnë atë, përbejnë shembujt më të mirë të aplikimit të arkitekturës residenciale të këtyre viteve në Shqipëri (fig.68). Strukturat urbane të tipit “super-blok” të cilat karakterizojnë qytetin socialist të kësaj periudhe, shfaqen edhe këtu të aplikuar në simensione me të reduktuara. Ato marrin një shtrirje prej 5 dhe 6.5 hektarë duke prekur limitin e poshtëm të tipologjisë urbane e cila njih dimensione akoma më të mëdha. “Super-bloku” socialist merr origjinën nga “City Beautiful Movement” (Levizja për Qytete të Bukura) në SHBA e cila pati fillesat në fund të shekullit 19’ si një vazhdimësi e teorisë së qytetit kopësht anglez. Në këtë periudhë kemi edhe aplikime të mirënjohura të arkitekturës moderne ku u aplikua kjo tipologji urbane si plani rregullues i Chandigarh në Indi i cili u projektua nga Le Corbusier në 1952, apo Brasilia projektuar nga Lucio Costa ne 1956(Ching et al, 2011;756). Në ish-Bashkimin Sovjetik, pas eksperiencës konstruktiviste e cila tregoi më tepër afinitet me arkitekturën racionale të bllokut funksionalist gjerman, aplikimet e para filluan në periudhën e regjimit stalinist, duke ju referuar fillimisht modelit perëndimor të pallatit borgjez të shekullit të 19’ e duke e përshtatur atë sipas ekonomisë së centralizuar. Disponibiliteti i truallit pa pagesë, nevoja për të ndërtuar me kosto të ulët, favorizuan rritjen e kesaj njësie urbane deri në përmasa ekstreme duke u kthyer në veçantinë karakterizuese të pejsazhit të qytetit socialist.



Fig.68. Foto ajrore e blloku të banimit. Tiranë 2020 (burimi autori)




Fig.69. Pjesë nga projekti për një Bar Bufe në hyrjen lindore të Kombinatit. Gen Plani 1:500. (burimi AQTN)

Bloku drejtkëndor i Kombinatit kompozohet me godinat e banimit të vendosura në perimetër, ndërsa brendësia përmban objekte shërbimi të nevojës së parë dhe objekte banimi që u shtuan më pas. I gjithë ky sistem bazohej në principin e arritshmërisë së shërbimeve pa përdorimin e mjeteve të transportit dhe në kohë sa më të shkurtër. Çdo “superbllok” është i rrethuar nga të gjitha anët nga rrugë automobilistike, ndërkohë që brendësia ka akses të rezervuar të automjeteve me rrugë shërbimi fundore. Shërbimet që pozicionohen në pjesën e brendëshme përfshijnë zakonisht kopësht/çerdhe, qendrën shëndetësore, shkollë fillore, etj., ndërsa qendra tregëtare apo “mapo” siç quhej në atë kohë, në rastin e Kombinatit gjendej e pozicionuar në perimetër nga ana e rruges kryesore në mënyrë që ti shërbente disa blloqeve (fig.69). Shërbimet e nevojës së parë në brendësi të blloqeve, shoqëroheshin me hapësira të bollshme publike të rezervuara për zhvillimin e jetë kolektive dhe për lojën e zbavitjen e moshave më të vogla të cilët mund të tutoroheshin fare lehtë prej banesave që zhvilloheshin në perimetër. Kështu edhe pse nuk egzistonte hapësira private, edhe në qytetin socialist mund të dallojmë një përshkallëzim në përdorimin e hapësirës ku dallojme atë me theks komunitar brenda njësive të banimit, si dhe atë monumentale e komemorative në shkallë qyteti. Ndërsa kjo e fundit prezantonte karakterin statik dhe distancimin e nevojshëm institucional, hapësirat brenda blloqeve kishte karakter më unitar dhe e zhveshur prej hierarkive. Këtu duhet theksuar se jo të gjitha blloqet urbane, përfshi dhe objektet brenda tyre, u ndërtuan me të njëjtën teknologji dhe cilësi. Diferencime të dukshme gjejmë ndërmjet godinave të ndërtuara në fillim nga krahu i shëtitorës dhe rrugës së Kavajës të cilat shërbyen për strehimin e specialistëve sovietikë dhe atyre që ishin në pozicione drejtuese. Këto godina u ndërtuan me tullë dhe me finitura e paisje më të mira, në krahasim nga godinat e po të njejtit bllok që u ndërtuan në brendësi të zonës së banimit nga ana Jugore, të cilat u realizuan me blloqe betoni, pa finitura dekorative. Një pjesë e mirë e ndërtimeve në zonën e banimit janë kryer nëpërmjet kampeve të punës dhe shfrytëzimit të punës së papaguar.

Kompaktësia e zgjidhjes për blloqet qendrore të banimit dallon me zhvillimet urbane më në periferi të terrenit kodrinor. Aty banesat e ulëta në linjë tentojnë të ndjekin formën e terrenit duke shoqëruar izoipset e duke krijuar disa terracime. Ndërsa në dy blloqet qendrore raporti me natyrën shprehet në një formë më kolektive me parqet e projektuara në brendësi të bllokut, në zhvillimet periferike solemniteti i parkut qëndror të bllokut shpërbëhet në kopështe të vogla me përdorim individual, karakteristike kjo e hasur në zonat më rurale. Me planin sovjetik, në frymë të ngjashme me “qytetin kopësht” në këtë zonë planifikoheshin vila të bashkangjitura me oborr, të cilat si në rastin e Maliqit do të përbënin një tipologji banimi të ndërmjetme mes fshatit dhe qytetit. Këtu familja përveç punës në fabrikë mund të përdorte territorin për bujqësi apo mbajtje kafshësh. Ndërkohë që implementimet e mëvonëshme, shfaqin braktisjen e tipologjive individuale në favor të banesave individuale të vendosura në rradhe, të cilat u implementuan në grupe me 4-5. Duhet vënë në dukje se tendenca për mos të ndërtuar njësi banimi individuale qoftë edhe në zona rurale, do të verifikohet edhe më vonë në qendrat e banuara të ndërtuara gjatë socializmit në Shqipëri, pasi kolektiviteti tregoi të ishte forca kryesore e sistemit. Në foton e mëposhtme është sjelle zona e Gastronomit nga eliografia e projektit Sovjetik mbi të cilën janë hedhur ndërtesat e faktit (fig.70). Vihet re shkrirja graduale e zonës urbane duke krijuar vazhdimësi nëpërmjet atikulacioneve të vizatimit të pejsazhit, ndërkohë që interpretimi projektit përcakton një kufi të qartë me objekte në seri pa kurrfarë diferencimi e artikulimi të kontaktit me natyrën.



Fig.70. Pjesë nga projekti Sovjetik, Sheshi i Gastronomit. Gen Plani 1:500. (burimi AQTN)

Fig.71. ish-Hoteli i beqarëve dhe qendra shëndetësore. Tiranë, Gusht 1957. (burimi: AQTN)

Sheshi i dytë, i ashtuquajtur “Gastronomi” gjendet në brendësi të zonës së banimit dhe përbën qëndrën civile e cila duke gjykuar prej fotove, duket se ka qënë ndërhyrja e parë ndërtimore në Kombinatin. Ai konturohet prej një ndërtese 4 katëshe e cila përmbante hoteleri dhe shërbime në katin përdhe, ndërsa në krahun jugor i bashkangjitet edhe qendra shëndetsore. Hoteli njihej me emrin “i Beqarëve” pasi strehonte kryesisht stafin e ri të fabrikës, para së të krijonin familje e të shpërnguleshin në apartamente (fig.71). Krahu lindor i sheshit konturohet prej objektit të shkollës dhe zonës së arsimit të përgjithshëm, e cila sipas projektit Sovietik shtrihet drejt lindjes duke ndarë zonën e banimit intensiv prej periferisë. Në krahun jugor të sheshit është paraqitur një strukturrë e cila mbyll aksin në mënyrë të ngjashme me godinën e Universitetit Politeknik në Tiranë por që nuk u ndërtua në realitet dhe nuk egzistojnë të dhëna apo projekte më specifike. Nga forma urbane e vizatuar, por edhe analizat lidhur me sheshin e hyrjes në fabrikë e përmbajtjen standart të qytetit socialist që është analizuar në kapitullin e mëparshëm, mund të hamendësojmë së bëhej fjalë për Pallatin e Kulturës. Vetëm nga fillimi i viteve 80’ në këtë pozicion u ndërtua një

lulishte me emrin “1 Maji”, ndoshta sipas një ideologjie komunikuese sërisht me Tiranën ku lulishtja me të njëjtin emer u pozicionua në zonën më historike të qytetit.

Komunikimi i unifikuar gjuhësor gjendet në thelb të projektit për ndërtimin e qytetit industrial. Si ndërtesat publike, ashtu edhe residencat bëhen pjesë e kësaj strukture organizuese e cila nëpërmjet përdorimit të stilit arkitekturor, kërkon të përçojë imazhin e një shoqërie të bashkuar me udhëheqjen në kryerjen e proceseve industrializuese. Objektet e banimit, në dallim prej atyre publike, mbajnë një lartësia konstante prej dy katesh të mbuluara me një çati të ulët që hidhet pak përtej fasadës (fig.72). Monotonia e horizontalitetit thyhet vetëm nga një dualitet kulmesh në qendër të fasadave të shtrira, të cilat kurorëzojnë dy lozha të vogla të ngrëna në volum porsid dy sy. Ky episod tepër familjar për Kombinatin, është i vetmi deviacion brenda uniformitetit të përgjithshëm të fasadës që karakterizohet prej një rregullshmërie të shpërndarjes së dritareve me akse afërsisht 4 metra. Perimetri i bllokut kufizohet nga ky tip banese e cila përsëritet edhe në versionin e saj linear, duke theksuar një perde të relativisht të mbyllur me hapje të ngushta çdo 50 metra (fig.73).



Fig.72- Pamje nga rruga e Kavajës. Tiranë, Kombinat 1959.(burimi: AQTN); **Fig.73-** Godina tip 18. Tiranë, Kombinat 1959.(burimi: AQTN);

Arkitektura e banesës shfaqet racionale dhe pa eksese nga pikëpamja dekorative në fasadat nga rruga dukë bërë që zona e banimit të ngjajë si një mur i unifikuar në funksion të debutit fuqiplotë të sheshit monumental. Ndërsa brendësia e bllokut është diçka tjetër. Elementi më i rëndësishëm në krahun e brendshëm bëhet shkalla kondominiale, e cila vazhdon të ruajë në mënyrë dinjitoze dimensionin publik si përse i përket hapësirave zemërgjera, po ashtu edhe trajtimit arkitektonik(fig.74). Në projekt duket një stol i gurtë i cili vendoset pranë hyrjes duke theksuar prezencën prej ngritjes së hapjes në pjesën e sipërme. Sërisht këtu takojmë motivin dual të harqeve që ndriçojnë hyrjet e apartamenteve. Këtu vëmë re edhe debutime me ballkone me balaustra e dekore klasike, të cilat i japin fasadës një shije tepër mesdhetare (fig.75). Trajtimi i bllokut të banimit në këtë periudhë ishte ende nën influencën estetizuese të klasiçizmit socialist ku imazhi i ambientin urban predominonte ndaj orjentimit dhe funksionalitetit. Kështu godinat tip konturojnë hapësirën urbane duke u rrotulluar e pasqyruar në plan, pa marre parasysh kushtet specifike tipologjike, por futen edhe këto në një debutim të përgjithshme që ka për kryefjalë formën.



Fig.74. Godina tip 18-këndore, pjesa brenda bllokut. Tiranë 2010 (burimi: autori); **Fig.75.** Detaj ballkoni. Tiranë 2010 (burimi: autori)

Referuar dokumentacionit në dispozicion, projektet e banesave të veçanta janë punuar nga zyra qendrore e quajtur “Drejtoria e Projektit” e atashuar pranë Kryeministrisë, e cila siç është shprehur më parë, kish grupuar specialistët më të mirë të kohës. Arkitekti Skënder Luarasi shfaqet si autor për pjesën e masterplanit dhe trajtimin e objekteve të veçanta në zonën e banimit. Banesat familiare me apartamente tip.18, janë objektet këndore të bllokut të banimit të cilat mbajnë firmën e tij. Për sa i përket organizimit planimetrik (fig.76,77), objekti Nr.18 paraqet karakteristikat tipologjike të godinave me apartamente të organizuara në linje me seksione të veçuara me thellesi 10.5 m. Kjo zgjidhje i jep përparësi kryesisht kostos së ndërtimit dhe mund të ndërtohet lehtë pa paisje e teknologji. Seksionet e ndryshme janë organizuar me nga 3 apartamente në kat ku spikasin kryesisht apartamentet me 3 kthina njëra prej të cilave kuzhinë dhe tualet. Apartamentet organizohen përgjithësisht në dy drejtime, ndërsa njëri përballë shkallëve merr dritë nga një drejtim. Nga pikëpamja distributive, arkitekti është kujdesur të pozicionojë kuzhinat nga ana e brendëshme e bllokut ndërsa tualetet janë organizuar në brendësi të seksionit me një zgjidhje pa ndriçim, por të paisura me vaskë që nuk ishte standart për atë periudhë. Një koridor i vogël bën shpërndarjen nëpër dhoma duke u kujdesur që të gjendet gjithmonë një hapësirë pranë hyrjes për lënien e rrobave të punës apo veglave. Kthinat janë të dimensionuara ngushtë në plan me sipërfaqe 60 m² për tre kthina dhe 80 m² për katër kthina, ndërkohë që variojnë në lartësi apartamentet e katit përdhe më atë të katit të parë. Prezenca e oxhakëve vetëm në korespondence të nyjeve higjienosantare nënkupton faktin se që në fillim ngrohja e tyre u mendua sipas një sistemi të centralizuar me avullin që vinte nga fabrika. Ndërkohë që ka gjithashtu të dhëna se apartamentet e para kanë qenë të paisura edhe me sistem audio të lidhur direkt me radion e fabrikës. Por në vazhdim nuk u mbajt e njëjta cilesi edhe pse projektuesit mbetën të njëjtë. Nga krahasimi me tipin tjetër linear, vërejmë krahas shenimeve për mundësinë e realizimit të ndërtimit me blloqe betoni, ashtu edhe ripozicionimin e oxhakëve në një pozicion më qendror në mënyrë që ti përgjigjeshin nevojave për ngrohje individuale.

Historia tregoi se ruajtja e një standarti të njëjtë për të gjitha godinat e banimit, ishte një sfidë e madhe për ekonominë e centralizuar. Kështu nevoja në rritje për banim, ndërkohë që financimet ishin të destinuara kryesisht për ndërtimin e fabrikave, orjentoi vendimarrjen drejt ndërtimit më të shpejtë dhe ekonomik. Në dallim prej

godinave të ndërtuara më mure tulle në fazën e parë deri 1952 të cilat konturojnë aksin qendror, faqet e brendëshme të blloqeve u ndërtuan me të njejtin tip arkitekturor, por të egzekutuar sipas një varianti të projektit fillestar i cili parashikonte realizimin me blloqe betoni. Këto ishin godina që u shpërndanë për një klasë më të ulët punonjësish, në krahasim prej banesave të tullës tæk të cilat ka evidenca se strehohej kryesisht stafi sovjetik (fig.78). Zgjerimet dhe dendësimi që ju bë vitet e mëvonëshme qendrës së banuar të Kombinatit, nuk paraqet më të njëjtën dëshirë dhe optimizëm në projektimin dhe ndërtimin e qytetit, siç hasim në periudhën e parë 49'-52'.




Fig.76. Tipologji banimi nr.18. Plan i katit te parë. Ark. Skënder Luarasi. Drejtoria Projekti. Tiranë 1952. Burimi AQTN



Fig.77. Tipologji banimi nr.18, fasadat. Ark. Skënder Luarasi. Drejtoria Projekti. Tiranë 1953 Burimi AQTN




Fig.78. Tipologji banimi nr.18' – Varianti i projektit të tipit “linear” me shenimet për ndryshimet në lidhje me tipin e vitit 1952 (shënim autori). Plan i katit përdhe. Autor: Skënder Luarasi. Drejtoria Projekti. Tiranë 1954. Burimi AQTN

4.5. Zona industriale

Zona industriale e Kombinatit të Tekstileve fillon punimet për ndërtimin paralelisht me zonën e banimit në vitin 1949. Me një shtrirje prej afro 30 hektarësh, sipërmarrja dukej vërtet kolosale për vendin e varfëruar të pasluftës. Akademia e Shkencave, në një shkrim propagandistik mbi historinë e ndërtimit socialist të Shqipërisë në periudhën 1944-1975, vlerëson fabrikën e tekstilit si një sukses të madh të sistemit i cili kish ditur të adresonte problematikën e plotësimit të nevojave për veshje të popullatës brenda një kohë të shkurtër. Aty shprehen se: “Industria e tekstilit dhe e veshjeve e rriti prodhimin e saj 40 herë kundrejt 1950 dhe 42 kundrejt 1938. Ndërtimi i kombinatit të tekstilit të pambukut 'Stalin' me një kapacitet prej 20 milion metra linear në vit dhe fabrika e leshit me një kapacitet prej 1 milion metra linear në vit, hodhi themelet moderne të kësaj industrie dhe solli një përmirësim rrënjësor në prodhim”(Akademia e Shkencave, 1988; 137). Luigi Za, përshkruan evolucionin e zonës industriale nëpërmjet intervistave me protagonistë të kohës të cilët shprehen: “Pas kompletimit, në vazhdim të viteve, Kombinati Stalin kishte 13 fabrika, por filloi me tre më të rëndësishmet dhe ofiçinat e suportit. Kompleksi u krijua në tre faza: në fazën e parë, 1950-51 u ndërtuan tre fabrikat kryesore, në 1956 u bë zgjerimi me tre fabrika të tjera gjithmonë me ndihmën e rusëve; në vitet shtatëdhjetë, kur mbërritën kinezët, u ndërtuan dy fabrika të tjera ku punoheshin stofrat e holla. Pas makinerive të para që u siguruan me shkëmbim në natyrë, apo dhuruar prej rusëve apo jugosllavëve, pas viteve shtatëdhjetë ndërmarrja filloi një strategji të re: nuk u ndërtuan më fabrika të reja, por u importuan makineri të reja [...]”(Za, 2012; 61). Por teksa fabrikat u ndërtuan me ritme të shpejta, problemi kryesor mbetej sigurimi i lëndës së parë. Pambuku importohej fillimisht nga BS dhe më vonë prej Egjiptit. Në vijim të sistemit pati gjithashtu përpjekje për të ngritur industrinë e prodhimit vendas, por ai nuk mund të mbulonte kurrësi kapacitetin e prodhimit të fabrikave, duke bërë që prodhimi të mbetej i lidhur ndaj ritmeve të importit të lëndës së parë.

Por pavarësisht vështirësive objektive të prodhimit dhe efektivitetit ekonomik të sistemit për të cilat është diskutuar në kap.3, një sipërmarrje të tillë siç ishte Kombinati i Tekstileve pati më tepër rëndësi simbolike nga pikëpamja e aplikimit të një shembulli që do të egzekutonte në praktikë ideologjinë komuniste e cila deri në këtë moment, nuk kish krijuar ende shembujt e saj material në Shqipëri. Kjo justifikon

preokupimin e vazhdueshëm formal i cili ashtu si tek hapësirat urbane, gjen vend shprehje edhe brenda zonës së punës. Arkitektura industriale e realizmit socialist, konsideron formën e shprehjes monumentale si një artefakt të veçuar i cili mund ti bashkangjitet si skenografi kapanoneve tip të prodhimit duke krijuar skena të tipit urban më tepër se të lidhura me prodhimin. Nga pikëpamja formale në Kombinatzona industriale shihet si një zgjatim i qendrës së banuar. Hapësira e prodhimit monumentalizohet duke dashur të ofrojë eksperiencatë një dimensionit hapësinor urban ideal, të cilin për nga madhësia nuk mund ta ofronte qendra qytetare. Kemi të bejmë me një lloj institucionalizimi të arkitekturës së fabrikës në qytetin socialist, ku shfaqet roli i veçantë që kishte njëësia e prodhimit në përhapjen e propagandës.





Fig.79. Planvendosje e zones industriale me indikacione për ndërtimin e dy fabrikave të reja për stofrat e holla. Pjesë nga projekti sovjetik. Moskë 1960. Burimi: AQTN; **Fig.80.** Gen-plan shk. 1:500 sipas redaktimit shqiptar. Tiranë 1981. Burimi AQTN

Struktura e zonës industriale i përgjigjet proceseve të prodhimit që do të zhvilloheshin në të. Pavarësisht implementimit me faza vihet re se, në ndryshim prej qendrës së banuar, zona industriale i përgjigjet në vazhdimësi vizatimeve fillestare Sovjetike (fig.79;80) Impianti i prodhimit organizohet prej një rrjeti ortogonal aksesh të shpërndarjes së brendëshme i cili merr fillimin prej hyrjes monumentale në sheshin Garibaldi. Vihet re një organizim me 3 fasha që shtrihen paralelisht nga lindja në perëndim. Fasha më e gjerë pozicionohet nga qyteti dhe rrjeshton repartet e prodhimit që u ndërtuan në fazën e parë e që u inaguruan në nëntor të vitit 1951. Ato ishin tezgjahu, ngjyrosja dhe fabrika e filaturës. Dy fashat e brendëshme aksesohen edhe nga hekurudha dhe janë destinuar për hapësirat e “backup”, si magazinat për sejcilin proces, ofiçina, marangozeri, etj. Në krahun më perëndimor të fundëm pozicionohet godina e termocentralit bashkë me strukturat ndihmëse për prodhimin e energjisë. Në fazat e mëvonëshme, fashat perimetrale u përdorën edhe për ndërtimin reparteve të reja të prodhimit siç ishte fabrika e kadifes në 1956 së bashku me fabrikën e leshit. Ndërsa në fillim të viteve 70’ Kombinatit i shtohet fabrika e stofrave të hollë e cila parashikohej gjithashtu prej projektit Sovietik, por që nuk ishte implementuar që në fazën e parë. Ndërsa pas vitit 1975 pas shkëputjeve së marrdhënieve me Kinën dhe fillimit të periudhës së vetëmjaftueshmërisë, u shtua vetem fabrika e spangos më një projekt të vitit 1976 e që u vu në funksionim në fund të dekadës. Ndërsa gjatë viteve 80’ u bënë kryesisht zgjerime të godinave egzistuese, siç ishte zgjerimi i fabrikës së leshit, zgjerimi i fabrikës së leshrave të holla si dhe zgjerim i tezgjahut Nr.1 me projekte të vitit 1981. Gjykuar prej moshës dhe përfaqësueshmërisë së tipareve të periudhave të ndryshme kur u zhvillua arkitektura industriale gjatë periudhës së socializmit në Shqipëri, pavarësisht degradimit Kombinatit Tekstil përmban një nga koleksionet të plota.




Fig.81. Fabrika e tezgjahut. Tiranë ~1960. Burimi: AQSH

Solemniteti i sheshit qëndror Garibaldi, trasmetohet edhe brenda fabrikës nëpërmjet aksit qëndror të zonës industriale (fig.81). Aksi i hyrjes në fabrikë vijon drejt një parku linear i cili zgjatet në brendësi të zonës industriale, duke penguar shikimin direkt nga sheshi qëndror në fabrikë nëpërmjet hyrjes monumentale. Parku linear shfaqet si një zgjidhje e nevojshme nga pikëpamja ambientale për kufizimin e zhurmave të fabrikës së tezgjahut nëpërmjet barrierës së gjelbërt, ndërkohë që mbante edhe një rol të rëndësishëm nga pikëpamja sociale pasi ishte zona e pushimit dhe e shkembimeve njerëzore përtej zinxhirit të prodhimit. Siç dëshmohet prej punonjësve “ Edhe mirëmbajtja e rrugëve të brendëshme i ishte besuar një grupi të

posaçëm, ishte edhe dikush që merrej me lulet, emri i të cilit më tingëllonte i pështatshëm për punën që bënte, Zizi, një personazh i famshëm që kujtohet ende sot me përmallim” (Za, 2012; 63). Sot parku egziston si hapësirë por me përjashtim të disa pemëve të larta të mbetura ende, nuk egzistojnë më gjurmë të pejsazhit të dikurshëm. Duke vëzhguar projektin sovjetik (fig.79) ai na paraqitet si i paisur me një pasazh qëndror i artikuluar në vijimësinë e tij me episode të rreshtuara të cilat krijohen në korrespondencë me hyrjet e fabrikave për një gjatësi prej 400 metrash, sikur për të dashur të shndërrojë intenerarin drejt vendit të punës në një shëtitje në qytet. Ndërsa nga pikëpamja funksionale, kjo skemë levizje siguron ndarjen e qartë të aksit të lëvizjes së këmbësorëve, prej rrugës automobilistike për mjetet e rënda e cila pozicionohet më në afërsi të fabrikave. Prezenca e parkut në brendësi të zonës industriale, është një dëshmi e përdorimit të dizajnit të pejsazhin si gjuhë unifikuese krahas arkitekturës, për të krijuar një tërësi të pa ndarë me zonën e banuar. Si përgjatë aksit veri-jug, po ashtu përgjatë rrugës së Kavajës, lulishtet lineare orjentojnë punëtorët drejt hyrjes së fabrikës, duke i dhënë kështu Kombinatit pamjen e një qyteti të gjelbërt (fig.82).



Fig.82. Ish-zona industriale, foto ajrore nga hyrja monumentale. Tiranë 2021. Burimi: Autori

Prezenca e parkut dhe për pasojë spostimi i vijës së ndërtimit të fabrikave drejt veriut, shihet gjithashtu si një oportunitet vizual me efekt surprizues, që i lejon fabrikave të shfaqin një pamje në perspektivë e duke i bërë ato më të lexueshme në momentin e hyrjes. Vihet re gjithashtu një lloj kujdesi për të diferencuar sejcilën prej fabrikave por duke ju referuar të njejtës tematikë tashmë të njohur. Koncepti i kolonadës me harqe përdorur në lozhën e Shkollës së Kuadrove, gjen vend edhe në stukturimin vizual të zonës industriale, duke theksuar nëpërmjet ballinash monumentale, momentin e hyrjes në sejcilën prej tre fabrikave që u ndërtuan në fazën e parë 1949-56. Kështu fabrika e tezgjahut në fasadën jugore prezanton një hyrje monumentale me një lozhe e cila strukturohet nëpërmjet 9 harqesh të plota të vendosura në pozicion qëndror (fig.85). Në krahasim me dy objektet e tjera, tezgjahu që ishte edhe fabrika më e madhe me nje siperfaqe prej 20.000 m², në përshtatje edhe

me procesin e mundimshëm por edhe rëndësinë për prodhimin, prezanton një fasadë më të plotë me lozha më të rralluara, për të krijuar një efekt qëndrueshmërie të shtuar. Në vazhdim të aksit në perëndim të fabrikës së tezgjahut, fabrika e ngjyrosjes (fig.83) shfaq një front më të ngushtë e të përqendruar i cili strukturohet arkitektonikisht në formën e një tempulli me një lozhe me 3 harqe të plota të cilat kulmojnë me një timpan qëndror. Vetë procesi i ngjyrosjes së tekstilit nënkuptonte triumfin ndaj sfidës së prodhimit bazë të pëlhurës që sigurohej prej fabrikës pararendëse.



Fig.83. Ish-fabrika e ngjyrosjes. Tiranë 2021. Burimi: Autori; **Fig.84.** Ish-fabrika e filaturës të stofrave të holla. Tiranë 2021. Burimi: Autori; **Fig.85.** Ish-fabrika e tezgjahut. Tiranë 2007. Burimi: Autori.

Aksi kryesor i zonës industriale mbyllet nga fabrika e përpunimit të leshit e cila mendohet të jetë ndërtuar e fundit, rreth vitit 1956 (fig.84). Hyrja monumentale e saj prezanton një zgjidhje më të artikuluar nga pikëpamja volumore se dy fabrikat e tjera, duke siguruar një akses anësorë në kaponin e prodhimit, ndryshe nga hyrjet qëndrore të dy fabrikave të tjera. Kjo vjen për shkak të prevalencës që kishte ngritja e stukturës hapësinore monumentale, siç ishte nevoja për një mbyllje sublimë të parkut, e cila shpesh kushtëzonte çdo veprim proporcional për zbritjen në distanca më

njerëzore të kufirit vizual të zonës industriale, duke konsideruar që shtrirja efektive e saj vazhdoi ende me fabrikën e stofrave të holla në perëndim. Zona administrative e fabrikës së leshit zhvillohet rreth një oborri të brendshëm tip ‘patio’, i cili hapet nga ana e aksit qëndror nëpërmjet një lozhe simetrike me tre harqe. Ky objekt, ndryshe nga dy godinat e tjera prezanton një zgjidhje me fasadë transparente e me mbyllje graduale të aksit monumental i cili depërton volumin duke krijuar oborrin e brendshëm. Kjo zgjidhje nga pikëpamja e raportimit me proceset e prodhimit nuk lejon analiza të ngjashme me dy fabrikat e tjera, por në këtë rast mbizotëron roli simbolik i mbylljes së aksit mbi karakterin formal në komunikim me procesin. Objektit kësaj here i bashkangjiten edhe dy kulla të shkurtra të tërhequra, të cilat ngrihen lehtë mbi volumin në formë “C”, duke vënë në dukje komunikim gjuhësor me drejtorinë dhe mencën në krahun tjetër të aksit. Nga pikëpamja e intersektimit volumore të masave horizontale dhe vertikale, gërryerja qëndrore rimerr tematikën e lozhës, por edhe nga çarjet në fasada të cilat ripersërisin temën e përgjithshme të dritareve me qemere të harkuara.

Investimi i fazës së parë në Kombinatin Tekstil finalizohet me ndërtimin e termocentralit, i cili u bë njëkohësisht dhe shkaku i ndryshimeve të projektit të parë të vitit 1947 (fig.86). Rendësia e impiantit të prodhimit të energjisë ishte fundamentale në funksionimin e industrisë së tekstit dhe vetë egzistencën e qytezës e cila ishte e detyruar të bashkjetonte me një burim ndotje të konsiderueshëm. Ish-protagonistë të asaj periudhe e kujtojnë në këtë mënyrë: “I ndarë, por i integruar me kompleksin industrial të cilin furnizonte me energji, ishte centrali i madh termoelektrik me funksionin e furnizimit me energji elektrike dhe avull të industrisë tekstile, por edhe ngrohjen e banesave, të paktën për vitet e para. Ai furnizohej me qymyr, duke djegur nga 350 deri 400 ton mineral në ditë, pra shume ndotës dhe me efekte që në ditë të caktuara mbulonin edhe Tiranën; ka funksionuar pa ndërprerje, ditë dhe natë, për dyzetedy vjet (1951-1993)”(Za, 2012; 64). Termocentrali furnizohej me lëndë djegëse nëpërmjet linjës hekurudhore, sipas një sistemi të automatizuar me rripa transportierë të cilat kryenin si furnizimin me mineral, ashtu edhe nxjerrjen e skorrjeve. Zona e trajtimit të lëndës së parë pozicionohet në perimetrin veror, ndërsa impiati elektrik pozicionohet në brendësi të zonës industriale nga ana jugore.




Fig.86. Plan i Termocentralit. Pjesë e projektit të rikonstruksionit të vitit 1990. Tiranë. (burimi: AQTN)
Fig.87. Kulla e ftohjes (kopje nga origjinali). Tiranë 1968. (burimi: AQTN)

Në këtë zonë karakteri horizontal i impiantit industrial, thyhet ndjeshëm nga një dualitet vertikal që paraqitet mes kullës së ftohjes e ndërtuar si cipë betoni në krahun jugor, dhe oxhakut të kuq me tulla që ngjitet mbi godinën e termocentralit në

pjesën veriore (fig.87). Ky ishte fundi i qytetit i cili mbyllej me elementët më karakteristik të pejsazhit të qytetit industrial socialist. Nga pikëpamja arkitekturore, zona fundore në këtë rast nuk u gjykua si e tillë për nga rëndësia, përkundrazi kërkon edhe kjo një tematikë monumentale të sajën të lidhur me propagandën e cila shpreh trajtat e një kështjelle që ngrihet me 3 nivele mbi pejsazhin bujqësor që zhvillohet në pjesën perëndimore. Shprehja arkitektonike e fasadave tejkalon kërkesat e karakterit teknologjik që karakterizojnë zakonisht ndërtesa të këtij tipi. Termocentrali është një ndërtesë me konstruksion metalik dhe fasada tulle të kuqe të punuar me dekore prej të njejtit material të lëna në dukje. Është e vetmja ndërtesë në të gjithë pjesën historike ku gjejmë përdorimin e tullës në dukje (fig.88;89;90). Dritare të dublikuara të cilat evidentohen më tej nëpërmjet thellimeve me korniza tulle që i organozojnë ato në vertikalishtet, skanojnë të gjithë perimetrin vertikalisht duke përfunduar, si në rastin e objektit të administratës, me qemere të harkuar që ndjekin kornizën e ndërtesës në mënyrë ritmike. Njëjtë si me rastin e fabrikës së tezgjahut, edhe kjo pjesë e zonës industriale vuan sot pasojën e lënies në harresë dhe degradimin e thellë që po çon drejt zhdukjes një komponent të rëndësishëm të historisë së industrializimit.




Fig.88-90. Termocentrali elektrik. Tiranë 2007. Burimi: Autori.

5. SFIDAT DHE PROBLEMATIKAT KRYESORE TË ISH-QYTETEVE SOCIALISTE

Historia e qyteteve të reja socialiste në Shqipëri, dëshmon se shkaku kryesor i krijimit të tyre përbën shpesh edhe arsyen e kontraktimit dhe rënies së tyre të mëvonëshme. Mund të thuhet se këto qytete ishin tejet të ngjashme ndërmjet tyre si për nga struktura e tyre urbane, po ashtu edhe arkitektura. Ato gati ishin konceptuar në mënyrë identike shpesh duke anashkaluar krejt çështje të gjeografisë, topografisë apo ato kulturore dhe siç edhe analizuam me rastin e Tiranës dhe veçanërisht Kombinatit, implementimi i modeleve shpesh orjentohej prej zgjedhjesh politike momentale e që nuk përkuan me zhvillimet ekonomike të mëvonëshme. Nga ana tjetër, pamundësitë ekonomike dhe zvarritja e proceseve të industrializimit, lejuan mundësinë e krijimit të vetëm pak prototipeve, të cilët më shumë se shëmbuj zhvillimi, i shërbyen propagandës e cila e promovonte si një standart të arritur në fushën e zhvillimit urban dhe emancipimit shoqëror. Ky proces homologimi i territoreve urbane, pasojë e centralizimit të politikave dhe prodhimit, bëhet më i dukshëm në vitet që pasojnë eksperiencën e veçantë me ndërtimin e Kombinatit Tekstil Stalin. Në vijim të viteve '60, standartizimi dhe tipizimi i ndërtimeve, fragmentuan dhe asgjësuan përfundimisht tendencën për të zhvilluar një temë urbane totale, qoftë kjo e lidhur me propagandën, e cila karakterizoi fazën e parë të aplikimit, atë të arkitekturës staliniste. Në ndryshim nga Tirana, i vetmi ndryshim arkitekturor që binte në sy në qytete me periferike, ishte cilësia e ulet e ndërtimit dhe rifiniturave. Ky fakt, konstatohet edhe nga pushteti i asaj kohe. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.447 datë 15.12.1962 “Mbi punën e Komiteteve Ekzekutive të Këshillave Popullor të qyteteve dhe mbi masat që duhen marrë për formimin e tyre të mëtejshëm” në pjesën e dytë “ndërtimi dhe dekorimi i qyteteve” thuhet se “Komitetet Ekzekutive të Këshillit të Popullor të qyteteve duhet të tregojnë kujdes të vecantë për ndërtimin, rregullimin dhe dekorimin e qyteteve të tyre, duke qenë se qytetet shërbejnë si model për fshatin, dhe aty dallohet progresi që vendi ynë ka bërë në rrugën e ndërtimit socialist”. Gjithashtu theksohet se gjatë ndërtimeve të shumta që do të bëhen, duhet patur në mendje nevoja për të ruajtur sa më shumë tokën bujqësore të fermave. Për këtë qëllim në zonat qendrore të qyteteve të mëdha objektet duhet të ndërtohen me 3 deri në 4 kate dhe në periferi me 2 deri në 3 kate. Në zonat malor, objektet lejohen të ndërtohen me 1 deri në 2 kate”. Siç treguan më vonë zhvillimet, në kushtet e një ekonomie të dobët, këto tentativa vunë më tepër në pah mediokritetin e sistemit për trajtimin e një kondite reale shoqërore, e cila prezantonte në mënyrë persistente gjëndjen reale në të cilën gjendej vendi. Në një pikë tjetër të vendimit theksohet se “ndërtesat me pamje të ngjashme duhet të shmangen në qytete sepse ato japin të njëjtin pamje. Pa e braktisur tipologjinë e projektit, duhet punuar për të ndërtuar ndërtesa me fasada të ndryshme, të bukura dhe në harmoni me ndërtesat e tjera dhe me rrugët. Jo të gjitha qytetet duhej të ndërtoheshin me të njëjtat ndërtesa dhe fasada. Aty theksohet se dekorimi i qytetit nuk duhet të jetë vetëm në qendër, organet drejtuese duhet të mendojnë se si të dekorojnë edhe lagjet, rrugët dhe çdo shtëpi të vetme. “Komitetet ekzekutive duhet të tërheqin sa më shumë aktivistë dhe njerëz të pasionuar për këtë problem, dhe për zbatimin e këtyre planeve duhet të tërheqin të gjithë popullatën e qytetit pa asnjë përjashtim nën sloganin “Sejçili prej nesh të zbukurojë shtëpinë e tij dhe të gjithë bashkë të dekorojme qytetin” (VKM 447,

1962). Në 1962 Revolucioni Kulturor ardhur nga Kina ishte në fillimet e tij. Slogane të reja me flamuj të kuq dhe simbole të tjera të komunizmit filluan të mbulonin ndërtesat e qyteteve të reja socialiste duke e kërkuar diferencimin në parrulla dhe mbishkrime të cilat u bënë të rëndomëta për çdo faqe kallakan apo fasadë kryesore. Dekorimi në fakt u shndërrua në një operacion të gjërë që pati për qëllim penetrimin e propagandës në çdo skaj të qyteteve. Por, rasti shqiptar në fakt paraqet ekstremet e dukurisë që u verifikua në të gjitha vendet e Lindjes. Sipas Czepczynski kur përshkruan situatën në Hungari, “planet madhështore dhe ambicioze rrallë u zbatuan plotësisht. Shkurtime të vazhdueshme në fonde, menaxhimi i keq dhe ndryshimet e papritura të prioritetëve, së bashku me vlerësimet e kufizuara, shndërruan shumicën e projekteve madhështore në gjysmë të realizuara. Shumë banesa nuk kishin shërbimet e domosdoshme: shumë pak nga qendrat e planifikuara të kulturës, ndërtesat administrative apo objektet sportive u përfunduan siç duhet. Një nga elementët karakteristikë dhe dallues të një qyteti socialist është pikërisht shpërdorimi i truallit urban, i cili shfaqet pothuajse në çdo qytet në forma të ndryshme”(Czepczynski, 2008; 69). Sigurisht që sistemi, siç kemi theksuar edhe më parë, ka pasur fazat e veta evolutive. Në Shqipëri, në fazat e para që kemi marrë nën analizë, mbizotëron zhvillimi i industrisë i cili do të mbetet prioritet për gati 3 dekada të karakterizuara nga një neglizhim në rritje të kushteve të zonave të banimit, karshi peshës financiare dhe morale që mori fabrika. Pra, në ndryshim prej qytetit industrial perëndimor ku kushtet për punëtorët u përmirësuan gradualisht, qyteti socialist sipas aplikimit shqiptar, njohu një rënie cilësore gjatë zhvillimit. Vonuar karshi vendeve të tjera të lindjes, vetëm pas viteve 80’ fillon një periudhë kur i jepet rëndësi komponentëve të tjerë urban dhe kryesisht me planet e qendrave ku vendin kryesor e marrin punimet për sheshin Skenderbej. Kostinskiy, duke ju referuar hapësirës sovietike thekson: “prioritet ju dha para së gjithash industrisë së rëndë, kundrejt ndërtimit të banesave dhe zhvillimit të infrastrukturës urbane. Vetëm rreth vitit 1960 filloi një fazë e re në zhvillimin urban: një vëmendje më e madhe iu kushtua ndërtimit të banesave dhe zhvillimit të shërbimeve”(Kostinskiy, 2001; 452). Lufta e ftohte dhe gara e armatimit patën një impakt të rëndë ekonomik për Shqipërinë e cila në vitet që pasojnë, do të shpenzojë energji të mëdha në fortifikimin e territorit, fenomen ky i quajtur ndryshe si “bunkerizimi”. Pikërisht tek këto politika, të cilat dalin përtej fushës studimore të shkencave urbane, por që efektet i kanë kryesisht urbane dhe territoriale, mbeten të ngulura thellë në strukturën dhe imazhin e qytetit socialist dhe shpesh përbëjnë edhe problematikat kryesore me të cilat përballet sot tranzicioni i tyre drejt ekonomisë së tregut. Prodhimi urban i kësaj periudhe për vetë mungesën e kapacitetit dhe paaftësinë për t’ju imponuar estetikisht dhe kulturalisht shoqërisë liberale, në vitet e tranzicionit hyri në një epokë ndryshimesh të pashoqe për botën perëndimore, të cilat karakterizohen nga një deformim i vazhdueshëm dhe pa rregulla të objektit, pare si produkt përfaqësues i një sistemi i cili nuk kishte patur kapacitetin për të gjeneruar dhe implementuar politika që do të shërbenin një të ardhmje më të qëndrueshme.

5.1. Ndërlikime në përcaktimin e qytetit socialist

Studime mbi qytetet socialiste në perëndim janë zhvilluar në faza të ndryshme, sipas ecurisë së historisë dhe momenteve kur ka patur zhvillime politike dhe kur interesi për njohjen e tyre ka qënë më i madh. Sigurisht që studimet mbi qytetin post-socialist filluan direkt pas rënies së murit të Berlinit dhe hyrjen në tranzicion të Bllokut Lindor. Jiri Musil në studimin e tij të vitit 1993, paraqet faktorët kryesor influencuan në zhvillimin e qyteteve socialiste dhe transformimet e tyre të mëvonëshme:

- Mosekzistenca e tregut të tokës dhe vendosja e çmimeve fikse për tokën, kështu që për përdoruesit - firmat dhe ndërmarrjet - vendosja brenda një qyteti si parametër ekonomik, ishte thuajse e parëndësishme;
- Menaxhimi qëndror dhe rregullatori i sektorit të banimit (kontrolli i shkëmbimeve të apartamenteve, blerja e shtëpive, qiraja dhe nën-qira) nga autoritetet lokale;
- Nacionalizimi i bazës ekzogjene dhe endogjene urbane, përfshirë tregtinë me pakicë dhe shërbimet; politikat për konsolidimin e tyre u bazuan në përfitimet e ekonomive të shkallës së lartë dhe lehtësirave menaxheriale;
- Nxitja e interesit publike mbi atë personal dhe interesat e një njësie territoriale më të lartë (shtetit) mbi ato të njësisë së nivelit më të ulët (nën-shtetëror).” (Kostinskiy, 2001; 452)

Ndërsa Kostinskiy, thekson më tej problematikën e mungesës së kohezionit midis pasurisë, tregut, individit duke listuar karakteristikat e tij të qyteteve socialiste në këtë mënyrë:

- kontroll shtetëror mbi përdorimin e tokës urbane;
- mungesë e plotë e pronës private;
- kontroll shtetëror mbi ekonominë e strehimit (financimi, realizimi i zhvillimit, shpërndarja e stokut të banesave dhe menaxhimi i tij);
- përdorim joekonomik dhe shpërdorimi i tokës, që rezulton nga mungesa e qirasë për tokën nën socializëm;
- organizimi i centralizuar i shërbimeve dhe furnizimit;
- zhvillim i limituar i shërbimeve dhe vendosja e lehtësive urbane pavarësisht nga struktura dhe vëllimi i kërkesës së tregut;
- dominimi i transportit publiku ndaj transportit privat;
- rëndësia ekskluzive e simboleve ideologjike në mjedisin urban, duke përfshirë stilin monumental arkitektonik të ndërtesave publike, duke nënvizuar theksin e vendosur mbi rëndësinë e veçantë të qendrës urbane” (Kostinskiy, 2001; 453).

Qytetet shqiptare në këtë drejtim ndryshojnë jo vetëm nga vendet e Evropës Perëndimore, por edhe nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe ato të ish-Bashkimit Sovjetik. Karakteristika dominante e qyteteve shqiptare është zbatimi i një diktature staliniste përgjatë gjithë kohëzgjatjes së sistemit, mungesa e një shoqërie civile dhe e strukturave të pjesëmarrjes lokale edhe pse regjimi e quante veten demokratik. Qytetet e reja industriale për të shmangur kosto të tepërta infrastrukture e transporti, u vendosën në zona të banuara dëndur duke rrezikuar shëndetin publik. Teknologjia e përdorur në këto industri ishte shumë e prambetur dhe degradoi me kalimin e viteve duke konsumuar vetveten brenda kohëzgjatjes së sistemit. Planet pesëvjeçare që organizonin ekonominë e centralizuar, ishin përqëndruar kryesisht në prodhim dhe kishin pak ose aspak hapësirë për mbrojtjen e mjedisit. Si pasojë, industrializimi i shpejtë dhe i përqëndruar shkaktoi degradimin gradual të mjedisit, shpesh duke kaluar edhe vendet më të industrializuara të Evropës Perëndimore. Obsesioni i regjimit me përmbushjen e planit, pa marrë parasysh se me çfarë kostoje, ishte vetë shkaku i kësaj përplasjeje me kontekstin natyror dhe shoqëror.

Ka shumë studiues të ndryshëm që e mohojnë ekzistencën e “qytetit socialist” si entitet të veçantë në arkitekturë. Sipas Smith argumentet e tyre bazohen në faktin se “qytetet e krijuara apo të modifikuara në mënyrë të konsiderueshme nën regjimin socialist, mund të kenë dështuar në reflektimin e parimeve dalluese socialiste, një këndvështrim i tillë mund të argumentohet. Për shembull, nëse në vend të familjes, komuniteti përfaqëson mënyrën e jetës socialiste, atëherë marrëveshjet e këtij lloji

karakterizojnë vetëm një pakicë të vogël të strehimit ekzistues në shumicën e qyteteve, madje edhe atëherë origjina dhe ruajtja e tyre ka të ngjarë të ketë qenë një rast më tepër si rrjedhojë i nevojës praktike se sa preferencë ideologjike. Nëse barazia në kushtet e banimit, cilësia mjedisore lokale dhe aksesit në shërbime është një aspiratë dalluese e socializmit, atëherë pejsazhi urban i njësisë strukturore urbane të planifikuar mund të përshkruhet bindshëm si socialiste. Megjithatë, koncepti i njësisë lagje me të gjitha shërbimet e integruara nuk është në asnjë mënyrë ekskluzive për Evropën Lindore dhe e ish-Bashkimit Sovjetik, ai mund të konsiderohet si simbol i zhvillimit urban të modernizmit. Një pamje më e gjerë e strukturës hapësinore urbane, me zona funksionale të planifikuara me kujdes, të lidhura së bashku me transportin e lirë publik, mund të sugjerojnë një rregull të llogaritur më mirë se sa në qytetin tipik kapitalist. Por ky element nuk përbën ndonjë veçanti thelbësisht dalluese, e cila mund të deduktohet vetëm nga parimet socialiste, të paktën jo më shumë sesa niveli i lokalitetit”(Andrusz et al, 1996;70). Lagjia, “mikro-rajoni” apo poli, pavarësisht prapavijës politike në konceptimin e tyre, në një interpretim më hibrid në kontekstin metropolitan bashkohor, shfaqin karakteristika sjellje të ngjashme që derivojnë prej bazës së urbanistikës moderne të fillim shekullit 20’. Ndërsa nuk duhet harruar edhe vlera studimore që mbart vetvetiu çdo operacion planifikimi. Sipas (Smith, 1996), kur merremi me qytetin socialist, çështja qëndron si tek interesi praktik por edhe akademik i tij, pasi qytetet e së ardhmes do të pasqyrojnë në një farë mase ato të së kaluarës - aq më tepër nëse ngurtësia e formave ekzistuese pengon procesin e ndryshimit. Pra, vleresimi i tyre është një problem më kompleks dhe i shtrirë në kohë që lidh si faktorë material ashtu edhe psikologjik. Teoricieni urban Marten Kuilman, shpjegon kompleksitetin e qyteteve nëpërmjet teorisë së mendimit filozofik katërshtresor. Në mbrojtje të teorisë së tij “kuadralektike” ai shprehet se: “disa qytete janë lindur në mendje. Shtrirja e një qyteti të tillë, siç jepet në përshkrime dhe vizatime, është një përpjekje e qëllimshme për të shprehur disa ide rreth jetesës dhe vendit të njeriut në këtë tokë. Subjekti i qyteteve ka konotacione të ngjashme me një mjedis quadrilectic, sepse nëpërmjet shumëllojshmërisë, avancimi dhe zgjerimi i mendimit mund të jetë më frytdhënës dhe efektiv”. Për të “zhvillimi i qyteteve në mendje është, në thelb, ‘i panatyrshëm’, sepse shumica e gjërave në natyrë rriten në një mënyrë ‘të natyrshme’. Njerëzit jetojnë në grupe, duke ndërtuar habitatet e tyre, siç kërkojnë rrethanat. Duhet të ketë një lidhje mes njerëzve, gjeografisë dhe qytetit në mënyrë që të funksionojë. Qytetet që lindin në mendje i sfidojnë këto rregulla (ose këtë komunikim), prandaj janë të mundshme vetëm kur zgjidhen bazat esenciale të bashkëjetesës si komunitet. Nga pikëpamja quadrilectike ekzistojnë katër lloje të qyteteve në mendje: (1) Qyteti Ideal; (2) Qyteti i së Ardhmes; (3) Qyteti Virtual; (4) Qyteti Quadralectic”. Kështu, sipas kësaj teorie “qyteti ideal është rezultati i një inventari psikologjik ku ‘më i miri nga të gjitha qytetet’ zgjidhet si numri një. Drejtimi në kohë është kryesisht pas (e cila është karakteristika kryesore e një inventari): ne i kemi parë të gjitha, dhe tani marrim më të mirën. Pavarësisht nga veprimet e nevojshme për të arritur qëllimin përfundimtar të ‘idealit’, rezultati i përgjithshëm është statik. Një zgjedhje (e vetme) është fundi i procesit krijues”. Më tej vazhdon me klasifikimin e tij “Qyteti i së ardhmes, nga ana tjetër, shikon përpara. Linjat e mundësive vijëzohen nga e tashmja në një moment në kohë, ku aspekte të caktuara të qytetit janë përmirësuar dhe përsosur. Prandaj, kërkimi për të ardhmen do të jetë dinamik, gjithmonë do të ketë më shumë: më shumë kohë, më shumë mundësi, më shumë njohuri dhe më shumë mundësi. Fantazia e pakufizuar për të arritur një identitet historik shpesh është një motivim i fortë për të hartuar këto lloje qytetesh. Një domosdoshmëri tjetër është një vullnet politik për të krijuar një vizion”. Ndërsa

“Qyteti Virtual – ndryshe nga një vend, i cili ekziston vetëm me aktualizimin - është sërisht një çështje statike. Elementet merren nga realiteti i dukshëm dhe vendosen së bashku në hapësirën kibernetike. Vizualizimet moderne kompjuterike janë në gjendje të krijojnë një botë të plotë virtuale, duke bërë që fotot të duken pothuajse më mirë se realiteti. Kjo botë virtuale ku dhe qytetet aty krijojnë botën e vet 'materiale dhe imateriale', të cilat nuk janë më të kënaqura me aspektet natyrore të botës” (Kuilman, 2011). Në lidhje me teorinë e tij, qyteti socialist shfaqet si një miks i këtyre tre karakteristikave të cilat marrin pesha të ndryshme sipas rastit: ishte një qytet ideal, një qytet i së ardhmes dhe njëkohësisht një qytet virtual. Kjo sepse fillimisht ishte një qytet në mendje, i drejtuar si në të kaluarën me tv cilën u raportua kryesisht oferta konkrete e sistemit të ri, por edhe në të ardhmen drejt së cilës aspironte gjithë kohës dhe në emer të së cilës kryheshin të gjitha sakrificat e aktualitetit. Gjithashtu u bë edhe një qytet virtual, kur u pa se realiteti i jetës së përditshme nuk ofronte shumë dhe propaganda përpigjej t’ju imponohej njerëzve si një realitet i mbivendosur virtual i cili shpesh krijon distancë të konsiderueshme prej realitetit fizik. Qyteti i sotëm, u përfaqësua në teorinë e Kuilman nga Qyteti Quadralectic, e cila shfaqet si një përmbledhje e llojeve të mëparshme të qyteteve të mendjes, të cilat krijojnë një realitet të ri bashkëveprimi teksa fuzionohen me kushtet konkrete. Ai merr parasysh katër ndarjet fillestare të realitetit fizik dhe meta-fizik duke e aplikuar këtë si metodë të veçantë leximi si pvr shkallën e qytetit, ashtu edhe arkitekturën. Është e qartë se një qasje e tillë mund të jetë vetëm dinamike. Ky përdor të gjitha pikështrimet e nivelit më të ulët të të menduarit dhe i shton pikëpamjen e vet më të gjerë. Sipas tij, “në momentin kur qyteti Quadralectic testohet në realitet, duket se zhduket. Thelbi i kuadrantit të katërt humbet kur shumëllojshmëria e ideve rreth formës (virtuale) merret nga fletët e vizatimit dhe u jepet ndërtuesve për zbatim. Qyteti është atëherë një Kuadranti i tretë, njësoj si të gjithë qytetet, që ekzistojnë sot.” (Kuilman, 2011).

5.2. Funkzioni dhe roli përfaqësues në arkitekturën e qytetit socialist

Një tjetër diskutim tek i cili egziston shumë debat rreth qytetit socialist, ka të bëjë me shkallën e ndërthurjes së anës funksionale me përmbajtjen ideologjike në urbanistikë dhe arkitekturë. Sipas Kuilman (2011), funksioni i një hapësire apo i një ndërtimi të caktuar ka një ndikim të rëndësishëm në konceptimin e tij arkitektonik. Ky funksion, i parë në një kontekst praktik ose monumental, me praninë e tij është ngulitur në strukturë. Një ndërtesë nuk është kurrë 'neutrale'. Çdo funksion do të thotë se 'pafajësia' e një ndërtese është e humbur. Siç thekson ai “aktiviteti njerëzor shpesh kërkon ndërtesa funksionale.[...] funksionaliteti gjithashtu, rritet me kërkesa më specifike të një hapësire apo ndërtese, në drejtim të evoluimit të aktiviteteve të caktuara njerëzore. Sheshi i qytetit dhe tregu janë "nevoja" urbane, ashtu si pistat ajrore, objektet sportive, fabrikat, etj. Ata kanë qëllimet e tyre për të ekzistuar dhe për t’u shfaqur”. Në fakt përdorimi i qytetit socialist u paraqit si diçka më e ndërlikuar se ndërtimi dhe pamja e tij e thjeshtë. Një ideologji e tërë paraqitej e integruar me aktin e themelimit të tyre, shpesh duke anashkaluar rëndësinë e çështjeve funksionale, pasi në rradhë të parë ishte përfaqësimi. Qytetet duhej të përfaqësonin fuqinë dhe ideologjinë e atyre që erdhën në pushtet. Në këtë dualitet midis funksionit dhe përfaqësimit ka pasur kryesisht rrisitë e veta stili stalinist në arkitekturën e qytetit socialist. Arkitektura e kësaj periudhe shërbeu si shëmbulli i parë integral i konfrontimit me shkallën e qytetit, dhe si i tillë tepër i qartë dhe i lexueshëm në qëllimet e tij. Czepczynski në studimin e tij mbi qytetin socialist, e lidh novacionin brenda stilit me historifikimin e realitetit dhe nevojën për monumente kur shprehet se “ 'risitë' stilistike, shoqëroheshin nga numri i monumenteve që synonin të bëheshin pika qendrore të projekteve të reja

urbane, duke i shtuar atyre tekste të kuptueshme. Monumentet madhështore u ngritën në nderim të Stalinit ndërsa ai ishte ende gjallë [...] Udhëheqësit lokalë konkuruan për të kënaqur mjeshtrat sovjetikë dhe riemëruan rrugë, sheshe, qytete dhe male me emrin Stalin ose me emrat e aleatëve të tij” (Czepczynski, 2008; 93). Ndërsa për Kuilman “prania e monumenteve tregon një dëshirë të njerëzve për të bërë një entitet abstrakt të dukshëm. Ideja fillestare e një monumenti është meditimi, qoftë adhurimi i paraardhësve, ndonjë akt heroizmi, tragjedi, apo thjesht për të pasqyruar domethënien e së kaluarës. Disa monumente moderne i kanë kaluar të gjitha këto faza për të bërë një deklaratë për të tashmen ose të ardhmen”, më tej vazhdon “përkufizimi i monumenteve në gjuhën e përditshme nuk është shumë i saktë. Një ndarje e trashë mund të bëhet në dallimin mes monumenteve të rastësishme dhe të qëllimshme. Lloji i mëparshëm përbëhet, për shembull, nga ndërtesa ose struktura të vjetra, të cilat janë 'monumente' në të drejtën e tyre. Vlerat dhe prania e tyre historike u jep atyre një arsye për meditimin. Përse kjo ndërtesë është akoma këtu, si i ka shpëtuar shkatërrimit nga natyra apo nga njerëzit? Ndoshta ishte e çmuar për arsyen e thjeshtë se njerëzit e pëlqenin ekzistencën e saj, ose më cinike, thjesht u anashkalua dhe humbi rrënojat e kohës për rastësi të fatit. Lloji i dytë është monumenti në kuptimin strikt: një veprim i qëllimshëm artistik i krijimit për të përkujtuar një ngjarje ose për të adhuruar një person ose ngjarje. Aspektet dualiste të masës (arkitekurore) dhe të pavlefshme vijnë përpara këtu: ata punojnë së bashku për të mbështetur 'monumentin' si kulminacionin e luftës së tyre të përjetshme” (Kuilman, 2011). Realizmi socialist në tentativë për t’u imponuar ndaj stileve të tjera, krijoi më tepër monumente të tipit të dytë, e për të siguruar superioritet shpesh dëmtoi rëndë apo asgjësoi ato monumente që Kuilman i përcakton si të kategorisë së parë. Në Shqipëri, ndryshimi i sistemit solli edhe një rikonceptim të vendeve dhe hapësirës, proces i cili është akoma në veprim edhe sot pas 30 vitesh. Një pjesë e monumenteve historike që i ish mohuar roli i tyre shoqëror duke i shkëputur apo alteruar me forcë përmbajtjen funksionale, kanë rifituar shpejt pozicionin e dikurshëm duke rikthyer vlerën reale historike. Por nuk mund të mohohet fakti se tentativa për t’ju mbivendosur kulturalisht traditës duke përdorur arkitekturën si argument të gjallë dhe shpesh duke e shkëputur prej përmbajtjes, ka shkaktuar shume dëme të riparueshme trashëgimisë kulturore të qyteteve shqiptare. Në vitet që pasuan aplikimin e stilit stalinist, forma arkitektonike u bë gjithmonë e më tepër eskkluzivitet i pushtetit duke krijuar një disbalancë akoma më të ndjeshme me pjesën tjetër të qytetit. Por teksa ndryshimet demokratike erdhën pas viteve '90, pikërisht ky prohibicionizëm i zgjatur, reflekton akoma pasojat në shoqërinë bashkohore me vështirësitë në dallimin e qartë të formës ndaj përmbajtjes. Në këto kushte, bëhet akoma më i nevojshëm konfrontimi i hapur me historinë e qyteteve të kësaj periudhe dhe konfrontimi i tyre me mënyrën e sotme të jetesës, duke përforcuar rolin e tyre edukues në funksion të një programimi më të mirë për të ardhmen.

5.3. Sheshet e qytetit socialist

Sërisht Kuilman (2011), gjatë aplikimit të teorisë së tij ‘quadralektike’ kryen edhe një interpretim të konceptit filozofik të sheshit duke ju referuar kuptimit të tij historic. Sipas tij: sheshi sugjeron, sipas vetë fjalës, një zonë katrore (square, nga anglishtja) apo drejtkëndore brenda një qyteti, por praktika arkitektonike është shumë më e komplikuar. Hapësira e hapur, që quhet "square", është në fakt një emër kolektiv për të gjitha llojet e shesheve të bëra nga njeriu, në forma dhe madhësi të ndryshme, të përshtatur brenda ose jashtë perimetrit të qytetit. Lidhja mes një sheshi dhe prejardhjes së tij të mundshme katërkëndëshe, ka për këtë arsye një karakter kompleks. Mund të thuhet, pavarësisht nga ky kompleksitet, që sheshi përfaqëson

'hapësirën e hapur' në një komunikim (midis qytetit dhe vëzhguesit) dhe për këtë arsye duket se drejtohet për tek 'Quadranti i Parë' (në terma quadralectic). Kjo përshtypje primare e 'boshllëkut' të sheshit të qytetit dhe lidhja e tij me padukshmërinë e dukshme mund të jetë vendimtare. Shumica e shesheve të mëdha në botë kanë dekorime skulpturore dhe / ose monumente. Sheshet e vogla dallohen për vendosjen e shtëpive në rradhë, kisha apo pallate, të cilat shënjojnë praninë e tyre. Përshtypja fillestare e boshllëkut duhet të rishikohet në procesin e vëzhgimit. Interpretimi i sheshit në kuptimin e një elementi me rëndësi publike, duhet të bëhet pjesë e një komunikimi më të gjerë - i udhëhequr nga zgjedhja e llojit të menduarit. Lidhur me Shqipërinë, veçanërisht me kryeqytetin Tiranë, transformimi i qendrës së qytetit ka shërbyer si një tregues i shkallës së zhvillimit në të gjithë vendin. Në shumë studime, Tirana zakonisht merret si një model për të treguar shkallën e zhvillimit në të gjithë vendin. Megjithatë ka ide kontradiktore se Tirana nuk mund të shërbejë si një tregues i matjeve, është ende e mundur të përdoren transformimet hapësirës përfaqësuese të Tiranës, për të dhënë një pamje të shkurtër të asaj që ndodhi në Shqipëri pas rënies së sistemit socialist. Duke iu referuar Rossit "përvoja e përbashkët konfirmon se studimet e thelluara pohojnë se: një qytet ndryshon plotësisht çdo pesëdhjetë vjet. Sigurisht, ka periudha të caktuara kohore në të cilat një qytet transformohet veçanërisht shpejt" (Rossi, 1982; 139). Kur Rossi flet për 'ndryshim', ai nënkupton të gjithë bashkësinë e vlerave që përfaqëson një qytet, përfshi ato materiale por edhe shoqërore. Periudha e tranzicionit modernist në Shqipëri ka kaluar nëpër disa etapa të lidhura kryesisht me ndryshimet e mëdha politike, të cilat kanë influencuar në mënyrën e raportimit të shoqërisë ndaj hapësirës publike. Kështu, mund të dallohen qartë në Shqipëri dy periudha të arkitekturës italiane: arkitektura eklektike në stilin e "novecento"-s italiane gjatë mbretërimit të Mbretit Zog, kur u përfunduan Kompleksi i Ministrive, dhe një periudhë e dytë e racionalizmit klasik që u zbatua kryesisht gjatë pushtimi fashist i viteve 1939-1943. Në këtë periudhë, arkitektura në Itali ndryshoi shumë në lidhje me stilin romantik dhe ringjallës të Brasini-t dhe Di Fausto-s. Tashmë doli në skenë një klasicizëm më i modernizuar e i pastruar prej dekorit e duke u orjentuar më tepër drejt plastikës volumetrike dhe arkitekturës së dritës e që mori emvrtimin racionalizëm.

Edhe pse mund të vërehen ndryshime të mëdha nga pikëpamja formale, si faza e parë ashtu edhe e dyta e arkitekturës italiane në Tiranë, u prek qartë nga një shprehje monumentalizuese tipike a arkitekturës totalitare. Ashtu si në Perandorinë Romake, ata po ndërtonin për përjetësinë dhe kjo demonstron me fiksimin për dimensionet e mëdha, përdorimin e simetrisë dhe materialeve të qëndrueshme të ndërtimit. Përveç kësaj, përdorimi i ikonografisë nocionaliste e më pas fashiste, ishte një mjet thelbësor identifikimi dhe komunikimi ndaj dhe drejt masave të popullsisë locale. Më vonë gjatë komunizmit, simbolet fashiste u zëvendësuan me ato komuniste dhe arkitektura u përshtat në mënyrë të përsosur. Në atë pikë, askush nuk po fliste më për arkitekturën fashiste, kishte vetëm arkitekturë socialiste dhe ndërtimet e periudhës italiane filluan një jetë të, apo më mire rilindën si të vjetëruara duke reflektuar një kornizë të re ideologjike. Për regjimin komunist "madhësia" nënkuptonte diçka të mirë, të fortë dhe të bukur, dhe ky nocion shkon gjithashtu në hapësirën përfaqësuese publike, e cila duhet të jetë e madhe mjaftueshëm për të mbajtur manifestime të lavdishme dhe të mbushura me njerëz. Më pare është analizuar Pallati i Kulturës i cili vërtet po përdorte lozhën si një tipar kryesor të komunikimit me sheshin para tij, por ndryshe nga propozimi i Bosio tek ndërtesa e GLA- sheshi Nënë Tereza, lozha tani qëndron e ngritur mbi një platformë me shume shkallë që shkëput ndërtesën nga hapësira

publike. E. Fagu dhe A. Qorri në artikullin e tyre mbi evolucionin e hapësirës urbane në raport me ideologjinë, duke ju referuar sheshit Skënderbej evidentojnë këto veçori që lidhje me arkitekturën teksa sistemi komunist arrinte në një fazë të pjekur: “Në fund të viteve ‘70, u bënë disa studime për përcaktimin definitiv të Sheshit Skënderbej. Megjithëse mund të vërehen disa ndryshime, këto propozime ndajnë të njëjtat synime: Bashkia e qytetit, vepër e Di Faustos u vendos që të rrënohej për të lënë vendin për Muzeun Historik Kombëtar i cili u hap në 1981, gjithashtu Kisha Ortodokse së bashku me pjesën tjetër të qendrës tradicionale, do t’i linte vendin ndërtimit të Hotel Tiranës në 1979. Në terma të kompozimit hapësinor të sheshit, muzeu i ri është një vëllim i madh monumental me dimensione të krahasueshme me Pallatin e Kulturës, por në dallim prej tij, me një arkitekturë të mbushur plot me simbolika nacionaliste. Kjo ndërtesë gjithashtu kishte nevojë për një hapësirë personale përpara, ku një shtatore e dytë ishte planifikuar paraprakisht e do t’i atribuohet Enver Hoxhës pas vdekjes. Monumenti i tij për shkak të pozicionit dhe madhësisë, u bë pika kryesore e sheshit, duke transformuar krejtësisht përmasat dhe perceptimin hapësinor. Më shumë sesa një hapësirë dinamike publike për shkak të pozicionit të tij qëndror në strukturën urbane të Tiranës, sheshi u kthye në një lloj abstrakti të materializuar historik i cili vjen në imazhin e një versioni evropianizuar të Kodrës Mansu në Pyongyang të Koresë së Veriut me statujën prej bronzi të Kim Il Sung që shihet prej të gjitha koridoreve qendrore të kryeqytetit” (Fagu & Qorri, 2019).

Me hyrjen në ekonominë e tregut, qendrat e qyteteve post-socialiste në mbarë Europën hynë në procese transformimi. Ndërsa qytetet socialiste përjetonin gjithmonë shkurtime të mëdha të mjeteve të nevojshme për shitjen me pakicë dhe shërbime të tjera, në periudhën e tranzicionit ata pushtuan qendrën urbane, shpesh në një mënyrë spektakulative. Janë këto aktivitete që mbushin rrugët qendrore kryesore me një sens të ri gjallërie. Në periudhën socialiste, qendra e qytetit ishte e karakterizuar nga nivel i ulët i qarkullimit, veçanërisht në zonat tregtare. Tani, në qytetin post-socialist ka një fluks të lartë të qiramarrësve të lokaleve në zona të tilla, ndërkohë që interieret e dyqaneve, restoranteve etj. rinovohen. Pas tregtisë dhe shërbimeve, qendra tani plotësohet nga zyra të shumta. Në fillim u përdorën ndërtesat ekzistuese, por pastaj filluan të shfaqen zyra të reja të ndërtuara me qëllim. Mirëpo pavarësisht rrekjeve për përshtatje me aktualitetin, duket se procesi drejt krijimit të një identiteti të ri kolektiv është i vështirë. Duke qënë se sheshet monumentale kanë në gjenezën e tyre një fuqi e cila kërkon të rrezatojë nëpërmjet tij imazhin e saj ideal, ndërsa në kushte të ndryshme politike kthehet në një dimension virtual i bën të vështirë aktivizimi e hapësirës me funksione, jashtase atyre që kombinojnë me arësyet direkte të krijimit të tyre. Sheshet e periudhës së socializmit, paraqesin mungesë përshtatshmërie dhe fleksibilitet të ulët në kohë. Tepër larg prej sheshit tradicional, në mungesë të një pushteti politik dominues këto sheshe mbeten memoce, plot zyrtësi e të pa afta për të animuar hapësirën, duke dëshmuar në një farë mënyre historikun e rëndë të dështimeve politike që influencuan në aplikimin e urbanizmit përfaqësues radikal.

5.4. Fabrikat dhe impiantet industriale

Sipas Kuilman, “një kategori e veçantë e ndërtesave monofunksionale përbëhet nga fabrika dhe zyra, ose më në përgjithësi nga 'poste pune'. Ato përfshijnë të gjitha ndërtesat, të cilat janë ndërtuar qëllimisht për të akomoduar një aktivitet produktiv njerëzor. Fabrikat janë vende pune të përbashkëta, duke frymëzuar frymën e krijimit dhe të veprimit, por shpesh pa ndonjë referim të qëllimshëm ndaj së bukurës. Zyrrat janë një ekuivalent modern, duke mos prodhuar asnjë rezultat të

dukshëm në aspektin material, por kanë marrë përsipër zhvillimin e shumë aktiviteteve moderne”. Për të, origjina e ndërtesës industriale lidhet me Revolucionin Industrial i cili filloi në Angli në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë. “Fabrikat janë vende moderne të soditjes, duke ofruar ngushëllim për një personalitet personal dhe kolektiv. Ky proces, i cili filloi në Angli, ishte mjaft i dhimbshëm në fillimet e tij, kur (Kuadrantit i tretë) 'pushteti' ishte ende i fortë. Këto anë të mprehta gradualisht u zhdukën kur (Kuadranti i katërt) ndjenjat mundën të shpreheshin, për shembull, në lëvizjen e Punëtorëve. Ato vepruan si një katalizator për të zgjeruar identitetin e një personi në identitetin e grupit.” (Kuilman, 2011). Në fakt siç është theksuar edhe më tej në këtë tekst, industrializimi gjatë komunizmit u pa si mjete për të ndërtuar proletariatin. Në rastin e Kombinatit, përtej llogjikës funksionale në arkitekturën e fabrikave egzistonte edhe një përpjektje në drejtim të formës, e cila përveç të tjerave shihej si një mjet për të identifikuar totalitetin e investimit, por nga ana tjetër solli edhe një risi në trajtimin e identitetit të qytetit industrial. Në vitet që pasojnë, arkitektura industriale e periudhës së socializmit në Shqipëri do të shënojë një shkëputje të dukshme prej këtij dimensionit estetik që hasim në aplikimet gjatë periudhës së parë të industrializimit. Kjo në fakt ishte një tendencë e përgjithshme në Frontin Lindor e cila erdhi si pasojë e reformave ekonomike që prezantoi Krushov pas ardhjes në pushtet. Sipas Czepczynski: “Në vitin 1954, një vit pas vdekjes së Stalinit, Bashkimi i Punëtorëve të Ndërtimit dhe Arkitekturës Sovjetike vendosi të kryejë zgjidhje të reja në fushën e dizajnit urban, pas konstruktivizmit dhe funksionalizmit në arkitekturë. Qytetet e reja duhej të bazoheshin në blloqet e mëdha të banesash, ndërkohë që i gjithë procesi i projektimit dhe ndërtimit duhej të standardizohej maksimalisht. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik botoi rezolutën 'Për heqjen e dekorit të tepërt në projektim dhe ndërtim [...] Liberalizime të caktuara në ekonominë e planifikuar socialiste, si dhe zbutja kulturore dhe estetike, lejoi arkitektët dhe projektuesit të kthehen në trendet e viteve 1930 dhe viteve 1940, të cilat deri atëherë ishin zhvilluar mirë në Perëndim. Procesi i kthimit në estetikën e vjetër ishte mjaft i menjëhershëm në Çekosllovakia, Poloni dhe Hungari, ndërsa në Rumanë dhe Bullgari zgjati pak vite dhe u shoqërua me një kërkim për një arkitekturë të re moderne, por kombëtare” (Czepczynski, 2008; 95). Rasti i Shqipërisë është më i afërt me Rumaninë dhe sidomos Bullgarinë, por në ndryshim prej tyre dalja e faktit prej Paktit të Varshavës në vitin 1961, zbehu influencat kulturore dhe shkëmbimin e njohurive profesionale me vendet e rajonit, duke orjentuar politiken drejt Kinës maoiste e cila suportoi financiarisht dhe teknikisht projektet e socializmit shqipëtar deri në fund të viteve '70. Edhe pse pjesa dërrmuese e industrisë socialiste u ngrit gjatë kësaj periudhe, elementi funksional dhe ekonomik mbizotëroi mbi elementin estetik. Tashmë arkitektura industriale krahasohej më tepër si një makineri prodhimi se sa si pjesë e qytetit, edhe pse duhet pranuar se edhe vetë qyteti i kësaj periudhe theksoi më tepër aspektet utilitare duke e shndërruar arkitekturën në një diskutim pur funksional.

Autoria hungareze Eva Kiss në tekstin e saj mbi transformimet hapësinore në Evropën Qendrore dhe Lindore pas socializmit, përmbledh faktorët përcaktues kryesorë të rënies së industrisë në ish vendet socialiste si më poshtë:

- Pëveçse një vonese të konsiderueshme, tranzicioni global drejt epokës postindustriale përfundimisht arriti edhe në Evropën Qendrore dhe Lindore. Rryma e ristrukturimit industrial filloi të ndihej në rajon në vitet 1980, por ndikimi i tij u vonua artificialisht nga politikat shtetërore që kishin prioritet industrializimin e gjërë.

- Çmontimi i sistemit socialist dhe politikave të tij ekonomike nisi korrëgjimin të rolit të madh disproporcional që sektori industrial luajti në ekonominë e Evropës Lindore.
- Kriza ekonomike që goditi vendet e EQL në fillim të viteve 1990 luajti gjithashtu një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e prodhimit industrial të tyre. Rimëkëmbja e mëvonshme industriale nuk arriti kurrë në disa degë të ekonomisë.
- Çlirimi i forcave të tregut të pasurive të paluajtshme nxiti ri-zhvillimin e tokës industriale në përdorime të tjera më fitimprurëse në vende tërheqëse urbane” (Eva Kiss in Stanilov, 2007; 148).

Ndërsa Kostinskiy e përshkruan procesin si pjesë e një trendi të përgjithshëm shterues dhe ai shkruan: “Në mënyrë tipike sektori industrial ka qenë në rënie të thellë. Në krahasim me fundin e viteve 1980 niveli i prodhimit industrial dhe rëndësia e industrisë në ekonominë urbane ra ndjeshëm; shfaqja e impianteve të reja industriale tashmë ishte një ngjarje e jashtëzakonshme. Ky "kompresim" i industrisë u shoqëruar me ristrukturimin e sektoreve ekonomike . Disa industri të konsumit - për shembull përpunimi i ushqimit - fituan më tepër rëndësi.”(Kostinskiy, 2001; 453) Në Shqipëri ndryshimet e para të rëndësishme demokratike ndodhën më 26 maj 1991, kur rreth 200 punëtorë në minierën e qymyrit Valias filluan një grevë të thellë urie brenda në minierë. Në ditët e ardhshme, qindra punëtorë në të gjithë vendin filluan greva urie në solidaritet me minatorët e Valiasit duke dëshmuar kushtet e rënda në të cilat ndodhej sektori industrial. Vitet e tranzicionit që pasojnë mund të konsiderohen më tepër si një proces ‘de-industrializimi’ me riorjentim të ekonomisë drejt sektoreve të tjera të prodhimit, ku turizmi dhe bujqësia së fundmi po përpiqen të mbyllin hendekun e madh të papunësisë që krijoi eksperiencia e dështuar industrializuese e viteve të socializmit.

5.5 Banesat dhe zonat e banimit.

Siç u theksua në pjesë të tjera të këtij studimi, industrializimi kishte përparësi të menjëhershme çështjen e strehimit të popullsisë migratore. Në rastin e Bashkimit Sovjetik, pas përfundimit të epokës staliniane, ndikim thelbësor në orjentimin e problematikave të theksuara lidhur me strehimin në qytet, pati Krushovi i cili inicioi një program të madh të zhvillimit të strehimit në fund të viteve 1950 Ishte rreth kësaj kohe që mikro-rajoni apo distrikti u bë baza themelore e ndërtimit të qytetit sovjetik. Ndërsa urbanistika staliniste nëpërmjet bllokut apo ‘super-bllokut’, u orjentua më tepër drejt hierarkizimit vertikal të terrtorit urban, duke i dhënë peshë absolute qendrës së qytetit sipas një principi radial, urbanistika e periudhës së modernizmit socialist, karakterizohet prej reformave të shtrirjes horizontale, pasojë e kërkesës së përgjithshme për banim por edhe të politikave më të rrafinuara të liderit revizionist. Sociologu amerikan D.Smith përshkruan mikro-rajonin duke u shprehur se "përbënte një njësi lagjeje të hapësirave jetike në formën e blloqeve të banesave apo apartamenteve, së bashku me shërbimet shoqëruese, për gati 5,000 deri 15,000 persona. Hapësirat këmbësore lidhin restorantet, çerdhet, kopshtet, kinoklubet, bibliotekat dhe objektet sportive, si dhe shërbimet arsimore, shëndetësore dhe kulturore. Kështu, të gjithë njerëzit dispononin një gamë të gjerë të nevojave dhe shërbimeve të përditshme brenda një distance të menjëhershme, shpesh brenda një shëtitje të shkurtër nga ku ata jetonin. Në një shkallë më të gjerë hapësinore, secili mikro rajon duhej të ishte pjesë e një hierarkie të mbivendosur të ofrimit të shërbimeve. Kështu, disa mikro-rajone mund grupoheshin për të formuar një kompleks banimi më të madh prej ndoshta 30,000 deri në 50,000 banorësh, për

ofrimin e një gamë më të gjerë shërbimesh brenda një rrezeje prej 1,000 deri 1,200 metra, krahasuar me 150 deri 200 metra për mikro-unionin. Lagjet rezidenciale u agreguan në lagje urbane prej 100,000 deri në 300,000 banorë, të cilët vetë ishin pjesë e zonave urbane me ndoshta një milion njerëz në një sektor të madh të qytetit. Koncepti i mikro-rajonit u adoptua shpejt në vende të tjera. Kjo rezultoi e përshtatshme për nevojat e rindërtimit të shpejtë të pasluftës dhe për zgjerimin e ri urban, veçanërisht në vitet 1960 kur teknikat masive të parafabrikateve mbizotëronin në ndërtimin e banesave urbane” (Andrusz et al, 1996; 75). Në këtë periudhë grupi NER, i përmendur në Kap.3, në botimin e tyre për 'Qyteti Ideal komunist' rëndësinë tre ide kryesore në bazë të 'sektorit rezidencial' që sipas tyre duhej të ishin:

1. Shkalla e Këmbësore - distanca e çdo rezidence nga qendra e shërbimeve përfshirë transportin publik nuk do të kalonte 500 yard deri 600 yard (~ 460m-550m, afërsisht 7 min ecje).
2. Mjedisi shkollor. Vendosija e komunitetit të shkollës në skaj të zonës së banimit lejon që oborret shkollore të lidhen direkt me tokën e parkut dhe pyjeve.
3. Parqet dhe zona rekreative. Hapësira midis sektorëve të banimit do të jetë e gjelbër, duke lidhur pemët dhe peizazhin e qendrës në pyje dhe parqe jashtë zonës së zhvilluar.

Spektori i banimit është një zonë e dendur e rrethuar nga një rrip i gjelbër, të paktën çerek milje i gjerë(~400m) dhe përfshin një qendër tregtare për 25 000 persona, një industri të lehtë dhe hapësirë për aktivitete kolektive” (Gutnov et al, 1968; 119). Gutnov etj., bënë dallimet ndërmjet dy llojeve themelore të shërbimeve që duhen dalluar mes nevojave të konsumatorëve. “Në kategorinë e parë janë llojet e shërbimeve që duhet të sigurojnë me efikasitet popullatën me artikuj të përdorimit të përditshëm. Këto shërbime duhet të ofrojnë një shumëllojshmëri të mallrave dhe duhet të jenë brenda një distance të shkurtër të ecjes. Kategoria e dytë e shërbimit përfshin: teatrin, farmaci, pishinën, parkun e lojrave me top, zyrat e administratës lokale, kafenenë, restorantet etj.”(Gutnov et al, 1968;75) Megjithatë, realiteti ishte ndryshe dhe propaganda ishte kthyer zëri i të vërtetës edhe kësaj here. Problematika kryesore vazhdoi të mbetej çështja bazë e strehimit dhe çdo lloj elementi tjetër si shërbime apo infrastrukturë urbane, mbetën si të rangun të dytë. Zhvillimet e viteve '60 nuk mbërritë në Shqipëri, si për shkak të komplikacioneve politike në lidhje me BS, por edhe pse ishin mënyra organizimi urban karakteristike të qyteteve të mëdha. Në Shqipëri standartet urbane përcaktoheshin nëpërmjet planeve rregulluese që përcaktonin direktiva për planet e nivelit më të ulët dhe shpërndarja e shërbimeve kryej në nivel blloku dhe lagjeje. Orjentimi i politikave të strehimit drejt ekonomisë së ndërtimit, sposto i kërkimit mbi arkitekturën e banesës drejt prodhimit të prototipeve gjithmonë e më simpliste, shpesh të ngulura në territor pa kurrfarë infrastrukture, u kthyen në realitetin e vrazhdë që karakterizoi zonat e banimit në afërsi të zonave të reja industriale.

Shumë studiues qyteti socialist krijoi shumë diferencime socio-ekonomike. Shoqëria socialiste sipas Smith, duhej të ishte relativisht e barabartë, veçanërisht në krahasim me shoqërinë kapitaliste. Sipas tij “avantazhi material mund të fshihet në mënyrë efektive pas mureve të jashtme të blloqeve homogjene të apartamenteve, por nëse diferencimi socioekonomik arrin një shprehje më të dukshme, në peizazhin urban ose si modele të dallueshme të ndarjes apo segregimit, atëherë kontradikta do ishte më e fuqishme, si dhe kërcënim për legjitimitetin e rendit politik mbizotërues” (Andrusz et al, 1996; 77). “Ndërkohë që mikro-rajoni individual pritej që të siguronte akses të

barabartë në të gjitha elementet e infrastrukturës urbane të lidhur me të, ky nuk ishte rasti për strukturën më të gjerë të qytetit në ofrimin e shërbimeve. Nevoja për të vendosur të paktën disa shërbime në nivel qendror në raport me popullsinë e madhe, në interes të efikasitetit, vepronte kundër shpërndarjes së drejtë për të arritur akses të barabartë për të gjithë. Një tjetër burim i pabarazisë në shpërndarjen hapësinore të planifikuar të shërbimeve ishte vonesa kohore midis ndërtimit të blloqeve të banimit dhe shërbimeve të lidhura me to, si pjesë e problemit të përgjithshëm të realizimit të pabarabartë të normave të cilat duhej të siguronin barazi lokale të shërbimeve. Cilësia e shërbimeve gjithashtu mund të ndryshonte midis lagjeve, me objektet më të larta të ofruara për punëtorët në ndërmarrje të veçanta, nuk ishin të hapura për njerëzit e tjerë që jetonin aty pranë”(Andrusz et al, 1996; 77).

Më tej Smith kryen një transekt të qytetit bashkohor post-socialist, duke ndarë zonat në dy tipologji kryesore nga pikëpamja e shtresëzimit socio-ekonomik dhe mjedisor:

- zona e brendshme me status të lartë të banimit, e zënë kryesisht nga grupet e profesionistëve; pak trafik dhe ndotje, por akses i mirë në shërbimet qendrore (të cilave u shtohen këtu, vende të veçanta për të privilegjuarit dhe elitën);
- zona e brendshme me status të ulët, me prona të vjetëruara; mjedisi i prekur nga zhvillimi industrial apo komercial, por akses i mirë në objektet e qendrës së qytetit;
- zonat e jashtme me status relativisht të lartë (disi larg nga qendra, në varësi të madhësisë dhe modelit të rritjes së qytetit), me përmasa relativisht të mëdhaja të apartamenteve të banesave kolektive; kryesisht nga punëtorë "white collars"³; ofrimi i shërbimeve dhe / ose transportimi në qendër të qytetit në mënyrë të drejtë;
- zonat e jashtme periferike të statusit më të ulët, me mbizotërim të strehimit social dhe një përqindje relativisht e lartë e emigrantëve; kryesisht punëtor krahu; industri me ndikim të dëmshëm mjedisor; qasja të ulëta në shërbime dhe të përkeqësuar nga vonesat në ndërtimin e infrastrukturës;
- zonat urbane dhe enklavat periferike të banesave private me cilësi shumë të varfër, shumica e të cilëve zihen nga emigrantët e fundit nga fshati; ofrimin e shërbimeve të pakta gati jo ekzistente” (Smith David in Andrusz, G., Harloe, M. & Szelenyi, I., 1996; 82).

Megjithatë duhet të theksohet se midis dy palëve të studiuesve të qytetit socialist, perëndimor apo atyre të Europës Lindore, ekziston pothuajse një marrëveshje universale se shkalla e ndarjes sociale dhe pabarazisë në socializëm ishte më pak se në kapitalizëm. Duke u kthyer në procesin në të cilin lindin diferencimet socioekonomike ose pabarazia në qytetin socialist, kjo do të ishte qartësisht e ndryshme nën kapitalizmin. Sidoqoftë, mund të pritët diferencimi i zonave rezidenciale aty ku ka pabarazi socio-ekonomike brenda shoqërisë urbane, një stok strehimi të ndryshueshëm, përqendrim hapësinore të kushteve të ndryshme të banimit dhe konkurrencë për banesat brenda sistemit të strehimit. Kësaj mund ti shtohen dallimet në nivelet lokale të ofrimit të shërbimeve dhe cilësia e përgjithshme mjedisore. Gjithashtu mund të pritët që edhe një lloj klasifikimi rezidencial të lindë nga ekzistenca e grupeve të dallueshme etnike ose kulturore, si dhe nga variacionet në strukturën familjare që çojnë në selektivitetin e banimit. Të gjitha këto kushte u përmbushën, pak a shumë në një masë si në Europën Lindore dhe në socializmin

³"white collars" ose "kollaret e bardha" njihen si klasa punonjëse më e privilegjuar, i referohet intelektualëve e profesionistëve. Termi filloi të shquhet në SHBA prej fillimit të shek.20 (shënim autori)

sovjetik. Disa segregime socio-ekonomike ishin rezultati i pashmangshëm dhe kur ndodh segregimi i banimit, pabarazitë sa vijnë e vetë-përforcohen. Qyteti post-socialist Shqiptar, shfaqet gjithashtu si një produkt i pashmangshëm i procesit modernizues, i cili për arsye jo aq sociale sa politike, paraqet ende shenjat e një realiteti tranzicional nga pikëpamja e ngritjes së komunitetit dhe krijimit të identitetit hapësinor.

6. TRANSFORMIMET POST-SOCIALISTE TË QYTETEVE

Pas rënies së murit të Berlinit dhe hapjes graduale të vendeve të lindjes me botën perëndimore, një kalvar transformimesh filluan si në aspektin shoqëror ashtu edhe në atë ekonomik, urban dhe arkitektonik. Qytetet ish-socialiste si pasojë e sistemit të centralizuar që ngjizi egzistencën e tyre, apo politikave të ngjashme që ndikuan për zhvillimin e tyre, ndajnë ngjashmëri përsa i përket problematikave të tranzicionit, të cilat shpesh burojnë prej vetë arsyeve të krijimit të tyre. Në Shqipëri, prishja e sistemit të vjetër ndikoi kryesisht tek qytetet industrial, të cilët me rënien e industrive u gjendën të braktisura dhe pa resurse të tjera për të ngritur ekonominë e re. Ky nuk është totalisht rasti i Kombinatit që referuam më sipër, ku pozicioni i afërt me Tiranën e ktheu këtë “qytet satelit” në një lagje tv sajën, por i shumë qyteteve të tjera të themeluara në funksion të industrializimit socialist si, Maliqi, Cerriku, Memaliaj e më tej gjatë sistemit Çorovoda, Gramshi, Laçi, qytete këto që themeluan vlerën e tyre të tregut, referuar thujse totalisht egzistencës së industrisë. Sociologu amerikan Smith, shprehet se: Qytetet e reja zakonisht u krijuan për disa funksione specifike të lidhura me prodhimin industrial ose nxjerrjen e mineraleve, forma e tyre përfaqëson versionin më të pastër të qytetit socialist të planifikuar në funksionalitetin e tij të zymtë. Teksa industrializimi i aplikuar sipas ekonomisë së centralizuar shfaq problemet e veta të cilat shtynë sistemin drejt kolapsit, një pjesë e autorëve fokusojnë vetë elementin propagandistik që ju bashkangjiti axhendës së pastër industrialiste, si shkaktarin e konsumimit të shpejtë, apo prodhuesin e “inflacionit” që grreu nga brenda ekonominë socialiste. Siç shprehet Kostinskiy (2001), në ekonominë socialiste faktorët joekonomikë të prodhimit - politikë, ideologjikë, simbolikë, socialë, ushtarakë, teknikë - kishin një rëndësi të madhe, në mos mbizotëruese. Kjo favorizoi totalitetin dhe 'gjigantizmin' në organizimin e hapësirës dhe planifikimit fizik, si dhe theksoi rëndësinë e kuptimit të saj simbolik, diçka në të cilën qyteti, sipas përkufizimit, luajti një rol veçanërisht të rëndësishëm.

Përvetësimi i arkitekturës nga propaganda dhe konsiderimi i ndërtimit si proces me ndikim parësor në formimin e njeriun e ri, influencoi së tepërmi dhe ndonjëherë ishte vetë arsye e mjaftueshme për egzistencën e qyteteve socialiste. Por, pavarësisht alienizimit, ndrydhjes mendore dhe kufizimeve kulturore e shkencore, që i bëri shteti totalitariste shoqërive, ishin pikërisht qytetet dhe vlera e tyre e padiskutueshme në organizimin e shoqëror, që triumfuan dhe bënë të mundura ndryshimet. Sipas Kostinskiy “transformimi i jetës socio-ekonomike që filloi në vendet post-socialiste në fund të viteve 1980, u manifestua para së gjithash në qytete” por, siç shton ai më tej “tranzicioni post-socialist, kërkoi të dekonstruktonte të gjitha mitet që u morën të mirëqena gjatë komunizmit, por në të njëjtën kohë, realiteti material ndonjëherë vështirësonte zhvillimet e reja kapitaliste. Në fillim, rënia e ekonomisë së centralizuar të planifikuar shkaktoi kaos. Thellësia e kaosit pasqyroi realitetin se periudha e tranzicionit ka të ngjarë të jetë më e gjatë; ndryshimi, në kuptimin e kolapsit të së 'vjetrës' dhe futja e institucioneve të reja politike dhe të mekanizmave të tregut nuk do të arrihej në terma afatshkurtër” (Kostinskiy, 2001; 451).

Në Shqipëri, arkitektura dhe ndërtimet e kësaj periudhe u projektuan në kushtet e emergjencës së gjithanëshme dhe restriksione të forta ekonomike, të cilat

nuk lejuan marzh fleksibiliteti për një përshtatje më të mire në terma afatgjatë. Siç shpjegonte Gutnov etj. në përshkrimet e ‘Qyteti ideal Komunist’, “sapo një ndërtesë e vetme banimi përfundohej dhe struktura e saj funksionon racionalisht, ajo nuk mund të zgjerohet lehtësisht në gjatësi, gjerësi apo lartësi. Më së shumti që mund të bëhet, është shtimi i një njësie tjetër të ngjashme pranë saj” (Gutnov et al, 1968; 152). Në vitin 1996, Smith (1996) parashikon se, nëse socializmi në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik krijoi struktura të tilla të qëndrueshme urbane, të cilat nuk mund të ndryshohen lehtësisht nga shoqëria post-socialiste, llojet e qytetit të trashëguara nga regjimet e vjetra do të mbijetojnë, të paktën pjesërisht, edhe në shekullin e ardhshëm. Dhe, për sa kohë që jeta urbane duhet të përshtatet me mjedisin ekzistues të ndërtuar, qyteti socialist do të veprojë si një pengesë për zhvillimin e formacioneve të reja shoqërore. Ndërkohë që problematika mbetet shume e mprehtë duke konsideruar se “rreth një e treta e popullsisë së botës jeton në ish-ekonomi të planifikuar në nivel qendror. Tranzicioni i këtyre vendeve drejt mekanizmave të konkurrencës me bazë tregun për shpërndarjen e burimeve është një nga çështjet dominuese të viteve 1990” (Bertaud & Renaud, 1994; 5). Rreth tre dekada pas kolapsit të sistemit komunist, në Shqipëri tranzicioni duket se po jep produktet e veta teksa vendi i afrohet proceseve të antarësimit European. Pjesa në vijim është organizuar në 5 nën-kapituj dhe trajton proceset e transformimeve tek ish-qytetet socialiste, duke u ndalur fillimisht në analizën e problematikave kryesore, për të vazhduar më sfidat dhe çështje që lidhen me adresimin e tyre.

6.1. Fenomene tranzitore në arkitekturën post-socialiste

Interesi i studimeve post-socialiste, merr një rëndësi të veçantë nëse e konsiderojmë si një mjet për të kuptuar tendenca të dialogut bashkohor midis shoqërisë dhe qytetit. Arkitektura socialiste krijoi një lloj tradite të sajën që u rrënjos në besimet dhe qëndrimet e shumë njerëzve. Nga njëra anë kolapsi i prituri i sistemit krijoi një shkëputje me të kaluarën e afërt moderne, por nga ana tjetër ky boshllëk i krijuar hapi mundësitë për një vazhdimësi të re e cila i referohet në mënyrë nostalgjike lidhjeve të mohuara historike. Ky proces sipas Boris Groys orjentohet nga një “rivendosje e vazhdimësisë historike dhe veçanërisht e neo-tradicionizmit” (Groys B. , 2011; 10). Fenomeni që përshkruan Groys, në rajonin e Ballkanit u shfaq direkt pas ndryshimeve të viteve ‘90. I frymëzuar nga heterogjeniteti i njohur i popullsisë dhe i ushqyer nga zhbërja e sistemit kulturor unifikues, vihet re një kthim në kulturat etnike, të cilat duke qenë mbajtur të ngrira gjatë viteve të socializmit, u rishfaqën të pa zhvilluara e në formën e tyre native e disi të përshpejtuar, të cilës rendomtazi i referohemi si kultura ‘turbo-folk’.

Në Shqipëri, arkitektët shqiptarë u shfaqën skeptik lidhur me ndryshimet që sollin periudha e tranzicionit nga pikëpamja urbane, të cilët duke ju referuar Tiranës shprehen se: “Ndërtimet e reja shpesh kanë dëmtuar memorjen urbane jo vetëm nëpërmjet prishjeve, por edhe nëpërmjet amortizimit vizual ose mumifikimit të ndërtimeve ekzistuese edhe kur ato nuk janë amortizuar fizikisht. [...] Ka shumë raste kur shumëkatëshi shqetëson brutalisht siluheta të formuara në memorjen historike e artistike të Tiranës siç ndodh në qëndër të qytetit pranë ansamblit të Kullës së Sahatit dhe Xhamisë së Haxhi Ethem Beut”(Eftimi & Alite, 1998;6). Periudha e socializmit dhe ekonomia e varfër, induktoi në shoqëri një mentalitet të lidhur pas përmbajtjes materiale më tepër se vlerës kulturore. Sipas atij mentaliteti, tradita shërbente më tepër si një sfond krahasimor për të evidentuar arritjet e socializmit, se sa si burim energjie për të ushqyer inovacionin e së tashmes. Sipas arkitektëve sovjetikë, “arkitektura socialiste përfaqëson një evolucion të pashmangshëm dhe inovativ nga

traditat e ndërtimit të së kaluarës” (Gutnov et al, 1968; 129). Në fakt historia tregoi se në ndryshim prej këndvështrimeve të modernizmit utopist, versioni i tyre socialist kishte përmbajtjen ideologjike, e cila mori gjithë kohës superioritet karshi eksperimentimit teknologjik që karakterizoi modernizmin europian. Ky ndryshim thelbësor ndërmjet shkencës si bazë për zhvillimin e qytetit apo politizimit të rëndomtë të procesit, padyshim që ka influencuar në vështirësitë e shtuara që hasin qytetet industriale post-socialiste. Sipas Tafurit, “arkitektura socialiste bazohej në një ideologji anti-urbane, që kishte një fytyrë antikapitalizëm e cila përfaqësonte edhe një lloj anarkie në vetvete”(Tafuri, 2007; 110). Në këtë llogjikë mund të argumentojmë thelbin e fenomene urbane post-socialiste, siç është ai i mbivendosjes kulturore me apo pa neotradicionalizma bashkohor, të cilat gjejnë bazën e tyre në traditën anti-urbanizuese të arkitekturës totalitare e cila krijoi fushën e vet të aplikimit, në panjohuri dhe paragjykimin të traditave të mëparshme arkitektonike.

Arkitekti shqiptar Maks Velo, i drejtohet jo pa ironi publikut Shqiptar në një prej shkrimeve të tij në gazetën Shekulli ku shprehet: “Në dhjetëvjeçarin e fundit 2000-2010 ndodhi një fenomen shumë i rëndë dhe kjo është shtrirja e ndërtimeve përgjatë akseve kryesore rrugore. Ajo që për mijëvjeçar kishte qenë një banim strategjik (ndertimi i veçuar larg e larg nëpër male, që siguronte një autonomi fisnore) u përmbys kokëposhtë. [...] Tërë Shqipëria është në rrugë. [...] Kjo ka sjellë tjetërsimin e tërë indit të banimit. Nuk kemi më fshatra, komuna dhe qytete por vetëm një qytetofshat të zgjatur”(Velo, 2013; 289). Sipas Ellin (2003) frika ndaj postmodernizmit dhe urbanizmit postmodern ishin shumë të lidhura. Në ndërtim, është e dukshme përpjekja për të projektuar në stilet tradicionale lokale (regionalizmi). Retribalizimi është gjithashtu i dukshëm në ndërtimin e komuniteteve të veçuara, më së shpeshti me rritjen e komuniteteve të pensionistëve. Megjithëse përpjekja për të harruar dhe shkatërruar ndërtesat e së kaluarës komuniste u manifestua në të gjitha vendet e Europës Lindore, ky proces u shoqërua edhe nga një lloj nostalgjie e cila ishte edhe pjesa më e papritshme por e imagjinueshme, e procesit të tranzicionit. “Nostalgjia është kryesisht për qytetin dhe jetën e vendit, jo për jetën suburbane”, për Ellinin nostalgjia është “e lidhur ngushtë me retribalizimin, reagimi nostalgjik përmban një dëshirë për t'u kthyer në të kaluarën si reagim ndaj ndërprerjes së pastër të modernizmit të kaluar. Sjellja nostalgjike është e dukshme në thirrjen për t'u kthyer në 'vlerat tradicionale' dhe institucionet, si edhe në rikthimin drejt natyrës (ambientalizmi)” (N.Ellin, 2003; 49). Sipas Ellin, përgjigjja e tretë ndaj frikës bashkëkohore është arratisja. Të dy retribalizimi dhe nostalgjia mund të konsiderohen si nenprodukte të arratisjes, por kjo kategori fokusohet në forma më ekstreme të tërheqjes nga komuniteti më i madh ose fluturimet në botën e fantazisë. Në Shqipëri fenomeni i ‘retribalizimit’ karakterizoi dy dekadat e para të tranzicionit, ndërsa dekadën e fundit vihet re një një ringjallje interesi për t’u konfrontuar me trashëgiminë e periudhës së socializmit. Sipas Czepczynski (2008), qytetit socialist ishte një mit, i cili u rrit nga mungesa e mediave të lira, diskutimit kritik, krahasimit dhe për shkak të kufizimeve të udhëtimit jashtë. Shumë prej nesh besonin se në të vërtetë jetonim në sistemin më të mirë të mundshëm.

Shumica e arkitektëve shqiptarë pajtohen se në dy dekadat e para të tranzicionit, arkitektura shqiptare ka hasur vështirësi në gjetjen e një trajektoreje me vlera identitare dhe e shkëputur prej interpretimeve personale. Me një ton radikal Maks Velo shprehet: “arkitektura jonë është në fazat e një çoroditje totale, pa strukturë estetike dhe morale”. Sipas Velos, “ajo që mungon është ndjenja e masës në përdorimin e materialeve. [...] Ka shumë materiale në fasada. [...] Por nuk ka

koherencë në stilet e arkitekturës dhe bëhet një lojë e pakuptimtë. Këto ndërtime e bëjnë qytetin të duket si cirk. Është një arkitekturë që reflekton prirje anarkije dhe individualizëm mesjetar” (Velo, 2010). Duke iu referuar qyteteve shqiptare dhe rindezjes së interes për folkun, arkitekti Velo shkruan se “Është si një eko e largët e kështjellave mesjetare dhe kullave të veriut, por këtë rradhë ato po ndërtohen në prag të mijëvjeçarit të tretë, rreth kryeqytetit dhe jo në malësive të Veriut. Edhe mjediset e brendshme janë tërësisht me gur apo dru dhe metal, por nuk kemi një stil që quhet rustic dhe që përdoret gjërësisht. Këtu kemi thjesht një aplikim, duke përsëritur teknikat dhe materialet tradicionale, pa i stilizuar ato. Ne nuk kemi një dizajn të ri, modern, por një përsëritje pa sens të stilit kullë.” (Velo, 2013;187). Duke marrë shembullin bullgar, antropologu kulturor Dichev thekson se "Bullgaria po përpiqet të kërkojë vendin e saj në konkurrencën e ndërtimit duke ndërtuar kështjella masivisht kitsch, pjesërisht financuar nga BE. Asgjë nuk mungon, kullat dhe katapultet, hedhësit e topave, plus çdo legjendë historike shërbyer nga ndërtuesit. Kështjellat e vërteta, në fakt mund të ndërtohet me më pak para - sepse ato mund të ndërtohen mbi shabllone të tëra ekzistuese. Ndërkohë, janë ndërtuar 35 objekte të tilla - bazuar në ngjarje shumë të dyshimta historike dhe përkundër protestave të forta nga ekspertët. Në shumicën e rasteve kemi të bëjmë vetëm me financimin e BE-së, i cili zbatohet përmes programit të zhvillimit rajonal. Dhe në një komunë po rrjedhin para të tilla, atëherë të gjithë mund të përfitojnë diçka, firma ndërtimi, ekspertë, zyrtarë të korruptuar etj. Por këto kështjella me të vërtetë shtojnë të ardhura nga turizmi, opo më vonë ato mund të bëhen barrë për komunat për shkak të shpenzimeve të mirëmbajtjes? Shumë ekspertë nuk besojnë se turistët janë të interesuar në një kështjellë të rreme ku burri dhe gruaja pozojnë me veshje mesjetare dhe kryqëzojnë shpatat. Pse pikërisht kështjella romake dhe mesjetare? Përgjigja është e qartë: për shkak të përpjekjes së dëshpëruar bullgare, për t'u paraqitur si pjesë e Perëndimit, si një komponent i traditës romake dhe të krishterë” (Dichev, 2015).

Ndërsa dhjetëvjeçari i fundit ka shënuar një hapje të konsiderueshme të Shqipërisë, si me vendet e Europës Perëndimore ashtu edhe më gradualisht me ato Lindore, shkëmbimi kulturor pa paragjykime, e vendos vendin brenda një sistemi më të gjërë ndërveprimi, duke nxitur konkurrencen rajonale në të mire të zhvillimit dhe në kohezion me zhvillimet bashkohore. Gjithashtu sistemi arsimor, me zgjerimin e aktivitetit edhe nëpërmjet futjes në sistem të arsimit jo-publik, ka krijuar një klimë më kompetitive për fushën, e cila ka filluar të prodhojë efektet e veta sidomos tek brezat e ri të arkitektëve. Nga ana tjetër, zhvillimi frenetik ndërtimor që po ekzekutohet vitet e fundit dhe vështirësitë për t'ju përgjigjur me modele të përshtatshme zhvillimi, duket se ndikojnë në një zgjatje artificiale të procesit të tranzicionit në mënyrën si prezantohet ai nëpërmjet qytetit.

6.2. Inkongruenca ndërmjet transformimeve urbane dhe institucioneve vendimarrëse.

Jeta urbane kishte një rëndësi të veçantë në marksizëm, si një forcë progresiste që inkurajonte identitetin kolektiv kundrejt atij individual. Planifikimi i centralizuar kombinuar me pronësinë shtetërore të tokës, do të thoshte se zhvillimi urban mund t'i nënshtrohej një kontrolli më të rreptë se në kapitalizëm. Struktura e brendshme e qytetit socialist supozohej të planifikohej për të lehtësuar shpërndarjen e një game të gjerë shërbimesh sociale si mjet për konsum kolektiv, përveç lehtësimit të zhvillimit të planifikuar të forcave prodhuese në interes të funksionimit efikas të ekonomisë. Transporti i lirë publik ishte një prioritet i lartë, për të siguruar akses të përshtatshëm në punë, kohë të lirë dhe burime të tjera të nevojës për kënaqësi dhe rekreacion.

Disponimi i banesave nga sektori publik ishte një nga mjetet më të rëndësishme me të cilat shteti kërkoi të sigurojë standarte jetese të kënaqshme dhe relativisht të barabarta për të gjithë, dhe ishin blloqet e apartamenteve që mbizotëronin, të cilat u japin karakter të tillë të veçantë peizazhit urban. Homogjeniteti tipik i planifikimit nëpërmjet principeve të zonimit, përzier me përdorimin e rëndomtë të godinave tip, përfaqësojnë imazhin më të zakonshëm të qytetit socialist. Ndërkohë që zhbërja e këtij imazhi urban në vitet e tranzicionit, shpesh u interpretua si një problematikë që ka lidhje me formën e arkitekturës, se sa një çështje diversifikimi të vetë përmbajtjes. Kështu, si në rastin e Kombinatit, zonat e banimit të socializmit u dendësuan më tej me godina banimi duke rënduar karakterin monofunksional të hapësirës, ndërkohë që edhe ish-zonat industriale që në masë të madhe u përdorën po prap për projekte të reja banimi.

Gjatë transformimeve post-socialiste, qytetet në Shqipëri hasin problematika që shpesh lidhen më tepër me institucionet politike të vendimarrjes, se sa me shkallën e zhvillimit të arkitekturës dhe urbanistikës, edhe pse këto dy faktorë mund të jenë të ndërlydhur. Problemet kryesore origjinojnë në çështje që kanë të bëjnë me demokratizimin/liberalizimin e planifikimit urban dhe të procesit të vendimarrjes. Siç konstaton M. Bego gjatë viteve tv para të tranzicionit: “faktor kryesor i degradimit progresiv urban është pasojë e ndërtimeve me ‘leje ndërtimi të rregullt’ të cilat, në të vërtetë dhe sistematikisht, jepen duke shkelur kërkesat ligjore të miratuara me Ligjin dhe Rregulloren e Urbanistikës në fuqi” (Bego, 2009; 89). Shkreli & Gjoni - arkitektë të gjeneracionit më të ri, e karakterizojnë këtë fenomen si ‘përdorim jo korrekt i territorit’. Ata paraqesin situatën me këto fjalë: “ideja se mund të blihet dhe të shitet çdo gjë, gjeti shprehjen ideale në zgjerimin intensiv (si fazë e parë e cila akoma nuk ka përfunduar) dhe atë ekstensiv (gjë që ka filluar të vihet në zbatim sidomos nga investitorët e fuqishëm e që akoma nuk është bërë karakteristike) të qytetit. bllokun hapësinor të banimit, parqet, rrugicat dhe bulevardet si njësi abstrakte që blihen dhe shiten pa marrë parasysh traditat historike, kushtet topografike, nivelin e urbanizimit apo nevojat shoqërore”. Sipas autorëve, është e kuptueshme që në sistemin kapitalist apo ekonominë e tregut “njësia bazë tani nuk është më blloku ose lagjja e banimit, por sipërfaqja e veçantë e ndërtimit vlera e së cilës mund të çmohet në bazë të metrave katrore dhe numrit të apartamenteve që shiten e që, për efekt të shfrytëzimit maksimal, shpesh herë kompozohen në projekt me sasira minimale ajri dhe drite.” Më tej ata konstatojnë se “vetëm kështu territori urban mund të shndërrohet në një mall, vlera e të cilit përcaktohet jo vetëm nga tregu, por dhe nga shkalla e korrupsionit. Tani po asistohet në fenomenin e trajtimit të terreneve vetëm nga pikëpamja e fitimit, pa u marrë në konsideratë elemente të rëndësishëm profesionalë si trafiku, orientimi, drejtimi i erërave, pejsazhi urban, dendësia e popullsisë etj. [...]. “Zonat urbane që po lindin jashtë kontrollit dhe kuadrin ligjor do të jenë problemet e së nesërme.[...] Për më tepër, këtij ekspansioni demografik nuk i korrespondon, fatkeqësisht, kurrfarë ekspansioni ekonomik i vendit”, ndërsa shtojnë më tej “Përdorimi i ashensorit po rrit edhe vertikalisht qytetin” (Shkreli & Gjoni, 1997). Ajo që u bë e evidente direkt pas viteve 90’, qe një prishje e balancës ndërmjet kriterëve projektuese të qytetit. Me futjen në lojë të faktorit treg, shumë nga parimet që u promovuan fort prej urbanistikës së periudhës së socializmit, u shfaqën të pa afta për ti dhënë përgjigje problemeve të qytetit bashkohor. Nga ana tjetër zbehja e rolit të shtetit solli edhe një lloj neglizhence nga ana e autoriteteve për të adresuar në kohë probleme të rëndësishme për të ardhmen e qyteteve, siç ishte paisja e tyre në kohe me instrumenta të ri planifikimi.

Në 1995 në esenë e tyre për "Qytetet pa treg të tokës: vendndodhja dhe përdorimi i tokës në qytetin socialist" Bertaud dhe Renaud theksojnë se "qëllimi i mirë i mbledhjes së qirasë së tokës nëpërmjet pronësisë publike totale dhe ndarjes së pasurisë së paluajtshme, ka dhënë rezultate të papritura dhe të padëshirueshme. Struktura rezultuese e qyteteve socialiste e bën kalimin në treg ekonomikisht shumë më të vështirë dhe të dhimbshme për shoqërinë. Kjo dëshmi gjithashtu ka implikime të mëdha për vendet në zhvillim të cilat janë duke luftuar me këtë çështje të njëjtë të rimëkëmbjes së qirasë së tokës dhe mund të tundohen nga forma të ndryshme të shtetëzimit të tokës dhe përkatësisë publike" (Bertaud & Renaud, 1994). Në përpjekjen për të teorizuar atë që ndodhi në peizazhin urban shqiptar, Shkreli & Gjoni (1997) përdorin idenë e 'permisivizimit' ose mungesa apo neglizhenca e një shumëllojshmërie të gjerë të sjelljeve shoqërore, - në këtë rast shpjegohet nga këta autorë si "humbja e kontrollit mbi territorin e cila çon në degradimin territorial, i cili është ushqyer nga dy faktorë bazë: 1. Mungesa e një Plani të Përgjithshëm Rregullues të shoqëruar nga një legjislacion dhe një kod urban të përshtatshëm, 2. Permisivizëm ilegjitim e abuziv, si shprehje e impotencës së një organizimi të caktuar shoqëror për të frenuar korrupsionin në instancat e ndryshme të burokracisë shtetërore; [...] kjo e kombinuar me [...] mungesën apo mospreokupimin për një politikë të përcaktuar urbane në pothuajse të gjitha programet e grupimeve politike shqiptare, gjë që domosdoshmërisht do të shpjerë në krijimin e ekzekutivëve të paaftë për tu perballuar edhe me problemet më klasike urbane si strehimi, trafiku, higjiena, infrastruktura, shërbimet etj." (Shkreli & Gjoni, 1997; 122). Mungesa e një axhende të përbashket mbi territorin e përcaktuar me një pjesmarrje të gjerë të aktorëve të përfshirë, duket se është thelbi i shume problemeve që u perceptuan me zhvillimin gjatë transformimeve post-socialiste.

6.3. Problematikat e organizimit hapësinor dhe social në qytetin post-socialist.

Jiri Musil duke ju referuar ish-vendeve socialiste të Europës Lindore, rëndit disa shkaqe kryesore të problematikave që u shfaqën gjatë transformimeve, duke shprehur se: "ndryshimet e dukshme socio-hapësinore dhe shoqërore mund të lidhen me sinergjinë e faktorëve shkaktarë të mëposhtëm: privatizimin dhe kthimin e pronësisë, rikthimi i pronës dhe tregu i tokës, de-industrializimi i qyteteve, prania në rritje e investorëve të huaj në industri, si dhe në shërbime, modifikimi i njëpasnjëshëm i banesave, duke përfshirë çrregullimin e qirasë, diferencat në rritje e të ardhurave, dobësimin e sistemit shtetëror të mirqënies, të sistemeve urbane të transportit publik, decentralizimit të qeverisjes së qyteteve, më shumë theks në cilësinë e mjedisit, disa liberalizime të politikave të emigracionit, individualizimin e vlerave dhe rritjen e pluralizmit të stileve të jetesës." Më pas pozicionon problematikat sipas hapësirës duke u shprehur se "në të gjitha qytetet post-socialiste ndryshimet kryesore janë të përqendruara në dy zona kryesore: në pjesët qendrore të qyteteve dhe në zonat periferike. Ndërtesa të reja - kryesisht ato administrative, qendra tregtare dhe hotele - janë ndërtuar në qendrat e të gjitha qyteteve të mëdha post-socialiste. Më të dukshmet në këtë drejtim janë ndryshimet e qendrës së Varshavës. Në qytete të tjera me bërthama historike të mirëmbajtura, si në Pragë, stoku ekzistues i ndërtesës po kalon nëpër rikonstrukcione dhe transformime nga strehimi në administratë dhe funksione të biznesit. Këtu lobi i shoqatave të përfshira në mbrojtjen e monumenteve luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e "pamjes"

historike të qendrës. Por qendrat janë gjithnjë e më shumë duke iu shërbyer turistëve dhe më pak vendasve” (J.Musil, 2005).

Qendra aksiale e Tiranës, me përfundimin e sistemit trashëgoi një stok të konsiderueshëm hapësirash të lira të cilat ishin kualifikuar si parqe, në sintoni me idenë e qytetit të gjelbër, që u shfaq gjatë periudhës së Mbretit Zog nga arkitektët italianë. Implementimi i tyre gjatë socializmit pati vazhdimësi, edhe pse tashmë duke përdorur metoda staliniste të përvetësimit të pronës private, proces ky që në mënyrë ironike por tepër domethënëse, u bë i njohur lokalisht me termin ‘më ra plani’. Ndërkohë, nëvojat për ofrime shërbimesh dhe nxitje të ekonomive të vogla private në fillimet e tranzicionit, shtyu autoritetet të fusin në sistemin ligjor konceptin e lejes së përkohëshme për ndërtime të çmontueshme në shërbim të biznesit. Vitet që do të vijojnë do të venë në dukje deformimin e pare, edhe pse ‘të përkohshëm’ që i bëhet trashëgimisë hapësinore të qytetit me atë që njihet si fenomeni i ‘kjoskëzimit’. Kjo periudhë e zyrtë nga pikëpamja urbane por shumë e gjallë nga pikëpamja e socializimit i cili rilindi prej koncentrimit të hapësirave rikreative, përhapri ngrehinat e veta të vogla dhe të mëdha, të çmontueshme dhe jo, si nëpër parqe, (ku më i njohuri ishte parku rinia me përqëndrimin më të madh të kafeve) dhe koridori i lumit Lana, i cili në vitin 2000 u bë i njohur si operacioni i pare i rikualifikimit urban në shkallë të madhe. Mirëpo teksa qyteti rrekej të ripërcaktonte konturet e veta hapësinore, kërkesa për shërbime qëndrore mbetet e pa adresuar duke shtyre të marri hov spekulimi ndërtimor. I pari rast që preku sensibilitetin profesional dhe ndezi debatin mbi ndryshimet radikale në mënyrën e të ndërtuarit të qytetit e që mund të përmendet në vijim të konsiderimeve historike të kësaj teme, ishte ndërtimi i dy godinave tip kullë në Bulevardin Dëshmorët e Kombit. Maks Velo në një shkrim protestë të kësaj periudhe, pasi sheh të domosdoshme fillimisht të krijojë një kontekst edukativ mbi arkitekturën, në të përditshmen “Gazeta 55” shkruan: “Asnjëherë nuk kam parë një efekt më negativ të një objekti arkitektonik. Veprimi i fushës së tyre manjetike është i fortë, madje shumë i fortë, por ky është një efekt shokues dhe helmues dhe kjo vjen nga antiteza e së mirës me të keqen. [...] Po të ishin ndërtuar në Vorë apo Laprakë nuk do të ishte ky efekt. Përse? Sepse bulevardi ishte i mrekullueshëm, sepse të gjitha godinat e ngritura, megjithëse stile të ndryshme, ruajnë idenë e parë të Brasinit dhe Bosios, kurse kullat bien në kundërshti të plotë me to. [...] Ky është rasti më skandaloz, jo vetëm në Shqipëri dhe në Ballkan, por në të gjithë Evropën në këtë dhjetëvjeçar.” (Velo, 2013; 63-64) Kostinskiy (2001) përpiket të grupojë shkaqet që udhëhoqën proceset duke theksuar se “transformimi i organizimit hapësinor të qyteteve është rezultuar i tre proceseve kryesore:

1. zhvillimi spontan i biznesit privat dhe rritja e numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
2. Roli i zvogëlimit të shtetit si rregullator i jetës socio-politike dhe pronar i ndërmarrjeve ekonomike;
3. Zhvillimi i qeverisjes urbane (si në nivel të qytetit ashtu edhe midis qyteteve), qëllimet e të cilit ndryshojnë nga ato të rajonit të mëparshëm dhe autoritetet shtetërore”

Lidhur me zhvillimet periferike e sidomos ish-qyteteve industriale që u gjendën jasht intenerareve historike të zhvillimit situata duket se shkon në të kundërt. Pasojat e ndryshimit të sistemeve u ndjenë më së tepërmi në aspektin e tkurrjes dhe degradimit të hapësirës urbane dhe sociale. Për të dhënë një panoramë të shkurtër, por në një masë plotësuese për kontekstin e përgjithshëm të qytetit socialist në Shqipëri, përveç Kombinatit të Tekstileve Tiranë po i referohemi edhe zhvillimeve me dy ish-

qytete industriale të themeluara thuajse paralelisht me Kombinatin. Qyteti i Cerrikut, 20 km prej Elbasanit u themelua në afërsi të fshatit me të njejtin emër, në mes të viteve '50 për industrinë e përpunimit të naftës e cila transportohej me tubacione nga Kuçova 30 km më në Jug. Sot numëron mbi 15 mijë banorë. Njëzet vjet tranzicion demokratik e ka transformuar atë në një qytet bujqësor me pasuri kulturore, një popullsi shumë të re por që ka një problem kryesor: papunësinë. Gjashtëdhjetë vjet pas ndërtimit të saj, ai ende rezervon disa nga emërtimet e së kaluarës. Gjatë regjimit komunist u quajt 'qyteti i të përndjekurve', ndërsa në kohën e demokracisë do të kujtohej për incidentin me rojet e gardës së republikës në vitin 1997, i quajtur gjithashtu si "Masakra e Cerrikut" (Qoraj, 2013). Në këtë periudhë ka pretendime të ndryshme nga kompani të ndryshme për të marrë koncesionet në atë që ka mbetur. Në korrik 2013, kompania Kurum u shpall fituesja e koncesionit të rafinerisë së naftës në Cerrik për ta kthyer atë në funksionin e mëparshëm, megjithatë pretendime të tjera ekzistojnë për ta kthyer atë në një fabrikë prodhimi për materiale ndihmëse të ndërtimit. Radio stacioni është ende në funksion, por me staf të kufizuar dhe Instituti i Duhanit si një burim tjetër punësimi, por ende sot është jashtë funksionit" (Qoraj, 2013). Pas viteve 1990 rafineria e naftës u ndalua dhe mbyllja e saj krijoi shumë papunësi. Një pjesë e banorëve punonte edhe në ferma shtetërore, të cilat u privatizua dhe toka u shpërnda banorëve ekzistues dhe jo pronarëve të mëparshëm. Mundësitë e punësimit të të rinjve janë shumë të kufizuara. Një rrjedhë e madhe e tyre largohen çdo ditë nga qyteti për arsye ekonomike. Cerrik ka shkollën e vetme në Shqipëri në fushën e studimeve mekanike bujqësore për nivelin e shkollës së mesme. Qyteti i Cerrikut ka gjithashtu nivelin më të lartë të papunësisë në rajon që është mbi 40 për qind. Ky është një fenomen shumë shqetësues për të rinjtë që zakonisht qëndrojnë në rrugë dhe parqe. Aktualisht 459 familje marrin asistencë sociale, por numri i aplikimit është duke u rritur (Qoraj, 2013). Cerriku përfaqëson rastin e një qyteteti në kërkim të një identiteti të ri.

Maliqi, 13 kilometra në veri-perëndim të Korçës, është një qytet satelit i themeluar paralelisht me Kombinatin e Tekstileve në 1951. Ato ishin të dyja investime të Planit të Dytë 2 vjeçar dhe nëse Kombinati përfaqësonte simbolikisht një përkujdesje staliniane për 'të veshur proletariatin', rasti i Maliqit kishte të bënte me 'shijen' dhe industrinë ushqimore, veçanërisht atë të sheqerit. Qyteti i ngritur në të zbritur të fshatit me të njejtin emër, u ngrit thuajse me të njëjtën gjuhë të stilit stalinist që u përdor në Kombinatin por në dallim ka një qendër më të vogël banimi që i përket periudhës së ndërtimeve sovietike. I konceptuar si mes fshatit dhe qytetit Maliqi krijoi një karakter të lavdishëm gjatë socializmit për shkak të rëndësisë që pati industria e tij prodhuese e cila pati një impakt të gjërë në territor. Në atë kohe, Maliqi u bë i famshëm edhe për mobilizimin në tharjen e kënetave dhe procesin ndaj 'sabotatorëve' (Dervishi, 2017) i cili sipas historianit shqiptar K. Dervishi, në vitin 1946 përfundoi me egzekutimin e disa prej profesionistëve inxhinjerë më të mirë të kohës, veprim ky që shkaktoi pas LLB2, largimin e misionit amerikan prej Shqipërisë. Kështu ndërmjet horrorit dhe dashamirësisë ëmbëlsuese të sistemit qyteti krijoi egzistencën e vet të lidhur me prodhimin industrial të sheqerit dhe kultivimin e lëndës bazë të panxharit, duke përbërë një ndarje më të thellë të klasave shoqërore, por nga ana tjetër duke prezantuar edhe një lloj integrimi të urbanes me ruralen. Sot, për shumë analistë shqiptarë, fundi i fabrikës së sheqerit të Maliqit ka nënkuptuar edhe fundin e qytetit. Sipas tyre jeta e qytetit është e vakët dhe ndërtesat sociale dhe kulturore janë shkatërruar. Maliqi sot është një mori shtëpish pa arkitekturë duke u zbehur gjithnjë e më shumë nga ajo që dikur e përfaqësonte. "Fabrika e sheqerit, dikur simboli i qytetit është një grumbull rrënojash dhe tani është shndërruar në simbol të

papunësisë së qytetit. Kudo që hedhim sytë, shohim vetëm mbetje ndërtesash të vjetra, më shumë në stilin sovjetik, që po shndërrohet në hedhurinë dhe grumbull tullash që vishen nga era dhe shiu. Qyteti ka qenë i rrënjosur thellë në të kaluarën dhe për të ardhmen askush nuk flet. Si rezultat i mirëmbajtjes së ulët dhe mungesës së investimeve, jo vetëm qyteti por edhe fusha bujqësore është shkatërruar. Përmbytjet e shpeshta në vitet e fundit kanë treguar se kjo zonë ka nevojë për investime të menjëhershme përndryshe është e destinuar të kthehet në origjinë, në kënetë siç ishte më parë” (Hoxha, 2014). Pas vitit 2010 një fazë e re e shkatërrimit ka ndodhur në ish fabrikën e Maliqit, pasi shumë prej makinerive të saj janë përdorur dhe shitur për skrap(Gazeta Shqip, 2011). Gjatë vitit 2012, ish-punëtorët e fabrikës së sheqerit të Maliq protestuan për shitjen e fabrikës për investitorët e huaj pasi ata shpallën të jenë aksionerë të fabrikës” (Gazeta Shekulli, 2012). Në vitin 2014 ka pasur disa përpjekje të vërteta për t'a dhënë ish fabrikën e sheqerit në koncesion për kompanitë e huaja. Aktualisht, ekziston një projekt polak, i cili dëshiron të rinovojë përsëri fabrikën e sheqerit. Mendohet se kapaciteti i ri i fabrikës do të jetë 80 mijë ton sheqer çdo vit dhe projekti i financimit është rreth 50 milionë euro ndërsa periudha e ndërtimit do të zgjasë rreth 18 muaj. Është planifikuar të punësohen rreth 20 mijë punëtorë që mund të ndihmojnë qytetin e Maliqit ku papunësia dhe vështirësitë ekonomike kanë arritur kulmin e tyre gjatë kësaj kohe dhe kjo mund të jetë një zgjidhje potenciale për shumë familje(Top Chanel, 2014). Maliqi gjithashtu mbetet në kërkim të një identiteti të ri, ndërsa në dallim nga Cërriku që është një qytet i veçuar, favorizohet më tepër nga pozita gjeografike në afërsi me qytetin e Korçës.

Rasti i Kombinatin e Tekstileve Tiranë përveç se prezanton problematikat e tranzicionit post-socialist, paraqet edhe një tranzicion tjetër brenda periudhës e cila për efekt krahasimi me kapitalizmin, tentohet të konsiderohet si homogjene. Siç kemi analizuar edhe më parë, vetë pushteti i asaj kohe ndërmoi revizionime të të ashtuquajturës “periudha sovietike”, duke përfshirë në censure investimet e asaj periudhe, ku për efekt konkretizimi me imazh u përdor kryesisht arkitekturën e stilit stalinist e cila, siç kemi kontaktuar nga analiza e Kap.4, pavarësisht disa përpjekjeve në aplikimin e motivit nacional, ishte treguar tepër e ngurtë duke vënë më tepër në pah karakterin e saj alienizues. Por më tepër se një fenomen i lidhur drejtpërdrejt me arkitekturën, deklasifikimi gradual i shembullit duket se buron prej nevojës së pushtetit për tu rigjeneruar e që në një pike të caktuar duhet ta bëjë mbi veten e vet, duke krijuar ‘shëmbuj’ dhe ‘antishëmbuj’, të cilat në thelb përbëjnë të njëjtat politika urbane, por me një propagandë të azhornuar. Gjithashtu, pas viteve ’60 teksa sfidat e ekonomisë centriste me kufizimin e ndihmës sovietike bëhej gjithmonë e më e prekshme, u zhvillua edhe një fare ‘anti-utopizmi’, i cili në fakt merr hov edhe tek vetë politikat post-staliniste krushoviane. Luigi Za, në studimin e tij me karakter social shprehet “Koha më e shkëlqyer dhe ngazëllyese e Kombinatit ishte nga vete themelimi deri në gjysmën e dytë të viteve shtatëdhjetë. Më pas filloi një rënie e pamëshirshme që çoi drejt fundit. Fati i Kombinat, më shumë se i kompanive të tjera, ishte i lidhur me ndryshimet politike dhe ekonomike në Shqipëri, për shkak të specifikës së tij për të qenë një përfaqësues "simbolik" i një zone banimi/industriale, një modeli të ri jete për punëtorët”, dhe më pas vazhdon: “Jeta e punëtorëve, ashtu siç në fillim kishte përfaqësuar konkretizimin e Shqipërisë "së re" dhe shpërblimin relativ ndaj një populli i cili gjeti dinjitetin e tij aty, më pas u shndërrua progresivisht në treguesin e dështimit të projektit politik të zhvillimit të një shoqërie socialiste "shembullore"(Za, 2012; 86). Ndërsa një autor shqiptar jep më tepër detaje mbi transformimet, duke u shprehur: “Ndonëse propaganda zyrtare rrekej, pak a shumë me

efektivitet, për ta paraqitur klasën punëtore si fitimtare e të lumtur, ishte para syve të të gjithëve se ai realitet nuk ishte parajsë. Në vizionin dantesk Kombinatit kishte për t'i takuar me siguri purgatori, meqë ferri shqiptar ishte gjetiu. Zhurma shurdhuese e makinerive të tezgjahut, duart plot kallo e të nxira nga grasoja, turnet e gjata e masakruese, njerëzit që ndërronin turnet e punës si *zombie*, jeta monotone e periferisë... Puna në fabrika ishte shumë e rëndë. Tek e fundit nuk kishte lista pritjeje për qytetarët e Tiranës, që mezi prisnin të transferoheshin në Kombinat. Ndodhte e kundërta, e jo pa arsye.” Megjithatë shton “Kombinati i kohës së sovjetikëve ishte shumë i ndryshëm nga i mëpasshmi. Pas periudhës së parë (deri në fillim të viteve 1960), kur thithej një ajër më tolerant, i ushqyer nga mirëqenia e jeta hareplotë, erdhën kohë më të vrazhda, racionalizimesh e shtrëngimesh, për të arritur mungesën e ushqimeve në vitet 1980. Nga ana tjetër, ekzistojnë shumë periferi, madje edhe periferitë e periferisë, dhe kombinatsit ishin të vetëdijshëm se u përkisnin atyre të planifikuara, që kishin një qëllim të caktuar në shoqëri.[...] Në qoftë se e kaluara e Kombinatit jetohet nga banorët e saj si e lavdishme, në përhumbjen e sotme bëhet i kuptueshëm frustrimi i tyre, mbi të gjitha ajo nostalgji që idealizon në mënyrë të natyrshme jetën e kohëve të kaluara.” (Devole, 2014)

Realiteti i Kombinatit sot në një farë mase është pasojë e çvlerësimit gradual si pasojë e ‘çensurës’ së aplikuar jo shumë vonë prej lindjes së tij. Dendësimet e ‘superbllloqeve’ me banesa tip 5=katshe karakteristike të banimit intenziv, u shfaqën direkt pas viteve ’70, ndërsa fabrikat shtonin prodhimin duke sfiduar teknologjinë që vjetërohej, Duket si një skenë e filmit ‘Metropolis’ të vitit 1927 prej regjizorit pionier Fritz Lang, por ky qe realiteti që karakterizoi degradimin deri në kolapsin e sistemit. Edhe pse fillimisht pati disa përpjekje për të rivënë në punë sektore të veçantë të fabrikave, u bë e qartë shpejt së industrializimi ishte tashmë jashtë axhendës politike për vitet që do të vijnë. Proçesi i tranzicionit si socialist ashtu edhe post-socialist, ka spostuar pozitat qëndrore urbane të Kombinatit në raport me Tiranën, duke e shndërruar atë në një zonë periferike të saj. Maks Velo ishte ndër të parët arkitektë shqiptarë, i cili trajtoi temat që kishin të bënin me trashëgiminë e realizmit socialist. Si një ish-artist dhe arkitekt I asaj periudhe e më pas i çensuruar e burgosur prej regjimit, Velo duke qenë në njohuri të zhvillimeve post-socialiste në vendet e tjera, trajton problemin në një kënd vështrim tepër realist dhe të emancipuar nga pikëpamja kulturore. Në përmbledhjen e tij të shkrimeve, sjell artikujt ‘Arkitektura e realizmit socialist në Tiranë’ butuar në 2004. Referuar Kombinatit ai shprehet: “Djadhtas ishte hyrja për në kombinat nëpërmjet një porte hark-triumfi. Anash portës-triumf ishin dy kulla që asnjëherë nuk e kuptova përse ishin bërë. Në majë të kullave ishin dy ballkonefanta-ëndërrimtarë. Një arkitekturë surreale, sa false aq dhe pa kuptim. Por kuptimin ajo e merr sot kur duam ta zbërthejmë atë sistem; dhe tani ne e prishëm. Veprat e arkitekturës të bëjnë të kuptosh lehtësisht dhe menjëherë epoka dhe fenomene shoqërore të komplikuar, prandaj edhe popujt e qytetëruar i mbajnë dhe i ruajnë. Këtë ne nuk po e kuptojmë akoma. Nuk ka nevojë të lexosh "Historinë e P.P.SH"-së as veprat e Enver Hoxhës, as dokumentet e marrëdhënieve me kampin. Mjafton të shohësh këto vepra arkitekturore, aty i kupton të gjitha.” (Velo, 2013;136). Velo atyre viteve propozonte një qëndrim të hapur ndaj qytetit, ku theksonte identitetin dhe rolin e tij edukativ për brezat e ri, qëndrim ky thellësisht i distancuar prej qëndrimit dekomunistizues të kohës i cili konsistoi kryesisht në lënien në harresë të asaj periudhe. “Kur janë të gjitha bashkë, jepet një imazh shumë më I koncentruar dhe shumëdimensional i gjithë vlerave dhe i antivlerave, i kërkesave që kishte për atë skulpturë, i ngritjeve, i zbritjeve, i kohës, i diferencave midis sculptures

sonë dhe asaj sovjetike. Të gjitha këto mund të shihen në këtë ekspozim.[...] Kur nuk ka skulpturë, mund të jenë relieve të ndryshme, por i gjithëansambli të fut në atë botë të diktaturës, të vuajtjeve, të përkujtimit të atyre njerëzve.” (Velo, 2013; 263)

Por edhe pse Maks Velo, një personazh tepër aktiv në jetën kryeqytetase në mbrojtjen e trashëgimisë arkitektonike, nëpërmjet shkrimeve të tij ka influencuar në një fare mase opinionin, referuar aktualitetit, përsëri procesi ka hasur në hezitime deri tani të pakuptueshme, duke preferuar më tepër lënien në harresë, se shfaqjen e rikontekstualizuar të arkitekturës, qofte kjo e ‘ndriçuar’ sipas atyre që e krijuan apo e ‘errëta’ e periudhës ku jetojmë. “Më 19 Shkurt 2010 u prezantua projekti më i ri i Bashkisë së Tiranës për kthimin e sheshit qendror të Kombinatit në një zonë me vepra arti. Ideja e këtij projekti është “Një zonë që shërben si një pike kujtese për vuajtjet e shqiptarëve gjatë diktaturës komuniste” dhe u prezantua në 19-vjetorin e përmbyesjes së monumentit të diktatorit E.Hoxha nga qendra e Tiranës. Ende nuk është vendosur se në ç’mënyrë do të prezantohen veprat dhe nëse bëhet fjalë për një memorial, një kompleks muzeal apo edhe mënyra të tjera ekspozimi. Për këtë Bashkia e Tiranës, pritet të hapë edhe konkursin, ku artistë shqiptarë e të huaj pritet të prezantojnë idetë e tyre.” (Velo, 2013; 261)

Por ndërsa çështjet që kanë të bëjnë me rikontekstualizimin e memorjës, në Shqipëri paraqesin ende paqartësitë objektive të distancës relative kohore prej të shkuarës së ‘padëshirueshme’, emergjencat sociale të evidentuara edhe në këtë kontekst, kanë në fakt një shtrirje të gjerë. Sipas Musil: “Duhet theksuar se si pjesë e proceseve të transformimit, ne vërejmë në të gjitha qytetet post-socialiste një kthim të ngadaltë të segregimit social, pa përmendur problemin e vazhdueshëm të papunësisë. Njëkohësisht në disa prej tyre shfaqet një fenomen i ri urban: gentrifikimi. Në të njëjtën kohë duhet theksuar se dallimet midis qyteteve të ish-blokut sovjetik po rriten pas vitit 1989. Sidomos dallimet midis qyteteve të ish-Bashkimit Sovjetik dhe qyteteve të vendeve post-socialiste të Evropës Qendrore janë duke u thelluar. Modelet urbane kulturore dhe shoqërore të periudhës para-socialiste po fitojnë gjithnjë e më shumë ndikim. Koncepti i varësisë së drejtimit është një fenomen shumëshpresor, veçanërisht kur aplikohet për qytete” (Musil, 2005). Shtresëzimi përfaqëson një metodë të bashkëjetesës: realitete të ndryshme që jetojnë në të njëjtin territor. Sipas Frojdit mjedisi përbëhet nga shtresa të ndryshme. Ambienti urban dhe shoqëror post-socialist sidomos shqiptarë, karakterizohet nga një evolucion i fazave të ndryshme të cilat janë të ndara qartë nga njëra-tjetra. Ndonjëherë ato madje nuk i pranojnë zhvillimet e reja. Për shembull, tradita arkitektonike shqiptare është përballur me konfrontime të ndryshme midis këtyre shtresave të përfaqësuar edhe në politikën arkitektonike dhe modelet e ndërtimit. Ndërtesat e reja socialiste ishin kundër modeleve të ndërtimit të Mbretit Zog. Ato denoncuan hapur këto lloj ndërtimesh. Megjithatë, në një mënyrë të fshehtë u shpreh edhe një vazhdimësi e caktuar midis arkitekturave të epokave të ndryshme. Edhe në ditët tona, ne po përballemi me këto lloj konfrontimi dhe pajtimi. Ndonjëherë duket se arkitektura e re bashkëkohore shqiptare nuk pranon asgjë me qëllim që të vazhdojë të zhvillojë rritjen kaotike të imponuar nga ekonomia e re e tregut. Ky lloj i marrëdhënieve është bërë i dukshëm në mjedisin tonë të përditshëm urban dhe kryesisht në qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, Vlora etj., ku fragmentet e reja bashkëjetojnë dhunshëm me shtresat e historike. Aplikimi i politikave totalitare mbi territorin urban provokoi një sjellje të orjentuar drejt masivitetit dhe eliminimit të traditave ekzistuese, duke imponuar një stil të ri që eliminon të parin. Studimi i shtresave homogjene të periudhës totalitare, ndihmon në matjen e produktit kulturor dhe lehtëson studimin e krahasuar të çështjeve që lidhen

me qytetin. Kjo është më e dukshme në ish-qytetet socialiste, që përfaqësojnë ndërtimin homogjen të socializmit në formën e tyre më të pastër, por bëhet edhe më e dukshme në qytet shqipëtare ku bashkëton gjithashtu edhe një bazë prej arkitekturës së periudhës së fashizmit e cila favorizon edhe studimet e kryqëzuara.

Modeli i shtresimit është zhvilluar edhe në shkencat shoqërore nga Castells, por jo duke përfaqësuar perspektiva në nivele, sepse 'shtresat' sipas tij "nuk përfaqësojnë nënsisteme autonome, si në modelin e Heeling. Ky model socio-hapësinor merret me tre lloje të ngjashme strukturash, të përbërë nga rrjedha/flukse të cilat janë "shprehja e proceseve që mbizotërojnë jetën tonë ekonomike, politike dhe simbolike. Nëse është kështu [rrjedhat që mbizotërojnë], mbështetja materiale e proceseve mbizotëruese në shoqëritë tona do të jetë tërësia e elementeve që mbështesin rrjedhat e tilla, dhe duke e bërë artikulin e tyre materialisht të mundshëm në të njëjtën kohë". Modeli pra mund të jetë përfaqësim i një pjese dominuese të sistemit socio-hapësinor. Megjithatë, teoria e shtresim-it përmban dobësitë e veta, kur më të rëndësishmet janë problemet që lidhen me shkrirjen e shtresave të ndryshme dhe formimin e episodeve të ndryshme të pakontrolluara brenda tyre. Në realitetin praktik, hapësira urbane në qytetet totalitare paraqet qartë disa tipare të vazhdimësisë. Megjithëse këto episode shfaqen në mënyrë të pa harmonizuar dhe agresive, nëse i krahasojmë ato me copa të ndryshme të mjedisit urban, mund të verifikohen dy probleme kryesore:

- ndërhyrjet që kanë shkatërruar homogjenitetin e shtresave të konsoliduara dhe që kanë krijuar kufij të ri në disa zona më parë të përcaktuara/definuara.

- problemet e vazhdueshme që shprehin limitet e tyre dhe që në njëfarë mënyre ndeshen me disa kufij të rinj, në territore të reja urbane që nuk i përkasin as të kaluarës e as të tashmes dhe që sot kryesisht janë definuar si realitete post-moderne, kryesisht të shprehura vetëm në kryeqytet - Tiranë.

Sipas Musil (2005), për të përmbledhur transformimet post-socialiste të vendbanimeve dhe sistemeve urbane është në një farë mase më e lehtë se sa gjetja e tipareve të përgjithshme të transformimeve ndër-urbane. Ai bën një listë të ndryshimeve kryesore të sistemit urban në vendet post-socialiste të Evropës Qendrore dhe Lindore: 1) Fundi i politikave të planifikimit urbanistik dhe politikave rajonale të rishpërndarjes rezultuan në rritjen e proceseve të polarizimit. 2) Qytetet kryeqytet dhe qytetet më të mëdha shohin një rritje më të shpejtë se sa në të shkuarën socialiste. Përkundrazi, qytetet e mesme dhe ato të vogla po përballen me rënie në madhësinë e popullsisë, disa në pozicionin ekonomik dhe politik. 3) Fundi i politikave rishpërndarëse rajonale dhe urbane të lidhura me decentralizimin politik në rritje, do të thotë se qytetet varen më shumë se në të kaluarën në potencialet e tyre endogjene ekonomike dhe sociale, në bazën e tyre ekonomike dhe në cilësinë e autoriteteve të tyre lokale. 4) Kryeqytetet dhe disa qytete të tjera të mëdha po rriten falë pozicionit të tyre si porta, kontakteve në rritje ndërkombëtare dhe falë rolit të tyre si vende takimi. 5) Fati i qyteteve të mesme dhe të vogla fillon të jetë i pasigurt dhe varet gjithnjë e më shumë nga vendndodhja e tyre, aksesit në autostradat kryesore, aeroportet etj. 6) Më e vështirë u bë gjendja e zonave të madha urbane industriale, baza ekonomike e të cilave ishte " industria e vjetër "ose minerare, si aglomerimi polak-silesian i sipërm (Polish Upper Silesian). 7) Gjithashtu u bë e vështirë gjendja e qyteteve dhe qytetezave në disa rajone periferike, si p.sh. në juglindje të Polonisë, në verilindje të Hungarisë ose në Sllovakinë lindore, si dhe në qytete të vogla në të ashtuquajturën

periferitë e brendshme të Republikës Çeke. 8) Rëndësia e faktorëve gjeografikë është treguar nga fakti se qytetet e vendosura në pjesët perëndimore të vendeve post-socialiste dhe rrugët kryesore të transportit me Evropën Perëndimore po rriten më shpejt se qytetet e ngjashme në rajonet lindore” (Musil, 2005).

Në dallim nga vendet kapitaliste, suburbanizimi si fenomen i botës perëndimore, me përjashtim të disa episodeve në fund të regjimit stalinist, mund të konsiderohej si një koncept i zhdukur në planifikimin socialist. Në Shqipëri procesi i migrimit u kontrollua prej shtetit në mënyrë rigoroze. Sipas Kostinskiy (2001), në ish-vendet socialiste, proceset e suburbanizimit nuk luajtën një rol kaq thelbësor si në vendet e avancuara kapitaliste. Qytetet socialiste në krahasim me vendet e tyre perëndimore në përgjithësi ishin më kompakte dhe më të populluara. Nuk kishte rivendosje masive të banorëve nga bërthama e aglomerimit në zonën e saj periferike. Në kushtet e kufizimit të vendosjes në qytetet e mëdha, popullsia e zonave të tyre periferike u rrit për shkak të migrimit nga jashtë aglomerateve (nga zonat rurale dhe qytetet e vogla). Por ky fenomen u shfaq furishëm pas ndryshimeve të viteve '90. Në Shqipëri suburbanizimi përfaqësoi një trend dhe njëkohësisht sfidën kryesore në 30 vitet e fundit. Teksa fenomeni që në fillimet e tij u pikas dhe u trajtua me seriozitet nga studiues të fushës, hasi në neglizhencën e autoriteteve të asaj kohe. B. Aliaj etj. në një prej botimeve të para serioze të post-socializmit në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës, veçanërisht mbi këtë problem shprehen: “ Të papunë, të izoluar dhe larg vëmendjes së autoriteteve të qeverisë qendrore, njerëzit nuk kishin asnjë alternativë tjetër përveçse të kërkonin një jetë më të mirë në rajonet më të zhvilluara të vendit: Tokat e Ulëta perëndimore (dmth rajoni bregdetar midis Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës) dhe në veçanti, përreth kryeqytetit (zona e Tiranës, Durrësit dhe Fushe Kruja), e cila ofronte mundësi më të mira punësimi [...] migrimi i pakontrolluar dhe i paplanifikuar nuk u konsiderua përparësi nga qeveria qendrore dhe lokale. Ndarjet administrative, në veçanti bashkia e kryeqytetit të Tiranës, nuk ishin në gjendje t'i përshtaten këtyre ndryshimeve.” Më tej japin të dhëna mbi ndryshimin e popullsisë urbane “në 1945, vetëm 20% e popullsisë jetonte në qytete. Gjatë 45 viteve të projekteve të strehimit komunizmit, popullsia urbane u rrit me 15%, kështu që më 1990, 35% e popullsisë jetonte në zonat urbane. Pas vitit 1990, popullsia urbane është rritur me 0,33% çdo vit, që do të thotë 17% gjatë 11 viteve. Llogaritje të përafërta tregojnë se hapësira e Tiranës e Madhe, me shume mundësi mund të jetë streha e afërsisht 1 milion banorëve në 2005.” (Aliaj et al, 2003; 84-85)

Në fakt, vetë zhvillimet urbane të periudhës së socializmit dhe politika e kontrollit me ligj të lëvizjes së popullsisë, nuk u treguan efektive në shmangien e fenomenit të suburbanizimit dhe karakteri ekspansiv i planeve rregulluese dominoi kryesisht në fillim të viteve '80, kur kërkesa për spostime në qytet u rrit ndjeshëm. Smith në kontekst të gjërë thekson se "forma hapësinore e diferencimit socio-ekonomik të sugjeruar nga provat në dispozicion mund të përmbliidhen si më poshtë. Zonat e brendshme paraqitën një shumëllojshmëri mjedisesh dhe grupesh shoqërore, me një strehim të mirë të kombinuar me akses në mjedisë kulturore për të gjeneruar atë që për shumicën e njerëzve mund të ketë qenë më e mira nga të gjitha botët në Moskë, përveç enklavave të fshehta të elitës. Në kontrast me këtë, ishin zonat e banesave të varfra të brendshme të qytetit, më pak substanciale sesa në qytete të tjera sovjetike, të pushtuara nga njerëz me status social të dukshëm më të ulët se inteligjenca dhe grupet profesionale që prireshin të mbizotëronin në qytetin e brendshëm. Zonat e jashtme u diferencuan nga ndryshime të gjera të cilësisë së mjedisit dhe gjendjes socio-ekonomike, me sektorët më të mirë që kanë përmasa

relativisht të larta të strehimit kooperativ dhe të punësimit që shkojnë me të, banorët sakrifikojnë nivelet më të larta të aksesit në objektet kulturore, pazarit dhe shërbimeve të tjera të qendrës së qytetit për një strehim të ri të cilësisë më të mirë dhe afërsisë me hapësirën e hapur në kufinjt e qytetit. Në sektorët e jashtëm ku mbizotëronte strehimi shtetëror, cilësia e mjedisit ishte më e mirë se në ato zona të vjetra, të brendshme të zëna nga njerëz me status më të ulët të punës, me përjashtim të aksesit të tyre më të favorshëm ndaj shërbimeve. [...] Ky përshkrim sugjeron dy modele të strukturës hapësinore urbane, modele me elementë koncentrike të zonës dhe modelet pikësore” (Andrusz et al, 1996; 81).

Në peizazhin e ri urban shqiptar sot, emergjenca kryesore mbetet urbanizimi i periferive dhe krijimi i hapësirave të reja për zhvillimin urban dhe rritjen e brendshme të qyteteve. Sipas Krier “lëvizshmëria e detyrueshme e masave periferike paraqet një kërcënim për qytetin dhe fshatrat. Ekonomia urbane nuk do të rritet më me zgjerim në fshatrat përreth apo mbizhvillimin e qendrave historike, por nga rizhvillimi, maturimi, hapja dhe deri, përfundimin e rritjes së brendshme të periferive. Ky mund të jetë qëllimi i një qytetërimi vërtet "ekologjik".” Më tej Krier propozon rrugëzgjdhje duke shprehur se “Transformimi i periferive do të mundësohet nëpërmjet shfuqizimit të praktikave funksionale të zonimit, riformulimit të planeve të përdorimit të tokës dhe rishikimit të programeve të zhvillimit urban. Riorganizimi policentrik i qyteteve, pra transformimi i periferive të pazhvilluara në lagje dhe fshatrat autonome urbane, do të jetë shtysë për një proces të transformimit territorial, rritjes së brendshme dhe lulëzimit të periferisë. Kjo do të sjellë sasi të mëdha të shtëpive njëfamiljare, banesave publike dhe bizneseve monofunkionale, zonave arsimore, tregtare dhe industriale në dispozicion për rizhvillim. Në këto fusha specifike planet zhvillimore ekologjike do të lejojnë krijimin e strukturave dhe funksioneve që mungojnë individualisht dhe që janë të nevojshme për ekonominë e tyre, jetën në komunitet dhe autonominë e tyre funksionale” (Krier, 2009; 109).

Problemet me tregun e tokës kanë ndikuar edhe në fizionominë e qyteteve të reja. Siç thekson Smith “në qytetin socialist nuk kishte treg të tokës dhe të gjitha format e përdorimit të tokës ishin mbikëqyrur nga autoritetet shtetërore. Mungesa e një tregu të tokës nënkupton mungesën e një mekanizmi efektiv për kalimin nga mjetet më pak ekonomike tek ato më ekonomike për përdorimin e tokës. Si rezultat, dendësia e banimit nuk zvogëlohet me distancën nga qendra në kufi me qytetin madje shpesh rritet. Kjo është e kundërta me atë që shihet në qytetet perëndimore, që funksionojnë nën kushtet e një ekonomie tregu. Për më tepër, banorët e blloqeve shumëkatëshe që ndodhen në skajet e zonave urbane të qytetit nuk shpërblehen për distancën e tyre të gjatë të udhëtimit me ambiente ekologjikisht më të pastra dhe estetikisht më të këndshme. Fabrikat dhe magazinat e vendosura pranë qendrave të qytetit nuk kanë stimul ekonomik për t'u tërhequr jashtë kufijve të qytetit, pasi toka i kushton atyre praktikisht asgjë” (Andrusz et al, 1996; 81). Ndërsa Kostinskiy jep sygjerimet e tij në kvte mënyre: “Në ekonominë e re, problemet me tregun e tokës kanë shkaktuar shumë ngërçe, veçanërisht sepse në disa nga qytetet e mëparshme socialiste ende nuk mund të blihet ose shitet: aty mund të jepen vetëm me qira. Megjithatë, në praktikë problemi i përcaktimit të pagesave të tokës ende ekziston. Kështu, problemi më urgjent dhe dominues i zhvillimit të tregut të strehimit është përpunimi i një politike bashkiake të orientuar drejt tregut. Natyrisht ideali do të ishte një politikë e cila krijon një treg masiv të të drejtave të tokës në dispozicion për mbarë vendin. Por, meqë autoritetet e shumë qyteteve nuk janë të përgatitur për të ndjekur këtë lloj politike, fillimisht do të ishte e kënaqshme riorientimi i konceptit 'centripetal'

të zhvillimit urbanistik dhe të futej në mekanizmat e llogaritjes së kërkesës reale territoriale të ndërtuesëve dhe blerësve të të gjitha llojeve të pasurive të paluajtshme, përfshirë strehimin” (Kostinskiy, 2001; 460).

Problematikat e konkurrencës urbane midis qendrave të mëdha e të vogla, pavarësisht propagandës e cila kërkonte ti jepte karakter horizontal politikave në lidhje me territorin, gjejnë bazën e tyre në aplikimet konkrete të viteve që pasojnë vrullin e themelimit të qyteteve të reja. Rreth viteve 70’ pas kolektivizimit, në Shqipëri u përhap parrulla ‘ta bëjmë fshatin më të bukur se qytetin’, por realiteti tregoi të ishte shumë i ndryshëm duke konsideruar dyndjen urbane që trajtuam në paragrafit parardhës. Sipas Kostinskiy “modelimi unik i zhvillimit të qyteteve në vendet ish-socialiste, nuk ishte vetëm për mungesën e mekanizmave në ekonominë e tregut, por edhe për zbatimin e një politike të veçantë urbane. Kjo politikë kishte si objektiv afatgjatë zhvillimin unik të vendbanimeve dhe eliminimin e dallimeve sociale lidhur me kushtet e jetës mes qyteteve dhe zonave rurale. Por “në praktikë kjo politikë u shpreh në strategjinë e rritjes së kontrolluar të aglomerateve urbane dhe përmbajtjes së rritjes së popullsisë në qytetet më të mëdha. [...] Rritja e një qyteti tani mund të shihet se ndikohet nga funksionet e tij të veçanta ekonomike, pozicioni gjeografik, gjendja e infrastrukturës së tij, lehtësitë mjedisore dhe 'efikasiteti' i veprimtarisë së qeverisjes vendore.” Më tej vazhdon, se në shumë aspekte ekonomia socialiste favorizoi rritjen e qyteteve të mëdha. Para së gjithash, kjo rritje ishte për shkak të zhvillimit të bazës industriale të qyteteve, veçanërisht ajo e manifakturës. Së dyti, rritja e qyteteve të mëdha ishte në shumë aspekte e përcaktuar nga fokusi intensiv i funksioneve administrative në to. Dhe së treti, qytetet e mëdha po merrnin pjesën më të madhe të investimeve në infrastrukturë (përsëri në kurriz të qendrave me përmasa më të vogla). Kostinskiy arrin në përfundimin se “pavarësisht nga fakti se në qytetet dhe aglomerimet e mëdha urbane, tregjet e punës janë më të balancuara se jashtë tyre, nuk duhet të harrohet se gjatë periudhës së tranzicionit këto kanë humbur një numër të madh të vendeve të punës. Së dyti, një rënie e mëtejshme në ndërtimin e banesave ka rezultuar nga ndërprerja e subvencioneve shtetërore. Së fundi, kostoja e jetesës në qytetet e mëdha është dukshëm më e lartë se në ato më të vogla, ndërsa mallrat dhe shërbimet e konsumit që kanë qenë në një furnizim kaq të kufizuar, tashmë janë bërë të arritshme edhe në qytete të vogla (udhëtime të mëparshme në një qytet të madh dhe në kryeqytet ishin të nevojshme)” (Kostinskiy, 2001; 463).

Realiteti shqiptar i dekadës së parë të tranzicionit u karakterizua përgjithësisht nga një mungesë e interesit për planifikimin e qytetit duke ju referuar kryesisht planeve të fundit të lëna prej sistemit të kaluar. Siç evidentuam më sipër, gjatë kësaj periudhe ambjenti urban paraqet një fazë eksperimentimi, teksa politika rrekej ti jepte përgjigje problemeve të kalimit të pronësisë. Gjatë dekadës së dytë vihet re një lloj ndezje e interesit për kontrollin e zhvillimit urban që erdhi edhe si pasojë e deformimeve të dukshme që sollin periudha e parë. Studime urbane siç ishte Masterplani për Qendrën e Tiranës i vitit 2002 nga Architecture Studio I cili rezultoi fitues prej një konkursi ndërkombëtar, risollën optimizmin për një rikthim të interesit drejt qyteteve egzistuese në kushtet e ekonomisë së re, teksa sfidat drejt saj kanë gjetur telajon e tyre të ekzekutimit sërisht në qytet. Sipas Leon Krier 'plani, horizonti dhe arkitektura e një lagje urbane rregullohet nga masterplani. Ky nuk është një projekt arkitektonik, është kusht paraprak për integrimin e projekteve të panumërta arkitektonike në një kompleks koherent urban, instrument që është i nevojshëm për të ruajtur harmoninë e tërësisë. Ai është më shumë se një mjet teknik; shumë masterplane të përkryer teknikisht gjatë viteve të pasluftës çuan në ekzaktësisht të

kundërtën. Një tejkalim arbitrar i rregullave shkon drejt tiranisë dhe më pas refuzimit.” Më tej vazhdon duke shprehur pikëpamjet e tij mbi kuptimin dhe përmbajtjen: “Për të garantuar efikasitetin e tij, masterplani duhet të ketë thjeshtësinë rrënjësore të parimeve morale. Ai ndahet në pesë pjesë: 1) Një plan për qytetin, që përcakton madhësinë dhe formën e lagjeve dhe parqeve urbane dhe rrjetin e rrugëve, bulevardëve dhe korridoreve peizazhistikë. 2) Një plan pjesor, duke përcaktuar rrjetin e rrugëve, shesheve dhe blloqeve. 3) Forma e ploteve individuale në secilin bllok urban: numri, forma, dhe lloji i përdorimit dhe lokacioni i kateve që mund të ndërtohen për çdo parcelë. 4) Kodi arkitektonik që përshkruan materialet, konfigurimet teknike, përmasat për elementët e jashtëm të ndërtesës (muret, çatitë, dritaret, dyert, portikujt, portat, muret e kopshtit, oxhaqet) dhe të gjitha elementet e ndërtruara që janë të dukshme nga hapësirat publike. 5) Kodi për hapësira publike, përcaktimi i materialeve, konfigurimeve, teknikave dhe dizenjove për shtrimin, mobilimin e rrugëve, shenjat, ndriçimin dhe mbjelljet”(Krier, 2009;121). Krier arrin në përfundimin se masterplani është instrumenti më i rëndësishëm dhe influent në rregullimin e territorit urban duke theksuar interesin publik të tij, por ai njëkohësisht evidenton problemet në mënyrë si zhvillohet procesi në realitet duke u shprehur se: “hipertrofia e sektorit publik, në dëm të sektorit privat, ka çuar në një hollim të konceptit të hapësirës publike. Planifikimi i masterplanit është një çështje legjislative dhe kushtetuese. Arkitektët dhe planifikuesit që punojnë për zhvilluesit e tokave private i shërbejnë interesave private; në këtë varësi ata nuk mund të veprojnë me të vërtetë si ligjvënësit publikë. Teknikisht, dhe në përputhje me kuptimin e plotë të titullit, autori i një masterplani duhet të ketë pavarësinë e një ligjvënësi, besnikëria e tij të jetë në interesin publik dhe jo vetëm për interesat e aksionarëve private” dhe në tej konkludon “një masterplan duhet të jetë një sintezë tre dimensionale, një kornizë legjislative dhe publike për zhvillimin optimal të interesave të veta dhe autonomisë. Duhet të përcaktojë kufijtë gjeografikë, ekologjikë, socialë dhe volumetrik përtej të cilave vendbanimet nuk duhet të rriten” (Krier, 2009; 217).

6.4. Ruajtja historike dhe konfrontimi me të kaluarën

Shqipëria, si shumë vende të tjera post-socialiste, prej shumë vitesh përballet me sfida të përditshme dhe diskutime të nxehta në lidhje me zhvillimet e ardhme të qyteteve dhe ruajtjen e trashëgimisë urbane dhe arkitektonike nga e kaluara. Këto debate ishin të pranishme edhe gjatë komunizmit megjithatë, ato kishin një qasje tjetër e cila bazohej kryesisht në një ‘ruajtje historike’, sesa në një program të trashëgimisë kulturore. Ideja komuniste për të kaluarën ishte ta ruante ashtu siç ishte, dhe duke marginalizuar atë nga e gjithë pjesa tjetër e qytetit. Edhe pse janë alokuar fonde për restaurimin dhe ishte zhvilluar një brez I kualifikuar restauratorësh, përsëri nga pikpamja e komunikimit me aktualitetin, trashëgimia kulturore mbeti e izoluar në historinë e saj. Gjatë komunizmit lagjet dhe objektet e të kaluarës shërbyen si një muze i izoluar, që nuk kishte të bënte me jetën e re që dëshironin të ndërtonin dhe me inkuadrimin e përparimeve shoqërore që ata kishin për qëllim. Shumica e ndërtesave historike u shkatërruan për të ndërtuar ndërtesa të reja uniforme dhe shumë pak prej tyre shpëtuan dhe u ruajtën në mënyrë të izoluar. E kaluara ishte aq e izoluar sa nuk mund të ndërvepronte me të rejtat, dhe e reja nuk kishte rrënjë në të kaluarën. Drejt fundit të viteve '60, me ngritjen e kultit të individit të diktatorit E. Hoxha, filloi një fushatë për përfshirjen e elementëve të folklorit të cilat u reflektuan në arkitekturën moderne me vepra si Pallati i Shkrimtarëve nga arkitekti Maks Velo, i cili në fakt shënon edhe “fillimin e represionit ndaj kulturës me tendenca modernizuese dhe ndjekjen e rrugës radikale” (Fagu & Nepravishta, 2020). Megjithatë, më të gjitha këto

shkëputje, siç kemi trajtuar më parë me rastin e Tiranës dhe Kombinatit (në Kap.3;4), brenda kompetitivitetit të tyre mund të vërehen disa vazhdimësi në ndërtimet mes periudhave sidomos ato që i përkasin ideologjive. Periudha socialiste në Shqipëri nuk ishte homogjene dhe huazoi shumë modele jo vetëm nga Bashkimi Sovjetik, por edhe nga regjimet e mëparshme. Ata përvetësuan nga ndërtimet e mëparshme, atë që u konsiderua si e dobishme për proletariatin. Kjo është edhe arsyeja pse në sot trshëgojme ende një pjesë të mirë të prodhimit ndërtimor të kohës së Zogut apo të pushtimit fashist. Nëpërmjet metodash të dyshimta të cilat janë përmendur edhe më parë, këto objekte ja kanë mbërritur ti mbijetojnë furtunave radikale mbi qytetin, here duke ndërruar funksion e here duke ju rikthyer përdorimeve të mëparshme, por duke siguruar një vazhdimësi memorie e cila kalon përtej funksionit dhe kuptimit të tyre historik momental.

Dilema kryesore që trashëgimia e këtyre qyteteve përfaqëson sot ka të bëjë me proceset e modernizmit social dhe ruajtjes kulturore ose historike. Kjo impikon nevojën e një procesi të detajuar kualifikimi të trashëgimisë socialiste. Siç thekson Krier në debatin e tij për modernizmin dhe kujtesën: "parë nga një distancë e caktuar dhe nën një dritë të mirë, edhe një qytet i shëmtuar mund të duket si toka e premtuar.[...] Për projektin arkitektonik kujtesa nuk është as parim moral as detyrim; nuk është arkiv i dëshmisë së vdekur; në të kundërtën është një instrument i njohurisë dhe dijes; paraqet një inventar të pashtershëm të zgjidhjeve praktike dhe estetike që i përgjigjen problemeve të përsëritura të vendeve të ndërtimit; është shtëpia e thesarit së artit të ndërtimit" (Krier, 2009; 75).

Në rastet e qyteteve të reja socialiste që u prezantuan në pjesë të tjera të këtij studimi, qendrat e tyre urbane ishin të parat që iu nënshtuan ndryshimeve demokratike. Në memorjen e qytetarëve të Tiranës mbeten të ngulitura thellë momentet e rrëzimit të busteve të diktatorëve që në mënyrë simbolike dhe tepër të kulturuar ezauruan urrejtjen për sitemin kundrejt vetë simbolikës që e përfaqësonte. Sipas Czepczynski "risitë stilistike" ishin të shoqëruara me një numër monumentesh, që synonin të bëheshin pika fokale e qendrave të reja urbane, duke shtuar tekste të kuptueshme për vendin. Monumentet madhështore u ngritën për Stalinin ndërsa ai ishte ende gjallë [...] Udhëheqësit lokal konkuruan për të kënaqur mjeshtrat sovjetikë dhe riemëruan rrugë, sheshe, qytete dhe male me emrin Stalin ose aleatët e tij" (Czepczynski, 2008; 95). Nga ana tjetër ky transformim që regjimi totalitar i bëri qytetit, nxiti shume urrejtje e cila u reflektua disi edhe mbi ndërtesat, kryesisht në formën e një eliminimi të pandërgjegjshëm i peizazheve të padëshiruara. Identiteti i kaluar i tyre si rezultat i këtij procesi bëhet më i padukshëm duke i lënë vend spekulimit. Shumë ndërtesa historike janë lënë qëllimisht të prishen ngadalë. Ndërkohë që qëndrimi i komunistëve ndaj qytetit, nuk ishte kështu në fillimet e tij, por e kundërta aty ku nuk prishte planet e tyre, duke e konsideruar atë si një resurs edhe pse të zhveshur prej karakteristikave kulturore. Sipas Groys (2011), qëndrimi i liderëve bolshevikë ndaj trashëgimisë borgjeze dhe kulturës botërore në përgjithësi mund të përmbledhet si më poshtë: të marrë nga kjo trashëgimi atë që është' më e mira 'dhe' e dobishme për proletariatin ' dhe ta përdorë atë në revolucionin socialist dhe në ndërtimin e botës së re. Më tej vazhdon: "në të kundërtën, për ideologët bolshevikë, pika zero ishte realiteti përfundimtar. Arti i së kaluarës nuk ishte historia e gjallë që mund të shërbente si udhërrëfyes për të tashmen, por depoja e gjërave të mbetura nga të cilat çdo gjë që dukej tërheqëse ose e dobishme mund të selektohej sipas dëshirës. Në kohën e Stalinin thuhej shpesh se Bashkimi Sovjetik ishte mbrojtësi i vetëm i

trashëgimisë kulturore që vetë borgjezia kishte refuzuar dhe tradhtuar” (Groys, 2011; 41).

Në rastin e qyteteve shqiptare të parat që iu nënshtruan modifikimeve shkatërrimtare ishin zonat historike para-socialiste, të cilat kishin një dendësi të ulët ndërtimi ndërkohë që favorizojnë prej afërsisë me qendrën. Deklasifikimi kulturor që ju bë qytetit historik në Kështu periudhën e komunizmit, sot është shndërruar në një akt fizik ndaj tij. Kështu pasi këto zona kanë kaluar nëpër një proces shkatërrimi për arsye ideologjike tani po vuajnë probleme të tjera të tilla si humbja e kujtesës apo ndryshe të një ‘amnezie urbane’ me natyrë komerciale. Siç ndodhi në vendet e tjera të Evropës Lindore, procesi i eliminimit të peizazheve të padëshiruara, u konkretizua me lënien e zonave historike në degradim të ngadaltë. Sipas Czepczynski (2008), qindra pallate dhe kala, manastire, kisha dhe mbi të gjitha shtëpitë e qytetit mbetën praktikisht pa pronarë, ose pronarët u privuan nga burimet financiare për të rinovuar dhe modernizuar stokun. Ky shkatërrim gradual, por i vazhdueshëm mund të quhet Havanizim, pasi kryeqyteti Kubanez është ndoshta shembulli më i njohur i procesit. Zakonisht u deshën disa dhjetra vjet derisa ndërtesat të ishin të pamundura për t’u restauruar dhe rinovuar. Meqenëse nuk kishte tokë me qira, nuk kishte presion tregu, dhe karakteristikat e padëshiruara të peizazhit u lanë të prishen dhe përfundimisht të harrohen. Lëvizja e prezervimit në botë filloi pas Luftës së Dytë Botërore dhe me maturimin e modernizmit. “Nga 1970, ruajtja kishte avokatë të fortë dhe fitoi një profil gjithnjë e më të fuqishëm politik dhe akademik në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë. Në vitin 1972, një traktat ndërkombëtar i quajtur Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore u miratua nga UNESCO” (Ching et al, 2011; 787).

Është e rëndësishme të përmendim shkurtimisht disa informacione mbi rolin e Shqipërisë në Organizatën Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara (UNESCO). Edhe pse një anëtar i kësaj organizate, Shqipëria ka ratifikuar shumë vonë Konventën e vitit 1972 në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore. Ajo e ratifikoi këtë konventë vetëm në vitin 1989, pra në muajt e fundit të regjimit socialist duke e përdorur sërish kulturën për politikë bërje, edhe pse më së fundmi me pikëpamje integruese. Tipari më i rëndësishëm i Konventës së Trashëgimisë Botërore të vitit 1972 është se ai “bashkon së bashku në një dokument të vetëm konceptet e ruajtjes së natyrës dhe ruajtjen e pasurisë kulturore. Konventa njih mënyrën në të cilën njerëzit ndërveprojnë me natyrën dhe nevojën themelore për të ruajtur ekuilibrin mes të dyve” (Unesco, n.d.). Aktualisht, në Listën e Trashëgimisë Botërore janë dy pasuri kulturore brenda territorit të Shqipërisë: Butrinti nga viti 1992 dhe qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës (2005). Ekzistojnë edhe katër pasuri të tjera të paraqitura në listën paraprake të organizatës së UNESCO-s: (1) Varrezat e Selces së Poshtme (1996); (2) Amfiteatri i Durrësit (1996); (3) Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Rajonit të Ohrit (2011); (4) Qyteti i lashtë i Apollonisë (2014). Megjithëse për arkeologjinë, interesat e organizatave ndërkombëtare dhe të qeverisjes qëndrore e vendore, kanë qenë më të mëdha, është e rëndësishme të përmendet se shumë pak përpjekje janë bërë për të ruajtur ndërtesat e ndërtuara gjatë regjimeve totalitare. Pushteti komunist ndërtoi kryesisht shumë muze për të lavdëruar Luftën e Dytë Botërore dhe rolin e Partisë në të. Por trashëgimia e asaj që u akumulua si njohuri para kësaj periudhe u eliminua dhe u ndalua të përdoret, apo u deformua për t’ju përshtatur një përdorimi të ri që shpesh shkonte diametralisht kundra me të parin. Arkitektura totalitare fashiste bazoi arkitekturën e ndërtesave të reja në Shqipëri duke marrë disa elementë lokalë nga tradita lokale. Në arkitekturën e tyre racionale ishte e

zakonshme kërkimi i rrënjëve kombëtare të cilat u pasqyruan edhe në ndërtesat e reja të ndërtuara në vitet 1928-1941 dhe në planifikimin urban të qyteteve shqiptare. Legjislacioni shqiptar për trashëgiminë kulturore ka pësuar ndryshime të vazhdueshme gjatë tranzicionit, por vetëm në vitin 2015, Ish-Kombinati i Tekstileve, figuron në listen e monumenteve të qarkut Tiranë me numër listor Nr.244, si monument të kategorisë së dytë. Ndërsa Maliqi, teksa degradon akoma nuk e gëzon atë status të tillë dhe aq me pak Cerriku. Ndërkohë që ndërhyrjet mbi këtë pjesë të qyteteve vazhdojnë të deformojnë çdo vlerë të tyre, nevojitet një agendë e veçantë shumëplanëshe si nga pikëpamja restauruese-ndërtimore po ashtu edhe informuese kulturore pvr të ndihmuar komunitetet të krijojnë një raport më realist dhe të stabilizuar më territorin urban. Kjo do të influencojë ndjeshëm në rigjetjen e raportit të njeriut me vendin dhe përdorimin e tij mbi bazën e prirjeve reale. Nga ana tjetër gabi mi së shkuarës nuk ka si mos të jetë një kosto e aktualitetit, politika nxitëse dhe financime bëhen të nevojshme sidomos në realitetet më periferike, për të rindezur motorin ekonomik aty ku është e mundur dhe ku ka brum për zhvillim. Ajo që bëhet e qartë nëpërmjet këtij studimi është se egziston një kapacitet për tu historizuar i tyre, i cili merr gjithmonë e më tepër kuptim sa më tepër shoqëria distancohet prej sistemeve dhe e sheh qytetin si një e mire publike. Fakt mbetet se 30 vite tranzicion, nuk kanë regjistruar ende lindjen e një qyteti të ri.

Sipas Krier “Vlera e monumenteve të lashta nuk qëndron në moshën materiale, por në cilësinë e ideve që ato i mishërojnë. Një rindërtim identik me llojin dhe cilësinë e njëjtë të materialeve, formave dhe teknikave që janë përdorur në origjinal ka më shumë vlerë se një origjinal në gjëmatra. Ajo që na shtyn në një monument të lashtë është modernizmi i vazhdueshëm i tij, aftësia e tij për të folur me ne dhe për të na lëvizur pavarësisht nga moshja, fuqia për të kapërcyer antikitetin e tij material. Iniciatorët nuk ishin ndërtues të rrënojave.” (Krier, 2009;79). Ndërsa sipas Butterfield, “pikëpamja se kujtesa është një pengesë për modernitetin ka qenë e përhapur gjerësisht nga arkitektë, artistë dhe teoricienë. [...] Plani i qytetit mund të përcaktojë një shesh që është vendosur mirë dhe që mund të ketë cilësi të përkujtimit (memorialit), por ju nuk duhet të keni një monument në të [...] Monumenti është edhe një përvojë personale, edhe një përvojë kolektive [...] Është një dëshmi se e kaluara është e vërtetë dhe se e kaluara është ende e pranishme” (Butterfield, 2003). Rossi e lidh praninë e monumentit me ritin që ekzekutohet në të. Për atë, riti është me i rëndësishëm se skena fikse”, ai besonte se 'rëndësia e ritualit në natyrën e tij kolektive dhe karakteri i tij thelbësor si një element për ruajtjen e mitit, përbën një çelës për të kuptuar kuptimin e monumenteve [...] nëse rituali është i përhershëm dhe ruajtja e elementit të mitit, atëherë po ashtu është edhe monumenti, pasi që në momentin që ai dëshmon për mitin, ai i bën të mundshme format e ritualit” (Rossi, 1982; 24). Për Rossin “njerëzit duhet të kërkohen kuptim në monumentet, arsyen e tyre, stilin e tyre dhe historinë e tyre. Më tej vazhdon, “vetë qyteti është kujtesa kolektive e popullit të tij dhe kujtesa është e lidhur me objektin dhe vendet. Qyteti është lokusi i kujtesës kolektive”. Por qyteti nuk mund të egzistojë në kundërshtim me kohën. Leximi i prirjeve dhe flukseve mbetet thelbësor në këtë proces, ky përafrim përbën edhe ndryshimin thelbësor nga planifikimet e periudhave totalitare. Sipas Rossit “si gjithmonë një marrëdhënie krijohet midis objekteve urbane që e strukturojnë qytetin dhe vendosjes së një projekti ideal apo skene të përgjithshme, por modeli i kësaj marrëdhënieje është kompleks. Sigurisht që ka qytete që kuptojnë prirjet e tyre dhe të tjerët që nuk e bëjnë këtë” (Rossi, 1982; 130)

Nga ana tjetër, monumentaliteti i shkuar dhe zhvillimet kaotike të së tashmes, provokojnë dëshirën për monumentalitete të reja. Leon Krier zhvilloi idenë e monumenteve të vërteta dhe të rreme. Për atë “rrokaqiejt (skyscraper) utilitare dhe 'tokë-kruajtësit (land-scraper)' janë monumente të rreme. Ato janë mbivendosje e përqendruar horizontale dhe vertikale të një funksioni utilitar nën një çati të vetme. Jo vetëm që lakuriqësia simbolike zbulohet përmes mureve të hollë të perdes, por karakteri utilitar i vëllimeve të tyre të trashë poshtëron dinjitetin dhe gradën e ndërtesave publike. Ndërtesat qytetare, arena, tempuj, teatro, faltore, biblioteka, kisha, obelisket, shatërvanet, muze, terme, memoriale, terminale dhe ura, janë elementët e vërtetë simbolik dhe publik në një qytet. Ato janë objekte të privileguara dhe ekskluzive të arkitekturës monumentale. Sheshet publike dhe horizonti (skyline) i qytetit janë sfera dhe skena e privilegjuar e tyre, protektoratet e tyre të shenjtë. Monumentalizmi i rrejshëm i rrokaqiejvë utilitar zbulon kotësinë e vet në lartësinë e tavaneve të saj dhe madhësive të dhomave. Cilado qofshin pretendimet e saj arkitektonike, një qendër tregtare periferike, kurrë nuk do të fitojë ndonjë vlerë simbolike të rëndësishme pavarësisht nga veshja e saj arkitektonike, qoftë tregtare, nautike, ose "dekonstruktiviste". Kur gjendet në një brez komercial, qëllimi i tij e pengon atë të fitojë kuptim tjetër përveç funksionit të tij utilitar” (Krier, 2009;34). Krier shton se 'bukuria monumentale dhe dinjiteti i një qendre historike nuk do të mbijetojë duke u shndërruar në një lagje thjesht banimi, tregëtare, biznesi apo argëtimi. “Përqendrimi i tepruar i një funksioni të vetëm utilitar nuk mund të krijojë monumentalitet të vërtetë; edhe akumulimi monumental i njësisve private të banimit (pavarësisht nëse ato financohen publikisht ose jo) nuk do t'u japë atyre status të vërtetë qytetar” (Krier, 2009;35). Kjo do të thotë se ish-qytetet e reja socialiste nuk mund të përfaqësojnë monumentalitet për shkak të funksionalitetit të tyre, por për shkak të historisë që ato përfaqësonin, aftësisë për ta komunikuar atë e për t'ju përshtatur realitetit të ri. Sipas antropologut kulturor Ditchev i cili lokalizon më tepër çështjen, “monumenti është rasti tipik i imitimit të formave kitsch në Ballkan të cilave u mungon përmbajtja”(Ditchev, 2015). Ai jep disa shembuj nga Bullgaria ku edhe pse ushtria sovjetike nuk kontribuoi në çlirimin e saj, ende në ditët tona janë ndërtuar monumente për 'çlirimtarët' - dhe kjo bëhet duke ndjekur modelin stalinist. Sipas tij, ky model është imituar edhe nga protobulgarë të tjerë që janë përpjekur të ringjallin disa nga personazhet e librave të historisë. "E gjithë kjo është në funksion të nevojës për të rimarrë, pastaj për të demonstruar se kemi atë që evropianët kanë. Dhe se ne jemi kombe krenar, njësoj si evropianët, edhe pse në fakt ne urrejmë të gjitha institucionet tona dhe inteligjencën tonë. Por, në vend të kësaj, kemi çdo hero tonin të vrazhdë në çdo shesh”(Ditchev, 2015).

Shumë arkitektë shqiptarë bien dakord që të ruajnë në formën e trashëgimisë kulturore apo më mire si shëmbuj të “antikulturalizmit” pjesët më përfaqësuese të ish-qyteteve socialiste duke i pare ato si një libër i hapur për nga vlera e tregimit të historisë. Siç u përmend pak më sipër për rastin e Kombinatit, Maks Velo duke evidentuar rëndësinë historike dhe vlerën e qytetit në paraqitjen e saj në një mënyrë të kuptueshme dhe më të lexueshme për publikun e gjerë, ishte një prej idhëtarëve të konservimit dhe evidentimit të faktorëve historik, si një mënyrë efektive për të shmangur idealizimin e saj dhe keqinterpretimin. Siç thekson Kopp në “Evropën Perëndimore, qëllimi kryesor i fuqisë së krijuar nga individëve me ndikim të caktuar nuk ishte të transformonte botën, por të mbante atë në strukturat e saj të vjetra. [...] Qëllimi i atyre që kanë rritur pushtetin [në Evropën Lindore] është të ndërtojnë një shoqëri të re, një shoqëri socialiste dhe në këtë rast duket pothuajse menjëherë nevoja

për t'i ofruar kësaj shoqërie një mjedis të ri" (Kopp, 1987;34). Nga ana tjetër ky mjedis, gjatë transformimeve post-socialiste ka humbur autenticitetin në shumë pjesë të tij. Për Krier (2009) është vetë industrializimi dhe zhbërja e artizanatit që sjell në këtë rast konsumimin e imazhit të brishtë të trashëgimisë së periudhës moderne. Ai shprehet se: "antagonizmi më i rëndësishëm që ekziston në arkitekturën sot nuk është midis traditës dhe modernizmit, por midis kulturës tradicionale dhe karikaturës së saj. Industria e ndërtimit ka zëvendësuar pothuajse në mënyrë universale: (1) teknikat e ndërtimit me mure mbajtës me ndarjen e strukturës mbajtëse nga fasada e jashtme; (2) materialet natyrore të ndërtimit nga zëvendësuesit artificialë. Reduktimin e mureve të jashtme në ekrane të thjeshta, lëvizje të vogla por të vazhdueshme diferenciale midis skeletit dhe lëkurës dhe zëvendësimin e materialeve natyrore me materiale sintetike me cilësi të ulët, kanë rezultuar jo vetëm në pamje moderniste, por edhe në ndërtesa në dukje tradicionale që janë të brishta dhe të prekshme, me jetëgjatësi të kufizuar dhe kosto të larta të mirëmbajtjes. Ato shpesh transformojnë ndërtesat me pamje tradicionale në fallco autentike, duke rezultuar pothuajse gjithmonë në kitsch postmodernist apo tradicionalist. Kriza e autenticitetit, e shkaktuar nga pamjaftueshmëria midis teknologjisë së ndërtimit dhe aparençës arkitektonike, ndikon në një analizë më të afërt të gjitha stilet bashkëkohore të arkitekturës, duke përfshirë ato të modernizmit. Pamja e tyre e industrializuar rrallë është rezultat i proceseve të vërteta industriale.

Sipas Ditchev(2015), kiçi në Ballkan është i rëndësishëm sepse elitat nuk janë autentike. Ai thekson se kitsch sipas tij "është një imitim global në botën moderne. Në këtë botë nuk është e rëndësishme ajo që ke, por se si vlerësohet ajo nga të tjerët. Më e mira që mund të kemi është ajo që ka një kosto të ulët. Kjo procedurë është e njëjtë me ata njerëz që, duke mos qenë në gjendje të udhëtojnë për në Venecia, ta kompensojnë këtë duke ekspozuar një gondolë si orendi zbukuruese në dhomën e tyre të jetesës. Për Ditchev, "Ballkani është një nga periferitë më të vjetra të një Evrope moderniste. Dhe kjo periferi për më shumë se një shekull ndjek një politikë kulturore e cila në thelb shkon drejt prodhimit të kiçit. Ajo që është lokale zakonisht shmanget duke adaptuar atë prestigjiozen e huaj, kështu që në rajon janë ndërtuar kombe. Si instrumente shërbejnë: udhëheqës në kuaj bronzi ose gjeneralë sovjetikë (me bazë në rajon), opera të stilit barok, afreske klasike, himne kombëtare dhe poetë kombëtar 'paqësorë'. Në një mjedis të panatyrshëm, mallra të tillë të importuar ose dekorime të reja nuk duken vetëm si të huaja, por edhe të paekuilibruara, siç është ndërtesa e Parlamentit në Tiranë, që ka dizajnin e saj të brendshëm me mobilje baroke ose ndërtesat monumentale të Bankës Kombëtare të Greqisë" (Ditchev, 2015). Siç tregon Krier, "thyerja ontologjike midis pamjes dhe realitetit prodhon banalitet. Thellësia tipologjike, morfologjike dhe tektonike e arkitekturës tradicionale është zëvendësuar me një thellësi sipërfaqësore. Teknikat tradicionale të ndërtimit dhe materialet natyrore janë të domosdoshme për të siguruar integritetin strukturor, arkitektonik dhe estetik. Investimi fillestar relativisht më i lartë përgjithësisht justifikohet nga rritja qëndrueshmërisë, dhe shpenzimet e zvogëluara të mirëmbajtjes, dhe përfundimisht nga një ndërtim më i këndshëm dhe më i mire" (Krier, 2009; 37). Sipas tij riorganizimi dhe rindërtimi i zonave të organizuara keq do të lehtësojë presionin e pasurive të paluajtshme në fshatrat e peisazhin e hapur dhe në qendrat historike, të cilat, sipas definicionit, kanë arritur zhvillim optimal në lidhje me dendësinë, format, funksionet dhe stilet. Për Krier, rivlerësimi dhe konsolidimi i trashëgimisë arkitektonike është thelbësor në definimin e identitetit dhe duke shkuar më tej jep edhe recetat për atë që sipas tij mund të quhet një qëndrim korrekt karshi saj. Ai

shkruan: “deri më sot, qendrat historike mbeten qendrat e vetme të vërteta të shoqërisë urbane të civilizuar [...] Detyrat e zhvillimit në qendrat historike duhet të ripërcaktohen sipas qëllimeve të mëposhtme: të rrethohet perimetri i tyre dhe të plotësohen zonat e fragmentuara nga përdorimi i bllokut, i parcelave dhe i llojeve të tjera të ndërtimit; nga tipet e rrugëve dhe shesheve; teknika dhe arkitektura e ndërtimit të jenë në harmoni me modelet ekzistuese; të hiqen përdorimi njëfunksional, komercial, biznes, dhe; të rregullohen raportet e përdorimit të parcelës me kapacitetet strukturore ekzistuese përreth; për të rifutur gamën e plotë të funksioneve urbane brenda distancës këmbësore. E gjithë mirëmbajtja, ruajtja, restaurimi dhe rindërtimi duhet të përdorin teknikat tradicionale të ndërtimit dhe materialet natyrore, kryesisht locale”. Sipas tij në përgjithësi "modernizmi përfaqëson mohimin e çdo gjëje që e bën arkitekturën të dobishme: pa çati, pa mure mbajtëse, pa kolona, pa harqe, pa dritare vertikale, pa rrugë, pa sheshe, pa privatësi, pa madhështi, pa dekorim, asnjë mjeshtër, asnjë histori, asnjë traditë”. Ai përfundon se sot, "çrrënjësia e mësimit të arkitekturës tradicionale nuk ka arritur të eliminojë kërkesën dhe nevojën për arkitekturën tradicionale dhe as praktikën e saj në mbarë botën” (Krier, 2009;87). Gjysmë shekulli më parë u duk se modernizmi socialist mund ti jepte përgjigje të gjitha problemet shqiptare të zhvillimit urban dhe ekonomik. Sot pas ndryshimeve të mëdha, gjithmonë e me tepër bëhet e dukshme një e ardhme tjetër për Shqipërinë, ajo e integrimin në Europën e Bashkuar. Aleancat e vjetra vetëm se shtynë në kohë këtë proces natyral për Ballkanin Perëndimor, por nuk mundën ta frenojnë. Por, teksa ky rikontekstualizim historik po bëhet fakt, sfidat e proceseve të integritit hasin në vështirësi që shpesh kalojnë kapacitetet e ekonomive të reja lokale, siç janë çështjet të rekuperimit mjedisor apo konservimit. Paragrafi i fundit të këtij kapitulli do të marrë në shqyrtim çështje të integritimeve europiane duke analizuar ato në kontekstin e ekologjisë dhe ruajtjes së trashëgimisë së periudhave totalitare.

6.5. Integrimi European

E ardhmja e qyteteve shqiptare është tashmë e lidhur me integrimin në BE të vendit, ndërsa zhvillimi urban dhe ekologjia e qyteteve në ditët e sotme, janë asociuar më së shumti me politikat nacionale dhe locale. Sot BE ka shumë qasje ligjore, por ende nuk egziston një sistem i unifikuar i kuadrit ligjor për urbanistikën dhe ndërtimin. Në publikim e BE të vitit 2012 - “Qytetet e së nesërme – Sfida, vizione, mënyra përparimi” citohet van den Broeck, duke vënë në dukje se “për shkak të kompleksitetit të sfidave ekziston nevoja për integrim të dimensioneve të ndryshme shoqërore, ekonomike dhe hapësinore. [...] Ndërhyrjet konkrete (sektoriale) [...] nuk do të rezultojnë kurrë në përgjigje të qëndrueshme dhe mund të kenë pasoja negative, madje edhe të rrezikshme sociale, mjedisore dhe hapësinore’. Një qasje e integruar ndaj zhvillimit urban ka disa dimensione. Sfidat urbane mund të shikohen në kuptimin e vendit ku ato shfaqen ose për kë janë më të rëndësishme. Ato gjithashtu mund të konsiderohen si niveli më i përshtatshëm i qeverisjes ose shkallës territoriale të kërkuar për t'i adresuar ato në mënyrë efektive.” (EU, 2012) Sidoqoftë, qëllimi kryesor politikave europiane ka qenë gjithmonë vendosja në kohezion të politikave urbane me ekologjinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Siç thekson Johannes Hahn, në parathënien e publikimit “Më shumë se dy të tretat e popullsisë evropiane jeton në zona urbane. Qytetet janë vende ku shfaqen të dy, problemet dhe gjenden zgjidhje e tyre. Ato janë tokë pjellore për shkencën dhe teknologjinë, për kulturën dhe inovacionin, për krijimtarinë individuale dhe kolektive dhe për të zbutur ndikimin e ndryshimit të klimës. Sidoqoftë, qytetet janë gjithashtu vende ku përqendrohen probleme të tilla si papunësia, veçimi dhe varfëria.” (EU, 2012)

Shumë bashki shqiptare kanë ndjekur Kartën Europiane të Qyteteve drejt Qëndrueshmërisë (Karta Aalborg) e cila që nga miratimi i saj në vitin 1994 është nënshkruar nga më shumë se 3000 autoritete locale. Sipas kësaj karte qytetet evropiane duhet të shkojnë drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Në pjesën e parë të deklaratës thuhet se "qytetet kanë qenë qendrat e industrisë, artizanatit, tregtisë, arsimit dhe qeverisjes [...] Ne e kuptojmë se stili i jetës sonë aktuale urbane, në veçanti modelet tona të ndarjes së punës dhe funksioneve, përdorimi i tokës, transporti, prodhimi industrial, bujqësia, konsumi dhe aktivitetet e kohës së lirë, dhe kështu standardi i jetesës, na bëjnë në thelb përgjegjës për shumë probleme mjedisore me të cilat përballet njerëzimi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi 80 përqind e popullsisë së Evropës jetojnë në zona urbane." Në këtë pjesë shtohet gjithashtu se "ne kemi mësuar se nivelet e tanishme të konsumit të burimeve në vendet e industrializuara nuk mund të arrihen nga të gjithë njerëzit që aktualisht jetojnë, aq më pak nga gjeneratat e ardhshme, pa shkatërruar kapitalin natyror. Ne jemi të bindur se jeta e qëndrueshme njerëzore në këtë glob nuk mund të arrihet pa bashkësi lokale të qëndrueshme. Qeveria lokale është më pranë vendit ku problemet e mjedisit janë me të preکشme dhe më afër qytetarëve dhe ndajnë përgjegjësinë me qeveritë në të gjitha nivelet për mirëqenien e njerëzimit dhe natyrës. Prandaj, qytetet janë aktorë kryesorë në procesin e ndryshimit të stileve të jetesës, prodhimit, konsumit dhe modeleve hapësinore" (Charter of European Cities & Towns Towards Sustainability, 1994).

Sipas Krier (2009) qytetet dhe peisazhet janë ilustrime të vlerave tona materiale dhe shpirtërore. Ata jo vetëm që shprehin vlerat tona, por u japin atyre një realitet të prekshëm. Ata përcaktojnë mënyrën se si përdorim ose harxhojmë energjinë, kohën dhe burimet tona të tokës. Kështu, arritja e urbanizmit, bujqësisë dhe industrisë ekologjike, paraqet një detyrë sfiduese për qytetërimin industrial. [...] Etika ekologjike në rritje po ndryshon thellësisht kushtet industriale, teknologjike dhe shoqërore. Sot, një pjesë e madhe e energjisë dhe imagjinatës i kushtohet prodhimit të ndërtesave të ashtuquajtura "ekologjike", mjeteve dhe mallrave të konsumit. Por ndërmarrje të tilla të lavdërueshme shpesh e shpërqendrojnë vëmendjen e publikut të gjerë nga qëllimi kryesor i ekologjisë, që është, domosdoshmërisht, kontekstual. Në këtë kontekst, tetëdhjetë vjet histori urbane në Bashkimin Sovjetik dhe rreth dyzet vjet të kësaj historie në vendet e tjera socialiste evropiane solli disa mësimet të rëndësishme të cilat Mussil i ka përmbledhur ato në 10 pika:

1. Qytetet në të gjitha llojet e shoqërive industriale janë thellësisht të përfshira në shoqëritë globale. Të gjitha shoqëritë industriale dhe post-industriale janë shoqëri urbane. Por kjo nuk do të thotë që qyteti si një fenomen sociologjik i veçantë është "shpërbërë" në shoqërinë globale. Teoria e përgjithshme e shoqërisë nuk mund të zëvendësojë sociologjinë urbane. Do të ekzistojë gjithmonë nevoja për të zhvilluar qasje specifike sociologjike që përpiqen të kuptojnë qytetin.

2. Dështimet e qeverisjes socialiste dhe të planifikimit të qyteteve ishin në një masë të madhe pasojë e dy shkaqeve kryesore:

a) në fazat e para, të mënyrës utopike të të menduarit:

b) më vonë, për interpretim tejet simplistik dhe teknokratik të funksionimit të qyteteve. Theksi tek projektet utopike ishte në rrënjët e një perspektive shumë statike të urbanologëve socialistë. Mbizotërimi i arkitektëve dhe teknikëve bllokuan zhvillimin e qasjes shumë të nevojshme kah një procesi të orjentuar në teorinë e socializmit urbanistik." (Musil, 2005).

3. Planifikuesit socialist e konceptuan qytetin si një entitet shumë sistematik që nuk pranonte natyrën pluraliste të qyteteve. Duket se qasjet e ekologjisë njerëzore, ose sociologjia moderne politike, që kombinojnë bashkëpunimin dhe perspektivat e konkurrencës, janë më realiste dhe më të dobishme.

4. Eksperimenti me qytete në vendet socialiste ku përqëndrimi i pushtetit politik, ekonomik dhe kulturor arriti nivele shumë të larta, duke mundësuar kështu rregullimin mjaft intensiv të proceseve urbane, në të njëjtën kohë ka dokumentuar rëndësinë e proceseve sociale spontane dhe të paplanifikuara (migracioni, jeta familjare, përdorimi i kohës, preferencat e jetesës, etj.) në formimin e qyteteve të ashtuquajtura të planifikuara.

5. Politikanët dhe planifikuesit socialistë përdorën për qeverisjen dhe ndërtimin e qyteteve kryesisht teori normative, të cilat megjithatë ndryshonin shpesh. Kjo solli shumë paqartësi në proceset urbane. Teoritë urbane analitike nuk përdorshin praktikisht si bazë konceptuale për planifikim.

6. Qytetet socialiste, sidomos "qytetet e reja" ndryshonin shumë nga qytetet e vendeve kapitaliste (qendra të dobëta, infrastruktura e dobët sociale, pa suburbanizim, më pak ndarje sociale), por sistemet urbane (dimensionet ndërurbane) të vendeve socialiste nuk dallojnë shumë nga ato në vendet kapitaliste. Proceset e urbanizimit socialist ndoqën me disa modifikime (qytete të vogla kapitale, qytete të shumta të mesme) një trajektore të ngjashme si në vendet kapitaliste. Modelet e trashëguara nga periudhat pre-socialiste kishin ndikim mjaft të fortë.

7. Zhvillimet urbane post-socialiste në vendet e Evropës Qendrore Lindore janë procese shumë komplekse. Nga njëra anë, ato mund të interpretohen si proces korrigjimi, dmth. kthimi në modelet pre-socialiste, në anën tjetër ato riprodhojnë shumë modele të periudhës socialiste dhe në të njëjtën kohë reflektojnë, edhe impaktin post-modern dhe ndikimet e ndërkombëtarizimit dhe globalizimit. Temat më interesante të kerkimit i perkasin studimet që përpiqen të zbulojnë balancën e re, si dhe përpiqen të formulojnë qëllime strategjike për situatën e re. Të rëndësishme janë gjithashtu studimet që krahasojnë zhvillimin post-socialist të Pragës, Budapestit dhe Varshavës.

8. Anëtarësimi i këtyre vendeve në Bashkimin Evropian formon një kornizë institucionale për korrektimin e proceseve, si dhe pranimin e modeleve të qeverisjes, procedurave të urbanistikës dhe kulturën politike të qyteteve të Evropës Perëndimore.

9. Zhvillimi i qyteteve sovjetike pas socializmit është më i komplikuar, kthimi në modelet para-socialiste është pothuajse i pamundur, e kaluara e trashëguar sovjetike është dominuese jo vetëm në aspektin fizik por edhe në aspektin politik dhe social. Në të njëjtën kohë, ndikimi i globalizimit dhe proceseve të perëndimimit në qytetet ruse ndjehet fuqimisht. Një nga sociologët urbanë rusë shpreh pikëpamjen se pjesa më e vështirë e modernizimit dhe demokratizimit të shoqërisë post-sovjetike do të jetë humanizimi i qyteteve sovjetike.

10. Nuk ka dyshim se analiza e transformimit të teksturës fizike, e strukturave institucionale, qeverisjes urbane, ekonomive komunale, stilet e jetës dhe madje edhe strukturat e popullsisë në qytetet post-socialiste mund të bëhen pjesë e rëndësishme e kërkimeve urbane evropiane” (Musil, 2005).

Analiza e Mussil përfshin edhe studimet e rasteve të zgjedhura në këtë tekst dhe problemet e tyre aktuale. E ardhmja e tyre është e rrënjosur në të kaluarën e tyre, edhe pse nuk ka lidhje të drejtpërdrejta me shkaqet. Ende e ardhmja e tyre do të varet kryesisht në transformimin e industrive tashmë të ndalura dhe ri-shpikjes së re që mund të bëhet për to. Duket ende herët të flitet për qëndrueshmëri në këto qytete. Sipas Krier(2009), zhvillimi i qëndrueshëm i qytetit është një mit i fuqishëm me

pakëz realitet. Në të vërtetë nuk ekzistojnë koncepte të besueshme të një qyteti të qëndrueshëm që mund të përgjithësohen. Ekzistojnë vetëm hipoteza me karakter pjesor. Ne jemi ende larg nga një projekt ekologjik global, që ndihmon për të marrë vendime inteligjente politike. Pyetja që do të imponojë veten gjatë viteve të ardhshme do të jetë ‘Cilat mund të jenë sistemet tona morale politike dhe teknologjike në kushtet e burimeve të kufizuara të energjisë së lirë?’ Për momentin abuzimi i termit "i qëndrueshëm", shkatërron besimin e tij politik dhe social dhe zvarrit gjetjen e zgjidhjeve eventuale” (Krier, 2009;137). Në Kartën Evropiane të “Cities & Towns Towards Sustainability” theksohet rëndësia e vendosjes së një ekuilibri të qëndrueshëm kur thuhet se "ne kërkojmë të arrijmë drejtësi sociale, ekonomi të qëndrueshme dhe qëndrueshmëri mjedisore. Drejtësia sociale domosdoshmërisht duhet të bazohet në qëndrueshmërinë dhe barazinë ekonomike, të cilat kërkojnë qëndrueshmëri mjedisore. Qëndrueshmëria mjedisore nënkupton mbajtjen e kapitalit natyror. Ajo kërkon prej nesh që shkalla e konsumimit të burimeve të rinovueshme, burimet e ujit dhe energjisë të mos kalojë normën me të cilën sistemet natyrore të mund t'i riplotësojnë ato dhe se shkalla me të cilën konsumojmë burimet jo të rinovueshme të mos jetë më e lartë se aftësia e burimeve të rinovueshme për t'u zëvendësuar. Qëndrueshmëria mjedisore gjithashtu do të thotë se shkalla e ndotësve të emetuar nuk tejkalon kapacitetin e ajrit, ujit dhe tokës për të absorbuar dhe përpunuar ato. Për më tepër, qëndrueshmëria mjedisore përfshin ruajtjen e biodiversitetit; shëndetin e njeriut; si dhe cilësitë e ajrit, ujit dhe tokës në standarde të mjaftueshme për të mbështetur jetën dhe mirëqenien e njeriut, si dhe jetën e kafshëve dhe bimëve, për të gjithë kohën.

Sipas Krier(2009), në të ardhmen, sfida ekologjike qëndron në vetë-riorganizimin e marrëdhënieve territoriale brenda rutinës së përditshme të shoqërisë. Ne bëjmë gabim nëse quajmë qytet çdo grup të madh ndërtesash, sepse vetëm një strukturë dhe formë e caktuar mund të meritojë atë emër. Një qytet nuk është rezultati i pashmangshëm i aktiviteteve të ndërtimit të një shoqërie. Një qytet mund të ndërtohet dhe të përparojë vetëm nëse përfaqëson qëllimet e individëve, të një shoqërie dhe të institucioneve të saj. Një qytet nuk është një aksident, por rezultat i vizioneve dhe synimeve koherente. Është një shpikje e shpirtit njerëzor. Pa këtë ide udhëzuese nuk do të kishte qytetërim urban. Prodhimtaria dhe logjika komerciale nuk përbëjnë domosdoshmërisht nevojë për qytete me vlerë të qëndrueshme. Ndërsa këto aktivitete janë kushte të domosdoshme për ndërtimin e vendbanimeve, qytetet e mëdha nuk janë kurrë nënproduktet e tyre automatike. Cilësitë si vitaliteti qytetar, urbaniteti, bukuria, krenaria e shtëpisë, qytetaria, karakteri dhe bukuria e hapësirave publike, shesheve, parqeve dhe arkitekturës nuk janë vetëm lulet e egra në fushën e marrëdhënieve ekonomike. Dinamizmi industrial i lënë në logjikën e vet zë tokën në mënyrë gati ushtarake, duke shkaktuar shumë dëme kolaterale. Ky është rasti i ish qyteteve socialiste shqiptare sot. Duket se lufta industriale sapo ka mbaruar. Sipas Indeksit të Performancës Mjedisore të Universitetit Yale, krahasuar me 163 vende, Shqipëria renditet në mënyrë mbresëlënëse në vendin e 15-të, përpara SHBA (49) dhe jo shumë larg Gjermanisë (11). Rekordi relativisht i mirë ekologjik i vendit mund të gjurmohet në një sërë faktorësh, nga cilësia e mirë e ujit dhe ajrit në biodiversitetin e pasur dhe burimet e shumta natyrore. Por ky është rezultati, jo i politikave mjedisore të synuara mirë, por më tepër i izolimit politik të vendit në dekada(Deutsche Welle, 2012). Sidoqoftë, sipas Krierit, “një vizion "ekologjik" nuk mund të kufizohet në një qytet, një rajon apo edhe një vend. Duhet të vendoset në një kontekst kontinental dhe të jepet në një kartë për mjedisin dhe për qytetin. Një kartë e tillë duhet të propozojë

zgjdhje tipike për problemet tipike që gjenden në çdo shkallë në qytet, periferi dhe fshat [...] Duhet të bazohet në një konsensus afatgjatë politik, kulturor dhe ekonomik; është komplementi i domosdoshëm i kushtetutës politike të kombeve moderne, një vizion etik dhe civilizues i lartësisë universale” (Krier, 2009; 101).

Në situatën e sotme shqiptare, problematikat më të theksuar ekologjike shfaqen të lidhura me qytetet të cilat impaktin e tyre e shtrijnë edhe në fshat e territorin përreth. Periferia industriale e periudhës së socializmit e cila sot gjendet e zhytur në ndërtime të periudhës së tranzicionit, pas kolapsit ka krijuar një kufi të ri të brendshëm në qytetin post-socialist. Leon Krier e sheh problemin tek të gjitha qytetet industriale dhe sipas tij shkaku duhet kërkuar në principet e zonimit rigjid që ju aplikua qyteteve gjatë modernizmit. Siç thekson ai, “pasoja më e veçantë e zonimit funksional është se ajo garanton konsumin maksimal të njësive të kohës, energjisë, pajisjeve dhe tokës për ekzekutimin e funksioneve të përditshme të të gjithë shoqërisë. Qarkullimi i njerëzve, mallrave dhe informacionit përfaqëson tani veprimtarinë kryesore të metabolizmit industrial të njeriut me natyrën. [...] Shembujt më ekstremë të zonimit rajonal u realizuan me pasoja të tmerrshme në ish-Bashkimin Sovjetik. Dhe megjithatë, edhe pse lidhja midis zbrazjes ekologjike dhe shkatërrimit kulturor është më e dukshme në regjimet totalitare, lagjet e shpërbëra të shumë qyteteve të Amerikës së Veriut janë po aq dramatike. Këto dështime tragjike shënojnë skajet e vdekura të shumë formave të kolektivizmit. Urbanizmi tradicional, multiciteti dhe përdorimet e ngjashme, shumëllojshmëria dhe dimensionin e madh, funksioni i parcelave të ndërtimit janë instrumente pa të cilat shoqëritë e bazuara në përgjegjësinë individuale, sipërmarrjen dhe konkurrencën e lirë nuk mund të prodhojnë qytete të qytetëruara dhe fshatra”. Më tej ai sqaron konceptin edhe në shkallë më të madhe duke shprehur se: "të gjitha shtetet industriale, pavarësisht nga ideologjia politike, nxisin dhe vendosin zonimin funksional në qytete dhe fshatra kundër të gjitha formave të rezistencës. Zonimet funksionale nuk janë një mjet neutral. Ato transformojnë një shoqëri të individëve aktivë dhe të pavarur në masa të mobilizuara por pasive. Zonimi funksional zëvendëson rendin organik të qytetit me çrregullimet mekanike të periferive dhe mungesën e qendrave dhe centralitetit të vërtetë. Fragmentimi funksional i një qyteti rezulton de facto në shkatërrimin e fshatrave; kjo do të thotë shpërbërja efektive e qytetit dhe vendit. Zvogëlon komunitetet rurale dhe urbane, fshatrat dhe pyjet, natyrën, burimet natyrore dhe njerëzore në statistika të thjeshta të shprehura në shifra dhe dendësi të këmbyeshme. Logjika industriale duket të jetë në konflikt me logjikën shoqërore dhe ekologjike, me logjikën etike dhe estetike. Ajo transformon çdo qytetar në një agjent të mundshëm dhe të pavullnetshëm të mbeturinave të energjisë. Në fakt, kolektivizmi industrial shpesh çon në pezullimin e nocioneve të ekonomisë dhe etikës. Ajo krijon probleme që është e paaftë ti zgjidhë dhe për pasojë supozon. Zonimi pezullon nocionin e përgjegjësisë individuale ose kolektive në mënyrë që të arrijë qëllimet e saj përfundimtare të padiskutueshme. Kur e lënë në vetvete logjika industriale është një aspekt moral, social dhe jo ekologjik” (Krier, 2009).

Karta Evropiane e “Cities & Towns Towards Sustainability” jep disa të dhëna se si mund të zhvillohet një strategji e qëndrueshme. Së pari, veprimi/aksioni duhet të bazohet tek konteksti. Kështu, sipas kësaj strategjie, pika tre shkruhet se "ne jemi të bindur se qyteti ose qyteza është njësi më e madhe e aftë që të adresojë e para disbalancat urbane, arkitektonike, sociale, ekonomike, politike, natyrore dhe ekologjike mjedisore që dëmtojnë botën tonë moderne dhe shkalla më e vogël në të cilën problemet mund të zgjidhen në mënyrë kuptimplote në një mënyrë të integruar,

holistike dhe të qëndrueshme. Ndërsa çdo qytet është i ndryshëm, ne duhet të gjejmë rrugët tona individuale drejt qëndrueshmërisë. Ne do të integrojmë parimet e qëndrueshmërisë në të gjitha politikat tona dhe do të bëjmë pikat e forta përkatëse të qyteteve tona bazën e strategjive vendore të përshtatshme”. Së dyti, ekonomia urbane do të orjentohej drejt ekonomisë së qëndrueshmërisë, “ne, qytetet dhe qytezat, kuptojmë se faktori kufizues për zhvillimin ekonomik të qyteteve dhe qytezave tona është bërë kapitali natyror, si atmosfera, toka, uji dhe pyjet. Prandaj duhet të investojmë në këtë kapital. Me qëllim prioritetizimin kjo kërkon: • investime në ruajtjen e kapitalit të mbetur natyror, siç janë rezervat ujore nëntokësore, toka, habitatet për speciet e rralla; • inkurajimin e rritjes së kapitalit natyror duke zvogëluar nivelin tonë të shfrytëzimit aktual, siç është energjia e pa-ripërtëritshme; • investime për lehtësimin e presionit mbi rezervat e kapitalit natyror duke zgjeruar kapitalin natyror të kultivuar, të tilla si parqet për rekreacion të brendshëm të qytetit për të lehtësuar presionin mbi pyjet natyrore; si dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të produkteve fundore, siç janë ndërtesat me efikasitet energjetik, transport urban miqësor me mjedisin” (Charter of European Cities & Towns Towards Sustainability, 1994).

Në Shqipëri, edhe pse vitet e fundit ka patur iniciativa nga ana e qeverive lokale për ngritjen e landfilleve për trajtimin e mbetjeve, është e rëndësishme të përmendet se ndotja mbetet një nga problemet kryesore të qyteteve shqiptare sot. Siç theksohet në një shkrim në Open Data Albania, “Ndotja në disa zona bregdetare është 6-15 herë mbi nivelin e lejuar dhe mbeturinat urbane janë gjithnjë në rritje ndërkohë që vetëm një pjesë e vogël riciklohet. Në përgjithësi ato digjen. Probleme të pafundme kanë të bëjnë me trajtimin e mbetjeve spitalore, kimikatet që shkojnë në lumenj, ajrin e ndotur në kryeqytet, pluhurin e krijuar nga ndërtimi i godinave komerciale ose ndotja akustike në zonat urbane”(Open Data Albania). Më tej vazhdojnë “Shqipëria nuk vuan nga mungesa e strategjisë, planeve, masave ose objektivave në letër, pasi lista është mjaft e gjatë. Deri më sot Shqipëria ka nënshkruar 7 Konventa Ndërkombëtare për çështje të ndryshme mjedisore; ka adoptuar 7 Strategji Zhvillimi për aspekte të ndryshme mjedisore; ka aprovuar mbi 20 ligje që miratojnë Protokolle, Marrëveshje dhe Amendime të ndryshme Ndërkombëtare; mbi 20 amendamente të ligjeve ekzistuese; mbi 80 vendime të Këshillit të Ministrave që lidhen drejtpërdrejt me mjedisin; mbi 20 Direktiva dhe mbi 5 Rregullore etj. Ajo që është e domosdoshme është vënia në zbatim e këtyre ligjeve dhe sipërmarrjeve të tjera, dhe më tej vullneti për të parë përmes masave në proces që synojnë mbrojtjen e mjedisit” (Open Data Albania).

Proceset e demokratizimit dhe të qëndrueshmërisë urbane shoqërohen në Kartën Evropiane “Cities & Towns Towards Sustainability” me procese që përfshijnë pjesëmarrjen individuale, vendimarrjen lokale, përgjegjësinë sociale, barazinë sociale etj. Kështu në pjesën lidhur me barazinë sociale shkruhet se : në, qytetet jemi të vetëdijshëm se të varfërit janë më të prekur nga problemet mjedisore (si zhurma dhe ndotja e ajrit nga trafiku, mungesa e lehtësive, strehimi i pashëndetshëm, mungesa e hapësirës së hapur) dhe janë më pak të aftë për t'i zgjidhur ato. Shpërndarja e pabarabartë e pasurisë shkakton sjellje të paqëndrueshme dhe e bën më të vështirë ndryshimin. Ne synojmë të integrojmë nevojat themelore sociale të njerëzve, si dhe programet e kujdesit shëndetësor, punësimit dhe strehimit me mbrojtjen e mjedisit. Dëshirojmë të mësojmë nga përvojat fillestare të stileve të jetesës së qëndrueshme, në mënyrë që të mund të punojmë drejt përmirësimit të cilësisë së jetesës së qytetarëve sesa thjesht të maksimizojmë konsumin. Ne do të përpiqemi të krijojmë vende pune që kontribuojnë në qëndrueshmërinë e komunitetit dhe në këtë mënyrë të zvogëlojmë

papunësinë. Kur kërkojmë të tërheqim apo krijojmë vende pune, ne do të vlerësojmë efektet e çdo mundësie biznesi në drejtim të qëndrueshmërisë në mënyrë që të inkurajojmë krijimin e vendeve të punës dhe produkteve afatgjata në përputhje me parimet e qëndrueshmërisë. Gjithashtu në lidhje me modelet e përdorimit të tokës theksohet se "në, qytetet dhe qytetezat, pranojmë rëndësinë e politikave efektive të përdorimit të tokës dhe planifikimit të zhvillimit nga autoritetet tona lokale që përqafojnë vlerësimin strategjik mjedisor të të gjitha planeve. Ne duhet të përfitojmë nga qëllimi për sigurimin e transportit efikas publik dhe energjisë që ofrojnë dendësi më të larta, duke ruajtur shkallën njerëzore të zhvillimit. Në të dy programet e rinovimit urban në zonat e brendshme urbane dhe në planifikimin e periferive të reja ne kërkojmë një përzierje të funksioneve në mënyrë që të zvogëlohet nevoja për lëvizshmëri. Nocionet e ndërvarësisë së barabartë rajonale duhet të na lejojnë të balancojmë fluksin midis qytetit dhe fshatit dhe të parandalojmë qytetet nga thjesht shfrytëzimi i burimeve të zonave përreth. Sa i përket modeleve të lëvizshmërisë urbane, karta e Aalborg thekson se qytetet do të përpiqen të përmirësojnë aksesin dhe të mbajnë mirëqenien sociale dhe jetesën urbane me më pak transport. Ne e dimë se është e domosdoshme që një qytet i qëndrueshëm të zvogëlojë lëvizshmërinë e detyruar dhe të ndalojë promovimin dhe mbështetjen e përdorimit të panevojshëm të automjeteve të motorizuara. Ne do t'i japim përparësi mjeteve të transportit ekologjikisht të shëndosha (sidomos në këmbë, çiklizëm, transport publik) dhe bëjmë kombinimin e këtyre mjeteve në qendër të përpjekjeve tona të planifikimit. Mjetet motorike individuale të transportit urban duhet të kenë funksionin ndihmës për lehtësimin e qasjes në shërbimet lokale dhe mbajtjen e aktivitetit ekonomik të qytetit" (Charter of European Cities & Towns Towards Sustainability, 1994). Përgjegjësia për klimën globale do të thotë se qytetet do të kuptojnë se rreziqet e mëdha që paraqesin ngrohja globale në mjediset natyrore dhe të ndërtuara dhe në gjeneratat e ardhshme njerëzore kërkojnë një përgjigje të mjaftueshme për të stabilizuar dhe pastaj për të zvogëluar emetimet e gazrave serë në atmosferë sa më shpejt të jetë e mundur. Është po aq e rëndësishme mbrojtja e burimeve globale të biomasës, të tilla si pyjet dhe fitoplanktoni, të cilat luajnë një rol esencial në ciklin e karbonit të tokës. Zvogëlimi i emetimeve të karburanteve do të kërkojë politika dhe nisma të bazuara në një kuptim të plotë të alternativave dhe të mjedisit urban si një sistem energjetik. Alternativat e vetme të qëndrueshme janë burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Më tej Karta Evropiane Cities & Towns Towards Sustainability vazhdon me vetëqeverisja lokale konsiderohet si një parakusht për të gjitha qytetet, sepse ata kanë njohuritë dhe potencialet krijues për të zhvilluar mënyra të qëndrueshme të jetesës dhe për të hartuar dhe menaxhuar qytetet tona drejt qëndrueshmërisë. "Si përfaqësues të zgjedhur në mënyrë demokratike të komuniteteve tona lokale jemi gati të marrim përgjegjësinë për detyrën e riorganizimit të qyteteve dhe qytezave tona për qëndrueshmëri. Shkalla në të cilën qytetet dhe qytezat janë në gjendje të ngrihen në këtë sfidë varet nga të drejtat e tyre për vetëqeverisje lokale, sipas parimit të subsidiaritetit. Është thelbësore që kompetenca të mjaftueshme të mbeten në nivel lokal dhe që autoriteteve vendore t'u jepet një bazë e fortë financiare" (Charter of European Cities & Towns Towards Sustainability, 1994).. Në të njëjtën kohë, qytetarët si aktorë kryesorë dhe përfshirja e komunitetit si qytete do të sigurojnë që të gjithë qytetarët dhe grupet e interesuara të kenë akses në informacion dhe të jenë në gjendje të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse lokale. Qytetet dhe qytezat do të kërkojnë mundësi për edukim dhe trajnim në qëndrueshmëri jo vetëm për popullatën e përgjithshme, por edhe për përfaqësuesit e zgjedhur dhe zyrtarët në qeverisjen vendore. Instrumentet që Karta Evropiane "Cities & Towns Towards Sustainability"

vlerëson të përdorë për menaxhim më të mirë urban ndaj qëndrueshmërisë, janë ato për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mjedisore; planifikimi mjedisor; rregullator, ekonomik dhe instrumentet e komunikimit si direktivat, taksat dhe tarifatat; si edhe mekanizmat për ngritjen e vetëdijes, duke përfshirë pjesëmarrjen e publikut. Menaxhimi i ri i qëndrueshëm synon të krijojë sisteme të reja buxhetore mjedisore të cilat lejojnë menaxhimin e burimeve tona natyrore në mënyrë ekonomike njësoj si burimet tona artificiale, 'paratë'. Karta shkruan se qytetet dhe qytezat "e dijnë se ne duhet të bazojmë përpjekjet tona për hartimin e politikave dhe kontrollin, në veçanti monitorimin e mjedisit, auditimin, vlerësimin e ndikimit, sistemet e kontabilitetit, balancimin dhe raportimin, në lloje të ndryshme indikatorësh, përfshirë ato të cilësisë mjedisore urbane, flukset urbane, modelet urbane, dhe, më e rëndësishmja, treguesit e qëndrueshmërisë së sistemeve urbane. Ne qytetet pranojmë se një sërë politikash dhe aktiviteteve që sjellin pasojë pozitive ekologjike, tashmë janë zbatuar me sukses në shumë qytete të Evropës. Megjithatë ndërkohë që këto instrumente janë mjete të vlefshme për të reduktuar ritmin dhe presionin e paqëndrueshmërisë, ato nuk e ndryshojnë drejtpërsëdrejti drejtimin e shoqërisë. Gjithsesi, me këtë bazë ekzistuese ekologjike, qytetet janë në një pozicion të shkëlqyer për të ndërmarrë hapin e pragut të integritit të këtyre politikave dhe aktiviteteve në procesin e qeverisjes për menaxhimin e ekonomive lokale urbane përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Në këtë proces ne jemi të thirrur për të zhvilluar strategjitë tona, për t'i provuar ato në praktikë dhe për të ndarë përvojat tona" (Charter of European Cities & Towns Towards Sustainability, 1994).

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Qëllimi kryesor i këtij studimi është ngritja e nje sfondi teorik per analizimin e modeleve arkitekturore dhe hapësinore të qyteteve të ndërtuara gjatë socializmit në Shqipëri, duke pozicionuar një focus te veçantë në fazën e pare të zhvillimit industrial 1948-56. Analiza mbi ish-Kombinatin e Tekstileve në Tiranë e cila është vepra me e spikatur dhe tërësore e kësaj periudhe, konkretizon qëllimin e hulumtimit teorik duke evidentuar elementet kryesor të analizës historike urbano-arkitektonike të qyteteve të periudhës së totalitarizmit socialist. Analiza arkitektonike e qytetit shihet në këtë tekst si nje mjet efikas për të evidentuar karakteristikat, qëllimet, politikat kryesore të cilat formëzuan pejsazhin urban të asaj periudhe. Vetëm nëpërmjet leximit kritik me fushë të gjerë duke përfshirë elementin social-politik brenda analizës arkitektonike, mund të evidentojme vlerat e tyre kulturore në kontekstin e sotëm postmodern. Nëpërmjet hulumtimit teorik mbi faktet locale të asaj periudhe, si dhe vendosjen e tyre në një kontekst më të gjerë, tëntohet të hidhen hapat e para drejt qartësimeve të mëtejshme mbi një periudhë ende të panjohur të historisë së zhvillimeve urbane në Shqipëri. Analizat kryesore bazohen në aspektet e urbanizimit të qyteteve socialiste dhe post-socialiste, përmbajtja e tyre tipologjike, gjuha arkitekturore e përdorur në lidhje me ideologjinë zyrtare të pranuar të asaj kohe.

Studimi u ndërtua mbi bazën e një analize empirike teorike mbi literature të huaj prej të dyja fronteve duke krahasuar me kontekstin nacional. Gjithashtu rol te rëndësishëm në arritjen e disa përfundimeve ka patur edhe konfrontimi midis dialektikave të ideologjive totalitare që pasuan deri në ardhjen në pushtet të komunistëve në Shqipëri, konkretisht duke u fokusuar mbi keto dy periudha kryesore: ndikimin italian-fashist (1914-1944), periudha e Paktit të Varshavës dhe marrëdhëniet me sovjetikët (1949-1964) që çuan në pranimin e socrealizmit si stil arkitektonik zyrtar. Studimi u përqendrua ne verifikimin e rolit të luajtur prej ideologjisë totalitare - procesi politik, dhe ndikimet e tjera që verifikohen nëpërmjet analizës arkitektonike; Roli i pjesëmarrësve kryesorë - arkitekt, urbanist, vizioni i liderit të partisë, ndikimi sovjetik, etj.

Qëllimi kryesor i studimit ishte ngritja e nje baze teorike si një hap i parë drejt leximit dhe analizës se prodhimit arkitektonik të asaj periudhe, sipas parimeve të kritikës liberale postmoderniste duke evidentuar konditat politike, risite dhe pershtatjet që shoqëruan implementimin e stilit zyrtar nëpërmjet ndërtimit të qyteteve të reja por duke ju referuar edhe raportit me qytetin historik. Pyetjet kryesore të hulumtimit u bazuan në vizionin që përfshijnë strukturat urbane dhe arkitektonike, masën që këto struktura i përgjigjen ideologjisë totalitare në kontekstin global dhe lokal, dallimet lokale dhe elementet tradicionale të përfshira në stilin zyrtar, tiparet specifike që ofrohen për ta bërë qytetin industrial konkurrues kundrejt qytetit tradicional, për mënyrën se si këto struktura janë cilësuar nga shoqëria historike dhe cili është statusi i tyre aktual, metodologjitë kryesore për ripërdorimin dhe rimëkëmbjen e trashëgimisë bashkëkohore dhe si mund të përshtaten në rastet specifike të paraqitura. Të gjitha këto çështje të veçanta u ri-grupuan, sipas konstatimeve kryesore të këtij studimi, në katër çështje qendrore kryesore që përfshijnë shkallën e zhvillimit të qyteteve dhe arkitekturës që u prodhua nga vitet e para te shtetit deri pas lufte, per te kuptuar vazhdimësitë dhe ndërprerjet kryesore midis arkitekturës fashiste dhe socialiste në Shqipëri; shfaqja dhe ndikimi i

arkitekturës socialiste e ne veçanti 'staliniste' në themelimin e qyteteve të para socialiste, evolucionin e tyre në qytete post-socialiste dhe si kjo ka ndikuar në formën e tyre arkitekturore aktuale si dhe transformimet e përdorimit të ndërtesave historike. Në fund jam shprehur edhe për çështjet e ruajtjes historike dhe trashëgiminë arkitektonike të qyteteve post-socialiste dhe zhvillimin e tyre të ardhshëm.

Në studim u konstatua se arkitektura 'staliniste' mund të konsiderohet si një stil specifik arkitekture brenda tendencës kryesore të realizmit socialist dhe që i referohet një periudhe të caktuar kohe. Dhe ndërkohë që arkitektura staliniste ishte një stil, krijimi i qyteteve të reja socialiste konsiderohej si një vendim politik që duhej ti përgjigjej ideologjisë së sistemit. Qytezat e vogla industriale si rasti i Kombinatit të cilat u trajtuan në studim u konsideruan si qytete megjithëse nuk kishin shumë referenca për një qytet të vërtetë. Studimi u përqendrua më shumë çështje të modernizmit socialist dhe ndikimit të tij dhe nuk shpjegon stile të tjera të arkitekturës siç janë konstruktivizmi, funksionalizmi, modernizmi perëndimor dhe postmodernizmi. Një pjesë e madhe e këtij studimi ka të bëjë me ndikimin e arkitekturës tradicionale, arkitekturës otomane dhe arkitekturës italiane në Shqipëri, të cilat ndihmuan në analizimin e qyteteve të reja socialiste që u zhvilluan në këtë territor.

Studimi tregon se arkitektura staliniste dhe ajo socialiste në përgjithësi, kanë pasur një ndikim të thellë në peizazhin urban të qyteteve shqiptare. Edhe pse kish filluar të implementohej një bazë urbanizimi modern prej regjimeve të mëparshme, në masë të gjerë transformimet moderniste të qyteteve dhe industrializimi i ekonomisë ndodhi në masë të gjerë gjatë regjimit socialist. Përkundër faktit se komunistët në Shqipëri e refuzuan "modernizmin" si term, qasja ime kryesore këtu bazohet pikërisht mbi këtë koncept. Një nga supozimet kryesore të tezës është se themelimi i qyteteve të para mund të analizohet edhe si skica e parë e një projekti modernist, edhe pse i mbyllur brenda kornizave ideologjike totalitare. Megjithëse një pjesë e projekteve të qyteteve socialiste janë konsideruar nga literatura perendimore si 'utopike', në këtë tekst ato nuk janë përcaktuar si të tilla për faktin se këto qytete u jetuan, funksionuan dhe ende vazhdojnë të ekzistojnë. Por, ndërsa themelimi i tyre u justifikua nga industrinë e afërta, ekzistenca e tyre e tanishme është në rrezik nga mbyllja e fabrikave dhe hyrja në periudhën post-industriale. Referuar teorisë së Lefebvre, në këtë tekst qyteti socialiste u studiua si një mundësi e veçantë për eksperimentim dhe shpikje në kushtet aktuale.

Studimi u frymëzua fillimisht nga projekti ATRIUM, qëllimi kryesor i të cilit ishte menaxhimi inteligjent, ruajtja, ripërdorimi dhe rivlerësimi ekonomik i arkitekturës së regjimeve totalitare të shekullit të 20-të. Gjetjet e studimit tregojnë lidhjen mes ideologjive dhe politikave urbane dhe arkitektonike. Arkitektura e socrealizmit manifestohet tashmë në kujtesën tonë kolektive, njohurinë dhe traditën si dhe kanë qenë subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme edhe pse gjithmone kanë rezatuar një lloj ambiguiteti që buron prej lidhjes me politikën e regjimit. Së dyti, përdorimi i ish ndërtesave socialiste përbëhet nga procese që orientojnë njerëzit drejt njohurisë, kuptimit dhe veprimit. Në vijim tregohet se veprimi nuk është gjithmonë i drejtuar drejt ruajtjes dhe sidomos në kontekstin shqiptar, por shpesh i lidhur me eliminimin e ndërtesave si pjesë e rëndësishme e kujtesës totalitare duke provokuar në këtë mënyrë eliminimin e pjesës së padëshiruar të historisë. Materialet e përdorura në këtë studim mund të ndahen në tri grupe: 1. Materialet që kanë të bëjnë me historinë e arkitekturës sovjetike në Shqipëri; 2. Raportet, librat dhe dokumentet në lidhje me

aktivitetet e autoriteteve qeveritare të regjimit socialist në Shqipëri dhe pas rënies së tij. Ndonjëherë dokumentet dhe raportet e regjimit socialist janë një propagandë e vërtetë, gjithsesi ato mund të kuptohen lehtë dhe të krahasojmë politikat midis regjimeve dhe tendencave kryesore; 3. Literaturë që kanë të bëjnë me historinë shqiptare, otomane, italiane, ruse dhe zhvillimet me Europën Lindore dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu referenca të shumta prej urbanistikës dhe arkitekturës së modernizmit perëndimor, kanë shërbyer si shembuj krahasimor të zhvillimeve në dyja frontet.

Pjesa e parë e tezës ka të bëjë me hyrjen, qëllimet, pyetjet kryesore të hulumtimit, përkufizimet, metodat dhe delimitimet e studimit. E dyta jep një pasqyrë të plotë të traditës arkitekturore shqiptare dhe tendencave kryesore që kanë ndikuar në të duke e parë një aspekt evolutiv sipas periudhave, me fokus të veçantë në karakterin politik të arkitekturës pas themelimit të shtetit shqiptar. Në pjesën e tretë jepet një ide e ideologjisë socialiste që ndikoi në krijimin e qyteteve të reja industriale në Shqipëri. Gjithashtu, një përshkrim i hollësishëm i historisë së arkitekturës shqiptare në vitet e para të sistemit dhe përgjithësisht mbi periudhën e paktit të Varshavës ku evidentohen vazhdimësi dhe ndërprerje midis stileve, ideologjive dhe raportit të tyre me anën sociale. Pjesa e katërt paraqet metodën e leximit dhe analizën e kontekstualizuar të Kombinatit të Tekstileve, qyteti socialist më i rëndësishëm nga pikëpamja e primatit historik. Ky studim i referohet disa kornizave teorike për të dalë në konkluzion të kontekstualizuara, duke e konsideruar qytetin si entitetin me kompleks nga pikëpamja e konglomeratit që përbëjnë çështje sociale, politike, urbane dhe mjedisore. Kryesisht si guida kryesore teorike në lidhje me qytetin kanë shërbyer kritikë të njohur të post-modernitetit perëndimor si Tafuri, Krier, Rossi por edhe filozofë si Lefebvre apo estetiste si Groys, historianë arkitekture si Ching, Zevi, Kopp etj. Musil, Smith, Konstinskiy, etj. shërbyen për të krijuar kornizën sociale të ndryshimeve, por edhe autorë shqiptarë kanë qenë të vlefshëm në perceptimin e situatave historike, si Velo, Kolevica, Bego, etj. apo ata më të rinj për të verifikuar aktualitetet. Kapitulli 5 përfshin sfidat dhe problematikat që hasin qytetet sot duke bërë një introduksion të tranzicionit si në kontekst të gjerë ashtu edhe atë lokal duke ju referuar edhe rasteve studimore. Gjetjet në rang teorik, artikuloohen të shpërndara në të gjithë tekstin, ndërsa zgjidhjet apo hipotezat do të analizohen kryesisht në kapitullin 6, bashkë me analizimin e transformimeve post-socialiste dhe sfidat e tyre të ardhme.

Është e rëndësishme të theksohet se ky studim u përpoq të hidhte dritë mbi marrëdhëniet komplekse midis arkitekturës dhe politikës, në një kohë dhe kontekst kur intelektualet ishin të privuar nga liria e shprehjes dhe propaganda pushtonte çdo debat teorik. Sipas Krier, arkitektura nuk është as autoritare, e as demokratike, por ajo ekziston në vetvete. Për të 'ekzistojnë mënyra autoritare ose demokratike për prodhimin dhe përdorimin e arkitekturës'. Ndërtesat mund të jenë çnjerëzore jo për shkak të arkitekturës, por vetëm për shkak të mungesës së arkitekturës. Një ndërtesë është çnjerëzore në mungesë të arkitekturës ose kur është e veshur me arkitekturë të pavlerësuar ose kitsch. Kitsch është si pamja e rreme ashtu edhe abstraksionet. Nuk ka arkitekturë reaksionare ose revolucionare, ka vetëm arkitekturë ose mungesa e saj, abstraksioni i saj. Në qytetet e sotme shqiptare mund të flasim kryesisht për mungesën e arkitekturës sesa prani të saj. Sfidat dhe problemet kryesore të qyteteve të reja ish-socialiste u provokuan kryesisht në komplikime që kishin të bënin me mungesë e pronës private, mosekzistencën e tregut të tokës, kontrollin e centralizuar të territorit dhe sherbimeve, shpërdorimi i tokës, mosrakordimi i kërkesës me ofertën përsa i përket sherbimeve, dominimi i një transporti public inefficient dhe mosegzistenca e

atij privat, prioriteti absolut që ju dha ideologjisë dhe simbolikës lidhur me të karshi prodhimit të lirë artistik të lidhur me trendet e kohës, etj. Konstatuam se për qytetet shqiptare situata ishte e ndryshme jo vetëm nga qytetet e Evropës Perëndimore, por edhe nga ato të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Bashkimi Sovjetik. Një karakteristikë dominante e qyteteve shqiptare ishte zbatimi i një diktature staliniste që karakterizon dhe zhvillimin urban dhe atë kulturor, mungesa totale e shoqërisë civile dhe strukturave lokale pjesëmarrëse, edhe pse regjimi e quante veten demokratik. Rigjediteti i arkitekturës burgosur në kanonet e ngurta të sistemit si dhe zgjidhjet e cingruara urbane, janë deshmi e mungesës totale të një vizioni mbi të ardhmen e qyteteve. Influenca simbolike në arkitekturë shfaqet si një domosdoshmëri për të komunikuar me ideologjinë dhe sistemin, pasi për arkitektët kjo mund të ishte e vetmja mënyrë për të aprovuar një projekt e për ta bërë realitet.

Nga pikëpamja e funksionit dhe përfaqësimit theksuam se funksionimi i qytetit socialist ishte më i ndërlikuar se ndërtimi dhe pamja e tij e thjeshtë. Një ideologji e tërë qëndronte pas themelimit të tyre, siç u verifikua me rastin shqiptar më shumë se funksionalë ata ishin përfaqësues. Ata donin të përfaqësonin fuqinë dhe ideologjinë e atyre që erdhën në pushtet. Në këtë dualitet midis funksionit dhe përfaqësimit erdhën risitë stilistike të arkitekturës staliniste. Shembuj të thjeshtë të këtij fakti ishin monumentet. Ndonjëherë edhe vetë ekzistenca e këtyre qyteteve mund të shërbejë për t'i përfaqësuar ato si monumente. Kur u referohemi fabrikave dhe njësive industriale, u tregua se si dëshira për arkitekturë, dekori si element thelbësor i arkitekturës së kësaj periudhe ishin të pranishme edhe brenda fabrikës si pjesë e planit për të impresionuar dhe edukuar klasën punëtore. Kombinati si shëmbulli më i realizuar i kësaj periudhe, është një dëshmi e gjallë e një realiteti politiko-shoqëror të ndryshëm nga ky i sotmi, i cili zhvillohej thuajse me të njejtët ingredientë por në rrethana të ndryshme politike. Rasti i Kombinatit, ve në pah të gjitha etapat që ka kaluar shteti socialist duke i paraqitur qartë ndryshimet dhe karakteristikat dominuese të sejcilës periudhë, pikërisht për këtë arsye ky rast, pjesa e mbetur historike e tij, mbartin vlera të jashtëzakonshme studimore të cilat përpiqemi të evidentojmë me origjinalitet në këtë tekst.

Tranzicioni post-industrial i qyteteve socialiste është provuar të ketë qenë i vështirë, veçanërisht në rastin shqiptar. Nga njëra anë një kolaps i papritur i sistemit krijoi një ndërprerje të beftë dhe të gjithë pranuar me të kaluarën, por nga ana tjetër pati një vazhdimësi të përfaqësuar kryesisht nga rivendosja përsëri në mënyrë artificiale e vazhdimësisë historike e cila shkaktoi mbirjen e fenomeneve të neo-tradicionalizmit. Ndërsa me kalimin e viteve veprimi, përpjekja për të harruar, lënë në degradim apo shkatërruar me dashje ndërtesat e së shkuarës komuniste, ky proces u shoqërua gjithashtu nga një lloj nostalgjie. Në Shqipëri nostalgjia për të kaluarën shkoi edhe më tej në kohë duke manifestuar një lloj individualizmi që ju mbivendos rregullit absurd të qytetit socialist në formën e shtesave adaptive dhe abuzive e cila më pas provokoi një etapë të re për qytetin me nisjen e fazës së rikualifikimit. Qytetarët janë përpjekur vazhdimisht të përmirësojnë mjediset e tyre të jetesës duke adaptuar por edhe nëpërmjet ndërtimeve të reja.

Jeta urbane kishte një rëndësi të veçantë në marksizëm, si një forcë progresive që inkurajonte identitetin kolektiv e jo individual, dhe planifikimi i qytetit shihej si një mjet i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve politike. Planifikimi qendror së bashku me pronësinë shtetërore të tokës do të thoshte se zhvillimi urban mund t'i nënshtrohet një kontrolli shumë më të madh se sa nën kapitalizëm. Struktura e brëndshme e qytetit socialist, duhej planifikuar për të lehtësuar shpërndarjen e një game të gjerë

shërbimesh sociale si mjet për konsum kolektiv, përveç lehtësimit të zhvillimit të planifikuar të forcave prodhuese në interes të funksionimit efikas të ekonomisë. Gjatë transformimeve post-socialiste, ish-qtetet socialiste shqiptare po përballen me shumë probleme që nganjëherë janë më shumë pjesë e politikës urbane sesa e modeleve arkitektonike. Problemet kryesore kanë në origjinën e tyre çështjen e demokratizimit të planifikimit urban dhe të procesit të vendimmarrjes gjë që na shtyn të mendojmë se në këto 30 vitet e fundit arkitektura shqiptare është në fazën e një konfuzioni, në kërkim të një strukturë estetike dhe morale të re ndaj qytetit e cila është ende në zhvillim.

Qyteti bashkohor sot gjendet nën presionin e ndërtimeve të reja - kryesisht administrative, qendra tregtare dhe hotele - janë ndërtuar në qendrat e të gjitha qytetet e mëdha post-socialiste. Gjithashtu, dalja nga sistemi i kontrolluar i migrimit dhe ulja e cilësisë së jetesës në qytetet me periferike, ka shkaktuar rritjen e periferive të kryeqendrave dhe qyteteve të mëdha. Si pjesë e proceseve të transformimeve urbane, vërejmë në të gjitha qytetet post-socialiste një kthim të ngadaltë të ndarjes sociale, pa përmendur problemin e vazhdueshëm të papunësisë që erdhi si pasoje e vështirësive për t'u integruar në tregun global, faktorë këto thelbësor që vënë në diskutim vetë egzistencën e tyre. Shtresëzimi përfaqëson një metodë të bashkëjetesës në Shqipërinë e sotme: realitete të ndryshme që jetojnë në të njëjtin territor. Ambienti urban dhe shoqëror shqiptar post-socialist, karakterizohet nga një evolucion i fazave të ndryshme të cilat shfaqen të ndara qartë, sikurse mund të vihet re se proceset në sejcilën prej fazave nuk janë kryer në mënyrë ezauruese. Siç pamë në rastin e Tiranës, përplasjet midis shtresave, epokave dhe regjimeve në të njëjtin mjedis urban, e vendos arkitekturën në një pozicion dëshmues të një bashkegzistence të dhimbshme të modernitetit me traditën në këtë pikë të globit. Gjenezat e raportimit aktual me territorin urban dhe më gjerë, mund të shihet tek historia e politikave totalitare të cilat nën ideale populiste të modernizimit, u orjantuan vazhdimisht drejt eliminimit të traditave ekzistuese, duke imponuar një stil të ri më të lavdishëm se i pari. Studimi i zonave homogjene të urbanistikës dhe arkitekturës totalitare, ndihmon në matjen e produktit kulturor dhe lehtëson studimin e çështjeve që lidhen me qytetin, si duke i trajtuar ato si teza ashtu edhe si antiteza për të testuar zhvillimet e së ardhmes. Kjo është edhe më e dukshme në ish-qtete industriale të themeluara të asaj periudhe, të cilat ende ruajnë stadin më të pastër të aplikimeve reale kundrejt teorive të lavdishme që impononte propaganda e atëherëshme.

Nga ana tjetër u tregua se suburbanizimi ishte një koncept i munguar në ish-planifikimin urban socialist. Në kushtin e kufizimit të zhvendosjes në qytetet e mëdha, popullsia e zonave të tyre suburbane u rrit për shkak të migrimit nga jashtë aglomerateve urbane, nga fshatrat dhe qytetet më të vogla. Në Shqipëri, suburbanizimi ka përfaqësuar një trend dhe një sfidë në 25 vitet e fundit që dëshmon edhe mbi kushtet e pabarazisë që sistemi krijoi si ndërmjet qytetit dhe fshatit ashtu edhe brenda vetes së vet ndërmjet qendrës dhe periferisë. Vërejtëm gjithashtu se ky trend i kishte rrënjët në zhvillimet gjatë socializmit kur diferencat më të mëdha u vunë re rreth viteve '80.

Problemet me tregun e tokës kanë ndikuar edhe në fizionominë e qyteteve të reja të socializmit. Mungesa e një tregu të tokës nënkupton mungesën e një mekanizmi efektiv për tranzicionin nga më pak ekonomik në atë më ekonomik të përdorimit të tokës. Si rezultat, industritë, fabrikat dhe magazinat e vendosura pranë qendrave të ish-qteteve industriale nuk kanë stimul ekonomik për t'u tërhequr jashtë

qytetit. Kështu, problemi më urgjent dhe dominues i zhvillimit të tregut të strehimit është përpunimi i një politike vendore gjithëpërfshirëse e më të orientuar drejt tregut. Qyteti i së ardhmes duhet të arrihet përmes rehabilitimit të kufijve që karakterizojnë qytetin e të tashmes.

Ruajtja historike e ish-qyteteve socialiste përbën gjithashtu një sfidë për të ardhmen e tyre. Këtu u tregua se në Shqipëri, ideja komuniste për të kaluarën ishte që ta ruante atë ashtu siç ishte, përfshirë marginalizimin prej pjesës tjetër të qytetit. E kaluara ishte aq e izoluar sa nuk mund të ndërvepronte me zhvillimet e reja urbane, dhe zhvillimet e reja nuk ishin të rrënjësura në të kaluarën. Në këtë mënyrë, e reja ishte diçka krejtësisht e ndryshme nga tradita dhe ndikoi në alienizimin e qytetit ndaj popullsisë lokale. Pavarësisht shkëputjeve kulturore që prezanton mjedisi urban, në Tiranë vërehen edhe disa vazhdimësi sidomos ndërmjet periudhave totalitare. Periudha socialiste në Shqipëri nuk ishte homogjene dhe huazoi modele jo vetëm nga fronti lindor dhe ish-Bashkimi Sovjetik, por edhe nga regjimet e mëparshme siç ishte fashizmi. Ata përvetësuan nga ndërtimet e mëparshme atë që u konsiderua si më e dobishme, por ndërkohë duke i zhbërë apo deformuar atyre kontekstin historik.

Kombinati i Tekstileve Stalin është shëmbulli më i realizuar i qytetit socialist në Shqipëri, i cili konkretizon një periudhë të shkurtër bashkëpunimit me ish-Bashkimin Sovjetik, por tepër të rëndësishme nga pikëpamja historike, sikurse edhe përcaktuese e zhvillimeve të mëvonëshme me arkitekturën dhe urbanistikën e regjimit. Në këtë tekst është propozuar një analizë kritike urbano-arkitektonike e cila merr fill prej kontekstit politik e duke gjetur lidhjet me linguistikën formale me të cilën komunikon arkitektura. Duke kryer këtë proces e duke ngritur një seri mjetesh analitike linguistike, procesi mund të inverteje vetveten. Arkitektura e qytetit socialist ka kapacitetin për të treguar më tepër se ç'dijme mbi atë periudhë, në momentin që konsolidohet një mënyrë adapte leximi. Sigurisht që përfshirja e elementit propagandistik i cili tejkalonte llogjikën racionale, bën të rëndësishme njohjen e instancave që karakterizuan zhvillimet e regjimit. Kështu tregimi për qytetin, nuk mund të shkëpusë faktet teknologjike, tipologjike e programatioko-funksionale prej ndikimit të faktorit politik, i cili duke mbivlerësuar elementin propagandistik, superoi në vendimarrje faktorin shkencor, racional të mendimit mbi ekonominë dhe qytetin.

Dilema kryesore që trashëgimia e këtyre qyteteve përfaqëson sot ka të bëjë me proceset e modernizmit social dhe ruajtjes historike. Në rastet e qyteteve të reja socialiste, qendrat e tyre ishin të parat që iu nënshtruan ndryshimeve demokratike edhe pse ishin ndërtuar për qëllime të tjera. Ndërtimi fillestar i qendrave historike apo shesheve të qytetit u bë për manifestime publike që mbështetnin regjimin. Identiteti i kaluar se bashku me përdorimin, nuk është më i dukshëm dhe tashmë është diçka e ndarë qartë nga epoka ku jetojmë. Me distancimin historik, këto dy realitete paralele sot po bëhen gjithmonë e më tepër të vazhdueshme. Nderkohe që vendasit, sidomos të rinjtë po humbasin kujtimet historike të lagjeve dhe të qyteteve të tyre. Ky fenomen që shfaqet si një eliminim i pandërgjegjshëm i të shkuarës së padëshiruar në fazat e transformimit, me deshtimet e urbanistikës bashkohore gradualisht po shnderrohet në të kundërtën e vet duke shkaktuar rikthime nostalgjike të cilat në mungesë të njohjes së fakteve, arsyeve dhe instancave politike që prodhuan një mjedis urban të caktuar, shnderrohet në interpretime kitch sa ironike po aq edhe të rrezikshme nga pikepamja e manipulimit të së shkuarës.

Gjysmë shekulli më parë u duk se modernismi socialist dha përgjigje për të gjitha problemet shqiptare të zhvillimit urban dhe ekonomik. Sot, peizazhi i qyteteve socialiste dhe lidhja e tyre me shumë probleme mjedisore kanë krijuar një hendek për ruajtjen historike dhe zhvillimet e ardhshme. E ardhmja e qyteteve shqiptare është shumë e lidhur me integrimin në BE të vendit, ndërsa sot urbanizmi dhe ekologjia janë lidhur më shumë me planet e zhvillimit. Sot BE ka shumë qasje ligjore, por akoma nuk ka një qasje me një sistem të unifikuar të ligjeve për urbanistikën dhe raportimit me territorin urban. Aq më tepër që, nuk gjejmë ende një agendë të përshtatshme për adresimin e problematikave të ish-qyteteve socialiste në nivel European, edhe pse territori që ato zenë brenda bashkësise është i konsiderueshëm. Sot ekologjia e qyteteve dhe orjentimi i ekonomisë drejt kursimit të resurseve përbejnë bazën e parimeve europiane mbi politikën e zhvillimit urban. Karta Aalborg, na shërbeu si model reference për parimet që duhet të përfshihen sot në përgjithësi në qëndrimin ndaj qyteteve.

Në të ardhmen e afërt ndryshimet kryesore në strukturën e përdorimit të tokës hapësinore të qyteteve post-socialiste ka të ngjarë të jenë:

1. Gentrifikimi i qendrave urbane, zgjerimi i tyre territorial dhe specializimi i brendshëm më i madh.
2. Nën-investime dhe, për rrjedhojë, rrënim i rrethinave fjetore (domethënë lagjet e karakterizuara nga ndërtimi masiv i banesave të standartizuara socialiste) në brezat e ndërmjetëm dhe të jashtëm urbanë si rezultat i riorientimit të investimeve dhe aktivitetit të ndërtimit në qendër dhe rrethinat prestigjioze.
3. Suburbanizimi - zgjerimi i qyteteve në zonat e afërta të gjelbërta”(Kostinskiy, 2001; 464).

Sipas Kostinskiy-t në të ardhmen, qytetet post-socialiste do të duhet të mbështeten në një shkallë më të lartë në resurset e tyre, bazën e tyre ekonomike dhe pozitën gjeografike, ku politika shtetërore e rishpërndarjes tashmë nuk ekziston më. Në vend të saj po shfaqet një skenar i konkurrencës intensive mes qyteteve, duke luftuar për investime, punë, zhvillim, dhe projekte prestigjioze. Në këto kushte duhet influencuar në ruajtjen e resurseve njëzore. Cilesia e kushteve të jetesës, siguria dhe ambienti i shëndetshëm janë ndër faktorët themelor që ndikojnë në vendimarrjen migruese të komuniteteve. Në këtë temë shfaqen ide revolucionare për rikonceptimin e strukturës së banimit siç ishte vizioni neotradicionalist i Robert Krier i krijimit të 'qyteteve brenda qytetit'. Sipas tij, blloku themelor i ndërtimit të qytetit policentrik është lagja autonome urbane, një qytet i vërtetë brenda një qyteti. Krier vë si komponent strukturor të kësaj ideje lagjen urbane, borgon, qytetin dhe metropolin. Njësi bazë është lagja urbane e cila është ndërtimi i shprehur i një komuniteti të interesave kolektive dhe individuale. Për Krier, është përbërësi themelor i çdo qyteti të vërtetë. Siç është një qytet brenda qytetit, kryesisht i vetë-mjaftueshëm, është gjithashtu anëtar i familjes së zgjeruar të qytetit fortesë dhe së fundi, metropolit. Në rastin e qyteteve shqiptare ende po kërkojmë qytetin brenda lagjes urbane, siç është rasti i Bllokut, ndërsa industritë virtuale dhe puna online po materializojnë një realitet të ri i cili duke zbehur influencën e çështjeve që kanë të bëjnë me lokacionin, po rizbulon qytetin në horizontalitetin e tij drejt zonave të reja të paisura me shërbime. Pavaresisht kësaj, vlera e qytetit, lagjes, komunitetit nuk do të reshti së egzistuari përderisa njeriu ka të njejtat kërkesa fizologjike dhe psikologjike. Moderniteti

perëndimor kalon përmes një rishikimi të vazhdueshëm të traditës ku gjen energjine dhe guiden për të parë drejt të ardhmes ku duam të shkojmë. Në këtë arsyetim, përmbajtja historike e qyteteve, qofshin këto edhe shembuj 'anti-historik' siç është trashëgimia socialiste, përbëjnë përsëri një ingredient esencial në amalgamën postmoderniste të qytetit bashkohor.

REFERENCES

- Akademia e Shkencave të Republikës Socialiste të Shqipërisë. Instituti i Historisë. (1988). *Historia e ndërtimit të socializmit në Shqipëri (1944-1975)*, 8 Nentori.
- Aliaj, B., Lulo, K., Myftiu, G. (2003). *Tirana the Challenge of Urban Development*, Cetus, ISBN 99927-880-0-3
- Baku, G. (2014). *Tirana e vjetër. Një histori e ilustruar*, Botimi i dytë, Mediaprint, ISBN 978-9928-08-101-8
- Bego, M. (2009). *Skeda arkitekture në kronikën e një jete të dallgëzuar 1965-2004. Mbi degradimin urban sot, Monografi: çështja e stehimit në periudhën e socializmit real*, DEA, ISBN: 978-99956-51-12-1
- Bertaud, A., Renaud, B. (1994). *Cities without land markets: lessons of the failed socialist experiment* (English). World Bank discussion papers; no. WDP 227 Washington, D.C.: World Bank Group. <http://documents.worldbank.org/curated/en/220721468739163461/Cities-without-land-markets-lessons-of-the-failed-socialist-experiment>
- Dobrenko, E., Naiman, E. (Eds.) (2003). *The Landscape of Stalinism: The Art and Ideology of Soviet Space*, University of Washington Press, ISBN-13 : 978-0295983417
- Bown, M.C., Taylor, B. (1993). *Art of the Soviets: Painting, Sculpture and Architecture in a One-Party State, 1917-1992: New Perspectives on Post-revolutionary Soviet Art*, Manchester University Press, ISBN-13: 978-0719037351
- Ching, D.K.F., Jarzombek, M., Prakash, V. (2011). *A global history of architecture*, Second edition, John Wiley & Sons, Inc, ISBN: 978-0-470-40257-3
- Czepczynski, M. (2008). *Cultural landscapes of post-socialist cities – representation of power and needs*, Ashgate, ISBN 978-0-7546-7022-3
- Dehaan, Heather D. (2013). *Stalinist City Planning – Professionals, Performance, and Power*, Toronto University Press, ISBN-13 : 978-1487521660
- Drançolli, F (2001). *Kulla shqiptare*. Prishtinë, ISBN
- Eftimi, T. & Alite, A. (1998). *Transformimi i imazhit të Tiranës. Përsëri në kërkim të identitetit të saj*, Perpjekja, Viti V, Nr.13 -14, Shtator – Dhjetor 1998, Marin Barleti, ISBN : 2073-4107
- Ellin, N. (2003). *Fear and city building. Fear itself*, The Hedgehog Review, Vol.5-No.3, ISBN: 978-0-00-823-570-3
- Stanilov, K. (Ed). (2007). *The post – socialist city. Urban form and space transformations in Central and Eastern Europe after socialism*. Dordrecht: Springer, ISBN 978-1-4020-6053-3 (e-book)
- Fagu, E.; Qorri, A. (2019) *Urban Transformations of Totalitarian Space in Tirana Skanderbeg Square*, International Journal of Science and Research (IJSR),

https://www.ijsr.net/search_index_results_paperid.php?id=ART20195404, Volume 8 Issue 2, February 2019, 1466 - 1477

Fagu, E., Nepravishta, F. (2020). *Modernisation and modernist architecture in Albania of the 20th century*. Third International Forum on Architecture and Urbanism, ISBN 978-9928-346-01-8

Ellin, N. (Ed). (1997), *Architecture of fear*, Princeton Architectural Press, ISBN-13: 978-1568980829

Fonyodi, M. (2008). *The orthogonal grid as the planned urban fabric*, Periodica Polytechnica Architecture, 39(1), pp. 19-25. <https://doi.org/10.3311/pp.ar.2008-1.03>

Freely, J. (2011). *A history of Ottoman Architecture*, Southampton: Wit Press, ISBN: 978-1-84564-506-9

Gazeta Shekulli. (2012). *Ish- punonjësit e Kombinatit të Sheqerit: Jemi aksionerë të mohuar*. Marrë online, 6 nëntor 2012. <http://shekulli.com.al/7514/>

Godoli, E. (2014). *La città socialista. Mutamenti delle prospettive critiche e problematiche della conservazione*, Forlì (Vol: 13-15), ISBN: 9788890927409

Godoli, E., Tramonti, U. et al. (2012). *Architetti e ingegneri italiani in Albania*, Edifir Edizioni Firenze s.r.l, ISBN: 978-88-7970-583-7

Gossop, Ch. (2006). *From Garden Cities to New Towns – An Integrative Planning Solution?*, Kongresi i 42-të, IsoCaRP, http://www.isocarp.net/data/case_studies/760.pdf

Graham, S., Marvin, S. (2001) *Splintering Urbanism: Networked Infrastructures, Technological Mobilities and the Urban Condition*, Routledge, ISBN 9780415189651

Groys, B. (2011). *The total art of Stalinism – Avant-garde aesthetic dictatorship, and beyond*, Verso, ISBN: 978-1-84467-707-8

Gutnov, A., Baburov, A., Djumenton, G., Kharitonova, S., Lezava, I., & Sadovskij, S. (1968). *The ideal communist city*, The MIT Press, ISBN-13 : 978-0262570534

Hoxha, E. (1964). *The facts about Soviet – Albanian relations*, Tiranë, Naim Frasheri State Publishing Enterprise. Marrë nga: <https://www.marxists.org/history/erol/albania/facts.pdf>

Hoxha, E. (1984). *Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re: kujtime dhe shënime historike*, Tiranë, Shtëpia Botuese 8 Nentori.

Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste(1981) *Historia e Partise së Punës*, Tiranë, Shtëpia Botuese 8 Nentori.

K.Marks, F.Engels (1968).*Manifesti i partisë komuniste*, N.I.SH 8 Nëntori. Tiranë, Stash 2204-65

Kargon, R. & Molella, A. (2008) *Invented Edens, Techno-cities of the twentieth century*, The MIT Press, ISBN: 9780262113205

- Kolevica, P. (2004). *Arkitektura dhe diktatura*, Botimi i dytë, Logoreci, ISBN: 99927-937-7-5
- Koolhaas, R., Brown, S., Link, J. (2004). *Content, OMA Project*, Taschen. ISBN: 3-783822830703
- Kopp, A. (1987). *Citta e rivoluzione. Architettura e urbanistica sovietiche degli anni venti*, Feltrinelli Editore, ISBN-13: 978-8807100840
- Kostinskiy, G. (2001). *Post – Socialist cities in flux*, f.470-484 në Handbook of Urban Studies, Roman, P. (Ed), Sage, ISBN: 0 8039 7695 X
- Krier, Leon. (2009) *The architecture of community*, Botimi i dytë, IslandPress, ISBN-13 : 978-1597265799
- Lubonja. F. (2007). *Blloku (pa nostalgji)*, Perpjekja Viti XII, Nr. 24, Marin Barleti, ISBN: 2073-4107
- Miglieccio, M.C. (2012). *Identita e architettura nell'esperienza albanese di Florestano di Fausto*, f.35-57, në Godoli, E., Tramonti, U. et al. Architetti e ingegneri italiani in Albania, Edifir Edizioni Firenze srl., ISBN: 978-88-7970-583-7
- Miho, K. (2003). *Shqipëria vështrim urbanistik 1912 – 1944*, Extra, ISBN 109992736380
- Miljutin, N. A. (1971). *Socgorod – Il problema dell'edificazione delle citta socialiste*, Botimi i parë, Milano, Il Saggiatore, EAN: 2560369081051
- Molnar, V. (2013). *Building the state: architecture, politics and state formation in postëar central Europe*, New York: Routledge, ISBN: 9780415622936
- Mosko, S., Sukaj, I. (1987). *Ndërtesa per veprimtari shoqerore – kulturore*, Tirana: Mihal Duri, OCLC: 47989626
- Muka, A. (2010). *Ndertimet tradicionale shqiptare si objekt studimi etnologjik*, f.510-518, Journal of Institute Alb-Shkenca. Vol. 3. Nr.4, ISSN 2073-2244
- Musil, J. (2005). *Why socialist and post-socialist cities are important for forward looking urban studies. Forward Look on Urban Science*, Helsinki 26-28 May 2005, marrë nga: <https://web.natur.cuni.cz/~simon1/Jiri%20Musil%20-%20Why%20socialist%20and%20post-socialist%20cities%20are%20important%20for%20forward%20looking%20urban%20studies.html>
- Paperny, V. (2002). *Architecture in the age of Stalin*, Cambridge University, ISBN: 978-0-521-29260-3
- Pauley, B. F. (2015). *Hitler, Stalin, and Mussolini: Totalitarianism in the Twentieth Century*, Sussex: Wiley-Blackwell, ISBN: 978-1-118-76592-0
- Pinder. D. (2013). *Reconstituting the Possible: Lefebvre, Utopia and the Urban Question*, f.28-45, International Journal of Urban and Regional Research. Vol 39 (1), DOI:10.1111/1468-2427.12083

- Prenushi, M. (1984). *Kolë Idromeno - jeta dhe vepra*, Shtëpia Botuese "8 Nëntori"
- Qendro, G. (2010, April 5) *Le surréalisme socialiste: l'autopsie de l'utopie*, Editions L'Harmattan, ISBN-13: 978-2343033440
- Riza, E. (2009). *Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare shek. XV-XIX*, Dita 2000, ISBN: 978-99943-57-94-9
- Rossi, A. (1982). *The architecture of the city*, The MIT Press, ISBN: 9780262181013
- Shkreli, A., Gjoni, D. (1997). *Tirana - ferri urban i fundshekullit të XX*, Perpjekja, Viti IV, Nr. 10, Mars – Gusht 1997, Marin Barleti, ISBN : 2073-4107
- Smith, D. (1996) *The socialist city*, f.70-99, në Andrusz, G., Harloe, M. & Szelenyi, I., *Cities after socialism – urban and regional change and conflict in post –socialist societies*, ISBN:9780470712733
- Stanek, L. (2011). *Henri Lefebvre on Space Architecture, Urban Research, and the Production of Theory*, University of Minnesota Press, Marre nga: <http://www.jstor.org/stable/10.5749/j.cttttxb>
- Storchi, S. (2007). *Il Fascismo E Una Casa Di Vetro: Giuseppe Terrangi and the Politics of Space in Fascist Italy*, f.231-245, Italian Studies 62 (2), DOI: 10.1179/007516307X227686
- Sulstarova, E. (2005). *Mbijetesa e perditshme nen Komunizem*, Perpjekja, Viti XI, Nr.21, Marin Barleti, ISBN : 2073-4107
- Tafari, M. (2007). *Progetto e utopia*, Editori Laterza, ISBN: 978-88-420-8399-3
- Thomo, P. (2012). *Korca – urbanistika dhe arkitektura*, Morava, ISBN: 978-99956-10-50-0
- Velo, M. (2013). *Betonizimi i demokracise*, UET Press, ISBN: 978-99956-39-97-6
- Vendim Nr. 447, datë 15.12.1962. *Mbi punën e Komiteteve Ekzekutive të Këshillave Popullor të qyteteve dhe mbi masat që duhen marrë për formimin e tyre të mëtejshëm*, AQSH
- Vickers, M. (2006). *The Albanians – a modern history*, New York, I.B. Tauris, ISBN: 978-1-78076-695-9
- Za, Luigi (2012). *Kombinat. Storia e vita quotidiana di un quartiere simbolo di Tirana*, Besa, ISBN: 978-88-497-0814-1
- Zevi, B. (2001). *Storia dell'architettura moderna*, Volume I, Giulio Einaudi, ISBN: 88-06-16903-3
- Zupancic, T. et.al. (2013). *Manual of Wise management, preservation, reuse and economic valorization of architecture of totalitarian regimes of the 20th century*, Municipality, ISBN 9616823329, 9789616823326

BURIME ONLINE

UNESCO Website -*The World Heritage Convention*, Marrë nga: <http://whc.unesco.org/en/convention/>

Open Data Albania, *General outlook of the environmental situation in Albania*. Marrë nga: <http://open.data.al/en/lajme/lajm/id/290/General-outlook-of-the-environmental-situation-in-Albania>

Qoraj, A. (2013). *Shkelqimi dhe renia e Cerrikut*, Gazeta Dita 1 dhjetor 2013. Marrë nga: <http://www.gazetadita.al/shkelqimi-dhe-renia-e-cerrikut/>

Rassam, S. (2001). *Kulla: A traditional Albanian House type in Kosovo*, Marrë nga: <http://www.unesco.org/archi2000/pdf/rassam.pdf>

Top Channel. *Concession of Cerrik plant*, 25 July 2013. Marrë nga: <http://www.top-channel.tv/english/artikull.php?id=9628>

Butterfield, A. (2003), *Monuments and Memories*. *New Republic*, Marrë nga: <http://www.newrepublic.com/article/monuments-and-memories>

Dervishi, K. (2017). 1946: *Ekzekutimi i grupit të inxhinierëve të Maliqit*, Marrë nga: <https://www.observatorikujteses.al/1946-ekzekutimi-i-grupit-te-inxhinierëve-te-maliqit/>

Deutsche Welle, *Albania struggles with environmental challenges*. 30.10.2012. Marrë nga: <http://www.dw.com/en/albania-environment-challenges/a-16343222>

Devole, R. (2014). *Kombinati (I)*. Pejsazhe të fjalës. Marrë nga: <https://peizazhe.com/2014/12/02/kombinati-i>

Ditchev, Ivaylo. (2015). *Kitsch-i ballkanik: Ç'ka Perëndimi, e kemi edhe ne*, Deutsche Welle. 12 Shtator 2015. Marrë nga: <http://www.dw.com/sq/kitsch-ballkanik-%C3%A7ka-per%C3%ABndimi-e-kemi-edhe-ne/a-18709628>

Kumriska, A. (2015). *Looking back: the ideal communist city*. *New Geography*. Marrë nga: <http://www.newgeography.com/content/004830-looking-back-the-ideal-communist-city>

Top Chanel. (2014). *Rikthehet fabrika e sheqerit ne Maliq*, Marrë nga: <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=281969>

Qendro, G., *Surrealizmi Socialist*, Marrë nga: <http://www.arkivalajmeve.com/Surrealizmi-Socialist.1046844005/>